1286

1941

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Koordinatori për të Drejtën e Informimit

Nr. 1143/1Prot. Tiranë, më 19.10.2018

Drejtuar: Z. Dorjan Matlija
Qendra "Res Publica"
Adresa Rruga "Bulevardi Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap 44 , kati 9.

TIRANË

I nderuar Zoti Matlija,

Lidhur me kërkesën tuaj, dërguar në adresën e Koordinatorit të KLSH-së protokolluar me nr. 1143, datë 08.10.2018, bashkëlidhur do të gjeni:

- Raportin e auditimit të ushtruar në drejtorinë e përgjithshme të harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik"

Lidhur me auditimin e kryer në:

- Bankën e Shqipërisë ju bëjmë me dije se ky auditim nuk ka përfunduar ende.
- Auditimi në Bashkinë Tirane për këtë vit do të nis së shpejti.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Luljeta NANO

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"MBI PËRPUTHSHMËRINË NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK"

Tiranë, Gusht 2018

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3-5**
II.	**HYRJA**	**5-6**
	Objektivat dhe qëllimi.	*5*
	Identifikimi i çështjes	*5*
	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	*5*
	Përgjegjësitë e audituesve	*6*
	Kriteret e vlerësimit	*6*
	Standardet e auditimit	*6*
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**6-7**
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**7-80**
	A. Mbi auditimin në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm	8-32
	B. Mbi auditimin në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit	33-64
	C. Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të mëparshëm	64-78
V.	**KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT**	**78-113**
VI.	**DOKUMENTE SHOQËRUESE**	**114**
	ANEKSE	**115-200**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

MBI ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE MFK E DH/KBFP

Në përfundim të auditimit të proceseve të punës, mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit konkludojmë se Drejtoria ka mangësi dhe dobësi në disa elementë të MFK. Kështu DH ka vendosur objektivat për vitin 2017 por pergjithesisht organizimi i strukturave AB dhe MFK rezulton të jetë jo i përshtatshëm për dimensionet dhe për karakterin e aktivitetit të Drejtorisë. Në DH/AB vendi i Drejtorit është vakant prej 6 muajsh dhe pozicioni i një specialisti ka qënë vakant për 3 muaj ndërkohë që Dejtoria parashikon rrezikun e mungesës së kapaciteteve si pengesë për realizimin e objektivave të saj. Delegimi i detyrave rezulton të jetë praktikë jo e rregulluar dhe e reflektuar në përshkriet e punës në kushtet kur një punonjës largohet. Të gjithë punonjësit janë në nivel specialisti pa hierarki raportuese apo eksperiences dhe rëndësisë së detyrave që ata kryejn. Ngarkesa e secilit punonjës sipas përshkrimeve ë punës nuk është rishikuar në mënyrë që të sigurojë ngarkesë të drejtë për secilin në funksion të eficensës së drejtorisë dhe cilësisë së produkteve së saj. Një punonjës kryen vlerësim të cilësisë së jashtme të AB, përpilon planet strategjike dhe vjetore të konsoliduara, trajnon në programin e certifikimit, merr pjesë në mbledhje të KKAB si anëtar, përpilon evidenca të konsoliduara për qëllim përpilimin e raportit vjetor, vlerëson dhe përpunon indikatorët e vlerësimit të aktivitetit AB etj. Ndërkohë që po sipas përshkrimeve të punës rezultojnë punonjës që kanë si detyrë vetem analizën e raporteve vjetore të AB (mars-maj) dhe azhornimin e faqes së internetit me njoftime dhe udhëzime urdhëra të nxjerra nga DH. Eshte ndërtuar rregjistri i risqeve por nga shqyrtimi i tij dhe i ngjarjeve të rëndësishme të ndodhura në sektorin publik gjatë vitit 2017 rezulton që ky rregjistër është një dokument pasiv dhe nuk është shqyrtuar në mënyrë dinamike nga DH/AB dhe MFK kjo me impakt lënien jashtë vëmëndjes dhe mosmenaxhimin e situatave si: ristrukturimi i Ministrive të linjës ku DH në rolin e saj udhëheqëse metodologjike duhej të kishte paraprirë me udhëzues efektet kontabël dhe financiare të këtyre ndodhive. Nuk është azhornuar ky rregjistër për të reflektuar efektet e qeverisë teknike në realizimin e objektivit të implementimit të sistemeve moderne pilot MFK. Objektiv ky i parealizuar. Nga DH është parashikuar risku i mungesës së kapaciteteve në burime njerëzore në lidhje me realizimin e objektivit të përmirësimeve ligjore dhe metodologjike në fushën e kontabiliteit publik por nga problematika e udhëzimeve të nxjerra, me shkelje dhe jo të harmonizuara ndërmjet tyre, që sjellin konfuzion në zbatimin e parimeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar, në gjykimin tonë duhet ti shtohet gjithshtu dhe risku i mungesës së profesionalizmit dhe ekpertizës. Mungojnë raportimet e brendshme dhe ato ndër-departamentesh kryhen vetëm me e-mail. Mbajtja e dokumentacionit të aktiviteteve ka mangësi të theksuara në plotësi, përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe siguri (backup). Nga vlerësimi i cilësisë së analizave që rezultojnë të thjeshta statistikore vërehet nevoja e trajnimit të punonjësve për mënyrat efikase të përdorimit të informacionit. dhe mbështetja me TI. Komunikimi brenda njësisë nuk është uniform; dhe stafi nuk është gjithmonë i vetëdijshëm për produktin/rezultatin e proceseve në të cilin ata kontribuojnë: rasti i përpunimit të pyetsorëve të vetëvlerësimit. DH ka përgatitur regjistrin e risqeve të proceseve por nuk gjejmë procedura të monitorimit të këtyre risqeve dhe kontrolle analitike në funksion të cilësisë së përmbushjes së objektivave. Pas viteve të para të ngritjes dhe konsolidimit si DH, shtylla e tretë e sistemit KBFP rrezikon të shndërrohet në një zyrë statistikore dhe e dedikuar për për procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm. Mbështetur nga një Bord KBFP pothuaj inekzistent DH duhet të bëjë një analizë të thellë për rolin e saj me qëllim identifikimin e risqkut strategjik të ekzistencës së saj.

MBI VLERËSIMIN E INDIKATORËVE QË TREGOJNË NIVELIN E ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE TË STATEGJSË PFM 2014-2020:

Vlerësimet e paraqitura në raportin vjetor të KBFP për ministritë e linjës janë përpiluar në kundërshtim me Pika II. Paragrafi 4 i Metodologjisë së vlerësimit të performancës së njësive publike". Duke u nisur nga referimi në opinionin e përgjithshëm, për efektivitetin, në gjykimin tonë, raportit i mungon një tregues efektiviteti për të 126 njësitë e marra në analizë dhe i llogaritur mbi bazën e rezultateve të performancës të 20 indikatorëve dhe treguesi 87% i efektivitetit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është përfaqësues i sistemit të qeverisjes së përgjithshme. Evidentohen mungesë të dhënash nga drejtoritë e Buxhetit dhe Thesarit, mungesë përgjegjshmërie menaxheriale me llogaritje dhe paraqitje që deformojnë rezultatin real të vlerësimit të sistemit të KBFP ndërkohë që Drejtorët e Përgjithshëm të këtyre Drejtorive janë dhe anëtarë të Bordit të Mbikqyrjes KBFP. Kemi konstatuar pasaktësi në në indikatorin "krijimi i detyrimeve të reja" ku MFE vlerësohet me 30 pikë maksimale për 0% fatura gjendje të papaguara më 31.12.2017. Për dy grup indikatorët e mësipërm, DH në rolin e saj si konsoliduese e të dhënave bën vetëm një përmbledhje mekanike të shifrave dhe një analizë të thjeshtë statistikore krahasimore me një vit më parë dhe në disa raste identifikon performuesin më të mirë apo më të dobët. Diferenca në treguesit e performancës së disa indikatorëve të paraqitur në raport; opinione të shoqëruar me referencë të komponentëve të vecantë të MFK dhe jo të sistemit KBFP në tërësinë e tij; aplikimi i kritereve pikësh maksimale të ndryshme për grupe të ndryshme njësish, paaftësi për të mbledhur të dhëna të plota për të gjithë grup-indikatorët sidomos ato në lidhje me zbatimin e Buxhetit; mungesa e aplikimit të faktorëve të rëndësisë për indikatorë të ndryshëm dhe jo aplikimi i një mesatareje të thjeshtë do ta bënte më të lehtë dhe transparente evidentimin e pikave të dobta të sistemeve të kontrollit duke rritur kështu vlerën e raportit në funksion të objektivit të tij ligjor

MBI MONITORIMIN E SISTEMEVE TË MFK DHE PËRGATITJA E RAPORTIT VJETOR PËR GJËNDJEN E MFK NË SEKTORIN PUBLIK:

Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e MFK nuk rezulton të ketë kryer dhe dokumentuar një analizën për përzgjedhjen e njësive që janë monitoruar, në disa njësi nukeshtë respektuar periudha e njoftimit paraprak; konkluzionet dhe vlerësimet në përqindje mbi mbi besueshmërinë e pyetësorëve nuk janë bërë pjesë e raportit të KBFP. Gjithashtu, vizitat në terren nuk janë shoqëruar me letrat e punës dhe dokumentime të tjera, në kundërshtim me aneksit 9 "Metodologjia dhe lista e kontrollit për vizitat në terren", pika 3. Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me pikën 2.2.2 të Manualit të MFK, monitorimet e njësive publike nga DH/MFK kryen në një periudhë shumë të reduktuar kohore (mars-maj) pra monitorimet kryhen vetëm për efekt të raportit vjetor, dhe jo si një monitorim i vazhdueshëm me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë, standardeve dhe udhëzimeve, i cili është një nga detyrimet kryesore të kësaj drejtorie. Pas përfundimit të monitorimeve në terren, rezultatet e tyre publikohen në raportin vjetor të KBFP, dhe më pas raportet i dërgohen njësive të monitoruara së bashku me pasqyrat e planit të tyre për zbatimin e rekomandimeve dhe implementimet në zbatim të përmirësimit të sistemeve të MFK. Në monitorimet e vitit 2016, raportet u janë dërguar njësive në Nëntor të vitit 2017, dhe në këto raporte, jo në të gjitha rastet ishte vendosur niveli i besueshmërisë pas monitorimit; nuk ishin plotësuar pasqyrat sipas së cilave punonjësit përgjegjës për monitorimin duhet të bëjnë dokumentim të krahasimeve të pyetësorëve të dorëzuar nga njësia me situatën reale; por ishin bashkëlidhur vetëm rekomandimet e lëna për njësinë. Konstatojmë se edhe për monitorimet e kryera për pyetësorët e vitit 2017, u ndoq e njëjta praktikë. Raportet në përfundim të monitorimeve nuk u dërguan në njësitë e monitoruara, nuk u protokolluan dhe nuk ju vunë në dispozicion grupit të auditimit deri në fund të këtij auditimi (qershor 2018).

MBI MBULIMIN ME AUDITIM TË BRENDSHËM, KAPACITETET E AUDITUESVE TË BRENDSHËM DHE EFICIENCA E STRUKTURËS AB

DH/AB, konstatohet se, nuk ka një analizë të plotë në sektorin publik nga ana e DH/AB për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që të paraqesin drejtë nivelin e shtrirjes së këtij shërbimi dhe cilësinë e tij në rang kombëtar Baza ligjore aktuale nuk sigurojnë pavarësinë, cilësinë e auditimit rrjedhimisht ngritjen e një strukture eficente dhe efektive në shërbim të mirëmenaxhit të fondeve publike. Në lidhje me planet strategjike dhe vjetore të konsoliduara, mungesa e evidentimit të ndryshimeve, mungesa e kontrollove të saktësisë së konsolidimit, mungesa e masave në ligj për rastet e mosdërgimit të planit strategjik dhe vjetor e bën proçesin e konsolidimit të planit strategjik një proçes formal dhe objektiv pjesërisht të arritur të Drejtorisë Harmonizimit të AB. Nga shqyrtimi i evidencave të vëna në dispozicion rezultojnë 22 njësi me 1 auditues dhe 26 njësi me 2 auditues pra gjithsej 48 njësi të ose 40% e sistemit AB janë në shkelje të Ligjit nr.114/2015 dhe nuk garantojnë kontrollin e brendshëm të cilësisë. Përfshirë këtu dhe 15 me eficiensë shumë të ulët (zero rekomandime apo gjetje) e con në 53% të sistemit shkallën e NJAB-ve ku sistemi i sigurimit të cilësisë mungon ose nuk funksion, rrjedhimisht ky sistem është ineficent. Shkelje të përhapura të ligjit nr.114/2015 dt. 15.10.2015, neni 11 në ngritje të strukturave AB dhe VKM nr.83 dt. 3.2.2016, në punësimet jo sipas kritereve ligjore dhe formale kanë shkaktuar ineficensë të sistemit të auditit të brendshëm duke mos realizuar qëllimin dhe detyrimin ligjor dhe duke shpenzuar në mënyrë jo eficente fondet publike të vëna në dispozicion. Referuar treguesit të dobishmërisë së aktivitetit të AB 14.9 leke/ 1 lekë të shpenzuar duke përfshirë këtë një gjetje të Ministrisë së Ekonomisë dhe Infrastruktures. Nëse kjo gjetje me dëm ekonomik do të përjashtohej nga llogaritja treguesi i dobishmërisë për gjithë sistemin AB (118 njësi) do të ishte 3.4 lekë /1 lekë kosto auditimi të shpenzuar. Në shkallë sistemi niveli i shkeljeve të konstatuara është më i ulët se viti 2016 me vetëm 1.819.500 mijë lekë ose më i ulti në 5 vitet e fundit. Edhe në numër 6.286 rastet e konstatuara për gjatë vitit 2017, janë më të ulta se numri prej 9.421 rastet e raportuara për vitin 2016. MIE përbëhet nga 8 audituesi e cila ka konstatuar 6,029,000 mijë lekë gjetjeve me dëm ekonomik në gjithsej 38 auditime të realizuara gjatë vitit 2017, ndërsa pjesa tjetër e gjetjeve me dëm ekonomik prej 1,819,500 mijë lekë i përket 118 NJAB të tjera që në përbërje të tyre kanë 392 audituesi dhe kanë realizuar 1322 auditime, e për rrjedhojë niveli i dëmeve të konstatuara për një auditim është 1,376 mijë lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 301/1, datë 19.03.2018 miratuar nga Kryetari i KLSH, ndryshuar me shkresën nr. 301/2 datë 28.05.2018, në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për periudhën nga 01.01.2017 deri ne 31.12.2017 u krye auditimi "Auditim përputhshmërie" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. V. G, Përgjegjës Grupi
2. P.B, Auditues
3. A.K, Auditues
4. J.T, Auditues

Titulli: Auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Marrësi: Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

Objektivat dhe qëllimi: Dhënia e opinionit të përputhshmërisë mbi aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Publik për vitin 2017 në lidhje me kuadrin rregullator në fuqi. Vlerësimi nëse aktivitetet dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.

Identifikimi i çështjes: Ligji përcakton Ministrin e Financave përgjegjës për: a) bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së auditimit të kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm dhe komiteteve të auditimit në sektorin publik, duke i propozuar Këshillit të Ministrave nxjerrjen e aktit nënligjor për këtë qëllim; c) miratimin e politikave, manualeve, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditimit të brendshëm për përshtatjen dhe përafrimin e tyre me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të auditimit të brendshëm; ç) emërimin dhe lirimin nga detyra të anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, sipas të nenit 21 të këtij ligji; d) paraqitjen në Këshillin e Ministrave, brenda muajit maj të çdo viti, të raportit vjetor për auditimin e brendshëm, si pjesë e raportit vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik. Për të ushtruar këto përgjegjësi, Ministri i Financave mbështetet nga Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm dhe menaxhimin e sistemit buxhetor. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Kriteret e vlerësimit.Për kryerjen e këtij auditmi, në lidhje me dhënien e opinionit për përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit jemi bazuar në Ligjin nr. 10 296 dt. 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar me Ligjin 110/2015 dt. 15.10.2015, Ligjin nr. 114/2015 dt. 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik", Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe urdhërat dhe udhëzimet specifike në lidhje me to.
Standardet e auditimit: Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit të

Përputhshmërisë, Rregulloren "Për Procedurat e Auditimit" miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, referenca të tjera ligjore dhe në referencë të Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm: Auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik u krye në kuadër të planifikimit fillestar të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar.

Objekti i këtij auditimi është vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të vitit 2017 i subjektit të audituar me kriteret e përcaktuara të vlerësimit.

Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me aktivitetin dhe raportimin për efekt të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, auditit të brendshëm dhe buxhetit.

Fushëveprimi i këtij auditimi përfshin të gjithë aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik e cila ka si mision të saj harmonizimin e standardeve, rregullave dhe procedurave në kryerjen, monitorimin dhe raportimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe të menaxhimit e kontrollit financiar në sektorin publik me funksionin kryesor të saj: rregullimin, monitorimin, dhe raportimin mbi veprimtarinë e auditimit në përgjithësi dhe të menaxhimit financiar dhe kontrollit në veçanti, si dhe kualifikimi dhe certifikimi i profesionistëve auditues. Kjo drejtori ka në varësi të saj 2 (dy) Drejtori: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm. Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar raporton tek Nëpunësi i Parë Autorizues (Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë). Gjithashtu kjo drejtori vepron si sekretariat i Bordit të Mbikëqyrjes së Kontrollit Brendshëm të Financave Publike (KBFP)

Çështjet kryesore të Auditimit: Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje të cilat në gjykimin tonë, kanë rezultuar më të rëndësishmet në bazë të vlerësimit të risqeve të identifikuara në fazën e parë të auditimit si dhe çështjeve të dala gjatë auditimit mbi aktivitetin e Drejtorisë së Harmonizimit të auditit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe kontrollin.
Çështjet kryesore në auditimin e aktivitetit të Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2017, paraqiten si më poshtë:

I. Në lidhje me Drejtorinë e Harmonizimit të AB:
1. Aktiviteti i Drejtorisë DH/AB në lidhje me hartimin e planit strategjik 2017-2019 të konsoliduar dhe planin vjetor 2017
2. Mbi krijimin e njësive të AB dhe mbulimi me auditim prej tyre dhe eficenca e strukturës AB
3. Mbi procesin e cretifikimit të audituesve të brendshëm dhe trajnimi i vijueshëm i detyrueshëm
4.Mbi organizimin dhe funksionimin e Komiteteve të auditimit

II. Në lidhje me Drejtorinë e Harmonizimit të MFK
1.*Mbi llogaritjen e efektivitetit të sistemit të kontrollit brendshëm financiar publik në Raportin vjetor KBFP*
2.Mbi zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të performancës, cilësisë, saktësisë dhe transparencës së të dhënave të paraqitura në Raportin vjetor,
3.Mbi çështje të harmonizimit dhe zhvillimit të standardeve të kontabiliteti publik
4.Mbi monitorimet dhe pilotimet e kryera nga DH/MFK sipas ligjit nr. 10296 dt. 8.7.2015 i ndryshuar

5.Mbi saktësinë e përpunimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit për komponentët e sistemit MFK

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. GJETJET DHE REKOMANDIMET NË AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E HARMONIZIMIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM:

DH/AB zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizuar në fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar. Gjatë auditimit u mor në shqyrtim aktiviteti DH/AB i paraqitur në Analizën vjetore të punës për vitin 2017, konkluzionet dhe opinioni i DH/AB i paraqitur në Raportin vjetor të vitit 2017 të sistemit financiar të brendshëm publik mbi funksionimin dhe progresin e sistemit AB në sektorin publik. I menaxhuar në mënyrë efektive, auditimi i brendshëm bëhet një element i rëndësishëm për të ndihmuar një njësi të arrijë objektivat e saj. Njësitë publike që kanë të ngritur strukturën e auditimit të brendshëm janë më të aftë të identifikojnë rreziqet e biznesit dhe joefikasitetin e sistemit, të ndërmarrin veprime korrigjuese të përshtatshme dhe të mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm. Megjithatë, për të ruajtur dhe përmirësuar kredibilitetin e auditimit të brendshëm, këto njësi duhet të monitorohet për efikasitetin dhe eficensen e saj. Për këtë qëllim është shqyrtuar dokumentacioni mbi aktivitetin dhe rolin e DH/AB për monitorimin e veprimtarisë AB sipas treguesve të efektivitetit dhe eficensës së AB: Profesionalizmi, cilësia e auditimit, pavarësia organizative, niveli i gjetjeve dhe rekomandimeve.

3.1 Mbi mbulimin me auditim të brendshëm, organizimi dhe shtrirja e NJAB-ve në sektorin publik *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)*

Nga auditimi për organizimin dhe funksionimin e DH/AB, konstatohet se, nuk ka një analizë të plotë në sektorin publik nga ana e DH/AB për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që të paraqesin drejtë nivelin e shtrirjes së këtij shërbimi dhe cilësinë e tij në rang kombëtar.

Situata:

Raporti i pasqyruar nga DH/AB mbi sistemin dhe mbulimin me auditim për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme është bazuar vetëm në 119 njësi (entitete publike) dhe pa patur një analizë për një mbulim të plotë lidhur me këtë funksion. Nuk përcaktohen kapacitetet audituese dhe mbulimi me auditim në shkallë sistemi me njërën nga format e përcaktuara në nenin 10 "Organizimi i shërbimit të Auditimit të Brendshëm" të Ligjit 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik*" dhe në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*", i ndryshuar pikat 1 dhe 7, ku përcaktohet se "*Njësitë publike brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të bëjnë organizimin e njësive të auditimit të brendshëm*", kështu nuk arrijmë të shprehemi me bindje sa % të njësive që duhet të mbulohen me shërbim auditimi të brendshëm përfaqëson nga numri 119 mbi të cilën përgatitet raporti vjetor.

Në kampionin prej 106 njësish që financohen nga Buxheti i Shtetit ku përfshihen Ministritë, Institucionet e Pavarura të ngritura me ligj si dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, u konstatua se në 24 prej tyre nuk ka mbulim me shërbimin e auditimit të brendshëm në njërën nga format e përcaktuara nga ligji. Kështu në 9 Bashki si Poliçan, Has, Pukë, Konispol,

Rrogozhinë dhe Delvinë nuk ka struktura të AB ndërsa në 3 Bashki Cërrik, Belsh dhe Kurbin, është miratuar ngritja e strukturës AB, por nuk ka filluar plotësimi i strukturës përkatëse me auditues, fakt që tregon se 18% të njësive të pushtetit vendor nuk kanë mbulim me shërbim AB, ky tregues është më i lartë 30% nëse do të merrnim në konsideratë njësitë e qarkut dhe të prefekturës (12 njësi).

Në 15 Institucione të Pavarura, konstatohet se nuk ka mbulim me shërbimin e auditimit të brendshëm në një nga format e parashikuara në ligj.

Kriteri: Ligji 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik*". VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*", i ndryshuar

Impakti: Mosfunksionim të auditimit të brendshëm në të gjitha njësitë e qeverisjes, me impakt negativ në mirëadministrimin e fondeve dhe ngritjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm për parandalimin e rasteve korruptive apo detektimin e tyre në kohë.

Shkaku: DH/AB nuk ka kryer një analizë të plotë në shkallë sistemi lidhur me funksionimin e auditit të brendshëm në funksion të përgjegjësive të saj përsa i takon monitorimit të auditit të brendshëm.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj, të analizojë mbulimin me auditim të brendshëm për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme me njërën nga format e përcaktuara në bazën ligjore dhe të marrë një rol aktiv për të garantuar që ky shërbim të shtrihet në gjithë sektorin publik.

Observacion i subjektit:

Gjatë hartimit të bazës rregullative për auditimin e brendshëm në sektorin publik, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DH/AB) në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë të Projektit të Binjakëzimit Austriako – Francez kanë analizuar në mënyrë të detajuar gjithë njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Mbas analizës së rezultateve u evidentua se në sektorin publik mund të krijohen 135 NJAB. Në përcaktimin e këtij numri të njësive përfshihen dhe 61 Bashki, të cilat përfaqësojnë njësitë e qeverisjes vendore. Aktualisht rezulton se disa prej këtyre Bashkive e kanë të pamundur nga ana financiare të krijojnë njësi auditimi të brendshëm. Në të tilla raste, duke qenë se ligji prevalon mbi aktet nënligjore (pika 1 e nenit 10 të ligjit nr. 114/2015), këto Bashki janë lejuar të lidhin aktmarrëveshje me njësi të tjera auditimi (bashki me buxhet dhe staf të madh e më të konsoliduara), për realizimin e këtij shërbimi. Nga të dhënat e përditësuara (mbas analizës së raportit vjetor) vetëm 7 nga 61 Bashki nuk e realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm. Gjykojmë se realizimi i një analize të re është i panevojshëm, por nga ana e DH/AB do të intensifikohet puna për monitorimin e vazhdueshëm të kësaj situate.

Komenti i grupit të auditimit:

Observacioni nuk pranohet pasi, realizimi i një analize të re është gjithnjë i nevojshëm, për më tepër kurë vazhdon të ketë probleme në realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, probleme të cilat janë trajtuar në raportin e paraqitur nga ana jonë.

3.2 Në lidhje me pavarësinë e strukturave të audituesit të brendshëm në sektorin publik
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)

Situata: Si një tregues tepër i rëndësishëm i cilësisë së auditimit dhe eficiensës së strukturës së AB, gjatë auditimit është shqyrtuar Ligji për Auditin e Brendshëm në sektorin publik" dhe Ligji nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe përmirësimet që këto ligje kanë pësuar me ndryshimet e bëra gjatë vitit 2015. Një përmbledhje e neneve kryesore ku në gjykimin tonë cënohet apo rregullohet pavarësia e strukturës së AB është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Nga analiza e tabelës, konkludojmë se ndryshimet dhe përmirësimet ligjore kanë forcuar dhe theksuar kompetencat e titullarëve për shërbimin e auditimit të brendshëm por nuk sigurojnë pavarësinë, cilësinë e auditimit rrjedhimisht ngritjen e një strukture eficente dhe efektive në shërbim të mirëmenaxhit të fondeve publike.
Shkrirja e një strukture të përgjithshme si Komiteti AB dhe krijimi i një Bordi "Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" sipas nenit 28 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 " Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me funksion "*Në Ministrinë e Financave ngrihet Bordi i KBFP, me detyrën e mbikëqyrjes së çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm, në sektorin publik", ndërkohë që konstatohet një* aktivitet minimal (2 mbledhje), me struktura në vetevete me konflikte të funksioneve operacionale dhe mbikëqyrëse nuk siguron mbikqyrjen e strukturave AB. I mbështetur me strukturën e DH/AB, sistemi AB monitorohet me akord vetëm për efekt të përpilimit të Planit të Konsoliduar Strategjik (Nëntor-Dhjetor) dhe për efekt të përpilimit të Raportit vjetor të KBFP (Shkurt- Maj).

Ligji 114/2015 AB dhe Ligji 10296 MFK i ndryshuar	**Ligji nr.9720/2007**	**Komenti i audituesit**
Neni 23: Përgjegjësitë e **Ministrit të Financave**. Për të ushtruar këto përgjegjësi, Ministri i Financave mbështetet nga **Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik** dhe **struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB** në Ministrinë e Financave Neni 24 Përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB: a) zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizuar në fushën e AB, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar; b) harton dhe propozon përmirësimin e legjislacionit kryesor dhe mbështetës për AB në sektorin publik; c) harton dhe propozon politikat, manualet, procedurat, udhëzimet dhe rregulloret për AB për përshtatjen dhe përafrimin e tyre me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të AB; ç) përgatit dhe administron planin e konsoliduar strategjik e vjetor të veprimtarisë	Neni 12 Statusi i Komitetit: Komiteti i AB është organ këshillimor pranë Ministrit të Financave. Komiteti propozon dhe këshillon për përcaktimin e strategjive dhe përmirësimin e veprimtarisë së AB, në sektorin publik. Neni 13: Detyrat e Komitetit janë: a) përgatitja dhe dhënia e vlerësimeve e të mendimeve për metodat e AB, të propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit; b) vlerësimi dhe dhënia e mendimeve për kuadrin, ligjor dhe rregullator, të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit në fushën e AB, në sektorin publik; c) vlerësimi dhe dhënia e mendimeve për raportet,	Ndryshimi ligjor që shkrinte Komitetin e Auditimit të Brendshëm në rang sistemi kaloi përgjegjësinë e krijimit të Komiteteve të Auditimit te çdo njësi individuale si kompetencë e titullarit. Kjo me qëllimin e synuar të **rritjes së eficensës** së strukturës së KAB dhe rolin e saj si mbështetëse e NjAB për të siguruar **pavarësinë dhe shmangien e konfliktit të interesit.** Por në të njëjtën kohë me ligjin vitit 2015 duket që një pjesë e funksioneve të KAB i kanë kaluar Bordit të KBFP I ngritur me anëtarë që kryejnë funksione operacionale në lidhje me AB.

së AB në njësitë publike; dh) harton dhe zbaton manualin për vlerësimin e cilësisë, e cila përfshin procesin e monitorimit dhe vlerësimit në **mënyrë periodike** të veprimtarisë së njësive të AB, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të AB; e) administron metodat e hartuara, në mbështetje të manualit të auditimit, për fusha specifike të AB të paraqitura nga njësitë e AB; ë) analizon rekomandimet e dhëna në raportet vjetore të njësive të AB; Ligji 10296 Neni 28 **Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik**. Në Ministrinë e Financave ngrihet Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, me detyrën e mbikëqyrjes së çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin **dhe auditimin e brendshëm**, në sektorin publik.	tremujore dhe vjetore, të veprimtarisë së AB në subjektet e audituara, të paraqitura nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për AB; ç) këshillimi i Ministrit të Financave dhe Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në të gjitha aspektet e planeve dhe të punës së AB, në përshtatjen e praktikave ndërkombëtare të auditimit, në cilësinë dhe funksionimin e AB në subjektet e audituara	Vlerësimi i veprimtarisë së AB në ligjin e ri është kufizuar në vetëm 1 raportim, atë vjetor.
Neni 11 punësimi i audituesit të brendshëm bëhet në përputhje me dispozitat e punësimit të nënpunesit civil dhe kodit te punës		Vendimmarrje e titullarit
Neni 10 pika 1 ngarkohen njësite publike te krijojne sherbimin e AB		Përgjegjësi e titullarit
Neni 10 pika 2 njësia e auditimit të brendshëm është e pavarur dhe raporton te titullari.		Konflikt interesi; punesim-raportim.
Neni 12 përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike. Ata janë përgjegjës për krijimin e njësive të auditimit, vendimmarrjen për politikat dhe strategjinë e auditimit		Titullari miraton/aprovon planin e auditimeve
Neni 16 pika ë: Përgjegjëse e audituesit të brendshëm: raporton te drejtuesi i njësisë së auditimit nëse vëren parregullsi apo veprime që përbëjnë vepër penale.		

Rëndësia:

Gjithashtu Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Financave, bazuar në nenet 10 e 26 të LAB, ka nxjerrë VKM nr. 83, datë 03.02.2016 për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm ku përcaktohen kriteret e krijimit të NJAB, organizimi e funksionimi i tyre dhe mënyra e sigurimit të shërbimit të auditimit nga njësitë publike që nuk i kanë ngritur këto struktura. Në fjalinë e dytë të pikës 3, të këtij vendimi është përcaktuar se: "*Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik*.", çka do të thotë se, në çdo kohë në strukturat e auditimit të brendshëm në shkallë sistemi, mund të punësohen mbi 143 auditues të brendshëm të paçertifikuar ose në 3 auditues njëri mund të punësohet i pacertifikuar. Ky përcaktim bie në kundërshtim me germën "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", dhe tejkalon kompetencat e Këshillit të Ministrave i cili sipas nenit 26, të këtij ligji, detyrohet të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 10, 13, dhe 22, por ***jo në zbatim të nenit 11***, ku përcaktohet punësimi i audituesit të brendshëm.

E lartë

Rekomandimi: Kjo situatë kërkon vëmendjen e menjëhershme të Bordit dhe strukturës DH/AB për të bërë analizë dhe propozime konkrete për përmirësime ligjore në funksion të shndërrimin e të sistemit AB në një vlerë e shtuar për sektorin publik dhe jo për tja lënë në dorë çdo gjë ndërgjegjësimit të titullarëve nëpërmjet trajnimeve. Këto përmirësime duhet të prekin komponentët:

- Përgjegjësisë së titullarit për krijimin e njësisë AB në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Veçanërisht për njësitë e qeverisjes vendore që shpesh janë njësi të vogla me pamundësi për të ngritur NjAB me tre punonjës të merret në konsideratë bashkimin dhe krijimi i njësive të AB në rrang qarku me staf të mjaftueshëm dhe hierarkik që siguron pavarësinë, objektivitetin dhe cilësinë e auditimit.
- Kriteret e punësimit duke ndryshuar (ulur) raportin 1/3 të audituesve të pacertifikuar për të shmangur emërime të AB pa eksperiencën e duhur, shpesh vetëm për qëllim të plotësimit të kriterit për të marrë çertifikatën e AB apo të emërimeve formale "me komandim" për një periudhë të përkohshme.
- Parashikimin e dispozitave shtrënguese si masa disiplinore dhe organizative në funksion të zbatimit të Ligjit 114/2015 dhe Ligjit 10296 dt. 8.7.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 dt. 22.10.2015
- Rikonceptimi i Bordit të KBFP dhe vetë Drejtorisë së Harmonizimit të AB për një monitorim me impakt real në zhvillimin dhe administrimin e strategjive të sistemit AB në përputhje me kërkesat ligjore dhe strategjinë e MFP 2014-2020.

Observacion i subjektit:

a*. Referuar nenit 12 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" gjykojmë se janë përcaktuar shumë qartë përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike. Theksojmë se përgjegjësia dhe përgjegjshmëria para ligjit është detyrim i të gjithë shtetasve. Para këtij detyrimi ligjor nuk mund të dalin kompetencat dhe përgjegjësitë e DH/AB.*

b*. Në nenin 11 të ligjit nr. 114/2015, është lejuar që 1/3 e përbërjes së NJAB mund të jenë me 3 vjet në profesionin përkatës dhe të pacertifikuar, kjo për faktin se:*

- *në regjistrin kombëtar të audituesve të brendshëm janë të përfshirë persona që nuk e kanë përdorur këtë certifikatë prej vitesh;*
- *Aktualisht strukturat ekzistuese të AB kanë në përbërjen e tyre auditues me përvojë, por që një numër i konsiderueshëm i tyre janë në përfundim të karrierës në sektorin publik;*
- *Përdorimi gjithnjë e më tepër i njohurive të teknologjisë së informacionit (auditimet TI);*
- *Nevoja e ngutshme për auditues me njohuri të mira të gjuhëve të huaja (për auditime specifike të projekteve me fonde IPA)*

Të gjitha këto arsye e bëjnë të domosdoshme hapjen e këtij procesi për të rinjtë, për sjelljen e një fryme të re në këtë shërbim aq të nevojshëm dhe të rëndësishëm për çdo njësi publike.

c.*Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik kryhet në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm (IIA). Sipas këtyre standardeve dhe bazuar në kuadrin rregullator, auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavaruar që jep siguri objektive dhe ofron*

këshilla për titullarët e njësive publike. Në fokus të veprimtarisë audituese nuk janë dëmi ekonomik dhe masat disiplinore ose organizative, por vlerësimi i riskut dhe i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe dhënia e sigurisë objektive për titullarët.

d. *Bazuar në ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, është përcaktuar se çdo ministri linje mund të krijojë Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Ky organ jep titullarit garanci të arsyeshme për mënyrën e funksionimit të njësisë publike dhe mbështet njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj. Roli dhe autoriteti i Komitetit të Auditimit të Brendshëm përcaktohet në Kreun I të VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike", kurse veprimtaria e Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik përcaktohet në nenin 28 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Këto dy organe funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Në këtë mënyrë nuk ka vend për rikonceptim. Në lidhje me sugjerimin tuaj për rikonceptimin e DH/AB, ju bëjmë me dije se nga ana jonë do t'i bëhet prezent menaxhimit të lartë në momentin e ndryshimit të strukturës organizative të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por vendimmarrja për këtë proces është kompetencë e menaxhimit.*

Komenti i grupit të auditimit:

a.*Observacioni nuk pranohet pasi, fakti që në disa njësi publike nuk janë ngritur strukturat e AB, apo nuk është realizuar shërbimi i AB në përputhje me kërkesat e ligjit, e bën të nevojshme përcaktimin me ligj të përgjegjësisë që duhet të ketë titullari i njësisë publike.*

b. *Observacioni nuk pranohet pasi, KLSH nuk ka kërkuar kufizimin e futjes së elementit të ri në strukturat e AB, por ka kërkuar heqjen e kufizimit të raportit, 1/3 e përbërjes së NJAB mund të jenë punonjës të pa certifikuar, kufizim i cili është vendosur me VKM nr. 83,datë 3.2.2016, pika 3, pasi bie në kundërshtim me nenet 11dhe 26, të Ligjit 114/2015 për AB.*

c. *Observacioni nuk pranohet pasi, KLSH për lënien e këtij rekomandimi është mbështetur në rekomandimet dhe propozimet që NJAB kanë bërë për titullarët e tyre në shumë raste. Në asnjë rast nuk jemi shprehur për cenimin e standardeve ndërkombëtare të AB, tashmë të pranuara, por gjykojmë se duhen mbajtur parasysh edhe praktikat më të mira të auditimit shoqëruar edhe me propozime të argumentuara për nisjen e procedurave disiplinore për rastet e parregullsive që konstatohen.*

d. *Observacioni nuk pranohet pasi, KLSH ka patur parasysh gjithë veprimtarinë e atyre pak KAB-ve dhe bordeve të KBFP që janë krijuar, si dhe vështirësitë e krijuara lidhur me realizimin e të gjitha përgjegjësive dhe funksioneve që ligji i ka ngarkuar në nenin 24, strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB. Në gjykimin tonë me këtë organizim dhe funksionim të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB, është e pamundur të realizohen detyrat dhe të ushtrohen funksionet që i ka përcaktuar ligji.*

3.3 Mbi Komitetet e Auditimit dhe aktivitetin e tyre
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)

Situata: Në nenin 13, pika 2 të Ligjit nr. 114/2015, është përcaktuar se: "*Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë*" dhe në pikën 3 është përcaktuar se: "*Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave*". Në zbatim të kësaj pike, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komiteteve të Auditit të Brendshëm një njësitë publike*", ku janë përcaktuar roli dhe autoriteti i Komitetit të AB, përbërja dhe funksionimi, si dhe kompetencat dhe raportimi. Në Kreun II-të "*Përbërja dhe funksionimi i KAB*", të këtij vendimi, pika 2, është përcaktuar se, "*Njësitë publike, të cilat kanë varësi funksionale nga një organ epror dhe kanë në strukturën e tyre NJAB nuk krijojnë komitete, por mbikëqyren nga komiteti i organit epror*".

Në pikën 3, të kreut të III-të këtij Vendimi, ku janë përcaktuar kompetencat dhe raportimi i Komitetit të Auditimit është cilësuar se: "*Komiteti i Auditimit të Brendshëm duhet të përgatisë, në fund të çdo viti, një raport përmbledhës për titullarin e njësisë publike, për veprimtarinë vjetore të komitetit*."

Nga sa më sipër konstatohet se, as në ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 dhe as në VKM nr. 160, datë 02.03.2016, *nuk janë përcaktuar kritere të qarta dhe të matshme për krijimin e Komiteteve të Auditimit, duke e lënë në vullnetin e titullarëve të institucioneve, si dhe nuk cilësohet detyrimi i tyre për të raportuar në DH/AB në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*.

Megjithëse në auditimin e vjetshëm, u kërkua që DH/AB të kishte një rol aktiv në ngritjen dhe mirëfunksionimin e Komiteteve të Auditimit si një instrument që do të siguronte pavarësinë e strukturave dhe aktivitetit të audituesve të brendshëm, konstatohet se nuk ka hapa apo masa konkrete. Gjykojmë se DH/AB nuk ka arritur të kuptojë drejt rolin e saj udhëheqës dhe monitorues së këtij sistemi të rëndësishëm. Për rrjedhojë megjithëse kanë kaluar mbi tre vite nga miratimi i ligjit të ri, janë krijuar vetëm 8 Komitete Auditimi, nga të cilat 5 prej tyre kanë raportuar në DH/AB. Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka arritur ta vendosi në funksionim Komitetin e Auditimit.

Raporti vjetor i përgatitur nga DH/AB nuk ka një analizë të plotë, referuar këtij "instrumenti" aktivitetit të Komiteteve të Auditimit, fakt që përforcon edhe njëherë sa perceptuam ne nga ky auditim, lidhur me rolin udhëheqës që struktura e DH/AB ka.

Kriteri: Ligji 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik*" ; VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komiteteve të Auditit të Brendshëm në njësitë publike*"

Impakti: Mungesa e pavarësisë së strukturave të AB me impakt të rëndësishëm në arritjen e objektivave të vendosura në Ligj. Objektivi i ligjit i paarritur.

Shkaku: DH/AB nuk ka vepruar në funksion të përgjegjësive të saj për sigurimin e funksionimit të instrumentave që garantojnë pavarësinë e strukturave dhe efiçencë të sistemit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Plotësimi i bazës rregullative ligjore me përcaktimin e institucioneve që duhet të ngrejnë Komitete Auditimi, afatet për krijimin e tyre dhe marrëdhëniet që duhet të kenë me DH/AB në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Duhet të plotësohen në ligj, kriteret e personave që përfshihen në Komitet e Auditimit, si dhe mënyra e përzgjedhjes së tyre duke ju referuar procedurave konkurruese, transparente dhe që realizohen nga struktura që nuk varen nga institucioni ku ato do të kontribuojnë.

Observacion i subjektit:

Në germën b) të nenit 12 të ligjit nr. 114/2015 dhe në VKM nr. 160/2016 "Për Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike" është e përcaktuar qartë vendimmarrja e titullarëve për krijimin ose jo të Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike që duhet të plotësojnë anëtarët e këtyre organeve. DH/AB në hartimin e aktit rregullator të cituar më sipër ka analizuar dhe përshtatur publikime zyrtare të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA) në Florida të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Duke qenë se ky vendim ka reflektuar një nga praktikat më të mira të funksionimit të Komiteteve të Auditimit të Brendshëm mendojmë se ndryshimi i propozuar është i pa nevojshëm. Roli i auditimit të brendshëm është të japë këshilla dhe rekomandime për titullarin e njësisë publike dhe ky Komitet është në funksion të këtij misioni dhe në mbështetje të veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm për të rritur pavarësinë e kësaj strukture.

Komenti i grupit të auditimit:

Observacioni nuk pranohet pasi, nga auditimi është konstatua se as në të ligjin nr. 114/2015 dhe as në VKM nr. 160/2016, nuk janë përcaktuar kritere të qarta dhe të matshme për krijimin e Komiteteve të Auditimit, si dhe nuk cilësohet detyrimi i tyre për të raportuar në DH/AB në Ministrinë e Financave, e për rrjedhojë gjykojmë se është i nevojshëm përmirësimi i këtyre dispozitave.

3.4 Mbi mbulimin e shërbimit të auditimit të brendshëm me kapacitete audituese sipas përcaktimeve ligjore *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)*

Situata: Për mbulimin e shërbimit të auditimit të brendshëm me kapacitete audituese sipas përcaktimeve ligjore, konstatohet se, gjatë këtij viti 38 njësi ose 32% e totalit të NJAB-ve e zhvillojnë veprimtarinë e tyre me më pak se tre audites në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*", ku përcaktohet se: "*Njësia e AB përbëhet nga jo më pak se tre punonjës përfshirë dhe drejtuesin e njësisë"*. Po ashtu, konstatohen 24 njësi me 1/3 ose më shumë të punonjësve të pacertifikuar. Pra në strukturat e AB ka punonjës të pa certifikuar dhe kjo situatë (e pranishme më shumë në organet e pushtetit vendor dhe njësitë e varësisë) mund të cënojë arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit të brendshëm në shkallë sistemi.

Në rang kombëtar, sipas evidencave të vëna në dispozicion nga DH/AB rezulton se me rritjen e numrit të njësive AB të ngritura niveli i audituesve të çertifikuar ka rënë nga 90% në 77% në dy vitet e fundit ndërkohë që aktualisht në proces çertifikimi janë 36 audites të punësuar. Jashtë sektorit

publik janë aktualisht rreth 1600 audituesë të çertifikuar (1911[1] audituesë të çertifikuar nga të cilët vetëm 308 të punësuar në sektorin publik). Kjo flet për qarkullim të shpeshtë të stafit të AB, punësimin vetëm për efekt të plotësimit të kriterit të çertifikimit apo emërimeve dhe largimeve politike.

Përshkrimi/Vitet	2013	2014	2015	2016	2017
Numri i njësive të auditimit	106	100	103	112	119
Pozicione të auditimit të plotësuara (në %)	95%	93.9%	92%	93%	93%
Audituesë aktual të certifikuar (në %)	85%	82.9%	90%	76%	77%
Trendi (+/-)		-2%	8%	-18%	1%

Në raportin vjetor të KBFP për njësitë e qeverisjes së përgjithshme gjejmë të cituar faktin se 10 njësi kanë drejtues të paçertifikuar por asnjë iniciativë apo tërheqje vëmendje për titullarët e njësive përkatëse. Nga evidencat del se ky numër është edhe më i lartë: 15 njësi, përfshi këtu dhe njësitë e krijuara me 1 audituesë në strukturë, apo 2 specialistë + 1 përgjegjës apo 1 specialist + 1 përgjegjës ku asnjë audituesë i punësuar nuk është i çertifikuar: Të gjitha këto njësi janë në shkelje të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 11 pika b[2].

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të NJAB në sektorin publik", i ndryshuar

Impakti: Struktura të papërshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së auditit të brendshëm në rang sistemi

Shkaku: Përcaktim në ligj, i cili lë hapësirë për interpretim sa herë bëhen ndryshime në strukturat e AB. Nga titullarët nuk i kushtohet vëmendjen e duhur kritereve që duhet të plotësohen, në mënyrë që të garantohet cilësia e auditimeve si dhe ndryshime të vazhdueshme të stafit të ab-së. Duke sjell në këto kushte prezencën e punonjësve të paçertifikuar në strukturat e AB-së dhe rrjedhimisht duke cenuar përmbushjen e misioneve të auditimit të brendshëm në shkallë sistemi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj, të marrë masa konkrete për të garantuar struktura të qëndrueshme të Auditimit të Brendshëm dhe monitorimin e vijueshëm të problematikave të lidhura me organizimin e strukturave AB.

Situata: Nga të dhënat e konsoliduara deri në fund të vitit 2017, referuar 119 njësive të qeverisjes qendrore, pushtet vendor, institucione të pavarura dhe shoqëri publike që raportojnë pranë DH/AB, veprimtaria mbulohet nga 400 audituesë ose 93% e numrit të planifikuar. Nga këta të çertifikuar janë 308 audituesë ose 77% e numrit të punonjësve të përfshirë në këto struktura dhe 92 audituesë të pa çertifikuar ose 23%. Detajuar si 36 punonjës në proçes çertifikimi dhe 56 punonjës të NjAB që nuk e zotërojnë këtë çertifikatë, por duhet të ndjekin procesin e çertifikimit. Nga analiza e të dhënave të raportuara nga strukturat audituese, rezulton se, nga këta 400 audituesë, 162 kanë eksperiencë pune në auditim deri në 5 vjet dhe 238 mbi 5 vjet punë si audituesë ose 59% e audituesve (238/400). Fakti që raportohet i grupuar numri i audituesve deri në 5 vjet, *nuk jep informacion të saktë të*

[1] *Sipas rregjistrit të Audituesve të Certifikuar të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*

[2] *Ligji nr.114/2015, neni 11, pika 2.b) drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i certifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm;*

punonjësve të përfshirë në këto struktura me vjetërsi nën 3 vite pune, për të gjykuar nivelin real të rekrutimit në strukturat e AB.

Kriteri: Rregullore e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 37, datë 16.03.2016

Impakti: Fakti që raportohet i grupuar numri i audituesve deri në 5 vjet, nuk jep informacion të saktë të punonjësve të përfshirë në këto struktura me vjetërsi nën 3 vite pune, për të gjykuar nivelin real të rekrutimit në strukturat e AB.

Shkaku: Formulari nr. 1, "*Përbërja Profesionale dhe Niveli i Kualifikimit të Punonjësve për periudhën ...*" paraqet periudhën e raportimit të viteve të punës grupuar në dy momente, nën 5 vite dhe mbi 5 vite.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Me qëllim që të pasqyrohet qartë punësimi i punonjësve në strukturat e auditimit të DH/AB të marrë masat e duhura për evidentimin e të dhënave të raportuara sipas kërkesave të nenit 11, të LAB, duke i grupuar AB të punësuar në këto struktura, sipas kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta, sipas nivelit arsimor që zotërojnë, përvojës në punë deri në 3 vjet, deri në 5 vjet dhe mbi 5 vjet, çertifikatat që zotërojnë, si dhe ditët e trajnimit që kanë realizuar gjatë vitit raportues.

3.5 Mbi planin strategjik dhe vjetor të konsoliduar të NjAB-ve *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)*

Situata: Nga auditimi mbi planet strategjik të auditit të brendshëm të Institucioneve Qendrore u konstatua se në 12 (dymbëdhjetë) prej tyre kishte mospërputhje me numrin e subjekteve për tu audituar mes planeve strategjike individuale të njësive dhe atij të konsoliduar, si p.sh Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Integrimit Europian, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Kulturës, Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Punëve te Brendshme. Në 2 (dy) prej tyre kishte mospëputhje me nivelin e riskut, përkatësisht në Ministrinë e Punëve të Jashtme u konstatua se kishte mospëputhje me nivelin e riskut "Ambasada Athinë-Greqi", "Romë-Itali" dhe "Tokio-Japoni" dhe në Ministrinë e Drejtësisë kishte mospëputhje me nivelin e riskut "Avokatura e Shtetit". Nga auditimi rezultoi që në 12 ministri kishte mosrakordime që konsistojnë në mospërputhje me numrin e subjekteve për tu audituar. Për 4 Ministri nuk kishte evidenca.

Njëkohësisht auditimi mbi planet strategjik të Auditit të Brëndshëm të Bashkive u konstatua se në 10 (dhjetë) prej tyre kishte mospërputhje me numrin e subjekteve për tu audituar, përkatësisht Bashkia Gramsh, Bashkia Mat, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Elbasan, Bashkia Tepelenë, Bashkia Divjakë, Bashkia Skrapar, Bashkia Lushnje, Bashkia Durrës, Bashkia Berat. Në 2 (dy) prej tyre kishte mospëputhje me nivelin e riskut, konkretisht Bashkia Gramsh u konstatua se kishte mospëputhje me nivelin e riskut "Agjensia e Shërbimeve Publike" dhe "Sektori Financës" dhe në Bashkinë Elbasan kishte mospëputhje me nivelin e riskut "Drejtoria e Prokurimeve Publike".

Nga auditimi rezultoi që në 52% të bashkive u konstatua mosrakordime që konsistojnë në mospërputhje me numrin e subjekteve për tu audituar.

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se, nga 90 subjektet objekt auditimi 19 prej tyre nuk kanë zbatuar afatin e dërgimit të planeve me një diapazon nga 1 ditë në 4 muaj (rasti i Albkontrollit).

Gjatë auditimit u konstatua se, ka subjekte të cilat gjatë vitit kryejnë rishikim të planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm. Nga auditimi i dosjeve të NJAB që kanë bërë ndryshime të planeve vjetore u konstatua se, problematika më e madhe qëndronte në paraqitjen e këtyre ndryshimeve, konkretisht nga 18 institucione 8 prej tyre nuk kishin bashkangjitur memon argumentuese mbi ndryshimet e ndodhura ndërsa në pjesën tjetër u konstatuan raste të detajimit të planit fillestar si dhe raste të tjera të mosdetajimit të këtij plani dhe nuk është i qartë shkaku për ndryshimin e planit vjetor të miratuar.

Manuali i Auditit të Brendshëm, pika 3.5 *Rishikimi i planeve strategjikë dhe vjetor të auditimit të brendshëm* ka parashikuar mënyrën se si duhet të operohet në rastet e ndryshimeve në plane, konkretisht: *Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NjAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit, (atje ku krijohet). Të gjithë planet vjetorë dhe strategjikë të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t'i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra.*

Nga informacioni i marrë nga auditimi i KLSH në subjektin ISSH u konstatua se, nga ana e ISSH është dërguar shkresa për ndryshim plani pranë DH/AB për vitin 2017, me nr. 9013 prot dhe datë 08.11.2017 në të cilën është specifikuar ndryshimi i strukturës organizative të DAB së Institutit të Sigurimeve Shoqërore që sjell si pasojë ndryshim në planin e auditimeve të njësisë. Shkresë e cila gjatë auditimit pasi është kërkuar nga grupi i aditimit nuk na është vendosur në dispozicion, së bashku me shkresën dërguese të planit strategjik dhe vjetor të ISSH, dërguar prej subjektit me shkresën nr. 7076/1 prot datë 07.11.2016. Gjithashtu, nga informacioni i marrë nga auditimi i KLSH në subjektin " FSDKSH" u konstatua se, ky subjekt raporton gjithsej 19 auditime të realizuara ndërkohë që në evidencat e DH/AB ky subjekt raportohet me realizim të 22 auditimeve. Çka dëshmon se të dhënat e pasqyruara nga ana e DH/AB nuk janë të konsoliduara me saktësi të plotë dhe për pasojë as të besueshme.

Kriteri: Manuali i Auditit të Brendshëm pika 3.5

Impakti: Mungesa e evidentimit të ndryshimeve, mungesa e kontrollove të saktësisë së konsolidimit, mungesa e masave në ligj për rastet e mosdërgimit të planit strategjik dhe vjetor e bën proçesin e konsolidimit të planit strategjik një proçes formal dhe objektiv pjesërisht të arritur të Drejtorisë Harmonizimit të AB.

Shkaku: Si rrjedhojë e moszbatimit të plotë nga ana e njësive publike të Manualit të Auditit të Brendshëm, pika 3.5 *Rishikimi i planeve strategjikë dhe vjetor të auditimit të brendshëm*

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj të përcaktuara në gërmën "h" të nenit 24 të LAB, për të ndihmuar njësitë e auditit të brendshëm pranë njësive publike, të përgatisë një përgjithësues të mangësive të konstatuara

në raportimet e paraqitura lidhur me hartimin e planeve strategjike dhe vjetore, me qëllim që NJAB të argumentojnë, mënyrën e pasqyrimit të këtyre ndryshimeve dhe të raportimit periodik të tyre, duke unifikuar formatet e shkresave shoqëruese të ndryshimeve në plan.

Observacion i subjektit:

-Në lidhje me konstatimin se "Në 2 (dy) prej tyre kishte mospëputhje me nivelin e riskut, përkatësisht në Ministrinë e Punëve të Jashtme u konstatua se kishte mospëputhje me nivelin e riskut "Ambasada Athinë-Greqi", "Romë-Itali" dhe "Tokio-Japoni" dhe në Ministrinë e Drejtësisë kishte mospëputhje me nivelin e riskut "Avokatura e Shtetit"., sqarojmë se paraprakisht niveli i riskut të subjekteve përcaktohet në fazën e hartimit të planit strategjik dhe vjetor dhe deri në momentin e auditimit ky nivel risku, nga ndryshime që mund të ndodhin në organizatë dhe nga vlerësimi profesional i audituesve të brendshëm, mund të ndryshojë.

- Në lidhje me konstatimin se "92% të ministrive kishin mosrakordime që konsistojnë në mospërputhje me numrin e subjekteve për tu audituar. Në 8% të Ministrive nuk kishte evidence", gjë që kundërshtohet nga ana e DH/AB. Të gjitha raportet vjetore të ministrive të linjës janë të plota (raport vjetor, evidenca dhe pyetësor vetëvlerësimi).

- Në lidhje me konstatimin se "në subjektin "FSDKSH" u konstatua se, ky subjekt raporton gjithsej 19 auditime të realizuara ndërkohë që në evidencat e DH/AB ky subjekt raportohet me realizim të 22 auditimeve. Çka dëshmon se të dhënat e pasqyruara nga ana e DH/AB nuk janë të konsoliduara me saktësi të plotë dhe për pasojë as të besueshme", Raporti Vjetor i FSDKSH me nr. 127/1, datë 15.02.2018, në pasqyrën nr.2 "Realizimi i planit të angazhimeve për vitin 2017" ka të realizuar 22 angazhime auditimi (4 a.përputhshmërie, 17 a. të kombinuara dhe 1 a.me kërkesë të titullarit). Gjë që dëshmon që të dhënat e DH/AB janë bazuar në raporte zyrtare, janë të konsoliduara me saktësi të plotë dhe profesionalizëm dhe për pasojë janë të besueshme.

Komenti i grupit të auditimit:

Të dhënat e paraqitura në Projektraportin e Auditimit janë marrë nga ato raporte që dispononi edhe ju, por krahasimet janë bërë me të dhëna të verifikuara nga KLSH në disa njësi publike të audituara nga ana jonë gjatë vitit 2017, fakt që tregon se hartimi i raportit bazuar vetëm në vetëdeklarim përmban pasaktësi.

3.6 Mbi sistemin e sigurimit të cilësisë së aktivitetit të NjAB *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)*

Situata:

DH/AB shprehet raport se "*...Përveç vlerësimit të jashtëm të cilësisë, vlerësimet e brendshme janë një element shumë i rëndësishëm i cili siguron monitorimin dhe mbikëqyrjen e punës së audituesve në vijimësi.* DH evidenton*: se 40 njësi AB ose **30%** e sistemit AB nuk garantojnë sigurojnë kontrollin e vlerësimin e cilësisë"*. Nga shqyrtimi i evidencave të vëna në dispozicion rezultojnë 22 njësi me 1 audites dhe 26 njësi me 2 audites pra gjithsej 48 njësi të ose **40%** e sistemit AB janë në shkelje të Ligjit nr.114/2015 dhe nuk garantojnë kontrollin e brendshëm të cilësisë. Në vijim, grupi i auditimit ka shqyrtuar evidencat duke marrë në konsideratë

dhe faktorin "*aftësi dhe kapacitete profesionale*" ku evidentojmë se për 15 njësi që vërtetë plotësojnë kriterin ligjor 2+1 të audituesve të punësuar por raporti: auditues të paçertifikuar kundrejt numrit total audituesish është 40% mbi 1/3 sipas kriterit ligjor. Këto njësi jo vetëm që janë në shkelje të VKM nr.83 dt.3.2.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", por duhen të merren në konsideratë kur flasim për vlerësim të cilësisë së auditimit dhe efiçensën e tij. Shumë nga këto njësi raportojnë një realizim plani 100-200% por me tregues perfomance shumë të dobët si psh: përqindja mesatare e zbatimit të rekomandimeve prej 36% dhe gjetje në vlerë prej 17 milion lekë në total për të 15 njësitë. Raste të tilla si:

1) K. sha me asnjë gjetje në vlerë nga auditi i brendshëm ndërkohë që nga raporti i auditimit të KLSH vetëm vlera e një gjetje me dëm ekonomik në një marrëdhënie kontraktore është 41.5 milion lekë ose mbi dyfishin e gjetjeve të 15 njësi AB së bashku,

2) Bashkia Kuçovë, Vorë me zero rekomandime në dy vjet,

3) Bashkia Kolonjë, me realizim 200% të planit të auditimit por vetem me 11 rekomandime që do të thotë që ka patur dhe auditime me as edhe 1 (një) gjetje dhe rekomandim. Fakti që kjo njësi ka kryer 28 auditime në 12 muaj koha mesatare për një auditim ka qënë 0.4 muaj pra në më pak se 10 ditë. Lind pyetja a kanë qënë këto angazhime auditimi apo inspektime?

4) Bashkia Dibër me 0% rekomandime të zbatuara**,**

5) Bashkia Malësia e Madhe në 14 auditime (175% realizimi plani) ka dhënë gjithsej 13 rekomandime pra më pak se 1 (një) rekomandim për auditim dhe për më tepër raporton vetëm 1 (një) të zbatuar**.**

duhet të silleshin në vëmendje në Raportin vjetor të KBFP dhe të paraqiteshin në analizë dhe opinion me profesionalizëm dhe transparencën e duhur në funksion të zbatimit të përgjegjësisë ligjore që kjo drejtori ka për përpilimin e këtij raporti.

Në përfundim, nëse këto 15 njësi ku efiçensa shumë e ulët është evidente, i shtohen numrit të njësive të raportuara më lart si njësi që nuk garantojnë sigurimin e cilësisë së auditimit e çojnë në 63 njësi apo **53% të sistemit të AB ku sistemi i sigurimit të cilësisë mungon ose nuk funksion, rrjedhimisht ky sistem është ineficent.**

E llogaritur mbi bazën e kostos mesatare për një auditim sipas Planit Strategjik 2017-2020: 1300.6 lekë, **totali i kostos së auditimeve të kryera nga njësitë e mësipërme është 26,012 mijë lekë dhe treguesi i dobishmërisë së auditimit do të ishtë 0.18 lekë / 1 lekë të shpenzuar** (duke supozuar se dëmet e vlerësuara janë të arkëtueshme).

Nga evidencat e shqyrtuara rezultuan 10 njësi AB si Universiteti i Tiranës, Fondi shqiptar i zhvillimit, Bashkia Klos, Prrenjas, Tropojë etj të cilat kanë kryer **zero** aktivitet për gjatë vitit 2017 me një numër punonjësish prej 12 vetë (paga vjetore e përllogaritur 16,380 mijë lekë).

Kriteri: Vlerësimi i aktivitetit të DH/AB për monitorimin e veprimtarisë AB sipas treguesve të efektivitetit dhe eficensës së AB: Profesionalizmi, cilësia e auditimit, pavarësia organizative, trajnimi i vijueshëm dhe suporti i drejtimit.

Impakti: Shkelje të përhapura të ligjit nr.114/2015 dt. 15.10.2015, neni 11 në ngritje të strukturave AB dhe VKM nr.83 dt. 3.2.2016, në punësimet jo sipas kritereve ligjore dhe formale kanë shkaktuar ineficensë të sistemit të auditit

të brendshëm duke mos realizuar qëllimin dhe detyrimin ligjor dhe duke shpenzuar në mënyrë jo eficente fondet publike të vëna në dispozicion. Referuar treguesit të dobishmërisë së aktivitetit të AB 3.8 leke/ 1 lekë të shpenzuar duke përfshirë këtë një gjetje të Ministrisë së Ekonomisë dhe Infrastruktures. Nëse kjo gjetje me dëm ekonomik do të përjashtohej nga llogaritja treguesi i dobishmërisë për gjithë sistemin AB (118 njësi) do të ishte 3.4 lekë /1 lekë kosto auditimi të shpenzuar.

Shkaku: Struktura përgjegjëse për monitorimin e sistemit AB, me një staf prej 4+1 punonjësish, përtej statistikave të konsoliduara të planeve strategjike dhe përpilimit të indikatorëve, nuk ka një analizë dhe pamje të plotë se si funksionojnë këto struktura për të evidentuar nëse këto funksione pjesë e njësive shpenzuese kryejnë aktivitetin e tyre me efektivitet e eficensë dhe janë vlerë e shtuar për njësinë dhe titullarin përkatës. Në raportin vjetor të sistemit KBFP për vitin 2017 DH konkludon me opinionin se;" *Shërbimi i auditimit të brendshëm nuk shtrihet në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, aktualisht kjo problematikë vërehet në institucionet e pavarura, njësi publike në varësi të Kryeministrisë dhe në disa bashki…Vihet re interesi në rritje i punonjësve të rinj për tu punësuar në strukturat audituese. Kjo shihet si një frymë e re, e përshtatur me zhvillimet teknologjike dhe energjinë që karakterizon brezat e rinj. Ata janë një gjeneratë e re që në bashkëpunim me audituesit me përvojë do të realizojnë në të ardhmen nivel gjithnjë e në rritje të cilësisë së punës së audituesve"*, nuk është serioze që në vend të vënies së theksit në çështjen e ekzistencës së strukturave të ngritura në shkelje të ligjit, të punësimit në shkelje të ligjit me tregues performance shumë të dobët dhe totalisht ineficente, flitet për të si një çështje politikash punësimi për brezat e rinj.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/AB në mënyrë të menjëhershme duhet të analizojë me profesionalizëm dhe në thellësi çështjen e efektivitetit dhe eficensës së njësive AB dhe të reflektojë këtë analizë dhe rezultatet e saj në opinionet e dhëna në raportin vjetor të KBFP. Është e rëndësishme që aktiviteti i auditimit të brendshëm të marrë reagime nga palët kyçe të interesit mbi efektivitetin e auditimit dhe të bëjë rregullime të nevojshme dhe ti përcjellë tek të gjitha njësitë e AB dhe jo vetëm tek ato njësi që kanë qenë pjesë e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

Raportimi i DH/AB të mos kufizohet vetëm në raportime vjetore deri në momentin që niveli i efektivitetit, eficensës së sistemit AB të vlerësohet në nivele të pranueshme. DH/AB në rolin e saj si harmonizuese e metodologjive dhe monitoruese e sistemeve KBFP ku një nga shtyllat është AB, duhet menjëherë të rishikojë metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik për komponentin AB, për të marrë në konsideratë matës relevant sasior dhe cilësor të efektivitetit dhe efiçencës.

Observacion i subjektit:

Në lidhje me konstatimet e grupit të auditimit, sqarojmë se nga ana e DH/AB do të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme NJAB, do të komunikohet me titullarët përgjegjëse dhe në fokus të trajnimeve të vijueshme profesionale do të jetë dhënia e këshillave mbi zbatimin e bazës rregullative të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky observacion nuk paraqet fakte apo argumente kundërshtues, për tu

konsideruar nga ana jonë.

3.7 Gjetjet e raportuara nga NjAB
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)

Situata: Bazuar në të dhënat e raportuara pranë DH/AB për vitin 2017, strukturat e 119 njësive të auditimit të brendshëm përmes 400 audituesve që ushtrojnë funksionet në to, kanë konstatuar një nivel dëmi ekonomik në shkallë sistemi prej 7,848,500 mijë lekë, vlerë që krahasuar me vitin 2016, është 3.7 herë më e lartë. Analiza tregon se në këtë vlerë shuma prej 6,029,000 mijë lekë i përket një auditimi të kryer nga NJAB e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në Autoritetin Rrugor Shqiptar, fakt që tregon se në shkallë sistemi niveli i shkeljeve të konstatuara është më i ulët se viti 2016 me vetëm 1.819.500 mijë lekë ose më i ulëti në 5 vitet e fundit. Edhe në numër 6.286 rastet e konstatuara për gjatë vitit 2017, janë më të ulëta se numri prej 9.421 rastet e raportuara për vitin 2016.

Tabela, vlera e dëmit në nivel total për një periudhë 5 vjeçare, shprehur në 000/lekë me ARRSH.

Gjetjet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Totali (në vlerë)	3.199.964	4.321.991	20.138.457	68.789.045	2.111.308	7.848.500
Totali (në numër)	4.698	3.556	4.441	4.186	9.421	6.286
Numri i audituesve	391	387	351	352	386	400

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar grupi i auditimit

Tabela, vlera e dëmit në nivel total për një periudhë 5 vjeçare, shprehur në 000/lekë pa ARRSH.

Gjetjet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Totali (në vlerë)	3.199.964	4.321.991	20.138.457	68.789.045	2.111.308	1.819.500
Totali (në numër)	4.698	3.556	4.441	4.186	9.421	6.286
Numri i audituesve	391	387	351	352	386	400

NJAB e MIE përbëhet nga 8 auditues e cila ka konstatuar 6,029,000 mijë lekë gjetjeve me dëm ekonomik në gjithsej 38 auditime të realizuara gjatë vitit 2017, ndërsa pjesa tjetër e gjetjeve me dëm ekonomik prej 1,819,500 mijë lekë i përket 118 NJAB të tjera që në përbërje të tyre kanë 392 auditues dhe kanë realizuar 1322 auditime, e për rrjedhojë niveli i dëmeve të konstatuara për një auditim është 1,376 mijë lekë.

Vlera e dëmeve të konstatuara nga strukturat e auditimit të brendshëm nuk është tregues domethënës për efiçencën e sistemit, kjo referuar literaturës apo praktikave ndërkombëtare. Megjithatë, në kushtet e Shqipërisë duhet të lexohet si ineficencë dhe varësi e plotë e këtyre strukturave nga titullarët e institucioneve, nëse i referohemi gjetjeve me dëme ekonomik të konstatuara nga audituesit e jashtëm shtetëror (KLSH).

Nga analiza e dëmit të konstatuar sipas fushave, konstatohet se **93%** e vlerës është konstatuar në fushën e prokurimit publik ose 7,276,824 mijë lekë, 4% e vlerës në fushën e tatimeve dhe taksave (tatime dhe dogana) ose 291,854 mijë lekë pjesa tjetër i takon grupit të tjera me 2%. Në fushën e administrimit të pronës shtetërore niveli i gjetjeve është 17,520 mijë lekë ndërkohë që KLSH, në këtë fushë ka dhe konstatimet më të rëndësishme.

Tabela " Gjetjet me dëm ekonomik sipas sistemeve, viti 2017"

Nr.	Gjetjet sipas sistemit	Dëmi ekonomik (000/lekë)	Gjetje %	Gjetje në numër	Gjejtje %	Nr i njësive që kanë raportuar gjetje
1	Prokurim, blerje dhe investime	7,276,824	93%	796	93%	30
2	Paga, shpërblime, trajtime, komisione	56,249	1%	515	0.72%	46
3	Fondet e sig. shoq dhe shëndetësore	8,017	0%	83	0.10%	12
4	Tatime, taksa dhe dogana	291,854	4%	606	3.72%	23
5	Admin. prone dhe pasurie	17,520	0%	751	0.22%	23
6	Privatizime, shitje dhe qeradhënie	21,546	0%	192	0.27%	14
7	Koncesione dhe ankande	11,303	0%	32	0.14%	6
8	Legalizime, urbanistikë dhe kthim pronash	2,406	0%	88	0.03%	10
9	Kreditim, subvencione	24,568	0%	22	0.31%	7
10	Të tjera	138,207	2%	3,201	1.76%	35
	TOTALI	**7,848,494**	**100%**	**6,286**	**100%**	

Gjatë këtij viti nga audituesit e brendshëm janë konstatuar 18 raste për investigim të mëtejshëm nga njësi të specializuara, kryesisht strukturat e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, AKU, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, P. Sh, Albpetrol, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor dhe Bashkia Kukës. Pesë prej këtyre rasteve i janë drejtuar për investigim të mëtejshëm Drejtorisë së Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pesë raste prokurorive të rretheve përkatëse, rastet e tjera i janë drejtuar titullarëve të njësive publike, Agjensisë së Prokurimit dhe Drejtorive të Policisë së Qarqeve përkatëse.

Kriteri: Ligji 10296 dt.8.7..2010 i ndryshuar; Manuali i Auditit të Brendshëm

Impakti: Opinioni i dhënë në Raportin vjetor të KBFP nga DH/AB i cili do të paraqitet nga Ministri i Financave në komisionin parlamentar është i bazuar mbi një analizë sipërfaqësore duke lënë të patrajtuar çështjen eficencës dhe perfomancës së njësive sipas karakteristikave të tyre (njësi qëndrore, vendore apo të pavaruara) bazuar në numër gjetjesh kundrejt problematikave të ngritura nga auditimi i jashtëm (KLSH). Kjo do të shërbente si një instrument sinjalizues për mungesën e theksuar të pavarësisë dhe kompetencën e NjAB-ve dhe rrjedhimisht dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit në zbatim të ligjit të MFK neni 18, pika 3

Shkaku: Formalizëm dhe analiza jo të plota për adresim të drejtë të problematikës nga DH/AB

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/AB të bëjë një analizë të drejtë dhe të plotë të nivelit të gjetjeve në raport me shtrirjen e strukturës AB në sektorin publik, llojeve të gjetjeve dhe në reflektim të rekomandimeve të KLSH si audites i jashtëm, dhe të raportojë drejt pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nivelin e strukturave AB dhe eficençës së punës së tyre. Plotësia dhe saktësia e raportimit mbi këtë sistem është jo vetëm obligim ligjor por edhe përgjegjshmëri ndaj funksioneve që kryhen.

Observacion i subjektit:

Pasqyra 3: Përmbledhëse e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit për vitin, tregon qartë se nga ana e strukturave audituese përcaktohet saktë vlera e dëmit ekonomik, megjithëse ky nuk është fokusi i

veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Audituesit e brendshëm kanë përgjegjësi ligjore të vlerësojnë dhe të japin rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për veprimet që duhet të ndërmarrin në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare, për ç'dëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes (neni 16 i ligjit 114/2015). Të gjitha këto përcaktime janë të bazuara tërësisht në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të cilat në Shqipëri janë të pranuara dhe zbatimi i tyre është në monitorim të vazhdueshëm.

Komenti i grupit të auditimit:

Observacioni nuk pranohet pasi, DH/AB duhet të kërkojë që të gjitha NJAB të plotësojnë pasqyrat për rezultatet e auditimeve të realizuara në përputhje me formatet e miratuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe ti analizojnë ato me të gjithë treguesit me qëllim që pasqyrohet e plotë e gjithë veprimtaria e tyre.

3.8 Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditit të brendshëm *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)*

Situata: Konstatohet se, në Manualin e Auditit të Brendshëm, publikuar në vitin 2016, nuk është përcaktuar qartë çështja e zbatimit të rekomandimeve e as mënyra e raportimit të tyre. Ndjekja në dinamikë e zbatimit të rekomandimeve është një nga treguesit thelbësor të performancës dhe eficensës së auditimit të brendshëm për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik. Kjo mangësi zbeh rolin e auditimit të brendshëm si mbështetës i titullarit të institucionit në arritjen e objektivave të njësisë dhe bie ndesh me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin publik*", nenit 6, "*Roli i auditimit të brendshëm*", gërma "ç", ku përcaktohet *"ç) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna*", nenit 14, "*Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm*" gërma "iv", ku përcaktohet, "*iv) veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar*;", si dhe nenit 24 "*Përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm"*, gërma "ë", ku përcaktohet se: "*ë) analizon rekomandimet e dhëna në raportet vjetore të njësive të auditimit të brendshëm*".

Nga auditimi u konstatua se, në formularin nr. 4, "*Rekomandimet e dhëna nga NJAB për periudhën (...)*", pasqyrohen të dhënat për rekomandimet ***e pranuara dhe të zbatuara*** gjithsej, sipas prioriteteve, ***por nuk pasqyrohen të dhënat për rekomandimet e papranuara dhe arsyet se pse***. Po ashtu nga auditimi i dosjeve u konstatua se, pjesa më e masdhe e njësive publike totalin e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak nuk janë hedhur fare ose janë të pasakta. Gjykojmë të nevojshme se përmirësimi i pasqyrave statistikore me të gjithë treguesit e nevojshëm do t'u shërbejnë më mirë titullarëve të njësive publike për përmirësimin e veprimtarisë dhe rritjen e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e e sektorit publik.

Kriteri: Manuali i Auditit të Brendshëm

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria DH/AB të shprehet qartë në Manualin e AB mbi domosdoshmerinë e një auditimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna, auditim i cili duhet të

japi shkaqet dhe përgjegjësitë e mosrealizimeve

Observacion i subjektit:

Në lidhje me konstatimet e grupit të auditimit, sqarojmë se në Manualin e Auditimit të Brendshëm është përcaktuar se njësitë e auditimit nuk mund të planifikojnë dhe të realizojë auditime të veçanta për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Kjo procedurë është proces monitorimi dhe sipas përcaktimeve në Standardin 2500 dhe bazuar në pikën 4.1.13 "Ndjekja e Rekomandimeve" të kapitullit IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm është parashikuar të kryhet:

- *nëpërmjet verifikimit të progresit si pikë e veantë e programit në vitin pasardhës;*
- *nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm;*
- *informacion në përfundim të afatit të përcaktuar në plan veprim.*

Ky është një proces që ka nevojë për monitorim të vazhdueshëm për arritjen e një niveli sa më të lartë në zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara. DH/AB ka të përcaktuar në ligj dhe luan rregullisht rol udhëheqës në drejtim të monitorimit të të gjithë veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim që kjo veprimtari të jetë gjithnjë e më shumë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Ndërkohë, një vlerësim i detajuar i veprimtarisë së auditimit të brendshëm të përfshirë dhe cilësinë e nivelin e rekomandimeve të dhëna kryhet në cdo vlerësim të jashtëm të cilësisë në të cilin jepen rekomandimet përkatëse për NJAB-në që monitorohet.

Komenti i grupit të auditimit:

Observacioni nuk pranohet pasi, nuk keni sjellë ndonjë argument të ri, e për rrjedhojë mbetemi në cështjet e konstatuara si më sipër.

3.9 Vlerësimi i jashtëm i cilësisë së aktivitetit të NjAB nga DH/AB dhe planifikimi i saj
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)

Situata:

Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm (DH/AB), është organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm.

Për vitin 2017, janë kryer 5 vlerësime të cilësisë, nga DH/AB në bashkëpunim me ekspertë të SIGMAS-s, në Ministrinë e Shëndetësisë, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, në Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe në bashkitë Berat dhe Fier. Sipas intervistave përzgjedhja është bazuar në metologji por nuk specifikohen kriteret e përzgjedhjes.

Gjatë auditimit, u shqyrtuan të gjitha dosjet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë, dhe u konstatua se kishte mungesë në inventarin e letrave të punës. Duke qenë se rezulatet e vlerësimit janë opinione që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e standarteve, ligjit dhe praktikave më të mira profesionale dhe zbatueshmerinë e përgjegjësive nga ana e titullarit mbi kryerjen e shërbimit të AB-së është e nevojshme që këto dokumente, të jenë pjesë e dosjeve në mënyrë që të arrihet dhënia e sigurisë së arsyeshme mbi punën e kryer. Po ashtu theksojmë nevojën e pranisë së të gjithë dokumentave zyrtare të auditimit në dosje, si projekt raporte dhe raporte finale. Gjithashtu nevojën e unifikimit të opinionit të dhënë në fund, duke shmangur në këto kushte situatën e kryer me ARRSH-në, ku në dy projekt- raporte janë dy rezultate të ndryshme, njëherë me ngjyrë

të verdhë e cila vlerëson përputhjen e pjesshme me kriterin, por përmirësim të nevojshëm në fusha të caktuara dhe herën tjetër ngjyrë portokalli që vlerëson përputhjen në disa fusha që kërkojnë përmirësime kritike (të domosdoshme) duke mos formalizuar një opinion përfundimtar zyrtar për vlerësimin e kryer.

Bazuar në pikën 7.2.1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm publik "*Vlerësimi i jashtëm i cilësisë i kryer nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB*", ku përcaktohet se "*Sruktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë NJAB, si më poshtë: - të paktën një herë në 5 vjet; ....."* DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB në përputhje me standardet ndërkombëtare të miratuara gjatë vitit 2017 duhej të kishte vlerësuar jo më pak se 23 NJAB (119:5). Fakti që, gjatë këtij viti nga DH/AB, janë kryer vetëm 5 kontrolle të cilësisë ose rreth 22% e detyrimit të përcaktuar sipas manualit, tregon se kjo strukturë me kapacitetet që ka e ka të pamundur të arrijë përmbushjen e objektivit prej 23 vlerësime të jashtëme të cilësisë. Duke e vlerësuar si një tregues shumë të rëndësishëm sigurimin e cilësisë së punës së auditimit të brendshëm, është e nevojshme që struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, të studiojë me përgjegjësi kapacitetet që ka për mbulimin e detyrave funksionale që rrjedhin nga neni 24 i LAB dhe t'i propozojë Ministrit të Financave gjetjen e rrugëve më efektive për realizimin e këtij detyrimi.

Nga auditimi konstatohet, DH/AB nuk ka hartuar programin vjetor për vlerësimin e jashtëm të cilësisë për periudhën deri në dhjetor 2017 pasi deri në përfundim të këtij auditimi nuk na u paraqit një dokument i tillë, çka bën të mos japim siguri mbi metodën e përdorur për kryerjen e misioneve dhe përputhshmërinë me Manualin përkatës.

Po ashtu DH/AB ka për detyrë krijimin dhe përditësimin çdo vit të regjistrit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së NJAB-ve, ku duhet të përfshihen të dhënat lidhur me:

- numrin e subjekteve,- statusin organizativ të NjAB,- nivelin e riskut,

- frekuencën e kryerjes së vlerësimeve të jashtme,- nivelin e kualifikimit të stafeve të NJAB-ve,- numrin e rekomandimeve të dhëna NJAB-ve për përmirësim,- vlerësimet e jashtme kryer nga KLSH apo vlerësues të kualifikuar të pavarur.

Grupit të auditimit ky regjistër iu dërgua elektronikisht por u konstatua se nuk arrijmë të marrim informacion mbi totalin e njësive publike që kanë ngritur strukturën AB, për frekuencën e kryerjes së vlerësimeve të tyre apo riskun. Më shumë ky regjistër vjen në formën e një database me institucionet ku është kryer vlerësimi.

Nga ana e grupit të auditimit, gjykojmë të arsyeshme se DH/AB duhet të ketë një pasqyrë të përditësuar të të gjitha njësive publike lidhur me vlerësimin e cilësisë dhe planifikimin e saj, në zbatim të gërmës a, të nenit 24 "*Përgjegjësitë e DH/AB*" me qëllim realizimin e monitorimit të veprimtarisë në nivel kombëtar.

Kriteri: Manuali i vlerësimit të jashtëm të cilësisë, Manuali i Auditimit të Brendshëm, Ligji i Auditit të Brendshëm

Impakti: DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB në përputhje me standardet ndërkombëtare të miratuara gjatë vitit 2017 duhej të kishte vlerësuar jo më pak se 23 NJAB

(119:5) ndaj sa më sipër nuk sigurohet mbulimi i nevojshëm për vlerësim cilësie nga ana e DH/AB.

Shkaku: Mungesë e kapaciteteve për të realizuar konform ligjit vlerësimin e jashtëm të cilësisë, rrjedhimisht pamundësi e arritjes së përmbushjes së objektivit prej 23 vlerësime të jashtëme të cilësisë të vendosur në pikën 7.2.1 të Manualit të AB.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB të studiojë me përgjegjësi kapacitetet audituese që ka për mbulimin e detyrave funksionale që rrjedhin nga neni 24 i LAB dhe t'i propozojë Ministrit të Financave gjetjen e rrugëve efektive për realizimin e objektivit prej 23 vlerësime të jashtëme të cilësisë çdo vit .

3.10 Mbi administrimin e procesit të çertifikimit të AB *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)*

Situata: Nga auditimi në lidhje me çertifikimin e audituesve të brendshëm publik, u konstatua se DH/AB ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në rregulloren e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 37, datë 16.03.2016. Kriteret e kualifikimit të audituesve të brendshëm publik janë rregulluar në kapitullin e VI-të LAB, ku në nenin 19, pika 2, përcaktohet se, të drejtën për të aplikuar në procesin e çertifikimit e kanë të gjithë individët e klasifikuar në shkronjën "ç" të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, pra punonjësi, që nuk zotëron çertifikatën si "Auditues i brendshëm", por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Gjatë kësaj periudhe ai duhet të pajiset me çertifikatën e audituesit të brendshëm, ndryshe ndërpret marrëdhëniet e punës. Sipas pikës 1, të nenit 19, të këtij ligji, Ministri i Financave ka detyrimin ligjor të përcaktojë procedurat e çertifikimit të audituesve që nuk e zotërojnë këtë çertifikatë, por ***jo të përcaktojë kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët***, pasi ato janë të përcaktuara me ligj. Konstatohet se, pikat 2 dhe 3, të nenit 9, të "Rregullores për procedurat e çertifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik" miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 37, datë 16.03.2016, janë në tejkalim të ligjit.

Nga auditimi u konstatua se i gjithë dokumentacioni që lidhet me mbledhjet e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe dokumentacioni që lidhet me zhvillimin e procesit të certifikimit të Audituesve të Brendshëm sikundër përcaktohet në nenet 6 dhe 8 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 37, datë 10.03.2016 "*Për miratimin e Rregullores për procedurat e certifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar, ***është inventarizuar por nuk është dorëzuar në Arkivin e Ministrisë*** së Financave nga Sekretari i KKAB dhe nga nëpunësi përgjegjës për procesin e certifikimit të Audituesve të Brendshëm, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6, ku përcaktohet se Sekretari i KKAB është përgjegjës për: "*Arkivimin në fund të çdo procesi certifikimi të të gjithë dokumenatve që lidhen më zhvillimin e mbledhjeve të Komisionit*" dhe me pikën 10 të nenit 8, ku përcaktohet se, nëpunësi përgjegjës për procesin e certifikimit të AB, është përgjegjës për: "*Dorëzimin në përfundim të çdo procesi certifikimi të dokumenteve në arkivin e Ministrisë së Financave, në përputhje me ligjet në fuqi".*

6.1 Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të nenit 23 të Rregullores nr. 37, datë 10.03.2016, është përcaktuar se: me shkresën nr.13169, datë 26.09.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të DH/AB&MFK është caktuar Komisionin i asgjësimit të fletoreve të testeve paraprake, të provimit dhe riprovimit, i ndryshuar me shkresën nr. 13199/1 datë 29.09.2017 (është ndryshuar njëri prej anëtarëve të këtij komisioni), i përbërë prej z.B.L Drejtor i DH/AB, S.B, specialist në DH/AB dhe D.E, specialist në sektorin e Shërbimeve. Ky komision ka mbajtur procesverbalin e datës 23.10.2017 mbi procesin e asgjësimit të materialeve dhe fletoreve të procesit të certifikimit për sezonin 2016-2017, ku ka cilësuar numrin e fletoreve për secilin test paraprak, për provimin dhe riprovimin me shkrim dhe për modulin specifik. Në këtë procesverbal cilësohet se ky Komision ***ka bërë numërimin e fletoreve*** dhe më pas ***asgjësimin e tyre nëpërmjet procesit të grisjes***. I gjithë ky proces është dokumentuar vetëm nëpërmjet një procesverbali në trajtë narrative, pa prova të tjera justifikuese mbështetëse dhe të besueshme, si fotografi apo video të këtij procesi, pët të garantuar siguri dhe besueshëri.

Nga auditimi u konstatua se, në nenin 23 të rregullores nr. 37, datë 10.03.2016, është përcaktuar se: "*Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e çertifikimit dorëzohen dhe ruhen në protokollin e Ministrisë së Financave në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletoreve të provimeve dhe riprovimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 3 muaj nga data e dhënies së provimit/riprovimit. Asgjësimi i tyre bëhet nga një komision prej tre anëtarësh, të caktuar me urdhër nga struktura përgjegjëse për kualifikimin në përbërje të të cilit janë dy punonjës të strukturës përkatëse për kualifikimin dhe një punonjës i strukturës përgjegjëse për shërbimet në Ministrinë e Financave. Deri në asgjësimin e tyre, fletoret administrohen nga struktura përgjegjëse për kualifikimin".*

Ky përcaktim nuk është në përputhje me Kreun II-E "*Ekspertiza e vlerës së ruajtjes së dokumenteve të Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*" të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 15 të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*", nenet 32-35, ku përcaktohen detyrimet e subjekteve shtetërore të cilat hartojnë listën konkrete të dokumenteve të tyre me rëndësi historike dhe me afat ruajtje të përkohshme, si dhe përcaktojnë afatet e ruajtjes për këto të fundit sipas modelit nr. 11, si dhe mënyra e asgjësimit të dokumenteve sipas listës së veçimit. Mënyra e asgjësimit e përcaktuar në këtë Rregullore është e gabuar dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 35 të "*Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shipërisë*", ku përcaktohet se, asgjësimi i dosjeve të përfshira në listën e veçimit, bëhet nga arkivi, apo sekretari-arkivi i subjektit shtetëror apo jo shtetëror ... dhe për asgjësimin e tyre mbahet procesverbal sipas modelit.12. të përcaktuar në këto norma. Asgjësimi Brenda 3 muajve pas përfundimit nuk lejon të kryhet auditim përputhshmërie mbi mënyrën se si është kryer procesi. *trajtuar hollësisht në faqen 30 të këtij Projektraporti.*

Kriteri: Rregullore e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 37, datë 16.03.2016

Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

Impakti: Mungesa e dokumentacionit justifikues të vendimmarrjes lidhur me procesin e certifikimit.
Mënyra e asgjësimit megjithëse është kryer sikundër është përcaktuar Rregullore është e gabuar dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 35 të "*Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shipërisë*" duke shmangur gjurmët e asgjesimit.

Shkaku: Përcaktimi dhe Rregullorja nuk janë në përputhje me Kreun II-E "*Ekspertiza e vlerës së ruajtjes së dokumenteve të Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*" të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 15 të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*", nenet 32-35, ku përcaktohen detyrimet e subjekteve shtetërore të cilat hartojnë listën konkrete të dokumenteve të tyre me rëndësi historike dhe me afat ruajtje të përkohshme, si dhe përcaktojnë afatet e ruajtjes për këto të fundit sipas modelit nr. 11, si dhe mënyra e asgjësimit të dokumenteve sipas listës së veçimit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: *DH/AB të marrë masa të mënjëherëshme për arkivimin e dokumentacionit që lidhet me veprimtarinë e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe me dokumentimin e procesit të certifikimit të Audituesve të Brendshëm.*
Ministri i Financave në cilësinë e përgjegjësit për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së AB të shfuqizojë nenin 23 të rregullores nr. 37, datë 10.03.2016 i cili specifikon se "*Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e çertifikimit dorëzohen dhe ruhen në protokollin e Ministrisë së Financave në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletoreve të provimeve dhe riprovimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 3 muaj nga data e dhënies së provimit/riprovimit si dhe të urdhërojë veçimin dhe asgjësimin e dokumentacionit të përkohshëm në përputhje me normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.*

3.11 Mbi rregjistrin e Audituesve të Brendshëm të Certifikuar *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 2)*

Situata: Nga auditimi për ushtrimin e funksioneve të DH/AB lidhur me hartimin dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të çertifikuar konstatohet se:
DH/AB mban regjistrin për audituesit e brendshëm që certifikohen si "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik", të emërtuar "Regjistri Themeltar i Audituesve të Brendshëm për çdo vit akademik" në të cilin përshkruhen: *Numri rendor që fillon me numrin 1, numri i amzës që fillon me numrin 0001, periudha e trajnimit, emri atësia mbiemri, modulet e trajnimit nga 1 në 5 (6 deri vitin e kaluar), data e lëshimit të certifikatës, vlerësimi dhe nënshkrimi i audituesit.*
Nga auditimi u konstatua se forma dhe përmbajtja e Regjistrit të Audituesve të Brendshëm përmban informacion të limituar. Regjistri duhet të emërtohet "Regjistri Kombëtar i Audituesve të Brendshëm të Certifikuar", për periudhën ...., ashtu siç është përcaktuar në ligj, dhe të përmbajë

informacion agregat në vite. Kjo do të mundësojë një pamje më të përgjithshme dhe me detaje të nevojshme për çdo person të përfshirë në sistemin e certifikimit të audituesve të brendshëm publik në Shqipëri, si dhe do ta bëjë këtë regjistër më të sigurt dhe më pak të cenueshëm prej manipulimit, apo ndërhyrjeve abuzive.

Përcaktimi i vlerës dhe i afatit të ruajtjes të Regjistri Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të Çertifikuar, si një dokument zyrtar i cili duhet të pasqyrojë të dhënat kryesore që përmban çertifikata me të cilën pajisen audituesit e çertifikuar si emrin atësinë mbiemrin, numrin e amzës, datën e lëshimit të certifikatës, vlerësimin e komisionit dhe nënshkrimin e audituesit të certifikuar dhe i shërben poseduesit të saj për të gjithë kohën që ai është i punësuar duhet të bëhet në përputhje me pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "*Për Arkivat*", neneve 21-23dhe 32-35 të "*Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*" dhe "*Listës Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Histarike Kombëtare (RHK)*", Artikulli përshkrues Nr. 287 dhe Nr. 288. Ky regjistër, krahas publikimit në faqen zyrtare të internetit në rubrikën përkatëse të Ministrisë së Financave duke ruajtur të dhënat personale të personave, duhet të protokollohet dhe të ruhet në zyrën e protokollit të kësaj Ministrie, si dokument i ruajtjes së përhershme dhe të shtohet me listën e audituesve të çertifikuar çdo vit.

Për sa më sipër gjykojmë se regjistri ekzistues duhet rishikuar dhe të ndërtohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit për Auditin e Brendshëm dhe Akteve të tjera rregulluese nënligjore, ku detyrimisht në përfundim të çertifikimit dhe dhënies së certifikatës, të evidentohen të dhëna për: nivelin e diplomës universitare që zotëron (në profesionin ekonomist, jurist apo disiplina të tjera), përvoja e punës në profesion, vitet e punës në total dhe ato në njab, modulet, vlerësimi respektiv të dhënë nga komisioni i kualifikimit, nënshkrimi prej anëtarëve të komisionit në çdo fletë të regjistrit, informacion në rast se ka ç'rregjistrim nga regjistri kombëtar si dhe informacion në rastet e konvertimit të çertifikatave etj. Ky regjistër në përfundim të çdo sezoni çertifikimi duhet plotësuar dhe depozituar në zyrën e protokoll arkivës të Institucionit si dokument i ruajtjes së përhershme.

Kriteri: Rregullore e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 37, datë 16.03.2016

Impakti: Mungesa e një Regjistri Kombëtar në formën zyrtare, me përmbajtje sipas kërkesave të ligjit dhe standardeve më të mira të kësaj fushe cenon besueshmërinë dhe sigurinë e informacionit të paraqitur në të.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DH/AB për plotësimin e këtij detyrimi

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Me qëllim që të përmirësohet mbajtja e Regjistrit Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të çertifikuar dhe të përmbajë një informacion të plotë dhe të pa cënueshëm nga manipulimet apo ndërhyrjet, DH/AB të rishikojë formatin e këtij regjistri dhe ta paraqesë për miratim tek Ministri i Financave si një dokument të ruajtjes së përhershme.

DH/AB të dorëzojë në Arkivin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Regjistrin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të Çertifikuar të përditësuar deri në sezonin e fundit të çertifikimit.

DH/AB të përpilojë listën e dokumenteve që krijohen gjatë procesit të

vlerësimit dhe çertifikimit të audituesve të brendshëm publik dhe t'i kërkojë Komisionit të ekspertizës përcaktimin e vlerës, afatin e ruajtjes dhe mënyrën e asgjësimit të dokumentave.

Observacion i subjektit:

Lidhur me konstatimin tuaj mbi formën dhe përmbajtjen e regjistrit të audituesve të brendshëm sqarojmë se të dhëna të tilla si: niveli i diplomës universitare që zotëron kandidati, përvoja e punës në profesion dhe përvoja në NJAB janë të dhëna që disponohen dhe përpunohen nga DH/AB në fazën e përzgjedhjes së kandidatëve për të ndjekur procesin e certifikimit, të cilat analizohet për përputhshmërinë me kriteret e miratuara në ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.Në lidhje me arkivimin e regjistrit të audituesve të brendshëm sqarojmë se na duket më e arsyeshme të arkivohet në përfundim të shpërndarjes së certifikatave të të gjithë përfituesve të titullit si "Auditues i Brendshëm në sektorin publik" për secilin sezon, si dhe për faktin se ky dokument shoqërohet dhe me nënshkrimet e audituesve të certifikuar.

Komenti i grupit të auditimit

Observacioni nuk pranohet pasi,duke e vlerësuar si një dokument tepër të rëndësishëm dhe të një rëndësie të veçantë me të cilin lidhet ushtrimi i profesionit të Audituesit të brendshëm publik është e rëndësishme të merren masa të menjëhershme për përmirësimin e tij për nga përmbajtje, si dhe ruajtjen në përputhje me normat tekniko organizative të ruajtjes së dokumentacionit në RSH.

3.12 Mbi trajnimin e Vijueshëm Profesional të administruar nga DH/AB
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 3)

Situata: Nga auditimi u konstatua se regjistri sipas të cilit DH/AB kryen administrimin e të dhënave të audituesve që kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional, nuk rezulton të garantojë saktësi të plotë të të dhënave, e reflektuar kjo në pamundësinë e DH/AB për identifikimin e personave që nuk kanë mundur të plotësojnë detyrimin për kryerjen e 80 orëve trajnim në dy vite, krahasuar me vitin e pjesëmarrësve në vitin e mëparshëm (grupi i auditimit identifikoi 6 raste, për të cilat nuk kishte të dhëna mbi mos kryerjen e trajnimit në programin e mëparshëm, për të plotësuar 80 orë trajnimi në dy vite), jo në përputhje të plotë me nenin 3, 5, 7, 11 dhe 14 të Rregullores së Trajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar sipas urdhrit nr. 3, datë 08.01.2016 të Ministrit të Financave.

Kriteri: Neni 3, 5, 7, 11 dhe 14 i Rregullores së Trajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar sipas urdhrit nr. 3, datë 08.01.2016 të Ministrit të Financave

Impakti: Pjesëmarrësit në trajnime nuk janë paraqitur në një formë që të mundësojë përpunimin e këtyre të dhënave dhe identifikimin e audituesve të cilët nuk kanë përmbushur 80 orë trajnim; Si rezultat DH/AB nuk ka mundur të identifikojë saktë personat që nuk kanë kryer 80 orë trajnim në dy vite dhe t'i paraqiteshin Bordit të KKAB.

Shkaku: Mangësitë në përpunimin e saktë të të dhënave sipas regjistrit të trajnimeve

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave të marrë masat për përgatitjen e një regjistri të plotë, i cili të

pasqyrojë saktë datën e certifikimit, audituesit e emëruar rishtaz, të larguar, me raport mjekësor etj, në mënyrë të identifikohen audituesit që nuk kanë përmbushur detyrimin për kryerjen e 80 orëve trajnim në dy vite, sipas nenit 5 të Rregullores së Trajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik.

Situata: Nga auditimi u konstatua se në Programin e Trajnimit të Vijueshëm Profesional, janë përzgjedhur për kryerjen e trajnimeve edhe punonjës të DH/KBFP dhe/ose anëtarë të KKAB, pozicione këto që kanë si përgjegjësi edhe administrimin e të dhënave të audituesve, vlerësimin e jashtëm të këtyre strukturave, mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e vendimeve lidhur me audituesit e brendshëm në sektorin publik. Gjithashtu, referuar kapaciteteve të Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, evidentohet nevoja për kryerjen e një planifikimi të ngarkesës që këto struktura kërkojnë, në mënyrë që pjesëmarrja në to të punonjësve të drejtorisë, të mos ndikojnë në kryerjen e detyrimeve kryesore të DH/KBFP.

Kriteri: Rregullorja e Trajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar sipas urdhrit nr. 3, datë 08.01.2016 të Ministrit të Financave

Impakti: Në programin e trajnimit të vijueshëm profesional janë pjesëmarrës 2 nga 5 anëtarët e KKAB, si dhe 2 punonjës të DH/KBFP në rolin e trajnerëve.

Shkaku: Mungesa e kryerjes së një vlerësimi të kapaciteteve të DH/KBFP si dhe analizimin e situatës për përfshirjen e të njëjtëve persona përgjegjës për administrimin, mbikëqyrjen, ekzekutimin e vendimeve lidhur me AB.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjatë përzgjedhjes së trajnerëve dhe anëtarëve të KKAB, të marrë masat për identifikimin e saktë të kapaciteteve dhe ngarkesës që kërkon angazhimi në këto struktura duke marrë në konsideratë përmbushjen e detyrave kryesore që këta punonjës kanë në Ministrinë e Financës, si dhe gjithashtu garantimin e ndarjes së përgjegjësive adminstrative, vlerësuese mbikëqyrëse dhe vendimarrëse të anëtarëve të tyre, mbi audituesit në sektorin publik.

Observacion i subjektit:

"Nga ana e menaxhimit të DH/KBFP është kryer në mënyrë të vazhdueshme një planifikim i vjetor i punës, ngarkesës për secilin specialist dhe jemi të bindur që pjesëmarrja si lektorë ne këto trajnime në bashkëpunim me ASPA-n, e disa prej punonjësve të drejtorisë nuk ka ndikuar në realizimin e detyrave por ka qenë një rrugë e mirë komunikimi me strukturat e auditimit të brendshëm për vënien në dukje të të metave e mangësive dhe eleminimin në vazhdimësi të tyre, nëpërmjet trajtimit të temave specifike dhe rasteve studimore në fushën e auditimit të brendshëm."

Komenti i grupit të auditimit

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

Kjo cështje është vetëm një aspekt i problematikës të konstatuar në vlerësimin e trajnimit të vijueshëm profesional, dhe referuar problematikës së vazhdueshme të raportuar nga ju si dhe të vënë në dukje nga ana jonë, mbi stafin e reduktuar të kësaj drejtorie, krahasuar aktivitetit të gjerë të saj, nuk mund të justifikojë pjesëmarrjen e vazhdueshme në këto trajnime, për këto arsye observacioni nuk meret parasysh.

B. GJETJET DHE REKOMANDIMET NË AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIN

3.13 Mbi diferencat e konstatuara në konsolidimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit të njësive të qeverisjes së përgjithshme *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 3)*

Situata: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Harmonizimit nuk rezulton të kryejë dhe dokumentojë në mënyrë të plotë dhe koncize konsolidimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit të dërguara nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme sipas shkresave përkatëse, në kundërshtim me nenin 26, pika 3 i cili citon se : *"Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për MFK ndihmon nëpunësin e parë autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të MFK dhe për përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e KBFP, ku përmblidhet informacioni i marrë, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.",* reflektuar kjo, në mangësitë dhe diferencat e evidentuara në sistemin PIFC me paraqitjen e rezultateve në mënyrë progresive në raportin vjetor të KBFP.

Kriteri: Neni 26, pika 3 e Ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar

Impakti: Konsolidimi i pyetësorëve nuk finalizohet me shifra të sakta dhe koncize në mënyrë që të kryhet saktë monitorimi i progresit të komponentëve ndër vite.

Shkaku: Mos kryerja e përditësimit të sistemit PIFC me pyetësorin e ndryshuar të MFK si dhe mangësitë në konsolidimin dhe unifikimin e të dhënave

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për përditësimin e sistemit PIFC me pyetësorin e ri në përputhje me manualin e MFK, në mënyrë që të dokumentohet saktë konsolidimi i të dhënave të gjeneruara nga njësitë, si dhe të monitorohet në mënyrë koncizë dhe të plotë progresi i komponentëve përkatës sipas vetëvlerësimit, në raportin e KBFP.

Observimi i subjektit

Për sa më sipër është mbajtur **Akt Konstatimi nr.3**, datë 08.06.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar me shkresën nr. 4816/8 datë 12.6.2018, ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

"Për Përshtatjen e ndryshimeve të reja të pyetësorit të vetëvlerësimit nga ana e DH/MFK, po bëhen vazhdimisht përpjekje për të zgjidhur këtë asistencë të azhdueshme. Konkretisht nëpërmjet asistencës së konsulentëve lokal dhe internacional po punohet për ndërtimin e një sistemi të ri në të cilin vetë institucionet të hedhin automatikisht të dhënat e pyetësorëve të vetëvlerësimit. Grupit të Auditimit të KLSH i janë dorëzuar të gjithë dokumentacionet e kërkuar duke përfshirë edhe pyetësorët evetëvlerësimit, përzgjedhja e të cilave është kryer në mënyrë rastësore nga ky grup".

Komenti i grupit të auditimit

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, nuk evidentohen fakte apo informacione të reja të cilat të konsiderohen nga grupi i auditimit. Sistemi i konsolidimit të të dhënave të pyetësorëve është një dokument i thjeshtë Access dhe referuar konkludimeve të DH/MFK në raportin vjetor të KBFP në shifra dhe vlera ekzakte, kjo drejtori duhet të ndërmarë masat

përkatëse për dokumentimin e saktë të këtyre rezultateve, dhe duke shmangur diferencat në mënyrat e ndryshme të dokumentimit të tyre: hard copy, elektronikisht,indikator, etj.

3.14 Mbi mos kryerjen e implementimit pilot të sistemeve të MFK në institucionet e përzgjedhura, për vitin 2017 *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 3)*

Situata: Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim planifikimet e aktiviteteve në kuadër të *shtyllës 5 të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020*, Drejtoria e Harmonizimit nuk ka mundur të kryejë implementimin e sistemit të MFK në asnjë nga njësitë e përzgjedhura pilot për vitin 2017, edhe pas ndryshimeve të kryera në numrin dhe llojin e tyre , duke mos përgatitur relacione shpjeguese dhe duke mos e prezantuar këtë cështje si mosrealizim objektivi në Raportin vjetor 2017. Konstatojmë gjithashtu se, përzgjedhja e Autoritetit Rrugor dhe Ministria e Brendshme, të cilat janë institucione të cilat kanë qenë pjesë e dy projekteve të mëparshme si njësi pilot të realizuara me ekspertë të huaj,, evidenton formalizmin në proces dhe lë të paqartë arsyet pse këto njësi klasifikohen si njësi pa sistem modern të MFK, edhe pse renditja e tyre në rankimet e pyetësorëve të vetëvlerësimit është e kënaqshme.

Kriteri: Shtylla 5 e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020

Impakti: Mos realizimi i një nga aktiviteteve kryesore të DH/MFK, evidenton mangësitë që ekzistojnë në planifikimet e kësaj drejtorie, të cilat ndikojnë edhe në progresin e pritshëm të objektivave të strategjisë.

Shkaku: Mos marrja e masave përkatëse nga drejtuesit e DH/KBFP për organizimin dhe planifikimin e punës sipas strategjisë 2014-2020.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për kryerjen sa më efektive të planifikimit dhe implementimit të sistemeve të MFK në institucionet pilot, në mënyrë që të realizohen pritshëmritë e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike në fushën e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik.

Observacion i subjektit:

"Procesi i pilotimit është një metodë e diktuar për herë të parë nga ana e projektit të binjakëzimit Austriako- Francez, në mënyrë që të mundësohej asistenca teknike mbi realizimin e kërkesave të MFK. Ministria e Brendshme është përzgjehdur për vitin 2018 për arsye se testimi është bërë më parë që në 2008, ndërsa Autoriteti Rrugor është zgjedhur si njësi shpenzuese me buxhet të konsiderueshëm dhe me vlerë të lartë të detyrimeve të prapambetura si dhe në fazë të ndryshimeve ristrukturore. Avokati i popullit dhe Autoriteti i Konkurrencës u përfshinë në planin e punës për tu monitoruar për herë të parë"

Komenti i grupit të auditimit

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

Për sa i përket përzgjedhjes së institucioneve, pavarësisht kohës në të cilën janë përfshirë këto institucione në projektet pilot, për shkak të numrit të madh të njësive që kanë nevojë për këtë asistim, cështja e ngritur nga grupi i auditimit vazhdon të ngelet një problematikë.

Gjithashtu, sqarojmë edhe njëherë që këto institucione janë përzgjedhur për implementimin pilot në vitin 2017, i cili nuk është kryer, edhe pse kjo nuk është interpretuar në këtë formë në Raportin vjetor të KBFP, për këto arsye observacioni nuk meret parasysh.

3.15 Mbi parregullsitë e konstatuara në monitorimet e kryera nga DH/MFK për vlerësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 3)

Situata: a. Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me nenin 18, pika 1 e Ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ku citohet se "*...Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga **njësitë e varësisë**, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji*", dhe urdhrin nr. 89 të Ministrit të Financave "*Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike"*, pika 3. II ku citohet se "*Raporti vjetor i konsoliduar për kontrollin e brendshëm hartohet bazuar në një sistem pikëzimi për çdo tregues të përcaktuar në këtë dokument (sipas formularit të kërkuar në Aneksin 1) dhe për çdo njësi qendrore apo vendore të monitoruar gjatë vitit, p.sh. për njësitë qendrore raportet që dorëzohen duhet të paraqiten në nivel grupi, i cili përfaqësohet nga mesatarja e pikëve të të gjithë sistemit (njësi qendrore + njësitë e varësisë), ndërsa për njësitë vendore do të jetë mesatarja e pikëve të njësisë: Bashki/Këshill qarku (aparat vendor + njësitë e varësisë).*", rezultoi se në dokumentacionin e dërguar pranë kësaj drejtorie nuk ka evidenca nëse në pyetësorët dhe raportet e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm nga njësitë e nivelit të parë të qeverisjes së përgjithshme janë kryer raportime në mënyrë të konsoliduar, pra duke përfshirë rezultatet edhe për njësitë e varësisë. Gjithashtu, edhe në kryerjen e monitorimeve për besueshmërinë e pyetësorëve, verifikimet e stafit të DH/MFK janë kryer vetëm për institucionin e përzgjedhur, pavarësisht se sipas kuadrit të sipërpërmendur, rezultatet e pyetësorit duhet të përfshijnë edhe varësitë e institucionit në fjalë.

Kriteri: Neni 18, pika 1 e ligjit "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*"; Pika 3. II e urdhrit nr. 89 të Ministrit të Financave "*Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike*".

Impakti: Pyetësorët e raportuar nga njësitë nuk paraqesin në mënyrë të konsoliduar rezultatin e përgjithshëm duke përfshirë dhe institucionet e varësisë si mesatare e tyre së bashku; gjithashtu dhe monitorimi nga DH/MFK kryhet mbi besueshmërinë e rezultatit vetëm të institucionit të përzgjedhur, duke mos përfshirë edhe varësitë.

Shkaku: Punonjësit e DH/MFK në raportimet e situatës së menaxhimit financiar dhe kontrollit në tërësi, si dhe në monitorimet e kryera, nuk kanë vepruar në përputhje me ligjin e MFK dhe metodologjinë e indikatorëve të performancës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të marrë masa për verifikimin dhe raportimin e saktë të pyetësorëve përgatitur nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe për kryerjen e monitorimeve duke vlerësuar besueshmërinë e pyetësorëve që përfshijnë jo vetëm institucionet

kryesore, por edhe varësitë përkatëse, në zbatim të ligjit dhe udhëzimit përkatës.

Situata:

b) Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e MFK i cili udhëzon *"Llogaritjen e numrit të njësive publike që do të monitorohen nga çdo punonjës i DH/MFK duke ndarë ditët e punës në dispozicion për një vit të caktuar që DH/MFK ka planifikuar të shpenzojë për vizitat në terren, si dhe duke u nisur nga kohëzgjatja e një vizite në terren.",* dhe sipas përqindjes: *50% njësi publike nga grupi "i performuesve të dobët", 25% nga "performuesit mesatar|, 25% nga "performuesit e mire" DH/MFK* nuk rezulton të ketë kryer dhe dokumentuar një analizë e tillë për përzgjedhjen e njësive që janë monitoruar . Gjithashtu, u konstatua se në përzgjedhjen e njësive për monitorim, nuk janë marrë në konsideratë: *rezultatet e pyetësorëve të institucioneve varësi të Kryeministrisë (grupi 87), rezultatet e pyetësorëve të Këshillave të Qarkut, njësitë shpenzuese të mëdha*; institucione këto që janë përfshirë sipas grupeve përkatëse, në raportin vjetor të KBFP.

c) Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me aneksin 9, pika 2 e Manualit të MFK ku citohet se: *"Dy javë para datës së vizitës në terren, DH/MFK, i dërgon shkresë kreut të subjektit me kërkesën për të përgatitur dokumentet përkatëse dhe të caktojë një person kontakti në njësi për të ndihmuar ekspertin e DH/MFK, për shembull të sigurojë dokumentet për ekspertin, të organizojë takime dhe kështu me radhë.",* shkresat për njoftimin e kryerjes së vizitës në terren janë dërguar nga DH/ MFK, në të njëjtën date, ku konkretisht për Bashkinë Elbasan, Peqin, Cërrik, MFE, Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, njoftimi është dërguar 5 ditë përpara fillimit të punës në terren, ndërsa për Bashkinë Durrës- Shijak; Kamëz-Krujë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Avokatin e Popullit, Prokurorinë e Përgjithshme, më shumë se 1 muaj përpara fillimit të punës në terren.

d) Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e Menaxhimit Financiar i cili citon "*Në përfundim të vizitës në terren punonjësi i DH/MFK kryen një vlerësim të përgjithshëm mbi besueshmërinë e procesit të vetë vlerësimit të njësisë publike: 100-75%- Vetëvlerësim i besueshëm dhe 74%-0%- Vetëvlerësim jo i besueshëm, i cili përfshihet në raportin vjetor të KBFP",* këto konkluzione të monitorimit mbi besueshmërinë e pyetësorëve nuk janë bërë pjesë e raportit të KBFP. Gjithashtu, vizitat në terren nuk janë shoqëruar me letrat e punës dhe dokumentime të tjera, në kundërshtim me aneksit 9 *"Metodologjia dhe lista e kontrollit për vizitat në terren",* pika 3.

e. Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me pikën 2.2.2 të Manualit të Menaxhimi Financiar, monitorimet e njësive publike nga Dh/MFK kryen në një periudhë shumë të reduktuar kohore(mars-maj) periudhë kjo kur duhet bërë dhe konsolidimi i rezultateve me qëllim rankimin e njësive dhe paraqitjen e tyre në Raportin Vjetor të KBFP. Pra monitorimet kryhen vetëm për efekt të raportit vjetor, dhe jo si një monitorim i vazhdueshëm nga ana e DH/MFK me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë, standardeve dhe udhëzimeve, i cili është një nga detyrimet kryesore të kësaj drejtorie, cituar në manual.

f. Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e MFK i cili

citon se: "Në përfundim të vizitës në terren, *hartimin nga punonjësit e DH/MFK të raportit për njësinë publike përkatëse, në të cilin krahas vlerësimit do të specifikohen edhe rekomandime konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të MFK. Ky raport i dërgohet zyrtarisht njësisë publike, e cila përgatit planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, të miratuar nga NA e njësisë publike. Një përmbledhëse e raporteve të vizitave në terren, bëhet pjesë e raportit vjetor të KBFP, në një kapitull të veçantë",* DH/MFK pas përfundimit të monitorimeve në terren, rezultatet e tyre publikohen në raportin vjetor të KBFP, dhe më pas raportet i dërgohen njësive të monitoruara së bashku me pasqyrat e planit të tyre për zbatimin e rekomandimeve dhe implementimet në zbatim të përmirësimit të sistemeve të MFK. Në monitorimet e vitit 2016, raportet u janë dërguar njësive <u>në nëntor të vitit 2017</u>, dhe në këto raporte, jo në të gjitha rastet ishte vendosur niveli i besueshmërisë pas monitorimit; nuk ishin plotësuar pasqyrat sipas së cilave punonjësit përgjegjës për monitorimin duhet të bëjnë dokumentim të krahasimeve të pyetësorëve të dorëzuar nga njësia me situatën reale; por ishin bashkëlidhur vetëm rekomandimet e lëna për njësinë. Konstatojmë se edhe për monitorimet e kryera për pyetësorët e vitit 2017, u ndoq e njëjta praktikë. Raportet në përfundim të monitorimeve nuk u dërguan në njësitë e monitoruara, nuk u protokolluan dhe nuk ju vunë në dispozicion grupit të auditimit deri në fund të këtij auditimi edhe pse rezultatet e këtyre monitorimeve janë përfshirë në Raportin vjetor të KBFP për vitin 2017. Në këtë raport nuk shohim që DH të shprehet për raste kur vlerësimi i tyre ishte korrigjues nga ai i vetëvlerësimit.

g. Nga auditimi u konstatua se manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit udhëzon se ndjekja e rekomandimeve do të kryhet në monitorimin e ardhshëm të institucioneve, por referuar numrit të monitorimeve të kryera gjatë një viti, si dhe metodologjisë sipas së cilës kjo përzgjedhje kryhet, <u>ndjekja e rekomandimeve do të mund të realizohet disa vite me vonë</u> (*mesatarisht 115 njësi publike që dorëzojnë pyetësorë/mesatarisht 15 monitorime në vit = 7 vjet. Pra ndjekja e rekomandimeve do të kryhet pas më shumë se 5 vitesh*).

<u>Kriteri:</u> Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

<u>Impakti:</u> Procedurat për planifikimin, kryerjen dhe raportimin e monitorimeve nuk është kryer në përputhje me manualin e MFK , mungojnë letrat e punës gjatë gjithë procesit që nga planifikimi deri në përfundim të monitorimit.

<u>Shkaku:</u> DH/MFK nuk ka organizuar punën për kryerjen e monitorimeve sipas parashikimeve të kuadrit ligjor përkatës.

<u>Rëndësia:</u> E lartë

<u>Rekomandimi:</u> Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për kryerjen e monitorimeve duke ju referuar plotësisht kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, me qëllim raportimin sa më të plotë dhe efektiv të nivelit të besueshmërisë dhe konstatimeve të siguruara gjatë vizitave në terren.

Observacion i subjektit:

"-Mbi përzgjedhjen e institucioneve të monitoruar janë kryer mbledhje të vazhdueshme dhe përzgjedhja është kryer bazuar në metodologjinë e monitorimit në terren, por në kuadër të përzgjedhjes të sa më shumë institucioneve, DH/MFK, vendosi të përfshijë edhe institucione

gjeografikisht afër. Për përfshirjen e institucioneve të grupit 87 si dhe Këshillat e Qarkut në monitorime, kjo është e pamundur për shkak të numrit të stafit.

- Gjithashtu dhe në manualin e MFK-së theksohet që informacioni i paraqitur pranë Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi funksionimin e sistemit të MFK-së nga njësitë publike duhet të jetë një informacion i konsoliduar, i cili duhet të përfshijë dhe informacionin nga njësitë e varësisë. Si rrjedhojë, mbi bazën e këtij informacioni të konsoliduar, DH/MFK-ja përfshin në mënyrë indirekte dhe analizën e këtyre njësive të varësisë.Përsa më sipër, DH/MFK konsideron të konsoliduar informacionin e përfshirë në pyetësorët dhe raportin që sjellin NJQP. Megjithatë, gjatë realizimit të vizitave në terren, punonjësit e DH/MFK i kërkojnë insitucioneve vënien në dispozicion të emaileve apo shkresave zyrtare të përcjelljes së pyetësorëve të vetëvlerësimit drejt institucioneve të varësisë.

- DH/MFK, dokumenton të gjithë procesin e realizimit të monitorimeve në terren duke filluar nga dërgimi i shkresës zyrtare pranë institucionit që do të monitorohet ku përshkruhet qëllimi i monitorimit dhe elementët objekt i monitorimit. Gjithashtu, përcaktohen ditët e monitorimit dhe më pas në përfundim të procesit, DH/MFK iu dërgon institucioneve të monitoruara një shkresë feedback me gjetjet kryesore dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e sistemit të MFK. Shkresat e informimit mbi nisjen e monitorimeve janë hartuar dhe dërguar për konfirmim të Sekretari i Përgjithshëm në kohën e duhur nga ana e DH/MFK, dhe vonesat mund të kenë ardhur nga ngarkesa e S.P në firmosjen finale të tyre.

- Monitorimi ka shërbyer si instrument ndërgjegjësimi pasi është vënë re një ulje e subjektivismit dhe i janë afruar më shumë realitetit në përgjigjet e dhëna. Gjatë monitorimit janë mbajtur list prezenca të pjesëmarrësve në takime si dhe shkresat e përgjigjeve janë duke u përgatitur pasi dërgohen pas raportit vjetor.

Komenti i grupit të auditimit

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni nuk meret parasysh për arsyet e mëposhtme:

- Lidhur me përzgjedhjen e institucioneve, mbledhjet dhe analizat e kryera nga DH/MFK së bashku me institucionet e shtuara në monitorim, nuk janë dokumentuar dhe nuk i janë vendosur në dispozicion grupit të auditimit.

-Lidhur me konsolidimin e pyetësorëve të varësisë nga njësia qendrore, DH/MFK nuk kryen një verifikim të pyetësorit të institucionit qendror së bashku me varësitë, pasi ai ka konkluduar në pyetësorin final, por vetëm për pyetësorin dhe raportin e njësisë qendrore, pasi institucione varësie nuk janë monitoruar, dhe ky dokument do të jetë i ndryshëm nga ai dërguar pranë drejtorisë, fakt ky, i konstatuar edhe nga pyetësorët tanë me stafin e drejtorisë, dhe shqyrtimin e raporteve në njësitë ky është kryer monitorimi.

- Dokumentacioni i vendosur në dispozicion grupit të auditimit për monitorimet e kryera për pyetësorët e vitit 2017, përfshinte vetëm shkresën e njoftimit për subjektet përkatëse, duke përjashtuar kështu dokumentacionet sipas formateve të parashikuara në manualin e MFK, trajtuar më hollësisht si më sipër.

3.16 Në lidhje me opinionin e përgjithshëm të DH/KBFP mbi efektivitetin e njësive të qeverisjes së përgjithshme dhënë ne Raportin vjetor të KBFP për vitin 2017.
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)

Situata:

Me paraqitjen e pikëve dhe rankimin e njësive të analizuar për të 20 indikatorët bëhet një paraqitje dhe analizë e sistemit të kontrollit në të 4 komponentët e tij, analizë mbi të cilën konkludohet nga Drejtoria e Harmonizimit (DH) se: ***"Opinion i Përgjithshëm:*** *Nga analiza e përgjithshme e këtyre indikatorëve, ne mund të arrijmë një konkluzion paraprak mbi komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Treguesit e mësipërm lidhen kryesisht me komponentin e aktivitetit të kontrollit, që përfshin ekzistencën e rregullave dhe procedurave të shkruajtura të proceseve kryesore si: të prokurimeve, të kontratave, urdhër-shpenzimeve, etj. Nga analiza e përgjithshme, rezulton që ka kontrolle efektive të ndërmarra nga ana e institucioneve, ku mesatarisht efektiviteti i tyre për njësitë e qeverisjes së përgjithshme* ***është 87%.*** *Megjithatë, në disa indikator apo tregues specifik lind nevoja për marrjen e masave për përmirësime të vazhdueshme në periudhat e ardhshme".*

Nga shqyrtimi i të dhënave, databaza e indikatorëve të dërguar nga Drejtoria e Thesarit dhe Drejtoria e Buxhetit sipas Urdherit nr. 89 si dhe databaza e indikatorëve të MFK dhe AB të përpunuara dhe administruara nga DH, konstatojmë se opinioni i mësipërm është dhënë në përfundim të përpunimit të të dhënave të **126 njësive** nga të cilat: 11 Ministrive të linjës, 61 Bashkive, 26 Institucioneve të pavarura; 17 njësi të grupit 87-në varësi të Kryeministrit dhe 11 njësi shpenzuese me buxhet të madh. Pra, paraqitja dhe vlerësimi i efiçenses së indikatorëve të performancës dhe opinioni për nivelin e funksionimit të sistemeve të kontrollit është bazuar në gjithsej 126 njësi nga 1253 njësi shpenzuese[3] ose 10% e numrit gjithsej.

Duke vazhduar më tej me shkallën e mbulimit të vlerësimit dhe onitorimit të sistemit të njësive të qeverisjes së përgjithshme, konstatojmë se indikatorët e Ministrive të linjës dhe rankimi i tyre përfaqëson vetëm situatën e sistemeve të kontrollit të brendshëm për aparatet e Ministrive dhe jo për njësitë e varësisë bazuar në shqyrtimin e raporteve dhe pyetsorëve të dorëzuar nga ministritë e linjës dhe intervista me specialistë të DH që përpunojnë këta pyetsorë. Konkretisht, pyetsori i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është plotësuar vetëm për aparatin e kësaj ministrie dhe nuk ka informacion për njësitë e varësisë. Në relacionin shoqërues flitet për ndryshimet strukturore të Ministrisë së Financave në fund të vitit 2017 me përthithjen e disa programeve të Ministrive të cilat më pas pushuan së ekzistuari por nuk ka asnjë koment apo shënim konkret se si ky proces ndikoi në 5 komponentët e menaxhimit financiar duke filluar me: analizën dhe azhornimin e risqeve që do të sillte ky ndryshim në burimet njerëzore, sistemet e komunikimit dhe informimit, monitorimit, kontabilitetit, inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme (transferimi nga librat kontabël të një ministrie te tjetra), delegimin dhe dorëzimin e detyrave, dhe rrjedhimisht gjykojmë se nuk janë pasqyruar në vetëvlerësimin e MFE.

[3] *Burimi: Sistemi i Pagesave -Drejtoria e Thesarit- Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

Gjatë auditimit konstatuam se, disa njësi varësie sjellin pyetësorin e vetevlerësimit pranë DH por ai nuk konsolidohet nga DH me argumentin (e specialistes përkatëse) se ai mund të ketë mbërritur në MFE si një kopje dytë ndërkohë që duhet të jetë dërguar tek njësia mëmë.
Të pyetur nëse gjatë monitorimeve të verifikimit të besueshmërisë së pyetsorëve është parashikuar verifikimi nëse këta pyetësor janë konsoliduar me vetëvlerësimet e njësive të varësisë, përsëri përgjigja është se një verifikim i tillë nuk bëhej sepse "çdo njësi varësie funksionon më vete me titullarë përgjegjës më vete".[4] Në kuadër të testimeve, iu kërkua Nëpunësit zbatues të MFE[5] të na vihen në dispozicion pyetsorët e njësive të varësisë me qëllim llogaritjen e efektivitetit të ministrive të linjës, me gjithë njësitë e tyre të varësisë. (Deri më 12.6.2018, nuk na është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar).

Kriteri: Ligji nr. 10 296 dt. 10.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *"Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në procesin e monitorimit të KBFP* Neni 6 Pika 1, pika a), b) dhe c): Përgjegjësitë e Ministrit të Financave ,
Neni 7 Pika 2: Përgjegjësitë e Nëpunësit të parë autorizues Neni 18 Pika 3, Neni 26 Pika 1,2 dhe 3, Neni 28 Pika 1,4 dhe 5: Përgjegjësitë e Bordit të Mbikëqyrjes së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.
Urdhri nr. 89 dt. 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë së për monitorimin e performancës së njësive publike"

Impakti: Për sa më lartë, vlerësimet e paraqitura në raportin vjetor të KBFP janë përpiluar **në kundërshtim me Pika II. Paragrafi 4 i Metodologjisë së vlerësimit të performancës së njësive publike" miratuar me Urdhrin nr. 89 dt. 28.12.2015.** Duke u nisur nga referimi në opinionin e përgjithshëm, për efektivitetin që është i bazuar "*kryesisht me komponentin e aktivitetit të kontrollit*"[6], në gjykimin tonë, raportit i mungon një tregues efektiviteti për të 126 njësitë e marra në analizë dhe i llogaritur mbi bazën e rezultateve të performancës të 20 indikatorëve**.** Ky tregues, do të mund të ekstrapolohej më pas në nivel sistemi publik në bazë dhe të peshës specifike apo faktorit të rëndësisë që këto 126 zënë në buxhetin e shtetit, për të paraqitur drejtë dhe me transparencë situatën e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik. Si konkluzion, në gjykimin e grupit të auditimit**, treguesi 87% i efektivitetit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është përfaqësues i sistemit të qeverisjes së përgjithshme dhe 20 indikatorëve** të miratuar me Urdhrin nr. 89 dt. 28.12.2015 i Ministrit të Financave.

Shkaku: Mungesë përgjegjshmërie menaxheriale në zbatimin e Metodologjisë së vlerësimit të performancës të sektori publik me pasojë shkelje e Pika II. Paragrafi 4 i Metodologjisë së vlerësimit të performancës së njësive publike" miratuar me Urdhërin nr. 89 dt. 28.12.2015.

Rëndësia: E lartë

[4] *Intervistë, E-mail: 2 specialiste të DH/MFK*
[5] *E-mail dt. 01.06.2018dërguar Zj. Roza naumi- Drejtore Financës pranë MFE*
[6] *I analizuar në në pjesën e II-të, pika 2.1.3 e Raportit vjetor 2017*

Rekomandimi: DH/KBFP duhet menjëherë të rishikojë proceset e punës, metodologjine e vizitave në terren, trajnimin e punonjësve të caktuar për monitorim dhe përpunim të m pyetësorëve të vetëvlerësimit, të azhornojë gjurmën e auditimit në lidhje me procesin e monitorimit dhe pilotimit me qëllim zbatimin në përputhje të plotë me Metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 89 dt. 28.12.2015.

*Për sa më sipër është mbajtur **Akt-konstatimi nr.4** dt. 14.6.2018 lidhur me opinionin e përgjithshëm mbi efektivitetin e njësive të qeverisjes së përgjithshme në pjesën e parë të Raportit vjetor për vitin 2017. Në vijim është observacioni i subjektit në përgjigje të këtij akt-konstatimi.*

Efektiviteti i përgjithshëm i njësive të qeverisjes së përgjithshme është llogaritur mbi bazën e sistemit të vlerësimit të indikatorëve të përcaktuar në metodologjinë e miratuar nga Ministri I Financave nr.89, datë 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike". Sipas nenit 18, pika 1, të Ligjit nr. 10296, i ndryshuar, Nëpunësi Autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe Nëpunësi i Parë Autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion për njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji. Gjithashtu dhe na manualin e MFK-së theksohet që informacioni i paraqitur pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi funksionimin e sistemit të MFK-së nga njësitë publike duhet të jetë një informacion i konsoliduar, i cili duhet të përfshijë dhe informacionin nga njësitë e varësisë. Si rrjedhojë, mbi bazën e këtij informacioni të konsoliduar, DH/MFK-ja përfshin në mënyrë indirekte dhe analizën e këtyre njësive të varësisë.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit u shqyrtua observacioni i ardhur nga DH/MFK me shkresën nr. 4816/11 prot, datë 19.06.2018 dhe risjellim në vëmendje se çështja e përfshirjes së njësive të varësisë është trajtuar në këndvështrimin e rolit të DH/MFK e cila i përdor të dhënat e pyetësorëve për të përpiluar Raportin vjetor të KBFP i cili paraqitet në Parlament nga Ministri I Financave dhe Ekonomisë. Për sa kohë kjo drejtori nuk ka kontrolle si gjatë përpunimit ashtu dhe gjatë monitorimit në terren për të verifikuar, konfirmuar saktësinë e pyetësorëve kjo ngarkon me përgjegjësi këtë Drejtori për pasaktësitë e vlerësimit të sistemit MFK në sektorin publik.

3.17 Në lidhje me mënyrën e zbatimit të "Metodologjia e vlerësimit të performancës" miratuar me Urdhërin nr. 89 të Ministrit të Financave dt.28.12.2015
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)

Situata: Në lidhje me mënyrën e zbatimit të "Metodologjia e vlerësimit të performancës" e miratuar me Urdhërin nr. 89 të Ministrit të Financave dt. 28.12.2015 konstatojmë se: Nga shqyrtimi i të dhënave të paraqitura në raport DH përdor një numër të ndryshëm indikatorësh për grup-njësi të ndryshme rrjedhimisht numër pikësh potenciale maksimale (600=

20indikatorë*30pikë)" të ndryshme. Metodologjia përcakton 23 indikatorë shoqëruar me anekset përkatëse udhëzuese për mënyrën e llogaritjes të secilit prej tyre. Këta indikatorë, plotësohen nga titullarët e njësive publike ose specialisti përgjegjës në DH/AB[7]. Në këtë metodologji nuk përcaktohen kufizime nëse për grup njësi të ndryshme duhen aplikuar indikatorë të ndryshëm apo ato mund të përjashtohen për shkak të mungesës së të dhënave. Kështu në raport vlerësimet janë bërë mbi bazën e kufijve maksimalë të paraqitur në tabelën si vijon:

Nga shënimet shpjeguese të tabelave të indikatorëve, grupi i auditimit nuk arrin dot në konkluzionin nëse disa indikatorë lihen jashtë vlerësimit për mungesë të dhënash apo për shkak të performancës së ulët?

Në konfirmim të sa më lartë, grupi i auditimit ka bërë një përllogaritje të treguesit të përformancës së sistemi KBFP bazuar në nivelin maksimal 600 të pikëve të mundshme, pa marrë parasysh këtu gabime të mundshme në përpunim[8], saktësi dhe besueshmëri në raportim[9] të cilat janë trajtuar në pikat e tjerat të këtij auditimi. Rezultati për çdo komponent dhe 126 njësi paraqitet si më poshtë ku treguesi i efektivitetit të menaxhimit të Buxhetit është në nivel NËN 50%; Thesari 65%'; auditi i brendshëm 63% dhe MFK 88%.

Kriteri: Ligji nr. 10 296 dt. 10.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *"Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në procesin e monitorimit të KBFP* Neni 6 Pika 1, pika a), b) dhe c): Përgjegjësitë e Ministrit të Financave ,
Neni 7 Pika 2: Përgjegjësitë e Nëpunësit të parë autorizues Neni 18 Pika 3, Neni 26 Pika 1,2 dhe 3, Neni 28 Pika 1,4 dhe 5: Përgjegjësitë e Bordit të Mbikqyrjes së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.
Urdhëri nr. 89 dt. 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë së për monitorimin e performancës së njësive publike"

Impakti: Pasaktësi në prezantimin real të situatës së sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.

Shkaku: Mungesë të dhënash nga drejtoritë e Buxhetit dhe Thesarit, mungesë përgjegjshmërie menaxheriale në bërjen transparente të problemit të grumbullimit të të dhënave me zgjidhje që deformojnë rezultatin real të vlerësimit të sistemit të kontrollit financiar financiar publik.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH në rolin e saj udhëheqës si harmonizuese, zhvilluese e metodologjive, bazës ligjore, manualeve etj., duhet bëjë një analizë dhe vlerësim të indikatorëve pas vitit të dytë të aplikimit të tyre. Kjo analizë duhet të ketë si objektiv vlerësimin bazuar në eksperiencën e deritanishme në grumbullim, përpunim, shpjegim, problematika reale të ardhura nga AB, auditi i jashtëm (KLSH) dhe rekomandimeve të SIGMA; të vlerësojë nëse ato janë relevante, efektive, transparente dhe paraqesin me transparencë, realitetin e sistemeve të kontrollit për të gjithë njësitë e qeverisjes publike; të identifikojë nëse ka paqartësi me Anekset dhe shpjegimet e tyre për mënyrën e llogaritjes së indikatorëve,

[7] *Urdhëri nr.89 i Ministrit të Financve dt.28.12.2015, pjesa II*
[8] *Trajtuar si pikë e vecantë mbi testimin e aplikacionit PIFC dhe procesit të punes së përpunimit të pyetsorëve.*
[9] *Trajtuar si pikë e vecantë"Mbi monitorimet besueshmërisë e MFK"*

*Për sa më sipër është mbajtur **Akt-konstatimi nr. 4** dt. 14.6.2018 lidhur me opinionin e përgjithshëm mbi efektivitetin e njësive të qeverisjes së përgjithshme në pjesën e parë të Raportit vjetor për vitin 2017. Në vijim është observacioni I subjektit në përgjigje të këtij akt-konstatimi.*

Metodologjia e sipërpërmendur është një akt nënligjor I përbashkët ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit. Sipas kësaj metodologjie, përpunimi i informacionit për 10 indikatorë (të evidentuara në metodologji) kryhet nga Drejtoria e Thesarit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe dërgohet më pas DH/KBFP, e cila përpunon informacionin në varësi të kërkesave të metodologjisë së vlerësimit. Për grupe të caktuara institucionesh, si Bashkitë, Institucionet e pavaruara, Grupi 87 dhe njësitë shpenzuese me buxhet të madh, nuk janë marrë në analizë të 20 indikatorët për shak të mungesës së të dhënave dhe pamundësisë për nxjerrjen e tyre nga sistemi. Ndaj, për të pasur një rankim sa më realist janë marrë në konsideratë vetëm ato indikatorë për të cilët disponoheshin të dhëna për të gjitha institucionet përkatëse. Vlerësimi me 0 pikë i këtyre indikatorëve që mungojnë nuk ndikon në vlerësimin e përgjithshëm dhe rankimin e këtyre institucione. Gjithashtu vlen të theksohet se DH/MFK ka parashikuar në planin e punës për vitin 2018 dhe rishikimin dhe përmirësimin e metodologjisë së mësipërme.

***Komenti i grupit të auditimit**:*

Nga grupi i auditimit u shqyrtua observacioni i ardhur nga DH/MFK me shkresën nr. 4816/11 prot, datë 19.06.2018 dhe risjellim në vëmendje se çështja e analizës së indikatorëve të përformancës mbetet pasi ato të analizohen për efikasitetin dhe relancën e tyre. Në rishikimin metodologjisë, DH/MFK të mbajë parasysh specifikat e çdo grup-njësi të qeverisjes së përgjithshme dhe të shqyrtojë arsyet pse mungojnë të dhënat dhe jo thjesht ti përdori ato si justifikim për përjashtimin e tyre nga vlerësimi.

3.18 Në lidhje me paraqitjen e të dhënave në Raportin vjetor të KBFP për vitin 2017 *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)*

Situata: Ndryshe nga Raporti i KBFP për vitin 2016, në paraqitjen e rezultateve të rankimit të Ministrive të linjës mungon analiza krahasimore në total për çdo ministri. Nëse do të bëhej kjo do ishte lehtësisht e lexueshme se **në të gjitha ministritë ka ulje të pikëve në total të 20 indikatorëve (ose 6% krahasuar me vlerësimin mesatar të një viti më parë)**. Nëse kjo analizë do të bëhej dhe rezultatet e saj do të paraqiteshin në raport, do të dukej qartë se indikatorët me ndikim më te madh në vlerësimin mesatar në rënie janë ato të: Thesarit -12% dhe Buxhetit -13%: Indikatori 1 "Dorëzimi në kohë i faturave në Thesar" ; Indikatori 4. "Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar" dhe Indikatori 10. "Krijimi i detyrimeve të reja".

Kriteri: Ligji nr. 10 296 dt. 10.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *"Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në procesin e monitorimit të KBFP* Neni 6 Pika 1, pika a), b) dhe c): Përgjegjësitë e Ministrit të Financave , Neni 7 Pika 2: Përgjegjësitë e Nëpunësit të parë autorizues Neni 18 Pika 3,

Neni 26 Pika 1,2 dhe 3, Neni 28 Pika 1,4 dhe 5: Përgjegjësitë e Bordit të Mbikëqyrjes së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.
Urdhëri nr. 89 dt. 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë së për monitorimin e performancës së njësive publike"

Impakti: Mungesë transparence në paraqitje të situatës reale të sistemit financiar dhe kontrollit.

Shkaku: Formati i raportit vjetor ndryshon sipas racionalitetit dhe propozimeve të menaxhimit të DH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Në funksion të qëllimit të dhe objektivit që Raporti vjetor i KBFP ka, DH duhet të sigurojë të dhënat dhe të kryejë analizë dhe paraqitje krahasimore të progresit të zhvillimit të sistemeve të kontrollit dhe performancës së sektori publik. Kjo në përputhje dhe me objektivat e përcaktuar në Strategjinë e MFP 2014-2020.

Observacion i subjektit

*Për sa më sipër është mbajtur **Akt-konstatimi nr. 4** dt. 14.6.2018 lidhur me opinionin e përgjithshëm mbi efektivitetin e njësive të qeverisjes së përgjithshme në pjesën e parë të Raportit vjetor për vitin 2017. Në vijim është observacioni i subjektit në përgjigje të këtij akt-konstatimi.*

Për shkak të procesit të ristrukturimit të disa Ministrive të linjës gjatë vitit 2017, në raportin vjetor për këtë vit nuk është paraqitur analiza krahasuese për ministritë e linjës për vitin 2017-2016, për të shmangur krahasimin mes informacioneve që nuk kanë bazë të njëjtë krahasimore. Informacioni për minitrië e linjës, përfshin Brenda dhe informacionin e funksioneve të përthithura nga ish ministritë e mëparshme, i cili vjen i konsoliduar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit u shqyrtua observacioni i ardhur nga DH/MFK me shkresën nr. 4816/11 prot, datë 19.06.2018. Në dokumentacionin e shqyrtuar gjatë auditimit nuk rezultoi ndonjë analizë apo koment për të shpjeguar se si pyetësorët e ministrive të linjës të përfshira në ristrukturim kishin përfshirë ose jo problematika apo situatën e programeve individuale të përthithura. Gjithsesi në tërësinë e tij mesatarja e pikëve për të gjitha Ministritë e linjës është më e ulët se ajo e një viti më parë në të 4 (katër) komponentët e saj: Thesar, Buxhet, MFK dhe AB.

3.19 Në lidhje me indikatorët e menaxhimit të Buxhetit dhe operacioneve të Thesarit; Sipas Urdhërit nr. 89 dt.28.12.2015 *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)*

Situata: Në lidhje me indikatorët e menaxhimit të Buxhetit dhe operacioneve të Thesarit; Sipas Urdhërit nr. 89 dt. 28.12.2015, Drejtoria e Thesarit dhe Drejtoria e Buxhet janë përgjegjëse për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e indikatorëve respektivë tek DH, për efekt konsolidimi në Raportin vjetor të KBFP. Me qëllim testimin e të dhënave dhe treguesve të paraqitur në Raportin vjetor i cili më pas do të bëhet pjesë e Raportit të zbatimit të Buxhetit të shtetit sipas Ligjit nr. 9936 dt. 26.6.2008, ju kërkua specialistëve të DH të na përcillej materiali i dërguar nga Drejtoritë e Thesarit dhe Buxhetit. Nga informacioni i marrë, u konstatua se përveç përcjelljes së tabelave të indikatorëve në format Excel, nga specialistet e drejtorisë së Buxhetit dhe Thesarit tek specialistet e MFK, nuk përcillet ndonjë analizë mbi monitorimin, vlerësimin e indikatorëve Thesar, Buxhet

dhe problematika të dala gjatë vitit me qëllim përpilimin e rekomandimeve që më pas do të diskutohen e miratohen në Parlament. Përjashtim bën vetëm indikatori 7 : Raporti fakt/plan i shpenzimeve korente" i shoqëruar me një shpjegim për vlerësimin mesatar në rang ministrie linje.

Për sa i përket saktësisë së vlerësimit të indikatorëve, nga shkëmbimi i informacioneve me rezultatet e auditimit financiar të KLSH për aparatin e MFE (përfunduar maj 2018) kemi konstatuar pasaktësi në në indikatorin "krijimi i detyrimeve të reja" ku MFE vlerësohet me 30 pikë maksimale për 0% fatura gjendje të papaguara më 31.12.2017. Kështu, informacioni i marrë nga grupi me burim Drejtoreshën e Financës së MFE, rezulton se shuma e faturave të prapambetura më 31.12.2017 ishte 30 milion lekë por që pas testimeve të po këtij grupi konstatohet se kjo vlerë është shumë e madhe. Në objektin e këtij auditimi, ky informacion vë në diskutim saktësinë e vlerësimit të indikatorit dhe përgjegjshmërinë në paraqitjen e tij dhe analizën e tij. Për dy grup indikatorët e mësipërm, DH në rolin e saj si konsoliduese e të dhënave bën vetëm një përmbledhje mekanike të shifrave dhe një analizë të thjeshtë statistikore krahasimore me një vit më parë dhe në disa raste identifikon performuesin më të mirë apo më të dobët. Në gjykimin e grupit të auditimit, DH/MFK nuk kryen kontrollo analitike për të siguruar saktësinë e tyre pavarësisht se kush e ka përgjegjësinë e përpilimit të tyre. Minimalisht duhet të bëhet një analizë mbi korrelacionin e indikatorëve: psh: nëse ka kontrata të dorëzuara me vonesë ekziston rreziku i krijimit të faturave të prapambetura. Për më tepër, analiza e indikatorëve si variabla të njeri tjetrit nxjerr në pah dhe subjektivizmin në vlerësim të indikatorëve të MFK dhe AB-së. Si mund të jetë situata e aktiviteteve të kontrollit, mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut kaq perfekte kur ende jemi në nivele 53% dhe 21% të dorëzimit të faturave dhe kontratave dhe në njësi ku performojnë mbi mesataren në AB dhe MFK. Grupi i auditimit ka përpiluar hartën e performancës së disa indikatorëve ku ilustron rastet me vlerësime maksimale në elementët e kontrollit por jo të zbatimit dhe operacioneve.

Kriteri: Ligji nr. 10 296 dt. 10.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *"Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në procesin e monitorimit të KBFP* Neni 6 Pika 1, pika a), b) dhe c): Përgjegjësitë e Ministrit të Financave ,
Neni 7 Pika 2: Përgjegjësitë e Nëpunësit të parë autorizues Neni 18 Pika 3, Neni 26 Pika 1,2 dhe 3, Neni 28 Pika 1,4 dhe 5: Përgjegjësitë e Bordit të Mbikëqyrjes së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.
Urdhëri nr. 89 dt. 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë së për monitorimin e performancës së njësive publike"

Impakti: Pasaktësi të theksuara në paraqitjen dhe vlerësimin e indikatorëve të Buxhetit dhe rrjedhimit në vlerësimin total të njësive të qeverisjes së përgjithshme,

Shkaku: Mungesë përgjegjshmërie menaxheriale e Drejtorisë së Harmonizimit në realizimin e detyrimit të saj ligjor për përpilimin e Raportit vjetor të KBFP. Mungesë e kontrolleve të detajuara në procedurat e grumbullimit dhe verifikimit të informacionit të marrë nga Drejtoritë e Buxhetit dhe Thesarit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/MFK duhet që menjëherë të rishikojë metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik, mënyrën e komunikimit midis drejtorive përgjegjëse, relacionet dhe analizat shoqëruese. Të krijojë kontrollet analitike që të sigurojë saktësinë e informacionit të marrë nga këto Drejtori me përgjegjësinë e njësisë që konsolidon të dhënat që paraqiten në Raport e më pa në Parlament nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Observacion i subjektit:

Metodologjia e sipërpërmendur është një akt nënligjor i përbashkët ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit. Sipas kësaj metodologjie, përpunimi i informacionit për 10 indikatorë (të evidentuara në metodologji) kryhet nga Drejtoria e Thesarit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe i dërgohet më pas DH/KBFP, e cila e përpunon informacionin e dërguar nga këto dy drejtori në varësi të kërkesave të metodologjisë së vlerësimit. Në vazhdimësi, do të realizohet vlerësimi i Metodologjisë së Monitorimit të Performancës së Njesive Publike me synim përmirësimin e mëtejshëm të saj në funksion të monitorimit sa më efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe performancës së institucioneve.

3.20 Në lidhje me indikatorët e performancës së auditit të brendshëm sipas Urdhërit nr. 89 dt. 28.12.2015 *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)*

Situata: Në lidhje me indikatorët e performancës së auditimit të brendshëm[10]: Indikatorët e AB kanë si synim matjen e performancës së strukturave të njësisë së auditit të brendshëm, mirë-funksionimin, efikasitetin dhe efiçencën e tyre në sektorin publik. Gjatë auditimit u konstatua se:

Indikatori 16 i llogaritur sipas udhëzimeve në Aneksin 19 nuk parashikon vlerësim për njësitë që i kanë audituesit në proçes certifikimi dhe lë vend për gjykim dhe ndërhyrje në vlerësimin përfundimtar. Nga vlerësimi i 28 njësive AB ose 24% e gjithë njësive të AB: Përqindja e devijimit në kampion me 65% vetëm për grupin e Bashkive, e cila e aplikuar në totalin e njësive të vlerësuara 61, do të ndryshonte vlerësimin e përgjithshëm të indikatorit nr. 16 nga 53% në 44% .

Indikatori 20 i llogaritur sipas udhëzimeve në Aneksin 23 çon në rezultate dhe vlerësim të gabuar (mbivlerësim). I llogaritur sipas aneksit 23:

> Indikatori"Kapacitetet e burimeve njerëzore të auditimit të brendshëm" =
>
> Pozicione vakante të AB/ numrin total të AB të miratuar në strukturën e njësisë publike (%)

Kështu nëse në një njësi (bashki etj) struktura e AB-së miratohet nga titullari me 2 audites, kjo njësi nuk raporton vende vakant edhe pse sipas Ligjit nr. 114/2015 njësia duhet të ngrihet me 2+1 audites, rrjedhimisht indikatori për këtë njësi llogaritet 2/2= 100% dhe vlerësohet me 30 pikë maksimale. Në këtë mënyrë indikatori nuk realizon realizon objektivin e tij

[10] *Struktura përgjegjëse e **harmonizimit te auditimit te brendshëm**, monitoron në nivel vjetor funksionimin e veprimtarise te strukturave te auditimit te brendshem ne sektorin publik. Ky monitorim kryhet nëpermjet analizës së përgjigjeve të pyetsorëve vjetorë të vetvleresimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, të cilat depozitohet cdo fillim viti pranë kësaj strukture.*

sipas Metodologjisë pika 4.1: "vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitit të njësisë publike me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi". Në gjykimin e grupit të auditimit, ky indikator duhet të riformulohet për të vendosur një nivel të poshtëm "jo më pak se 3" për të vlerësuar drejtë njësitë që janë në shkelje të ligjit nr. 114/2015, aq më tepër që ky është i vetmi indikator që bën vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të të aktivitetit të titullarëve të njësive publike në lidhje me AB. Pavarësisht kufizimeve në buxhet dhe kapacitete për të ngritur një NjAB me tre specialistë, njësia raportuese nuk mund të vlerësohet me pikët maksimale.

Indikatori 19: Cilësia e raporteve të audituesve të brendshëm e përpiluar sipas Aneksit 22, në fakt plotësohet nga punonjësit e DH/AB pas leximit të 115 raporteve vjetore të dërguara nga NjAB-të. Pasi raportet shpërndahen midis 3 specialistëve, lexohen dhe në gjykimin e tyre bëhet vlerësimi në pikë sipas kësaj tabele: 0 - 2% : 30 pikë / 3 - 5% : 25 pikë/ 6 - 25%:15 pikë/ 26-50%:10 pikë/ 51-75%: 5 pikë/ 76-100%: 0 pikë. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me përpunim të dhënash dhe intervalet në përqindje janë të pakuptimta. Në përmbledhje, vlerësimi i këtij indikatori për 77 njësi rezulton me mesatarisht 19 pikë. Në gjykimin tonë, përtej vlerësimit që mund të bëjnë 3 specialistë të cilët kryejnë edhe shumë detyra të tjera, mbi formatin dhe përmbajtjen e raporteve vjetore të AB-ve do të ishte më efektive dhe efiçiente kombinimi i këtij indikatori më një tregues tjetër cilësie dhe dobisë së punës së AB: ai i zbatimit të rekomandimeve. Ky indikator është i miratuar në Metodologjinë e vlerësimit të perfomancës dhe i rekomanduar nga SIGMA në pasaportën e indikatorëve.

Kriteri: Ligji nr. 10 296 dt. 10.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *"Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në procesin e monitorimit të KBFP* Neni 6 Pika 1, pika a), b) dhe c): Përgjegjësitë e Ministrit të Financave ,
Neni 7 Pika 2: Përgjegjësitë e Nëpunësit të parë autorizues Neni 18 Pika 3, Neni 26 Pika 1,2 dhe 3, Neni 28 Pika 1,4 dhe 5: Përgjegjësitë e Bordit të Mbikqyrjes së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.
Urdhëri nr. 89 dt. 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë së për monitorimin e performancës së njësive publike"

Impakti: Pasaktësi të theksuara në paraqitjen dhe vlerësimin e indikatorëve të Buxhetit dhe rrjedhimit në vlerësimin total të njësive të qeverisjes së përgjithshme,

Shkaku: Paqartësi në shënimet shpjeguese të Anekseve të përcaktuara në Metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik. Pasaktësi në përpilimin e të dhënave dhe mungesë kapacitetesh për një shpërndarje të drejtë të volumit të punës për të mos cënuar cilësinë e saj.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/AB duhet të propozojë rishikimin e menjëhershëm të anekseve dhe shpjegimeve të dhëna në to me qellim përmirësimin e cilësisë së përpunimit të tyre, rritjen e saktësisë dhe relevancës së vlerësimit. DH/AB në mënyrë të menjëhershme duhet të analizojë me profesionalizëm dhe në thellësi çështjen e efektivitetit dhe eficensës së njësive AB dhe të reflektojë këtë analizë dhe rezultatet e saj në opinionet e dhëna në raportin vjetor të KBFP. Është e rëndësishme që aktiviteti i auditimit të brendshëm të marrë reagime nga palët kyçe të interesit mbi efektivitetin e auditimit dhe të bëjë rregullime të nevojshme dhe ti përcjellë tek të gjitha njësitë e AB dhe jo

vetëm tek ato njësi që kanë qenë pjesë e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

DH/AB në rolin e saj si harmonizuese e metodologjive dhe monitoruese e sistemeve KBFP ku një nga shtyllat është AB, duhet menjëherë të rishikojë metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik për komponentin AB, për t'u marrë në konsideratë matës relevant sasior dhe cilësor të efektivitetit dhe efiçencës.

3.21 Mbi cilësinë, përmbajtjen dhe transparencën e Raportit Vjetor të KBFP
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)

Situata: Pas shqyrtimit të të gjithë indikatorëve të performancës dhe vlerësimit të sistemit të kontrollit brendshëm finaciar publik I dhënë mbi to, grupi i auditimit gjykon se përveç disa ndryshimeve pozitive me shtim të numrit të njësive të analizuara (26 institucione të pavarura dhe 11 njësi të grupit-87 në varësi të Kryeministrit), Raporti vjetor i KBFP për vitin 2017 ka mangësi në prezantim të situatës dhe në cilësi -përmbajtje. Me një mbulim ende të limituar të njësive të analizuara (10% e numrit total të njësive shpenzuese), me një analizë të thjeshtë statistikore nga ana e Drejtorive përgjegjëse e bën këtë raport të paplotë dhe jo efektiv në: 1) objektivin e tij për të "ofruar një garancie të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efiçente me kalimin e kohës"[11] dhe në 2) përmbushjen e përgjegjësive ligjore sipas Ligjit nr. 10 296 dt. 8.7.2010 i ndryshuar, neni 6.

Kriteri: Ligji nr. 10 296 dt. 10.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *"Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në procesin e monitorimit të KBFP* Neni 6 Pika 1, pika a), b) dhe c): Përgjegjësitë e Ministrit të Financave ,
Neni 7 Pika 2: Përgjegjësitë e Nëpunësit të parë autorizues Neni 18 Pika 3, Neni 26 Pika 1,2 dhe 3, Neni 28 Pika 1,4 dhe 5: Përgjegjësitë e Bordit të Mbikëqyrjes së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.
Urdhri nr. 89 dt. 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë së për monitorimin e performancës së njësive publike"

Impakti: Diferenca në treguesit e performancës së disa indikatorëve të paraqitur në raport; opinione të shoqëruar me referencë të komponentëve të veçantë të MFK dhe jo të sistemit KBFP në tërësinë e tij; aplikimi i kritereve pikësh maksimale të ndryshme për grupe të ndryshme njësish, paaftësi për të mbledhur të dhëna të plota për të gjithë grup-indikatorët sidomos ato në lidhje me zbatimin e Buxhetit; mungesa e aplikimit të faktorëve të rëndësisë për indikatorë të ndryshëm dhe jo aplikimi i një mesatareje të thjeshtë do ta bënte më të lehtë dhe transparente evidentimin e pikave të dobëta të sistemeve të kontrollit duke rritur kështu vlerën e raportit në funksion të objektivit të tij ligjor.

Shkaku: Përpunimi tepër manual i të dhënave i cili mund të automatizohej me kosto të brendshme të paktën në nivele funksionesh Excel-i, pa kërkuar investime shtesë (built –in macro), kjo në përfitim të analizës së mirëfilltë ekonomike, monitorimeve dhe pilotimeve. Gjithashtu, në gjykimin tonë, mungon një strategji master- data në përpunim të dhënash që janë baza e

[11] *Urdhëri nr.89 dt.28.12.2015 Pjesa I. Pika 2 dhe 4*

konkluzioneve të raportit dhe opinioneve të dhëna në të për tu paraqitur më pas nga Ministri i Financave në Parlament.; kjo e shoqëruar me formalizëm dhe subjektivizëm në qasjen, metodën dhe llojin e analizës; me ndryshime në formatin e Raportit që kanë sjellë një impakt minimal në nxjerrjen e konkluzioneve të plota, transparente dhe të qëndrueshme mbi gjendjen e sistemeve të kontrollit në sistemin publik.

Mungesa e analizës së performuesve "më të dobët" në sistem; mungesa e një reference dysheme në vlerësim (kemi njësi të vlerësuara me 100 pikë nga 600 të mundshme) pa asnjë analizë dhe masa konkrete ndaj titullarit të tyre apo propozime nga DH dhe Bordi i KBFP për parashikim të masave organizative dhe disiplinore në Ligji nr. 10 296 në lidhje me ngritjen, funksionimin e sistemeve të kontrollit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/KBFP duhet të azhornojë gjurmën e auditimit të procesit të hartimit të Raportit vjetor KBFP ku të përcaktohet formati dhe procesi i propozimeve për ndryshime në të në mënyrë që ato të diskutohen paraprakisht me Drejtoritë dhe njësitë nga të cilat duhet të sigurohet informacioni si dhe të miratohen nga Bordi i KBFP për relevancën dhe impaktin e tyre.

*Për sa më sipër është mbajtur **Akt-konstatimi nr. 4** dt. 14.6.2018 lidhur me opinionin e përgjithshëm mbi efektivitetin e njësive të qeverisjes së përgjithshme në pjesën e parë të Raportit vjetor për vitin 2017. Në vijim është observacioni i subjektit në përgjigje të këtij akt-konstatimi.*

Mënyra e konsolidimit të të dhënave të pyetësorit të vetëvlerësimit në sistemin KBFP është ndërtuar për herë të parë nga Drejtoria IT të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për përshtatjen e tij me ndryshimet e reja të pyetësorit të vetëvlerësimit nga ana e DH/MFK, po bëhen vazhdimisht përpjekje për të zgjidhur këtë situatë duke kërkuar një asistencë të vazhdueshme. Konkretisht nëpërmjet asistencës së konsulentëve lokal dhe ndërkombëtar po punohet për ndërtimin e një sistemi të ri, në të cilin vetë institucionet të hedhin automatikisht të dhënat e pyetësorit të vetëvlerësimit, për të shmangur kalimin në disa hapa të procesit të hedhjes së pyetësorëve në sistem. Në raport, janë paraqitur opinion dhe vlerësime faktike, bazuar në monitorimet në vend. Bazuar në këto vlerësime si dhe në analizën e përgjithshme të indikatorëve janë shprehur opinion apo konkluzione të përgjithshme për çdo kapitull. E gjithë analiza e përgjithshme është bazuar në vlerësimet e indikatorëve si dhe përgjigjet e pyetësorëve të vetëvlerësimit të hedhur në programin Microsoft Access.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit u shqyrtua observacioni i ardhur nga DH/MFK me shkresën nr. 4816/11 prot, datë 19.06.2018. Reagimi i subjektit është i pjesshëm lidhur vetëm me përpunimin manual të të dhënave që përsëri reflekton mungesën e suportit të Drejtorisë IT. Mungesa e një analize cilësore e indikatorëve dhe ndërthurja e tyre deri në dhënien e opinionin mbetet mangësi e Raportit vjetor. I njëjti koment paraqitej edhe në observacionet e projekt raportit të kthyer nga DH/KBFP.

3.22 Mbi procesin e rishikimit dhe miratimit të raportit vjetor KBFP për vitin 2017 në zbatim të Ligjit nr. 10296 dt. 8.7.2010 i ndryshuar, neni 28 i tij.
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)

Situata:

Verbalisht është konfirmuar nga Drejtoresha e Përgjithshme e Drejtorisë së Harmonizimit të KBFP se draft-Raporti është kaluar për shqyrtim në Bordin e Mbikëqyrjes së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik më 24.5.2018. Grupi i auditimit ka kërkuar ti vihej në dispozicion minutat e mbledhjes së Bordit me vërejtjet dhe sugjerimet e mundshme të ardhura prej tij në zbatim të Ligjit nr. 10296, nenit 26. Gjithashtu kemi kërkuar nëse ka shënime, sugjerime nga Nëpunësi i Parë Autorizues para miratimit të tij për t'u përcjelle te Ministri i Financave dhe Ekonomisë në zbatim të nenit 7 të Ligjit 10 296. Me e-mail kemi një konfirmim nga Drejtoresha e Përgjithshme ku thuhet se nuk ka patur vërejtje në lidhje me Raportin nga Nëpunësi i parë Autorizues. Minutat e mbledhjes së Bordit nuk na janë vënë ende në dispozicion.

*Për sa më sipër është mbajtur **Akt-konstatimi nr. 4** dt. 14.6.2018 lidhur me opinionin e përgjithshëm mbi efektivitetin e njësive të qeverisjes së përgjithshme në pjesën e parë të Raportit vjetor për vitin 2017. Në vijim është observacioni i subjektit në përgjigje të këtij akt-konstatimi.*

Raporti vjetor I KBFP për vitin 2017 është diskutuar dhe në mbledhjen e datës 22 Maj 2018 të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në të cilin nuk ka pasur vërejte apo propozime për ndryshime nga anëtarët e këtij Bordi. Gjatë këtij takimi është mbajtur procesverbali i mbledhjes, i cili është miratuar nga të gjithë anëtarët e bordit. Në momentin në të cilin është kërkuar procesverbali i mbledhjes nga grupi i punës së KLSH, dokumenti ka qënë në fazë zbardhjeje dhe miratimi nga ana e anëtarëve të bordit. Bashkëlidhur, këtij observacioni, ju lutem gjeni dhe një kopje të procesverbalit në fjalë

3.23 Mbi hartimin e udhëzimit për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të shtetit për vitin 2017 në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)

Situata:

Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ka për qëllim të harmonizojë standardet, rregullat dhe procedurat në kryerjen, monitorimin dhe raportimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe të menaxhimit e kontrollit financiar në sektorin publik. Ajo, nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, përgjigjet për azhornimin e metodologjisë së kontabilitetit publik me zhvillimet bashkëkohore dhe ndjekjen e procesit të zbatimit të strategjisë së qeverisë për implementimin e standardeve të kontabilitetit publik. Dokumenti i shqyrtuar nga grupi i auditimit është: analiza vjetore e DH/KBFP; Raporti vjetor mbi sistemet e KBFP për njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2017; dosje e aktivitetit të zhvillimit të metodologjive, udhëzimeve e ligjeve, minutat e mbledhjeve të Bordit të Mbikëqyrjes KBFP, Strategjia e MFP 2014-2020, Pasaporta e indikatorëve-SIGMA. Në analizën vjetore konfirmohet se është realizuar objektivi me hartimin e udhëzimeve si vijon:

1) Udhëzimi nr. 23 dt.22.12.2017 për mbylljen e llogarive vjetore të

buxhetit të shtetit për vitin 2017, si një detyrim ligjor i përvitshëm, në të cilën përcaktohen afatet dhe procedurat e nevojshme për mbylljen e llogarive vjetore nga njësitë publike dhe konsolidimi i tyre nga ana e Ministrisë së Financave. Ky udhëzim**,** ashtu siç përmendet në raport është një udhëzim i përvitshëm që përcakton afatet për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2017 dhe përgatitet në bashkëpunim me Drejtorinë e Thesarit dhe Buxhetit dhe nuk përbën ndonjë përmirësim të legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

1.1) Në pjesën e parë, pika1.b konstatojmë se MFE udhëzon që *"të gjitha shpenzimet publike të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017 të njohura* ***brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël*** *dhe të regjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2017, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave*" bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008, neni 61 ku përcaktohet metoda e njohjes së shpenzimit: "*Metoda e shpenzimeve dhe e të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me: a) njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës*;". Për më tej në këtë udhëzim parashikohen masa disiplinore në rastet kur kërkesat e këtij Udhëzimi nuk zbatohen nga ana e nëpunësve autorizues dhe zbatues :pika 39 e udhëzimi " Nëpunësi I Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nëpërmjet këtij udhëzimi MFE autorizon mosrregjistrimin e faturave në raste kur nuk ka fonde disponibël, raste të cilat gjithashtu bien në kundërshtim me Nenin 40 "E drejta për të kryer shpenzime", Neni 50 " Angazhimet buxhetore", Neni 51 "Menaxhimi I shpenzimeve", Neni 52 "Kryerja e shpenzimeve". Kjo praktikë autorizon mos regjistrim të faturave për shpenzime të kryera në mungesë të fondeve, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura, mos marrjen e masave për krijimin e tyre, dhe cënon vërtetësinë e pasqyrave financiare.

1.2) Në Udhëzimin nr. 23 i hartuar si pjesë e aktivitetit të DH/MFK në zbatim të përgjegjësisë së saj për zhvillimin dhe harmonizimin e metodologjisë dhe bazës ligjore në fushën e kontabiliteti, konstatohet vetëm një ndryshim krahasuar me Udhëzimin e një viti më parë në nenin 27 ku shtohet paragrafi " *Për të gjitha Ministritë dhe institucionet për të cilat gjatë vitit 2017 ndryshuan fushat e mbulimit dhe përgjegjësitë në zbatim të VKM-ve përkatëse, gjë që u reflektua edhe në ndryshimet e programeve buxhetore në Aktin Normativ nr. 3, datë 06.11.2017, rakordimi i planit për buxhetin e vitit 2017 me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të bëhet me ministritë dhe institucionet që i administrojnë këto fonde aktualisht*". Pra, **Udhëzimi rregullon rakordimin e planit buxhetor por jo kontabilitetin**. Nisur nga fakti se DH/MFK nuk ka hartuar ndonjë udhëzim tjetër të posaçëm për të trajtuar çështjen e ndryshimeve strukturore para mbylljes së vitit fiskal, konkludojmë se DH/MFK ka gjykuar të mjaftueshëm se me përcaktimin se kush rakordon planin buxhetor kjo do të mbulonte dhe rregullimin kontabël të përthithjes dhe konsolidimit të pasqyrave financiare 11-mujore të Ministrive dhe programeve që pushuan së ekzistuari pas Nëntorit 2017. Kështu çështje si: kush do të mbyllte pasqyrat financiare 11-mujore, afati i dorëzimit të tyre

	nëse duhej të përcaktohej një periudhë tranzicioni për përpunimin e të pasqyrave, për transferimin kontabël dhe fizik të inventarëve dhe aktive të qëndrueshme, kush do të ishte personi përgjegjës për përgatitjen dhe miratimin e tyre: punonjësi i larguar apo i transferuar në Ministrinë e re me një detyrë dhe tagër tjetër kanë mbetur të patrajtuara dhe kanë qenë objekt i auditimit financiar të KLSH në aparatin e MFE gjatë periudhës shkurt-maj 2018, gjetjet e të cilit evidentojnë çështjet me lartë dhe përgjegjësinë e DH/MFK sipas Ligjit 10296.
Kriteri:	DH/MFK duhet të zhvillojë, plotësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për çështjet e kontabilitetit në zbatim të: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në republikën e Shqipërisë" Kreu VII "Kontabiliteti i Sistemit Buxhetor", Neni 61 "Standardet dhe procedurat e kontabilitetit", Neni 62 "Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 " Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , Neni 6, "Ministri i Financave" Neni 26 "Roli i Strukturës përgjegjëse të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Neni 28 "Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" Urdhër nr. 68, datë 8.6.2018 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik", Pika. 1 "Krijimi i Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik", çështja a; Pika. 2, çështja d; Pika. 3, çështja d, çështja e.
Impakti:	Shkelje e ligjit nr. 9936 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në sektorin publik", mos regjistrim i gjithë transaksioneve të ndodhura brenda afatit dhe periudhës raportuese me efekt cënimin e vërtetësisë së pasqyrave financiare të konsoliduara, krijimi i detyrimeve të prapambetura, pamundësi për të evidentuar rastet e kryerjes së shpenzimeve në kundërshtim me Ligjin. Është nxjerrë një udhëzim në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore duke krijuar kështu mundësinë e pranimit të faturave të lidhura për shërbime të papërfunduara apo punime të pamarra në dorëzim, duke i reflektuar ato si të realizuara për efekt të zbatimit të buxhetit të shtetit. Kjo sjell mbivlerësim të detyrimeve ndaj furnitorëve, njohje e shpenzimit kur ende ai nuk është kryer që do të thotë përdorim i fondeve buxhetore për shpenzime dhe punime të pakryera dhe të paverifikuara, pasaktësi e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe pasqyrës fiskale të konsoliduar për shpenzimet kapitale. Kontributi i DH/MFK për çështjet e kontabilitetit dhe raportimit financiar është një objektiv i pa arritur në rolin e saj udhëheqës metodologjik. Nuk ka informacion nëse pasqyrat financiare të shtetit më 31.12.2017 pasqyrojnë saktë dhe drejtë gjendjen e financave dhe aktiveve publike
Shkaku:	Mungesë përgjegjshmërie menaxheriale e Drejtorisë së Harmonizimit në realizimin e misionit të saj si harmonizuese e legjislacionit dhe metodologjise në fushën e kontabilitetit dhe kontrollit financiar.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandimi: DH/MFK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të shqyrtojnë, analizojnë, raportojnë dhe marrin masa për vlerësimin dhe evidentimin e impaktit e këtij udhëzimi në pasqyrat fiskale të konsoliduar të shtetit dhe në përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Observacioni i subjektit:

Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ka për qëllim të koordinojë dhe harmonizojë standardet, rregullat dhe procedurat në kryerjen, monitorimin dhe raportimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, të menaxhimit financiar e kontrollit si dhe azhornojë metodologjinë e kontabilitetit në sektorin publik. Gjatë hartimit të udhëzimit mbi mbylljen e llogarive vjetore, roli i DH/MFK-së ka qënë rol koordinues në mbledhjen e informacionit të dërguar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Thesarit. Elementët teknikë të këtij udhëzimi si afatet dhe procedurat e nevojshme për mbylljen e llogarive vjetore nga njësitë publike dhe konsolidimi i tyre janë kompetencë e Drejtorisë së Thesarit dhe Buxhetit brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në gjykimin tonë, ky rekomandim nuk është kuptuar nga subjekti, pasi nëse roli i Drejtorisë së Harmonizimit është vetëm koordinues, duke marë dhe përcjellë shifra jo të sakta, të cilat paraqiten më pas në raportin e Ministrit, atëherë ka vend për rishikimin e udhëzimit dhe rolin koordinues të DHKBFP.

3.24 **Mbi Udhëzimin "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"**
(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)

Situata: Mbi Udhëzimin "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme": Ky udhëzim është finalizuar, miratuar dhe publikuar si Udhëzimi nr. 8 dt. 9.3.2018. Për përpilimin e këtij Udhëzimi është ngritur grupi i punës me Urdhrin nr. 142 dt. 17.11.2017 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e bazës rregullatore të kontabilitetit publik për një periudhë tranzitore, deri në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (IPSAS)". Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion: dosje e çështjeve të ndjekura në lidhje me kontabilitetin dhe përmirësime të tjera ligjore; nuk rezulton të jetë e plotësuar me minutat mbledhjeve të grupeve të punës apo relacione "dhënie mendim" apo versione finale të miratuara të udhëzimeve të përpiluara apo të analizës të sipër përmendur. Në kushtet kur prej disa vitesh është shtruar çështja se sistemit publik shqiptar i mungojnë standardet e kontabilitet të miratuara, nuk disponojmë nga DH/MFK ndonjë mbledhje të dedikuar të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, për propozimin e hartimit të një dokumenti të tillë tranzitor, duke përcaktuar çfarë konkretisht rregullon ai, çfarë ndryshimesh sjell? Pika 2 thotë "rivënie në zbatim të rregullave në fushën e kontabiliteti publik? A kanë qenë të përpiluara dhe të detyrueshme për zbatim më parë këto rregulla dhe kur pushuan së zbatuari? Cila është përcaktuar si periudhë tranzitore; Cilat IPSA janë përshtatur/adaptuar?
Në këtë Udhëzim, pika 8 thuhet se " Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave në sektorin publik ka të bëjë me: • njohjen e shpenzimeve të

vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës; si dhe • njohjen e të ardhurave në çastin e arkëtimit të tyre. Pra kemi të bëjmë me një "cash basis" të modifikuar. Nëse ky udhëzim sjell ndryshime në njohjen trajtimin dhe mënyrën e kontabilizimit të transaksioneve të caktuara atëherë Udhëzimit i duhej të plotësoj me parashikim të një periudhë tranzicioni si çdo praktikë ndërkombëtare e Bordeve rregulluese dhe mbikëqyrëse që nxjerr një standard apo letër pune shpjeguese për të shmangur konfuzion në interpretim dhe për një paraqitje të drejtë të pasqyrave financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme brenda një viti ushtrimor. Gjithashtu, në Udhëzimin nr. 23 dt. 22.12.2017 pika 30, konfirmohet se baza ligjore, rregullatore për përgatitjen e pasqyrave financiare është Udhëzimi nr. 14 dt. 2006, i rishikuar 2007, 2008, i Ministrit të Financave mbi përgatitjen dhe publikimin e Pasqyrave Financiare Vjetore për institucionet qendrore, vendore dhe njësitë e zbatimit të projekteve për marrëveshjet me donatorët e huaj. Nga shqyrtimi i ndryshimeve të vitit 2007 dhe 2008 në Udhëzimin nr. 14 dt. 28.12.2006, konstatuam se ndryshimet e vitit 2008 shfuqizuan pikat 8 dhe 9 e rubrikës I-rë, përkatësisht:

8. *Drejtoria e Kontabilitetit në Ministrine e Financave, mbi bazën e informacionit të depozituar, harton brenda datës 15 Qershor 2007 përmbledhëset e llogarive vjetore 2006 në keto nivele; Për Ministritë dhe Institucionet e tjera qëndrore ; Për ISSH dhe ISKSH Për njësite e menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj; Për organet e Qeverisjes Vendore,*

9. Drejtoria e Kontabilitetit në Ministrinë e Financave mbi bazën e të gjithë informacionit të hartuar e depozituar ***bën konsolidimin e pasqyrave*** *financiare të vitit 2006 në nivel qëndror e lokal dhe i raporton ato brenda datës 15 Korrik 2007.*

Pra Udhëzimi nr.14 i dt. 28.12.2006 i ndryshuar me Udhëzimin nr. 10 dt. 27.2.2008 nuk parashikon një pikë se kush bën konsolidimin e pasqyrave financiar duke mbetur përsëri me Udhëzimet e përvitshme për mbyllje të llogarive të buxhetit nga Thesari.

Një tjetër sqarim që duhej të parashikonte DH/MFK është raporti/lidhja midis Udhëzimi nr. 14 i 2006-s dhe Udhëzimi nr. 8 i 2018-s. A janë ata plotësues të njëri tjetrit apo ai më i hershmi shfuqizohet.

Parimi i njohjes dhe regjistrimit të shpenzimit

Udhëzimi nr. 23 dt. 22.12.2017, pika 1.b: Në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme përfshihen: Të gjitha shpenzimet publike të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të regjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2017, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave (accrual basis)

Udhëzimi nr. 8 dt. 09.03.2018, pika 37. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, para përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor, janë të detyruara të rakordojnë, vetëm për të dhënat mbi bazë cash (cash basis), me degën e thesarit të juridiksionit që i mbulon. Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të

ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet. Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët.

Udhëzimi nr. 8 dt. 09.03.2018, pika 42. "*Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara (commitment), për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", në varësi të natyrës së tyre*". Kjo është në shkelje të Ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë , neni 61 ku thuhet se shpenzimi njihet në momentin e ndodhjes pra jo të pagesës. Fakti që nuk ka fonde disponibël për pagesë nuk është arsye që këto shpenzime të njihen si shpenzime të periudhave të ardhshme pasi ato në të vërtetë kanë ndodhur.

Kriteri: DH/MFK duhet të zhvillojë, plotësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për çështjet e kontabilitetit në zbatim të Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në republikën e Shqipërisë" Kreu VII "Kontabiliteti i Sistemit Buxhetor", Neni 61 "Standardet dhe procedurat e kontabilitetit", Neni 62 "Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 " Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Neni 6, "Ministri i Financave" Neni 26 "Roli i Strukturës përgjegjëse të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Neni 28 "Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" Urdhër nr. 68, datë 8.6.2018 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik", Pika.1 "Krijimi i Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik", çështja a; Pika. 2, çështja d; Pika. 3, çështja d, çështja e.

Impakti: Konfuzion në zbatim të parimeve të kontabilitetit për çështje të njohjes dhe rregjistrimit te shpenzimeve me impakt mosrregjistrimin e shpenzimeve të ndodhura për shkak të mungesës së fondeve me impakt pasaktësi dhe paraqitje jo të drejtë të pasqyrës fiskale të konsoliduar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të shtetit.

Shkaku: Mungesë përgjegjshmërie menaxheriale e Drejtorisë së Harmonizimit në realizimin e misionit të saj si harmonizuese e legjislacionit dhe metodologjisë në fushën e kontabilitetit dhe kontrollit financiar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/MFK të rishikojë menjëherë Udhëzimin nr. 8 me qëllim harmonizimin e tij me ligjin për menaxhimin e buxhetit dhe Udhëzime të tjera në fushën e kontabilitetit.

Observacioni i subjektit:

Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" është hartuar, nëpërmjet një grupi pune me përbërje nga stafi i Drejtorisë së Buxhetit, Drejtorisë së Thesarit dhe DH/MFK-së, në mbështetje të nenit 3 dhe 61 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, si dhe nenit 10 dhe 11 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Qëllimi i këtij udhëzimi është krijimi i bazës rregullatore për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, bazuar në Parimet Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit të Sektorit Publik (kuadri rregullator i fushës), udhëzim i cili do të përdoret si një masë tranzitore deri në modifikimin përfundimtar të kuadrit rregullator të fushës në përputhje me pjesët e përzgjedhura të IPSAS-ve. Për këtë, DH/MFK është pjesë e një projekti të Bankës Botërore në lidhje me Zhvillimin e Kontabilitetit në Sektorin Publik, i cili synon implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS) në vendin tonë.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit është në dijeni për rolin tranzitor të këtij udhëzimi, por i qëndron mendimit se ky dokument, në nene të caktuara të tij nuk është në harmoni me ligjin e buxhetit dhe jo në përputhje të plotë me parimet e kontabilitetit.

3.25 Në lidhje me "Analiza e nevojave dhe përmirësimeve ligjore në fushën e kontabilitetit" *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)*

Situata:

a. Në pjesën IV të Raportit vjetor të KBFP, "Detyra të tjera" pika 4 – DH/MFK shprehet se është realizuar gjithashtu ky objektiv. Me kërkesën e grupit të auditimit na u vu në dispozicion një kopje e kësaj analize që në fakt është produkt bashkëpunimi në kuadër të projektit me Bankën Botërore, PULSAR, BMF, SAFE dhe SECO "Zhvillimi i Raportimit Financiar në Sektorin Publik Shqiptar". Pavarësisht kontributit të përfaqësimit të DH/MFK, nuk gjejmë të shprehur dhe dokumentuar shkallën e përafrimit të Udhëzimit nr. 8 i dt.9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* si udhëzim tranzitor deri në miratimin e plotë të IPSAS i propozuar dhe miratuar 7 muaj më vonë kësaj analize.

Ndërkohë, konstatojmë se DH/MFK ka kontribuar në shqyrtimin dhe dhënie mendimesh në lidhje me Ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" nr. 25/2018. Qëllimi i ndryshimeve ligjore ishte përmirësimi I standardeve për kontabilitetin dhe raportimin financiar, përafrimi i tyre me direktivën nr. 2013/34/BE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 26 qershor 2013 "Lidhur me pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet që kanë të bëjnë me lloje të caktuara të ndërmarrjeve.." duke mbështetur kështu angazhimet strategjike të vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Nga shqyrtimi i neneve të direktivës dhe neneve të Ligjit të ri të kontabilitetit rezulton një përafrim i plotë i 11 neneve dhe i pjesshëm për 27 neneve nga 164 gjithsej. Ndryshimet konsistojnë në klasifikimin e ndërmarjeve raportuese në varësi të madhësisë së tyre në dy kritere: nr. Punonjësish dhe qarkullim vjetor. Ky ndryshim është parashikuar si fazë e parë ë përgatitjes së standardeve të kontabilitetit publik I parashikuar në Strategjinë e MFP 2014-2020. Sipas kësaj strategjie duhej të kishte filluar implementimi i pjesshëm i IPSAS dhe raportimi i progresit të implementimit do të kishte si indikator matës : nr. e institucioneve që aplikojnë IPSAS kundrejt numrit total të njësive të

qeverisjes së përgjithshme. Aktualisht ky ligj nuk sjell asnjë përmirësim në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar publik dhe ndryshimet janë iniciuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit kështu që fakti se DH/MFK ka dhënë mendime nuk mund të konsiderohet kontribut në funksion të arritjes së objektivit të Drejtorisë për zhvillimin e kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik.

b. Në lidhje me vazhdimësinë e punës së DH/MFK në fushën e kontabilitetit *nën* përgjegjësinë që i jep Ligji 10296 dt. 08.07.2010 i ndryshuar, është raportuar se në aktivitetet e planifikuara për vitin 2018, kjo drejtori do të përfshihet në projektin e Bankës Botërore për hartimin dhe implementimin e fazave deri në implementimin e plotë të IPSAS në të gjithë sistemin publik. Gjithashtu në analizën vjetore të drejtorisë dhe Raportin vjetor të KBFP, drejtoria shprehet për angazhimin e saj në zhvillimin e kontabilitetin publik dhe privat. Ndërkohë në bazë të ligjit në fuqi të kontabilitetit dhe ligjit të miratuar në Mars 2018 dhe që pritet të hyjë në fuqi më 1.1.2018 ngarkohet Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit si një organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik me detyrën që: a) të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe në koherencë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

c. Nga pikëpamja e rregullshmërisë së dokumentimit të këtij procesi kemi konstatuar se në dosjen e vënë në dispozicion nga punonjësit e DH/MFK nuk rezulton të ketë një dokumentim të relacioneve apo memove të brendshme të analizave apo komenteve në kontribut të hartimit të draft-udhëzimeve pavarësisht komunikimeve me e-mail midis specialistëve gjatë procesit. Me kërkesë të përsëritur, dosja është plotësuar gjatë procesit të auditimit me një kopje të Udhëzimit nr. 23 (ende e pa publikuar deri në fund të muajit Prill), kopje të Urdhërit për krijimin e grupit të punës për përgatitjen e Udhëzimit nr. 8, ndërsa shënimet e minutave të grupit të punës janë të pazbardhura dhe të padokumentuara zyrtarisht).

Kriteri: DH/MFK duhet të zhvillojë, plotësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për çështjet e kontabilitetit në zbatim të :Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në republikën e Shqipërisë" Kreu VII "Kontabiliteti i Sistemit Buxhetor", Neni 61 "Standardet dhe procedurat e kontabilitetit", Neni 62 "Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 " Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Neni 6, "Ministri i Financave" Neni 26 "Roli i Strukturës përgjegjëse të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Neni 28 "Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" Urdhër nr. 68, datë 8.6.2018 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik", Pika. 1 "Krijimi i Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik", çështja a; Pika. 2, çështja d; Pika. 3, çështja d, çështja e.

Impakti: Në konkluzion, theksojmë se struktura e DH/MFK nuk ka arritur të përmbushë objektivin e saj për azhornimin e metodologjisë së kontabilitetit publik me zhvillimet bashkëkohore dhe ndjekjen e procesit të zbatimit të strategjisë së qeverisë për implementimin e standardeve të kontabilitetit publik.

Shkaku: Mungesë përgjegjshmërie menaxheriale e Drejtorisë së Harmonizimit në

realizimin e misionit të saj si harmonizuese e legjislacionit dhe metodologjisë në fushën e kontabilitetit dhe kontrollit financiar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DH/MFK duhet të jetë e qartë që detyrimi ligjor i punës së saj (scope) është kontabiliteti publik. Përfshirja e çështjeve të kontabilitetit privat si një nga objektivat e DH-së është i pabazuar dhe shkakton mbivendosje, konfuzion dhe ineficensa.

Observacioni i subjektit:

Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik është një drejtori rregullatore, koordinuese dhe politikbërëse, jo vetëm në fushën e menaxhimit financiar dhe kotnrollit, por dhe për fushën e kontabilitetit, në kuadër të përgjegjësisë që ka Ministri i Financave dhe Ekonomisë për publikimin e standardeve dhe hartimin e legjislacionit në fushën përkatëse për kontabilitetin privat dhe publik. Gjithashtu, stafi i DH/MFK-së është pjesë e grupit ndërinstitucional të punës për Kapitullin 6 të Progresraportit "Legjislacioni tregtar", ndaj pjesëmarja e tyre në përmirësimin e legjislacionit të kontabilitetit në sektorin privat është shumë i rëndësishëm. Në koordinimin e punës së saj në lidhje me hartimin dhe miratimin e ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, DH/MFK ka bashkëpunuar me një sërë institucionesh, nga të cilat janë marrë mendime dhe komente të ndryshme si dhe me konsulentë lokal dhe ndërkombëtar të Bankës Botërore.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Gjatë shqyrtimit të kuadrit ligjor mbi të cilin funksionon Drejtoria e Harmonizimit, nuk jemi ndeshur me detyrimin ligjor të kësaj drejtorie për përfshirjen në aktivitete të fushës së kontabilitetit publik, megjithëse vlerësohet puna e bërë nga punonjësit e saj. Fokus i rëndësishëm duhet të jetë përfundimi i legjislacionit të kontabilitetit të sektorit publik, për të cilin janë kryer një sërë trajnimesh dhe mendimesh me ekspertë kombëtare dhe ndërkombëtarë, për këto arsye observacioni nuk pranohet.

3.26 Në lidhje me Standardet e Kontabilitetit Publik në Strategjinë MFP 2014-2020 *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 4)*

Situata: Në lidhje me Standardet e Kontabilitetit Publik në Strategjinë MFP 2014-2020 thuhet se: *Qëllimi i standardeve është të përmirësojnë cilësinë e raportimit të përgjithshëm financiar nga institucionet e sektorit publik, duke çuar në vlerësime më të informuara të vendimeve të Qeverive për alokimin e burimeve, duke rritur në këtë mënyrë transparencën dhe përgjegjshmërinë. Megjithëse plani kohor i strategjisë aktuale është deri në vitin 2020, do të merren masa përgatitore me qëllim miratimin gradual të këtyre standardeve ndërkombëtare.* Deri në fund të periudhës së auditimit (qershor 2018) ende nuk është përmbushur masa e 1: krijimi i një strukture/funksioni të veçantë për kontabilitetin publik pranë Ministrisë së Financave për mbikëqyrjen e kontabilitetit në qeveri në përgjithësi dhe kalimin bazuar në SEKP në veçanti. Raporti vjetor i KBFP për vitin 2017 citon se do të ngrihet një sektor me tre specialistë në strukturën e DH/KBFP gjatë vitit 2018. Ndërkohë Bordi i Mbikëqyrjes së KBFP tashmë i krijuar prej 2016, nëse do të kishte funksionuar jo vetëm me 3 mbledhje gjithësej, do të kishte filluar punën e tij me grumbullimin e gjithë

udhëzimeve në vite për të unifikuar së paku referimin e neneve[12] të Kushtetutës, ligjeve dhe VKM ku ato bazohen.
b) Në lidhje me bashkëpunimin me KLSH për çështje të kontabilitetit.
Konstatojmë se Bordi i KBFP nuk ka zbatuar pikën të rregullores ku thuhet se ai duhet të ftojë përfaqësues të KLSH në rastet kur trajtohen çështje të kontabilitetit.

Kriteri: DH/MFK ka zhvilluar, plotësuar kuadrin ligjor dhe rregullator për çështjet e kontabilitetit në zbatim të bazës ligjore dhe rregullatore:

Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në republikën e Shqipërisë" Kreu VII "Kontabiliteti i Sistemit Buxhetor", Neni 61 "Standardet dhe procedurat e kontabilitetit", Neni 62 "Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 " Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Neni 6, "Ministri i Financave" Neni 26 "Roli i Strukturës përgjegjëse të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Neni 28 "Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" Urdhër nr. 68, datë 8.6.2018 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik", Pika. 1 "Krijimi i Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik", çështja a; Pika. 2, çështja d; Pika. 3 , çështja d, çështja e.

Impakti: Puna e DH/MFK në zbatim të Ligjit 10296 dt. 08.07.2010 i ndryshuar, neni 26 është fragmentizuar, rastësore jo vetëm për shkak të mungesës së kapaciteteve të dedikuara për kontabilitetin por mungesës së vizonit dhe përgjegjshmërisë menaxheriale. Të mbetur në pritje të fillimit të projektit të Bankës Botërore, DH ka nxjerrë udhëzime që nuk kanë sjellë krijimin e një baze rregullatore të qëndrueshme të kontabilitetit publik, çështje që KLSH ka vite që sjell në vëmendje të kësaj strukture. Fakt i rëndësishëm është gjithashtu dhe se me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri "Për Kontabilitetin" nr. 25/2018, më 1 Janar 2019, sektori publik nuk ka asnjë bazë ligjore mbi të cilën të mbështetet për rregullimet kontabël, dhe kjo është një situatë që duhet të sensibilizojë strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të mos presi fillimin e projekteve të Bankës Botërore.

Shkaku: Mungesë përgjegjshmërie menaxheriale e Drejtorisë së Harmonizimit në realizimin e misionit të saj si harmonizuese e legjislacionit dhe metodologjise në fushën e kontabilitetit dhe kontrollit financiar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Parashikimet dhe fazat e implementimit të IPSAS, në kuadër të projektit duhet të bëhen transparente dhe objektivat afat-shkurtër dhe afat-mesëm të drejtorisë në lidhje me kontabilitetin të ndërtohen në terma konkretë mbi to. Referuar pasaportës së indikatorëve të përpiluar nga SIGMA, DH/MFK duhet të parashikojë raportimin e ecurisë së implementimit të IPSAS.

Observacioni i subjektit:

Në lidhje me zhvillimet në fushën e kontabilitetit publik, është vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe raporti përfundimtar i "Gap analysis" i Bankës Botërore i realizuar në bashkëpunim me DH/MFK-në

[12] *Neni 78: "1 Kuvendi vendos me shumicën e votive, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përvec rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar..*
Neni 83

dhe drejtori të tjera brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në të cilin evidentohen gjetjet dhe situata aktuale e kontabilitetit në sektorin publik në lidhje me aspekte të ndryshme. Pas këtij raporti, po zhvillohen aktivitetet e tjera në bashkëpunim dhe me Bankën Botërore, në kuadër të përmbushjes së dy objektivave kryesore: a) Implementimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik (IPSAS) në vendin tonë; si dhe b) Ngritja e kapaciteteve profesionale brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe për të gjithë financierët e sektorit publik. Gjithashtu, theksojmë se në fund të qershorit 2018 është miratuar struktura e re e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në të cilën është krijuar dhe sektori i kontabilitetit për sektorin privat dhe publik brenda Drejtorisë së Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Gjithashtu, sipas rekomandimit të mësipërm, DH/MFK ka përgatitur udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", nëpërmjet një grupi pune me përbërje dhe nga stafi i Drejtorisë së Buxhetit, Drejtorisë së Thesarit, që rregullon kontabilitetin në sektorin publik me kuadrin regullator të fushës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i raportit të Gap Analysis, grupi i auditimit konstaton se ky dokument është përgatitur nga stafi i Bankës Botërore dhe ekspertë të jashtëm për Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, duke mos evidentuar ndonjë kontribut specifik të stafit të DH/KBFP, për të justifikuar punën e bërë prej tyre gjatë vitit 2017, në këtë drejtim.

Në lidhje me strukturën e re të krijuar pranë Ministrisë, deri në fund të periudhës objekt auditimi kjo strukturë nuk ishte krijuar ende, pavarësisht planit të veprimit të Strategjisë PFM 2014-2020 ku specifikohet se brenda 2015 do të krijohej një funksioni të veçantë kontabiliteti brenda MF-së. Përtej shkaqeve objektive, nxjerrja e një udhëzimi po brenda vitit 2018 me ndryshimet strukturore të qeverisë është larg realizimit të objektivave të strategjisë për këtë fushë.

3.27 Mbi raportimin pranë DH/MFK të shoqërive aksionere, organizatat jofitimprurëse, autoritete të përbashkëta, etj *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 3)*

Situata:

Nga auditimi u konstatua se pas ndryshimit të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 në atë nr. 110/2015, datë 15.10.2015, konkretisht neni 18 i tij, pika 1, janë përjashtuar nga përgjegjësia për përgatitjen së pyetësorëve të vetëvlerësimit dhe raportit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe dorëzimin e tyre tek nëpunësi i parë autorizues, **njësitë publike të përfshira në pikën 2, të nenit 3**: *Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.* Referuar fushës së zbatimit të ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për përgatitjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, i cili përfshin: njësitë e qeverisjes së përgjithshme; shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme; njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare;

raportimi pranë Nëpunësit të Parë Autorizues dhe DH/MFK, kufizohet vetëm tek njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në ndryshim me ligjin e auditimit të brendshëm ku fusha e zbatimit dhe raportimi pranë DH/AB është e njëjtë. Si rezultat, raportimi i DH/MFK për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, kryhet nga analizimi i te dhënave për rreth 125 njësi publike (njësitë e mëdha të qeverisjes së përgjithshme), nga një total prej mbi 1200 insitutionesh që rezultojnë nga të dhënat e buxhetit. Referuar problematikave të konstatuara më sipër në këtë material, për garantimin e kryerjes së konsolidimit të të dhënave të institucioneve të varësisë në pyetësorët dhe raportet e njësisë qendrore, numri i njësive që monitorohen dhe raportohen nga DH/KBFP bëhet edhe më i vogël, dhe si rezultat më pak gjithëpërfshirës. Kështu, referuar rëndësisë së njëjtë të këtyre dy drejtorive, si pjesë të DH/KBFP, dhe raportimin mbi situatën e Kontrollit të Brendshëm, sigurimi i një informacioni thelbësor, edhe pse jo të hollësishëm nga një numër më i gjerë i institucioneve përgjegjëse për krijimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në raportimin vjetor të KBFP garanton një pamje më të plotë, të saktë dhe gjithëpërfshirëse të këtij dokumenti.

Kriteri: Neni 3 i ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"

Impakti: Raporti mbi situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë publike nuk është përfaqësues i sektorit publik sipas nenit 3 pika 1, pasi të dhënat e përpunuara bazohen vetëm tek një numër i vogël njësish, krahasuar me totalin e institucioneve që janë përgjegjëse për krijimin e sistemeve të MFK.

Shkaku: Përjashtimi nga përgjegjësia për raportimin pranë NPA të pyetësorëve dhe raporteve të MFK për njësitë e pikës 2 & 3 të nenit 3 të ligjit të MFK; si dhe pyetësorët tepër të gjatë dhe jo të përshtatshëm për njësitë e sipërcituara.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si institucion përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, të marrë masat për përgatitjen dhe shpërndarjen e pyetësorëve të veçantë dhe të personalizuar sipas grupeve, për institucionet e varësisë, shoqëritë tregtare, OJF, autoritetet e përbashkëta apo institucione të tjera të financuara nga buxheti i shtetit apo që kanë në përdorim asete shtetërore, në mënyrë që këto institucione, si njësi të sektorit publik përgjegjëse për zbatimin e ligjit të MFK, të bëhen pjesë e raportit të KBFP dhe të monitorohen nga DH/MFK për funksionimin sa më të mirë dhe efikas të sistemeve të tyre në zbatim të manualit dhe ligjit të MFK.

3.28 Mbi problematikat e konstatuara në regjistrin e Nëpunësve Autorizues dhe regjistrin e Nëpunësve Zbatues të njësive publike *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr.3)*

Situata: Nga auditimi u konstatua se regjistrat e administruara nga DH/MFK për Nëpunësit Autorizues dhe Zbatues të njësive publike, përmbajnë një sërë

pasaktësish, e evidentuar kjo në strukturën dhe përmbajtjen e të dhënave, në kundërshtim me nenin 26, pika 1. dh e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", ku përcaktohet detyrimi i kësaj drejtorie për administrimin dhe monitorimin e tyre. Nga inspektimi i këtyre regjistrave, u konstatua se regjistrat janë të organizuar në Excel, por me pamundësi përpunimi të dhënash, për shkak të formatit dhe organizimit të tyre; u konstatua duplikim të dhënash për të njëjtat institucione; mungesë e plotë e informacionit mbi arsimimin, pozicionin e punës; mungesë e datave dhe shkresave konfirmuese për N.Z; mungesë e informacionit të plotë në rastet e nëpunësve të deleguar për një periudhë të përkohshme (mungesë në aplikimin e kontrolleve për sinjalizimin në mbarimin e afatit të delegimit); mangësi në përditësimin e të dhënave si dhe pamundësi për monitorimin e kriterit ligjor mbi arsimimin e NZ, në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit të ndryshuar të MFK.

Kriteri: Neni 12 dhe neni 26, pika 1. dh e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"

Impakti: Të dhënat e prezantuara në regjistrin e NA dhe NZ përmbajnë mangësi dhe pasaktësi, duke mos paraqitur saktësisht nëpunësit përkatës si dhe me pamundësi për të përpunuar dhe monitoruar informacionin në to.

Shkaku: Përpunimi jo i saktë dhe me mangësi të konsiderueshme i këtyre regjistrave nga nëpunësit përkatës të DH/MFK

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për përgatitjen e regjistrave të saktë dhe të plotë duke përditësuar të dhënat, në mënyrë që të kryhet përpunimi dhe monitorimi i këtyre dokumentacioneve në përputhje me nenin 12 dhe 26 të Ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

Observacion i subjektit

Për sa më sipër është mbajtur Akt **Konstatimi nr. 3**, datë 08.06.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar me shkresën nr. 4816/8 datë 12.6.2018, ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

"*Regjistrat e NA dhe NZ plotësohen dhe regjistrohen sipas të dhënave të dërguara nga vetë institucionet dhe kanë të dhëna vetëm ato që njësi që kanë sjellë kërkesë për konfirmim të firmave të autorizuara. Gjithashtu ndodh që për disa institucione të cilat janë mbyllur dhe nuk ushtrojnë aktivitet DH/MFK nuk e ka marrë informacionin e duhur sipas një kërkese, duke sjellë një mos përditësim të informacionit nga institucioni. Theksojmë se regjistri mbahet për efekt disponimi informacioni dhe nuk ndikon në ecurinë e punës pasi regjistrimet përkatëse bëhen sipas kërkesave ligjore...*"

Komenti i grupit të auditimit

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni nuk merret parasysh, pasi:

Konstatimi i grupit të auditimit i referohet përgjegjësisë së DH/MFK për administrimin e regjistrit të nëpunësve autorizues dhe zbatues, punë kjo e cila mund të kryhet nga kjo drejtori në mënyrën që gjykon të përshtatshme, dhe nuk kufizohet vetëm në kërkesat e dërguara nga njësitë, pasi kjo mund të kryhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Thesarit, me rakordime

periodike. Gjithashtu, theksojmë edhe njëherë që regjistri përmban shumë pasaktësi dhe paplotësi në mënyrën e organizimit, unifikimit, përpunimit dhe administrimit të të dhënave në tërësi, dhe rastet e paraqitura në Akt Konstatim, ishin vetëm një pjesë e tyre.

3.29 Mbi mangësitë e identifikuara në planifikimin dhe kryerjen e trajnimeve nga DH/MFK *(Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 3)*

Situata: Nga auditimi u konstatua se DH/MFK nuk disponon një regjistër apo dokument përmbledhës mbi trajnimet që janë kryer dhe pjesëmarrësit përkatës ndër vite, në mënyrë që të evidentohen saktësisht nevojat për trajnim dhe të shmangen praktikat formale për to, referuar detyrimit ligjor të drejtorisë, cituar në nenin 26, pika 1 c. " *DH/MFK është përgjegjëse për përcaktimin e nevojave dhe udhëheqjen e trajnimeve e të trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë publike".* Gjithashtu, rezulton se për trajnimet e kryera në bashkëpunim me ASPA-n , roli i punonjësve të DH/MFK kufizohet vetëm në përgatitjen e materialeve dhe prezantimin e tyre, si të kontraktuar nga ASPA, duke mos u përfshirë në aspektin organizativ të tyre, identifikimin e pjesëmarrësve, administrimin e dokumentacionit, etj.

Kriteri: Neni 26, pika c e ligjit "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar.

Impakti: Trajnimet janë kryer duke mos marrë parasysh historikun e trajnimeve të mëparshme në njësitë e trajnuara, nevojat për trajnim; gjithashtu pjesëmarrësit në trajnime jo në të gjitha rastet janë identifikuar nga DH/MFK, duke kryer trajnime rutinë dhe me tematika të njëjta vit pas vite.

Shkaku: Mungesa e një dokumenti në formë regjistri/databaze, për të gjithë pjesëmarrësit në trajnime sipas viteve dhe tematikave përkatëse

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për krijimin e një dokumenti përmbledhës në formë regjistri për administrimin e të dhënave mbi pjesëmarrësit dhe tematikat e trajnimeve ndër vite, në mënyrë që të identifikohen saktë nevojat për trajnim sipas institucioneve, duke lënë mënjanë praktikat formale në kryerjen e trajnimeve.

Observacion i subjektit:

Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolli, në kuadër të detyrave funksionale të saj realizon një sërë trajnimesh si individualisht ashtu dhe në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA-n). DH/MFK- mban listëprezencat për të gjitha trajnimet e organizuara prej saj, ndërkohë qe trajnimet që zhvillohen në bashkëpunim me ASPA-n, listëprezenca dhe organizimi i trajnimit bëhet nga ky institucion. Gjithashtu, DH/MFK, në varësi të kërkesave që mund të ketë pasur nga institucionet apo në varësi të nevoja të identifikuara nga vet stafi i saj gjatë monitorimeve në vend, sugjeron pjesëmarrës te menaxherët e trajnimit të ASPA-s. Për trajnimet e realizuara individualisht, DH/MFK identifikon vet pjesëmarrësit, bën njoftimet përkatëse si dhe organizon të gjithë elementët e tjerë të nevojshëm për të realizuar aktivitetin. Në varësi të pjesëmarrësve,

DH/MFK ka përgatitur kurrikula të veçanta, me tematika të përshtatura sipas nivelit të pjesëmarrësve.

Komenti i grupit të auditimit

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni nuk meret parasysh, pasi referuar përgjegjësisë ligjore që DH/MFK ka për kryerjen e trajnimeve, drejtoria duhet të marrë masat për kryerjen dhe dokumentimin e saktë të këtyre trajnimeve, nëpërmjet historikut të pjesëmarrësve sipas tematikave, nevojave si dhe ndryshimeve në fushën e MFK. Kryerja e trajnimeve në bashkëpunim me ASPA-n e lehtëson punën e drejtorisë, por nuk e justifikon mungesën e informacionit për këto trajnime nga ana e DH/MFK.

C . MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITIMIT TË MËPARSHËM

3.1 Mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Auditimit të Mëparshëm *(Trajtuar me hollësi në aneksin nr.1)*

Situata:

1.1 Drejtoria e Harmonizimit të luajë një rol udhëheqës në drejtim të monitorimit më të kujdesshëm të treguesve të realizimit të planit nga Njësitë e AB, duke forcuar kërkesat për të raportuar edhe arsyet e ndryshimeve apo devijimeve nga planifikimi fillestar. Të ketë një uniformitet në trajtimin e auditimeve me temë zbatimi i rekomandimeve, duke eliminuar problematikën e konstatuar. Afati: Deri në Dhjetor 2017

Ky rekomandim **është pranuar pjesërisht** me komentin e menaxhimit si vijon: "*Bazuar në kapitullin IV të Manualit të AB, është përcaktuar qartë që në realizimin e planit gjatë vitit mund të ketë ndryshime të vlerësimit të riskut ose problematika të dala që kërkojnë zgjidhje nga titullari i njësisë publike, për të përmirësuar proceset e qeverisjes, administrimit të riskut dhe proçese vetë kontrollit. Duke qenë proçes monitorimi, zbatimi i rekomandimeve nuk do të planifikohet dhe nuk do të raportohet si angazhim i veçantë. Megjithatë, ky proçes do të jetë në fokus të përmirësimit, nga ana e DH/AB, e cila do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme realizimin dhe devijimet e planit nga NJAB-së".* Në dokumentin " Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH" dt. 01.05.2018, menaxhimi shton se: "... *Në kuadrin rregullator është përcaktuar se asnjë njësi auditimi nuk mund të planifikojë dhe të realizojë auditime të veçanta për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna..... DH/AB ka të përcaktuar në ligj dhe luan rregullisht rol udhëheqës në drejtim të monitorimit të të gjithë veprimtarisë së AB, me qëllim që kjo veprimtari të jetë gjithnjë e më shumë në përputhje me standardet ndërkombëtare".*

Opinioni i grupit të auditimit:

Bazuar në dokumentacionin e dosjes së ndryshimeve të planeve vjetore të vëna në dispozicion nga DH/AB, konstatohet se gjatë vitit 2017 janë protokolluar gjithsej 18 kërkesa për ndryshim plani auditimesh nga të cilat vetëm 13 janë të shoqëruara me shpjegime. Gjithsesi, mbetet e paqartë se si DH/AB mund të monitorojë ndryshime të tjera që mund të jenë bërë nga njësi të tjera por që mund të mos kenë njoftuar, pra mungon një element kontrolli që do të garantonte saktësinë e shifrës së realizimit të planit të

auditimeve që paraqitet në raportin vjetor të KBFP ku gjejmë njësi me realim plani mbi 200%.
Kjo pikë është trajtuar edhe në auditimin e aktivitetit për vitin 2017 ku janë paraqitur gjetje dhe konstatime mbi mangësitë, pasaktësitë në raportim të planeve dhe ndryshimeve të tyre, në formatet e kërkesave dhe arsyet e paraqitura për ndryshime. **Kjo pjesë e rekomandimit edhe pse është pranuar nuk gjejmë të jetë ndërmarrë ndonjë veprim për harmonizim të formateve, mënyrës së raportimit dhe kontrollit për saktësinë e raportimit dhe DH/AB përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit mbetet në mosveprim.**
Për sa i përket pjesës së rekomandimit mbi auditimet tematike "për zbatimin e rekomandimeve" që ato të paraqiten si auditime të veçanta dhe jo pjesë e zërit "shërbime këshillimi", konstatojmë se nuk janë bërë ndryshime në formatin e evidencave për të dalluar këto angazhime ndërkohë që institucionet raportojnë auditime të kryera të llojit "mbi zbatimin e rekomandimeve". Gjithashtu, argumentimi i menaxhimit të DH/AB në lidhje me këtë çështje është i paqartë se c'pjesë e "kuadrit rregullator" përcakton se: " *..asnjë njësi auditimit nuk mund të planifikojë dhe realizojë auditime të veçanta për ndjekjen e rekomandimeve*". Ndërkohë Ligji 114/2015, neni 6, neni 14 parashikon "..dhe lloje të tjera të auditimeve", duke mos e kufizuar mundësinë e kryerjes së auditimeve tematike, ose me kërkesë të titullarit, për zbatimin e rekomandimeve. Sipas Manualit të AB pika 2.6.1 parashikon detyrimin e titullarit për raportimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të AB. Pika 4.1.13 e Manualit të AB në përputhje me Standardin 2440 parashikon " *Audituesit e brendshëm vlerësojnë përshtatshmërinë, efektivitetin dhe afatet e veprimeve të ndërmarra nga menaxhimi për adresimin e çdo rekomandimi të auditimit. Kjo njihet si "ndjekja e procedurave" dhe mund të bëhet pjesë e angazhimit të auditimit për vitin që vjen, kur një gjë e tillë është përfshirë në planin strategjik të auditimit të brendshëm, ose si një angazhim i veçantë, nëse nuk është planifikuar ndonjë angazhim auditimi në atë sistem*"
Në përputhje me standardet e AB-së: 2010 "Planifikimi" dhe 2030 "Menaxhimi i burimeve", monitorimi i zbatimit të rekomandimeve, edhe pse mund të mos planifikohet si një angazhim i veçantë, NJAB duhet të planifikojë kohën ditë-njerëz për monitorimin e rekomandimeve të lëna që do të ndiqen dhe raportohen në bazë të rëndësisë, riskut të vlerësuar[13].
Gjithashtu, duke qenë një indikator i rëndësishëm i efektivitetit të NJAB (pasaporta e indikatorëve sipas SIGMA) identifikimi, paraqitja e tyre mbetet e rëndësishme për të dalluar këtë angazhim nga angazhimet tematike me indicie apo me kërkesë të titullarit; **Në gjykimin tonë, DH/AB mbetet në mosveprim në lidhje me këtë rekomandim dhe rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.**

1.2 Koordinimin e punës së auditimit të brendshëm me strukturën përgjegjëse për inspektimin financiar me qëllim forcimin e punës së organeve të inspektimit dhe trajtimit me profesionalizëm të rasteve të denoncuara. Transparenca dhe njoftimi i publikut për rastet e

[13] *Standardi 2500- Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve dhe Manuali i Auditimit të brendshëm pika 4.13.1&2*

trajtuara është me rëndësi për të rritur jo vetëm rolin, por edhe besueshmërinë ndaj kësaj strukture. Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi **është pranuar pjesërisht** i shoqëruar me komentin e menaxhimit si vijon: "*Përcaktimin në gërmën d të nenit 14 të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, ku specifikohet raportimi menjëherë në formë të shkruar te titullari I njësisë publike dhe tek Ministri i Financave, i cili ka në varësi strukturën e inspektimit financiar publik, kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e NJAB përbëjnë vepër penale, është një dispozitë shteruese.*
Nuk është detyrë dhe përgjegjësi e strukturave të AB të raportojnë në lidhje me ecurinë e këtyre investigimeve. Megjithatë shprehemi se të gjitha raportet e inspektimit financiar janë të publikuara në ëëë.financa.gov.al dhe ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm. Ndërkohë DH/AB do të përfshijë edhe me tej në trajnimin e vijueshëm të audituesve të brendshëm strukturën e inspektimit financiar për të diskutuar lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e secilës palë në këtë drejtim.". Në dokumentin "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit 2016", dt. 01.5.2018, menaxhimi i DH/AB shton se: "*Në të gjitha Programet e Trajnimit të Vijueshëm Profesional për AB janë përfshirë dhe trajtuar tema specifike mbi trajtimin e rasteve të mashtrimit dhe korrupsionit dhe komunikimin ndërmjet funksioneve të AB, Inspektimit Financiar dhe KLSH. E gjitha kjo për të qartësuar rolin dhe përgjegjësitë e audituesve në trajtimin e rasteve të dyshuara për mashtrim dhe korrupsion*".

Opinioni i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të trajnimeve të vijueshme si: listeprezenca dhe temat e trajtuara në 4 Modulet e trajnimeve të vijueshme nuk u konstatua pjesmarrje e specialistëve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar. Gjithashtu nga komunikimi me Drejtoren e Përgjithshme të DH/KBFP në lidhje me këtë pikë nuk konfirmojmë se janë kryer mbledhje apo takime të posaçme midis dy departamenteve në lidhje me rolin, përgjegjësitë e secilës palë.

Në lidhje me transparencën, faqja zyrtare e Drejtorisë së Inspektimit Financiar nuk është e disponueshme (kërkimi i dt. 22.5.2018- 13.6.2018), gjithsesi numri i raporteve të publikuara nga kjo drejtori nuk është objekt i këtij auditimi për të konfirmuar plotësinë dhe nivelin e transparencës së publikimeve. Gjithsesi, vlerësuar mbi bazë të evidencave të vëna në dispozicion më 05.05.2017 (format Excel) nga specialistja e DH/AB, rezulton se janë përcjellë në Drejtorinë e Inspektimit Financiar nga AB-të vetëm 4 raste për investigim nga 19 raste të raportuara gjatë vitit 2016. **Në gjykimin tonë ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

1.3 Është e nevojshme të bëhen plotësime në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", I ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", lidhur me një formulim më të plotë të fushës së zbatimit të ligjit. MFE të marrë masa me qëllim zbatimin e plotë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, duke përfshirë sipas karakteristikave specifike të tyre

shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme; dhe duhet të shprehet në kuadër ligjor për zbatimin nga institucionet e pavarura të cilat krijojnë apo shpenzojnë fonde publike. Nisur nga fakti se ndryshimet e këtij ligji sapo kanë ndodhur, mund të rritet roli aktiv i DH/MFK pranë MFE, për një kuptueshmëri sa më të lartë të shtrirjes dhe funksionimit të MFK edhe përmes përgatitjes së një udhëzimi unifikues. Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi pranohet pjesërisht i shoqëruar me komentin e menaxhimit si vijon**: "***Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 i ndryshuar, në nenin 3 përcakton qartë fushën e zbatimit të tij. Ky ligj ngarkon me përgjegjësi për zbatimin dhe implementimin e sistemit të MFK të gjitha njësitë e përfshira në këtë nen. Për sa i përket rritjes së rolit të DH/MFK, në rritjen e nivelit të kuptueshmërisë së koncepteve dhe funksionit të MFK, DH/MFK asiston në mënyrë të vazhdueshme këto institucione me qëllim implementimin e kërkesave ligjore".*

Opinioni i grupit të auditimit

Në dokumentin "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit 2016" të DH/KBFP dt. 01.05.2018 nuk paraqitet ndonjë plan konkret veprimi në lidhje me qartësimin e fushës së zbatimit dhe rolin e DH/MFK dhe se si kjo drejtori i ka asistuar në mënyrë të vazhdueshme institucionet e pavarura me qëllim implementimin e kërkesave ligjore. Kështu shoqëritë tregtare me kapital shtetëror vazhdojnë të mos raportojnë apo dorëzojnë pranë kësaj drejtorie formularët e vetëvlerësimit të MFK. Mbetet i paqartë racionaliteti në legjislacion, midis detyrimit për të raportuar aktivitetin e NJAB dhe jo gjendjen e MFK-së nga këto njësi të pavarura kur që të dyja janë dy shtylla të sistemit KBFP.

Kjo çështje, e fushës së zbatimit të Ligjit 10296 dhe roli i DH/KBFP janë trajtuar përsëri në raportin e auditimit të vitit 2017. **Në gjykimin tonë ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

1.4 Drejtoria për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të verifikojë regjistrin e nëpunësve zbatues lidhur me statusin e institucioneve, konfirmimet e nëpunësve zbatues, kriterin e arsimit të lartë dhe kriterin e vartësisë direkte nga titullari me qëllimin eliminimin e kundërshtive me ligjin, si edhe përditësimin e informacioneve të përmbajtura në regjistrin e nëpunësve zbatues. Afati : Menjëherë

Rekomandimi **është pranuar** shoqëruar me komentin e menaxhimit **se: "***Lidhur me rekomandimin përkatës, për Nëpunesit Zbatues (NZ) që ushtrojnë funksionin në më shumë se një institucion, sqarojmë se bëhet fjalë për ato institucione ku pozicioni i NZ është vakant dhe përkohësisht mbulohet nga NZ i institucionit epror me qëllim mos pengimin e veprimtarisë financiare. Për sa i përket institucioneve të cilat janë mbyllur dhe nuk ushtrojnë më aktivitet ekonomik, DH/MFK nuk është e informuar për këto institucione. Për sa më sipër do të mbahet në konsideratë një bashkëpunim akoma më i ngushtë me Drejtorinë e Buxhetit dhe të Thesarit në MFE. Kriteret e përshkruara në nenin 12 të ligjit te MFK zbatohen me rigorozitet nga ana e DH/MFK. Rastet e evidentuara i përkasin periudhës*

para miratimit të ligjit të ri të MFK. Në vazhdimësi, në përfundim të periudhës kalimtare dy-vjeçare te parashikuara ne ligj (neni 32), DH/MFK do të marrë masat për evidentimin e të gjithë institucioneve, NZ e të cilave nuk përmbushin kriteret dhe do të bëhet njoftimi i institucioneve përkatëse që të marrin masa për zëvendësimin e tyre me punonjës të cilët i plotësojnë kriteret ligjore".

Opinioni i grupit të auditimit:

DH/MFK, në përfundim të periudhës kalimtare dy-vjeçare mbi implementimin e kërkesave ligjore për nëpunësin zbatues, ju ka dërguar shkresën nr. 17416, datë 1.12.2017 të gjitha institucioneve të qeverisjes së përgjithshme me qëllim marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të nëpunësit zbatues me punonjës që përmbushin kriteret. Gjithashtu, është njoftuar edhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e kritereve të nëpunësit zbatues, të përcaktuara në nenin 12 si dhe marrjen e masave për rishikimin e të gjithë atyre nëpunësve civilë në pozicione pune të nëpunësit zbatues të cilët nuk përmbushin kriteret. Për këtë qëllim, me kërkesën e DAP, ju është përcjellë edhe lista e plotë ku evidentohen nëpunësit civilë në pozicione pune me funksione të nëpunësit zbatues të cilët nuk përmbushin kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010.

Përsa i përket cilësisë dhe rregullsisë së mbajtjes dhe përditësimit të regjistrit të nëpunësit zbatues, bazuar në regjistrin të vënë në dispozicion me datë 11/4/2018, janë konstatuar disa pasaktësi që nuk lënë mundësi për raportime të plota e të sakta në numër, dhe për më tepër në vlerësim dhe kontroll plotësim kriteresh arsimimi. Gjetjet në lidhje me regjistrin e NA dhe NZ i janë paraqitur menaxhimit të DH në Akt-konstatimin nr. 3 dt. 8.6.2018. **Në gjykimin tonë ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i zbatuar.**

2.1 Të rishikohen treguesit e përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015, vlerësimi i performancës për vitin 2016, për të qenë më përfaqësues dhe dhënë një pamje të drejtë të funksionimit të sistemit të auditimit të brendshëm dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik. Afati: Deri në Dhjetor 2017.

Ky rekomandim **nuk është pranuar** nga DH/ KBFP. Në dokumentin "Plan veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH" menaxhimi argumenton mospranimin e rekomandimit si vijon: "*..metodologjia e Monitorimit të performancës është përdorur për herë të parë në vitin 2016, dhe kërkon kohën e duhur për të testuar efektivitetin e saj në vlerësim. Gjithashtu, sqarojmë se në raportin përfundimtar në lidhje me këtë rekomandim ka pasaktësi. Analizohet vlerësimi sipas kësaj metodologjie i NJAB në Bashkinë Sarandë. Sqarojmë se kjo NJAB ka të miratuar një strukturë me dy AB, të cilët janë të çertifikuar, të trajnuar dhe me eksperiencë të gjatë profesionale. Miratimi i strukturës sipas akteve ligjore nuk është përgjegjësi e NJAB. Në këto kushte kjo NJAB nuk mund të vlerësohet negativisht ose me më pak pikë"*

Opinioni i grupit të auditimit:

Aktualisht, raporti vjetor i KBFP për vitin 2017 nuk ka në përmbajtjen e tij një vlerësim nëse indikatorët e performancës janë testuar apo vlerësuar nga

DH/MFK dhe AB për efektivitetin e tyre bazuar kjo në eksperiencën e këtyre drejtorive nëpërmjet: komunikimit me njësitë; asistenca e ofruar në përgjigje të kërkesave vetë njësisë apo cilësinë e raportimit të formularëve të vetëvlerësimit të konsoliduar, problematika të dala nga vlerësimet e jashtme të kryera, etj. Gjerësisht, problematika e disa indikatorëve në mënyrën e përpunimit të tyre, mënyrës së llogaritjes është evidentuar edhe gjatë auditimit të aktivitetit për vitin 2017 me efekte në në vlerësimin e treguesit të efektivitetit të perfomancës së sistemeve të kontrollit në sektorin publik. Këto problematika të konstatuara janë paraqitur në Akt-konstatimin nr. 4 dt. 14.06.2018.

Përsa i përket rastit të marrë në shqyrtim në Bashkinë Sarandë, ky konstatim i grupit të auditimit, nuk është kundërshtuar si i pasaktë në observacionet e DH pas dërgimit të projekt raportit të audimit për vitin 2016. Gjithashtu, argumenti që struktura e NjAB-së Sarandë është e miratuar nga titullari i vetë njësisë nuk justifikon: - shkeljen e Ligjit 114/2015 ku përcaktohet numri minimal i një njësie AB, - subjektivizmin dhe pasaktësinë e rezultatit të indikatorit. (Në llogaritje merret e mirëqenë se nuk ka vende vakante) si dhe - impaktin në saktësinë dhe pasqyrimin e drejtë të situatës së KBFP i konkluduar dhe raportuar në raportin vjetor të KBFP përgatitur nga kjo drejtori në zbatim të Ligjit 10296 i ndryshuar. Në gjykimin tonë rekomandimi nuk është kuptuar në thelbin e tij pasi, rasti i Bashkisë Sarandë është vetëm një shembull i problematikës në lidhje me mënyrën e llogaritjes së indikatorit[14] të performancës së AB-së gjë që çon në një vlerësim jo të drejtë (mbivlerësim) të tij dhe më pas të vlerësimit përfundimtar për njësinë (mbivlerësim). **Në gjykimin tonë, DH edhe pse ky rekomandim nuk është pranuar mbetet në mosveprim** duke marrë në konsideratë vazhdimësinë e problematikës gjatë vitit 2017 dhe impaktin e tij në saktësinë e raportimit të Ministrit të Financave më komisionin parlamentar.

2.2 Ministria e Financave dhe Ekonomisë të rishikojë organizimin dhe funksionimin e Bordit të KBFP, me qëllim kthimin e tij në një strukturë që i shërben përmirësimit të menaxhimit të sistemit të MFK në shkallë vendi, duke synuar një pjesëmarrje më të reduktuar por më efektive dhe veçanërisht këshilluese në fushën e kontrollit. Të ndryshoj raporti ekspert i jashtëm/ punonjës Ministrie, raport që ndikon jo vetëm në funksionimin e kësaj strukture por edhe në eliminimin e konfliktit që ekziston nga kryerja e funksionit të anëtarit nga drejtuesit e lartë të kësaj Ministrie. Afati: Menjëherë

Rekomandimi nuk është pranuar *shoqëruar me komentin e menaxhimit si vijon: "Mënyra e organizimit të Bordit KBFP është përcaktuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 28. Në zbatim të ligjit për MFK, u hartua dhe miratua Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 68, datë 08.06.2016 "Për krijimin e Bordit të KBFP". Në gjykimin tonë përbërja e Bordit të KBFP me anëtarë nga MFE dhe anëtarë me përvojë në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, kontabilitetin, dhe në fushën e auditimit të brendshëm është e*

[14]Aneksi23 :Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të pa plotësuara= Pozicione vakante të audituesve të brendshëm/ numrin total të audituesve të miratuar në strukturën e njësisë publike (%)

nevojshme për arsye se ky përfaqësim është gjithëpërfshirës në implementimin dhe mbarëvajtjen e sistemit të KBFP. Anëtarët e MFE disponojnë informacionin e nevojshëm mbi kontrollin e brendshëm si dhe adresojnë problematikat e ndryshme me të cilat përballen institucionet gjatë implementimit të këtij sistemi...".

Opinioni i grupit të auditimit: Në argumentin e tij për mospranim të rekomandimit të KLSH-së, menaxhimi vijon me përshkrimin e aktivitetit të Bordit KBFP përgjatë vitit 2017. Aktiviteti i këtij Bordi është trajtuar si një pikë e veçantë në auditimin e vitit 2017, ku edhe jemi shprehur mbi përputhshmërinë, efektivitetin e këtij aktiviteti i cili konsiston në vetëm dy mbledhje, njëra nga të cilat ka qënë objekt i auditimit të mëparshëm. Kryerja e aktivitetit si detyrim i Ligjit nuk është një argument relevant për mospranimin e rekomandimit në lidhje me efektivitetin e këtij aktiviteti dhe konfliktin e mundshëm të interesit apo funksionit të anëtarëve të këtij Bordi për të siguruar pavarësinë dhe objektivitetin e vendimeve të tij.

Disa anëtarë të Bordit të KBFP me funksione specialist apo drejtues në DH kryejnë funksione në zbatim të ligjit 10296 dhe 114/2015 ndërkohë marrin pjesë dhe vlerësojnë këto aktivitete apo raporte për të cilat ata vetë janë përgjegjës për hartimin e tyre. Kështu punonjësit e DH i gjejmë si: trajnues të kontraktuar nga ASPA; hartues tezash; korrigjues provimesh; anëtar komisioni çertifikimi; anëtar Bordi Mbikëqyrës KBFP apo anëtar Bordi Mbikëqyrjes Publike. Pavarësisht aktivitetit, struktura e këtij Bordi nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017 dhe deri në momentin e përfundimit të këtij auditimi dhe në gjykimin tonë **DH/KBFP mbetet në mosveprim të qartësimit dhe shmangies së konfliktit që ekziston nga kryerja e funksionit të anëtarit nga roli i tij si mbikëqyrës.**

2.3 DH/MFK, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për monitorimet në vend të institucioneve publike bazuar në pyetsorët e vetëvlerësimit, të dokumentojë procedurat e ndjekura dhe problematikat e hasura për çdo njësi të monitoruar. Monitorimet të realizohen në institucione të cilat vlerësohen me një nivel risku të lartë apo të moderuar, duke larguar nga praktikat formale të realizimit të këtyre procedurave. Afati: Në vijimësi

Rekomandimi nuk është pranuar shoqëruar me komentin e menaxhimit në dokumentin ' *Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së " date 01.05.2018, si vijon "DH/MFK, dokumenton të gjithë procesin e realizimit të monitorimeve në terren ...*" si dhe " *Institucionet për monitorim përzgjidhen në bazë të metodologjisë së vizitave në terren (të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.06 "Për miratimin e Manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit") ku formula është 50% e institucioneve që kanë performuar dobët, 25% e institucioneve që kanë një performancë mesatare dhe 25% e institucioneve që kanë një performancë të mirë. Pasi ndahen në këto tre kategori,nga secila kategori përzgjidhen ato njësi të cilat kanë një nivel risku më të lartë".*

Opinioni i grupit të auditimit:

Në lidhje me procedurën e ndjekur për monitorimet e pyetësorëve të vetëvlerësimeve për vitin 2017, është konstatuar se janë dërguar shkresat për njoftim monitorimi në njësitë e zgjedhura për monitorim, megjithatë dosja e monitorimeve të kryera ka mungesa të theksuara në lidhje me

dokumentat që do të reflektonin dhe evidentonin punën e kryer duke filluar që me procesin e planifikimit të këtyre monitorimeve mbi bazë vlerësimin e riskut deri në rezultatet e monitorimeve. Deri në përfundim të këtij auditimi. Kur raporti është dërguar për miratim te Ministri i Financave dhe Ekonomisë nuk janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit raportet e monitorimit, observacionet, takimet e kryera me njësitë si proces ballafaqimi apo diskutimi me justifikimin e ngarkesës së punës dhe prioritetit dhe se ato do të përpilohen pas mbarimit të Raportit vjetor. Raportet e monitorimeve janë pjesë e Raportit final por mbetet e pamundur, testimi i këtij informacioni për saktësinë, plotësinë dhe eficensën e monitorimeve të kryera si një aktivitet tepër i rëndësishëm i DH/MFK që do të jepte një siguri të arsyeshme mbi efektivitetin e sistemit të KBFP. Kjo pikë dhe problematikat e konstatura në auditimin e vitit 2017 është trajtuar gjerësisht dhe paraqitur te menaxhimi i DH me Akt konstatimin nr. dt .8.6.2018. **Në gjykimin tonë edhe në këtë pikë, pavarësish një rritje në numër të monitorimeve krahasuar me vitin 2016, procesi mbetet i mangët dhe nuk lë vend për vlerësim të përputhshmërisë së aktivitetit të kësaj Drejtorie në kuadër të përmbushjes së rolit të saj si monitorues i sistemit të MFK në zbatim Ligjit** nr. 10296, neni 26, pika 2.

2.4 Me qëllim që të sigurohet mirëfunksionimi i Komiteteve të Auditimit si organe këshilluese pranë titullarit, si një hallkë shtesë për rritjen e pavarësisë funksionale të strukturave të auditimit të brendshëm, të rishikohet VKM nr.160, dt.02.03.2016 " Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike" mbi të cilin ngrihen , funksionojnë dhe raportojnë Komitetet e Auditimit, duke adresuar me kujdes problematikat e konstatuara. Vëmendje të shtuar duhet të ketë deklarimi i konfliktit të interesit që cënon objektivitetin e këtyre strukturave. Afati: Mars 2018

Rekomandimi nuk është pranuar me argumentin se: "*DH/AB në hartimin e VKM nr. 160, datë 02.03.2016 " Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike", ka analizuar dhe përshtatur publikime të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA) në Florida të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Duke qenë se vendimi ka reflektuar një nga praktikat me të mira të funksionimit të Komiteteve të Auditimit të Brendshem mendojme se ndryshimi i propozuar është i panevojshëm. Roli i auditimit të brendshëm është të japë këshilla dhe rekomandime për titullarin e njësisë publike dhe ky Komitet është në funksion të këtij misioni dhe në mbështetje tëpunës së njësisë së auditimit të brendshëm për të rritur pavaresinë e kësaj strukture. Duke qënë se krijimi i këtyre strukturave ishte në vitin e pare të funksionimit, mendojmë se akoma nuk mund të dalim me analiza tëmirefillta në lidhje me efektivitetin e funksionit të tyre"*

Opinioni i grupit të auditimit:

Pavarësisht se rekomandimi nuk është pranuar nga ana e subjektit, problematika e ngritur është konstatuar dhe gjatë auditimit të vitit 2017. Në kuadër të Ligjit 114/2015 dhe VKM nr. 160 dt. 02.03.2013, konstatojmë se gjendja e Komiteteve të Auditimit, mënyra e raportimit të tyre apo

monitorimi i aktivitetit mbetet e pambuluar apo trajtuar edhe gjatë periudhës 6 mujore pas auditimit të vitit 2016 dhe rekomandimit respektiv të KLSH. Kështu, konstatojmë se:
-Numri i Komiteteve të ngritura mbetet po 8-të ; Nuk ka ndonjë një udhëzim për detyrimin dhe mënyrën se si këto Komitete Auditimi duhet të raportojnë tek DH/AB,
-Nuk ka një analizë nga DH/AB, në vijim të rekomandimit të KLSH-së për përmirësime ligjore apo nënligjore për të rritur eficiensen e këtyre KAB-ve, nxitjen e ngritjes së tyre specifikisht në institucione qëndrore me shumë njësi varësie. Vetë Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ka jo funksional KAB e krijuar në 12.04.2016 dhe nuk raporton asnjë aktivitet të KAB-së në raportin e analizës vjetore për vitin 2017.
- Në kuadër të rolit të saj monitorues DH/AB, nuk ka kryer ndonjë monitorim apo analizë mbi cilësinë e punës së KAB ekzistuese, vlerën e tyre të shtuar nëse ka për të justifikuar vlerën për para të shpenzuar nga buxheti për këto struktura.
Gjithashtu sjellim në vëmendje pjesë nga pjesë nga raporti i auditimit për vitin 2016: "*Në Vendimin nr. 160 datë 2.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Njësitë Publike", përcaktohen ndër të tjera kompetencat dhe përbërja e këtyre organizmave. Gjykojmë se kriteret e strukturave që jo vetëm do të monitorojnë punën e njësive të auditimit për të garantuar pavarësinë por edhe cilësinë e rekomandimeve, rol këshillimor për dhënie të një garancie të arsyeshme Titullarëve të institucioneve publike, potencialisht nuk mund te garantojnë kapacitete ekspertizë në nivelin e nevojës për të.... Në rastet kur këto Komitete janë krijuar kemi përsëritje të ekspertëve të përfshirë në këto Komitete që reflekton potencialisht mungesën e kapaciteteve për të siguruar një mision të plotë në dhënien e garancive të arsyeshme lidhur me procesin. Nga analiza e emrave që qarkullojnë në këto struktura, konstatojmë edhe problematikën që një pjesë e tyre shfaqen në pozicionin e drejtuesit të njësisë së auditimit në institucionet e tyre dhe anëtarit të Komitetit të Auditimit në një institucion tjetër po të të njëjtit rang. Në kushte konflikti interesi gjykohet prezenca e titullarit të njësisë së Auditimit të Prokurorisë së Përgjithshme në Komitetin e Auditimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ujërave. Në këto kushte, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave duhet të analizojë objektivisht situatën e krijuar, dhe kërkojmë që të vendosë kërkesa dhe kritere specifike për të mënjanuar rastet e konfliktit të interesit, në fakt e në dukje por duke siguruar ruajtjen e niveleve të lartë të profesionalizmit të përfaqësuesve"*. Për shkak të ndryshimeve të ndodhura, shkrirja dhe riorganizimi i ministrive mund të ketë tejkaluar rastet e përmenduara, por kjo nuk do të thotë që struktura e DH/AB të mos ketë në fokus vlerësimin e konfliktit të interesit të personave që përshihen në këto struktura, dhe më e pakta që mund të bëjnë është të angazhojnë strukturat përgjegjëse për vlerësimin e konfliktit të interesit. **Në gjykimin tonë, DH/AB mbetet në mosveprim në lidhje me këtë rekomandim.**

2.5 Të përcaktohet një procedurë e brendshme që të sigurojë formalizmin e procesit të konsolidimit dhe miratimit të Planit Strategjik dhe Vjetor të sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin

publik. Të kërkohet që procesi i hartimit të këtyre planeve, edhe në njësitë, të ketë për bazë një vlerësim risku të kujdesshëm dhe jo formal. Afati : Deri Mars 2018

Ky rekomandim **nuk është pranuar** me komentin e menaxhimit si vijon: "*Plani i konsoliduar strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së NJAB në sektorin publik është një material i bazuar mbi planet e miratuara të NJAB. Ky plan vlerësohet nga DH/AB si një dokument i rëndësishëm mbi të cilin analizohet veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik. Në hartimin e ligjit, i cili i është shpërndarë për mendim grupeve të interesit, është vlerësuar që ky dokument duhet të dërgohet për informacion te Ministri i Financave, si dhe autoriteti përgjegjës për bashkërendimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Bazuar në Kapitullin III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, është përcaktuar qartë që plani duhet të bazohet në një vlerësim sa më real të riskut të njësive publike"*
Gjatë auditimit për aktivitetin e vitit 2017, konstatojmë se procesi i konsolidimit të planeve strategjike dhe vjetore të sistemit të AB nuk ka ndryshuar. Planet hidhen manualisht dhe mbahen në formë elektronike në Excel. Specialistja përgjegjëse, për konsolidimin e planeve vjetore por dhe më pas e të gjithë evidencave në lidhje me realizimin e aktivitetit vjetor të AB ku ajo asiston rast pas rasti njësitë, sidomos ato të krijuara rishtaz për mënyrën se si përpilohen këto plane strategjike mbi bazë të vlerësimit të riskut. Nga raporti vjetor dhe analiza vjetore e drejtorisë konstatohet se vlerësimi i riskut mbetet një aktivitet problematik, i cekët dhe formal. Gjatë auditimit u shqyrtuan me zgjedhje rreth 90 plane strategjike dhe vjetore dhe në shumë prej tyre pjesa e risqeve të identifikuar ishte thjeshtë një perifrazim teorik i llojeve të risqeve i pakonkretizuar sipas natyrës dhe funksionit të njësisë. Në trajnimet e vijueshme shumë tema ndërtohen dhe paraqiten me fokus vlerësimin e risqeve dhe hartimin e regjistrit të riskut, rolit të koordinatorit të riskut etj ku specialistja është edhe trajnuese. **Gjykojmë se mbetet i nevojshme një rishikim i procesit të konsolidimit të planeve dhe i ndarjes së detyrave për të lënë kohë analizave dhe këshillimit e më pas monitorimit gjatë vitit për zbatimin e këtyre planeve dhe azhornimin dinamik të regjistrit të risqeve.**

2.6 Te rishikohen treguesit mbi të cilët monitorohet dhe raportohet aktiviteti i AB, duke vënë theksin dhe mbi tregues të cilët reflektojnë vlerën e shtuar të strukturave të auditimit të brendshëm. Të plotësohen treguesit lidhur me nivelet e rikuperimit të efekteve financiare në buxhet si dhe të harmonizohet dhe standardizohet praktika e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit të brendshëm në shkallë sistemi kjo do të rrisë ndërgjegjësimin dhe kulturën menaxheriale të drejtuesve në njësitë e sektorit publik. Afati : Menjëherë dhe në vijimësi

Ky rekomandim **nuk është pranuar** nga DH.AB. Gjatë punës audituese të aktivitetit të vitit 2016, evidenca dhe raporti i vënë në dispozicion u analizuan dhe testuan duke arritur në të njëjtin konkluzion me atë të grupit të auditimit të vitit të kaluar, se treguesit dhe indikatorët nuk janë përfaqësues i cilësisë së punës së auditit të brendshëm dhe vlerë e shtuar

për menaxhimin dhe njësinë ku ata operojnë. Gjetjet, mangësitë në llogaritje, shpjegimet e anekseve të AB dhe vlerësimi i tyre me shkallë të lartë subjektivizmi, i janë paraqitur drejtimit të DH.AB në A.K nr. 4 dhe çështja e zbatimit të rekomandimeve është trajtuar më lart në pikën 1.1.

2.7 Përcaktimin e qartë të përgjegjësive mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse të Komisioni i Kualifikimit të AB në procesin e zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm si lidhur me Trajnimin e Vijueshëm të detyrueshëm dhe Certifikimin e Audituesve të Brendshëm në Sektorin publik, përgjegjësi që duhet të jenë të ndara nga detyrat ekzekutive dhe administrative të Drejtorisë së Harmonizimit të AB në MFE. Afati : Në vijimësi

Ky rekomandim **nuk është pranuar** me argumentin e menaxhimit si vijon: "*KKAB dhe DH/AB kanë të përcaktuar qartë në aktet ligjore në fuqi rolet dhe përgjegjësitë lidhur me procesin e çertifikimit si dhe trajnimit të vijueshëm. Me konkretisht, bazuar në gërmën c) dhe Ç) të pikës 14 të VKM nr.116, datë 17.02.2016 | Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e KKAB ne sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit", Komisioni realizon të gjitha detyrat dhe merr vendime për procesin e çertifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në përputhje me rregulloret përkatëse të miratuara nga Ministri i Financave. Përkatësisht në nenin 6 të Rregullores për proçedurat e çertifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik", miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 37, dt. 16.3.2016, të ndryshuar dhe ne nenin 7 të "Rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve në sektorin publik" miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr .3, date 08.01.2016, janë specifikuar përgjegjësitë e KKAB"*

Opinioni i grupit të auditimit

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e aktivitetit të KKAB, nuk u konstatua ndryshime në procedura apo rregullore. KKAB, përveç përcaktimeve në Ligjin 114/2015, ka funksionuar dhe ushtruar kompetencat mbështetur në: VKM nr. 116, datë 17.02.2016 "Mbi organizimin, funksionimin dhe përbërjen e KKAB dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit", Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 3, datë 01.2016, " Për miratimin e Rregullores së TVD për audituesit e brendshëm" dhe Urdhrit Nr. 37, datë 16.03.2016 " Për miratimin e procedurave për certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik" ndryshuar me Urdhër nr.26 datë 21.03.2017 si dhe Urdhër nr.136 datë 30/12/2016 për "Miratimin e pragramit te trajnimit të vijueshëm te detyrueshëm për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2017". Mbështetur në përcaktimet e akteve të mësipërme, KKAB parashikohet të kryejë funksion mbikëqyrës të procesit të trajnimit dhe çertifikimit të audituesve dhe bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për auditimin e brendshëm në MFE. Specialistët e DH/AB janë të gjithë të përfshirë në procesin e certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm e më pas të hartimit të relacioneve të vlerësimit të procesit, cilësisë së trajnerëve dhe më pas konsolidojnë raportimeve vjetore dhe bëjnë vlerësimin me pikë të njësive AB që ata vetë kanë trajnuar e certifikuar.

Gjatë periudhës së auditimit, në mbarim të mandatit 2 vjeçar të KKAB

është miratuar struktura e re .

2.8 DH/AB të rishikojë dhe të përditësojë Regjistrin e Audituesve të Brendshëm të Certifikuar dhe të trajnuar me qëllim që ky dokument të përmbajë informacion të dobishëm dhe të nevojshëm që të pasqyroje situatën e zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm në kohë, por njëkohësisht të shërbeje si dokument dhe bazë të dhënash për të siguruar analiza të zhvillimit për të ardhmen. Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.

Ky rekomandim **nuk është pranuar** me argumentin e menaxhimit si vijon: "*Në pikën 2 të Nenit 15 të Rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdher te Ministrit te Financave nr. 3 dt. 08.01.2016, përcaktohet se në Regjistrin e AB-ve përfshihen të gjithë audituesit në detyrë dhe audituesit e brendshëm që nuk ushtrojnë profesonin por kanë ndjekur programin e TVP dhe të gjitha vendimet e KKAB për njohjen e trajnimeve ose publikimeve. Bazuar në këtë përcaktim të Regjistrit Kombëtar i Audituesve të Brendshëm të certifikuar nuk mund të ndërthuret me këtë regjistër. Në lidhje me të dhëna të hollësishme mbi audituesit e brendshëm në sektorin publik, theksojmë që megjithëse DH/AB i posedon nuk mund ti publikojë***.***

Opinion i grupit të auditimit.

Ligji përcakton detyrimin e DH/AB për të hartuar dhe përditësuar Regjistrin e Audituesve të Brendshëm të Certifikuar. Regjistri i audituesve të brendshëm të trajnuar është publikuar në faqen zyrtare të internetit ëëë.financa.gov.al . Konstatojmë së forma dhe përmbajtja e Regjistrit të Audituesve të Brendshëm konstatojmë që përmban informacion të limituar. Regjistri duhet të integrohet me Regjistrin e Audituesve të Brendshëm të Certifikuar për periudhën dhe të përmbajë informacion progresiv dhe elementë të sigurtë identifikues të AB të certifikuar. Ky regjistër duhet të integrohet me regjistrin e trajnimit të vijueshëm për të ndjekur rastet që nuk janë në përmbushje të detyrimit të TVP. Regjistri është dokument zyrtar, dhe si i tillë duhet të protokollohet në fund të çdo viti në zyrën e protokollit të Ministrisë së Financave, krahas publikimit në faqen zyrtare të internetit në rubrikën përkatëse të Ministrisë së Financave. Përsa më sipër gjykojmë se Regjistri duhet rishikuar dhe të ndërtohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin II të Ligjit për Auditin e Brendshëm dhe Aktivitete të tjera rregulluese nënligjore ku detyrimisht të evidentohen të dhëna për: niveli i shkollimit, vitet e punës në total dhe ato në njësi AB; të dhëna personale (përfshirë NID); informacion në rast se ka c'rregjistrim nga regjistri kombëtar etj. Ky regjistër në përfundim të çdo sezoni çertifikimi duhet plotësuar dhe depozituar në zyrën e arkivës të Institucionit.

2.9 Në vijim të problematikës së evidentuar nga auditimi, Ministria e Financave dhe Ekonomise të rishqyrtoje zbatimin e VKM nr. 786, date 09.11.2016 " Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anetarëve, si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike", duke vlerësuar pozicionin e çdo anëtari në këtë bord. Afati: Menjëherë

*Ky rekomandim **nuk është pranuar** me argumentin e menaxhimit si vijon: "Për sa i përket këtij rekomandimi, nuk është kompetencë e DHKBFP,*

zbatimi dhe monitorimi i VKM nr. 789, dt. 9.11.2016, si dhe vlerësimi i përbërjes së këtij bordi, i cili është përzgjedhur sipas rregullave në fuqi. Ndërkohë, në gjykimin tone procedura e përzgjedhjes është bërë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në këtë VKM, dhe mbështetur në urdhrin nr.115, dt. 01.12.2016 "Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtareve të BMP dhe për ngritjen e komisionit ad-hoc"

2.10 Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa, duke iu drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me qëllim verifikimin e konfliktit të mundshëm të interesit për anëtarët e Komiteteve të Auditimit, Bordit te Menaxhimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publik. Në rast se nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk do të konstatohet veprim lidhur me këtë rekomandim brenda afatit 20 ditor, kur duhet të prezantojë planin e veprimit për sa është rekomanduar, KLSH të adresojë pranë ILDKPKI kërkesën për verifikimin e konfliktit të interesit në rastet e specifikuara me lart. Afati : Menjëherë

Ky rekomandim **është pranuar pjesërisht** me argumentin e menaxhimit: "*Në strukturat e përmëndura, nga ana jonë nuk është konstatuar asnjë konflikt interesi. Në këtë raport nuk është paraqitur asnjë rast konkret i konfliktit të interesit por vetëm një gjykim i përgjithshëm. Përbërja dhe përzgjedhja e këtyre organeve është përcaktuar më së miri në aktet ligjore në fuqi. Vlen të përmendet, që një pjesë e mirë e këtyre akteve ligjore janë dërguar për mendim prane KLSH, në momentin e hartimit te tyre, duke marrë në konsideratë sugjerimet e përshtatshme. Gjithsesi, MFE do bashkëpunoje ne vazhdimësi me ILDKP për të verifikuar rastet e mundshme të konfliktit te interesit".*

Opinion i grupit të auditimit

Shpjegojmë se është e pa konceptueshme që strukturat që merren me garantimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, pjesë e të cilave është edhe zbatimi i rregullave të etikës dhe parandalimi i konfliktit të interesit nuk kanë arritur të lexojnë cfarë kemi cilësuar në raportin e auditimit për vitin 2016. Konflikti i interesit është një koncept i gjerë që lidhet si me konfliktin në funksione dhe përgjegjësi edhe konfliktin e mirëfilltë të personave në anagazhimin në strukturat e cilësuara në rekomandimin e KLSH. Duhet të theksojmë se përzgjedhja e personave dhe formaliteti i procedurave të konstatuara nuk lidhen me kërkesat ligjore por me papërgjegjshmëritë e personave që kanë patur detyrën dhe funksionin për të vepruar në përputhje me kërkesat që ka vendosur ligji. Për të qënë më specifik po sjellim përsëri në vëmendje pjesët respektive të trajtuara në Raportin e auditimit për vitin 2016, me shpresën se strukturat do dijnë të lexojnë konfliktet funksionale që cënojnë sistemet e kontrolleve të brendshme por edhe konfliktet e interesit për persona të caktuar për të cilët përfshirja në strukturat respektive lidhen me marrëdhënie të ndërsjellat interesash akademike dhe familjare.

Pjesë nga Raporti i Auditimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar, 2016*: "Bordi i Menaxhimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (BMKBFP), krijuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 82, datë 02.10.2014, nuk ka*

funksionuar asnjëherë gjatë periudhës që ishte në fuqi. Me Urdhrin nr. 68 datë 08.06.2016 "Për krijimin e Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" është shfuqizuar Urdhri nr. 82, datë 02.10.2014, dhe është përcaktuar përbërja e bordit që kryesohet nga Ministri i Financave dhe përbëhet nga anëtaret si vijon: znj. G. P., nëpunësi i parë autorizues; znj. K. H, Drejtor i Përgjithshëm i DHKBFP, znj. M.Dh., Drejtor i Përgjithshëm i Buxhetit; z. L. S, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit; znj. E. L, eksperte; Z. J. N, ekspert; Z. E.B, ekspert. Gjykojmë se një formatim i tillë i bordit me pjesëmarrje të gjerë të nëpunësve që kanë detyrim dhe obligim të funksioneve të tyre mbikëqyrjen por edhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, i japin karakteristikat e një bordi formal që nuk arrin të prodhojë një oponencë të nevojshme për të sjellë rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale por edhe të reflektojnë aspektet kryesore për ndërhyrje. Në gjykimin tonë ka nevojë që të vlerësohet edhe konflikti i interesit i personave të emëruar në këtë bord, në mënyrë që kjo përbërje të garantojë realizmin e objektivit dhe misionit që ka kjo strukturë".

Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFK, në cilësinë e Sekretariatit të Bordit të KBFP, paraqet pranë këtij bordi problematikat e ndryshme të njësive publike, ndërkohë që drejtori i strukturës që përbën sekretariatin dhe përgatit Raportin vjetor për sistemet është pjesëmarrës në bord me të drejtë vote. Nënpunësi i parë autorizues është nënpunësi ku raportojnë të gjitha njësitë publike lidhur me nivelin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimin financiar, ndërkohë që miraton raportin për të cilin ka përgjegjësi direkte për mirëfunksionimin e sistemeve. Ndërkohë pjesë të funksionimit të sistemeve janë edhe drejtori i thesarit dhe drejtori i buxhetit të cilët japin siguri për sistemet për të cilat menaxhojnë dhe duhet të japin llogari. Në Bord të KBFP ekziston konflikti i interesit për shkak të lidhjes familjare por dhe lidhjeve të pune apo akademike që mund të cënojnë objektivitetin dhe paanshmërinë në vendime.

Për sa cituar më sipër, në raport është paraqitur shumë qartë dhe e bën lehtësisht të lexueshme faktin që jemi në kushtet e konfliktit të interesit për sa kohë që vlerësimi është bërë nga struktura të lidhura pra drejtor/vartës apo kolegë pavarësisht kërkesave dhe kritereve të vendosura nga Ministri i Financave për garantimin e cilësisë së këtij procesi. Ngarkimi i drejtorit të DH/MFK i cili përgjigjet për monitorimin e funksionimit të menaxhimit financiar, kontrollit, kontabilitetit dhe raportimit financiar me detyrën e kryetarit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike janë në kushtet e konfliktit të funksionit përtej faktit nëse ka konflikt interesi në këtë rast. Në gjykimin tonë, argumenti për mospranimin e plotë të rekomandimit nuk qëndron dhe Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar është përgjegjëse për mos veprim për të eliminuar minimalisht konfliktin e interesit të konstatuar nga auditimi.

Kriteri: *Ligji nr. 154/2014 dt. 19.2.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" Neni 15 gërma j; Neni 16, pika 1; Neni 25 pika ç; Neni 30 pika 1 dhe 2*

Impakti: Problematikat e konstatuara në DH/KBFP vijojnë të ekzistojnë duke mos u marrë masat e duhura për përmirësimin e situatës, duke sjellë një impakt në cilësinë dhe eficiencën e performancave publike.

Shkaku: DH/AB nuk ka marrë masat e duhura dhe mbetet në mosveprim.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Nëpunësi i Parë Autorizues, Bordi i Mbikëqyrjes KBFP dhe Drejtoria e Harmonizimit të KBFP të marrin masa të menjëhershme për implementimin, monitorimin dhe përmirësimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.Gjetje nga auditimi: Si një tregues tepër i rëndësishëm i cilësisë së auditimit dhe eficensës së struktures së AB, gjatë auditimit është shqyrtuar Ligji nr. 114/2015 "Për Auditin e Brendshëm në sektorin publik" dhe Ligji nr.10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe përmirësimet që këto ligje kanë pësuar me ndryshimet e bëra gjatë vitit 2015. Ndryshimet dhe përmirësimet ligjore kanë forcuar dhe theksuar kompetencat e titullarëve për shërbimin e auditimit të brendshëm por nuk sigurojnë pavarësinë, cilësinë e auditimit rrjedhimisht ngritjen e një strukture eficente dhe efektive në shërbim të mirëmenaxhit të fondeve publike.
Shkrirja e një strukture të përgjithshme si Komiteti AB dhe krijimi i një Bordi "Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" sipas nenit 28 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" me funksion "*Në Ministrinë e Financave ngrihet Bordi i KBFP, me detyrën e mbikëqyrjes së çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm, në sektorin publik", ndërkohë që konstatohet një* aktivitet minimal (2 mbledhje), me struktura në vetevete me konflikte të funksioneve operacionale dhe mbikqyrëse nuk siguron mbikqyrjen e strukturave AB.
Nga shqyrtimi i bazës ligjore konstatohet se, as në ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 dhe as në VKM nr. 160, datë 02.03.2016, *nuk janë përcaktuar kritere të qarta dhe të matshme për krijimin e Komiteteve të Auditimit, duke e lënë në vullnetin e titullarëve të institucioneve, si dhe nuk cilësohet detyrimi i tyre për të raportuar në DH/AB në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.* Megjithëse në auditimin e mëparshëm, u kërkua që DH/AB të kishte një rol aktiv në ngritjen dhe mirëfunksionimin e Komiteteve të Auditimit si një instrument që do të siguronte pavarësinë e strukturave dhe aktivitetit të audituesve të brendshëm, konstatohet se nuk ka hapa apo masa konkrete. Gjykojmë se DH/AB nuk ka arritur të kuptojë drejt rolin e saj udhëheqës dhe monitorues së këtij sistemi të rëndësishëm. Për rrjedhojë megjithëse kanë kaluar mbi tre vite nga miratimi i ligjit të ri, janë krijuar vetëm 8 Komitete Auditimi, nga të cilat 5 prej tyre kanë raportuar në DH/AB. Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka arritur ta vendosi në funksionim Komitetin e Auditimit. Raporti vjetor i përgatitur nga DH/AB nuk ka një analizë të plotë, referuar aktivitetit të Komiteteve të Auditimit, fakt që reflekton mungesën e vëmendjes së DH/AB referuar këtyre instrumentave, për të cilat u gjykua se do të ndikonin shumë në rritjen e pavarësisë së strukturave AB dhe për më tepër në garantimin e cilësisë së punës audituese.
Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Financave, bazuar në në nenet 10 e 26 të LAB, ka nxjerrë VKM nr. 83, datë 03.02.2016 për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendëm ku përcaktohen kriteret e krijimit të NJAB, organizimi e funksionimi i tyre dhe mënyra e sigurimit të shërbimit të auditimit nga njësitë publike që nuk i kanë ngritur këto struktura. Në fjalinë e dytë të pikës 3, të këtij vendimi është përcaktuar se: "*Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si audituesë të brendshëm në sektorin publik*.", çka do të thotë se, në çdo kohë në strukturat e auditimit të brendshëm në shkallë sistemi, mund të punësohen mbi 143 audituesë të brendshëm të paçertifikuar ose në 3 audituesë njëri mund të punësohet i pacertifikuar. Ky përcaktim bie në

kundërshtim me germën "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", dhe tejkalon kompetencat e Këshillit të Ministrave i cili sipas nenit 26, të këtij ligji, detyrohet të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 10, 13, dhe 22, por ***jo në zbatim të nenit 11***, ku përcaktohet punësimi i audituesit të brendshëm. Në rang kombëtar, sipas evidencave të vëna në dispozicion nga DH/AB rezulton se me rritjen e numrit të njësive AB të ngritura në sektorin publik, niveli i audituesve të çertifikuar në këto struktura, ka rënë nga 90% në 77% në dy vitet e fundit. Aktualisht në sistem ka 92 punonjës të pacertifikuar që janë punësuar në këto struktura (nga 400 audituesnë gjithë sistemin), pra 23% të strukturave të auditit të brendshëm në nivel kombëtar.

1.1- Rekomandimi: Kjo situatë kërkon vëmëndjen e menjëhershme të Bordit dhe Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, për të bërë analizë të thellë dhe propozime konkrete për përmirësime ligjore në funksion të shndërrimin të sistemit AB në një vlerë e shtuar për sektorin publik dhe jo për tja lënë në dorë çdo gjë ndërgjëgjësimit të titullarëve nëpërmjet trajnimeve. Këto përmirësime duhet të prekin komponentët:

- Rikonceptimi i Bordit të KBFP (në strukturë dhe në përmbajtje) dhe vetë Drejtorisë së Harmonizimit të AB për një monitorim me impakt real në zhvillimin dhe administrimin e strategjive të sistemit AB në përputhje me kërkesat ligjore dhe strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike.

- Përcaktimin e qartë të kërkesave ligjore për ngritjen e Komiteteve të Auditimit, afatet e ngritjes, kompetencat e tyre dhe mënyrën e raportimit, duke u larguar nga praktika e deritanishme që imponon kërkesa të larta të kulturës menaxheriale. Duhet të sanksionohen në ligj, kriteret e personave që përfshihen në Komitetet e Auditimit, si dhe mënyra e përzgjedhjes së tyre duke ju referuar procedurave konkuruese, transparente dhe që realizohen nga struktura që nuk varen nga institucioni ku ato do të kontribojnë.

- Cilësime të përgjegjësisë së titullarit për mbulimin me auditim të brendshëm në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Të përcaktohen qartë modalitetet e mbulimit me auditim të brendshëm të njësive të qeverisjes vendore, të cilat në shumë raste janë në kushtet e pamundësisë për të ngritur NjAB me tre punonjës, duke kërkuar bashkimin dhe krijimi i njësive të AB në rang qarku me staf të mjaftueshëm dhe hierarkik që siguron pavarësinë, objektivitetin dhe cilësinë e auditimit.

- Kriteret të forta punësimi në këto struktura duke ndryshuar (ulur) raportin 1/3 të audituesve të pacertifikuar për të shmangur emërime të AB pa eksperiencën e duhur, shpesh vetëm për qëllim të plotësimit të kriterit për të marrë çertifikatën e AB apo të emërimeve formale "me komandim" për një periudhë të përkohshme, si dhe duke rritur kriterin e eksperiencës në punë, masa këto të domosdoshme për të garantuar profesionalizimin e strukturave, faktor që shoqërohet gjithmonë me pavarësi audituese.

- Parashikimin e dispozitave shtrënguese si masa disiplinore dhe organizative në funksion të zbatimit të Ligjit 114/2015 dhe Ligjit 10296 datë 8.7.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 datë 22.10.2015.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Në Udhëzimin nr.23 datë 22.12.2017 *"Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit për vitin 2017",* konstatohet vetëm një ndryshim krahasuar me Udhëzimin e një viti më parë, respektivisht në Nenin 27 ku shtohet "*Për të gjitha Ministritë dhe institucionet për të cilat gjatë vitit 2017 ndryshuan fushat e mbulimit dhe përgjegjësitë në zbatim të VKM-ve përkatëse, gjë që u reflektua edhe në ndryshimet e programeve buxhetore në Aktin Normativ nr.3, datë 06.11.2017, rakordimi i planit për buxhetin e vitit 2017 me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të bëhet me ministritë dhe institucionet që i administrojnë këto fonde*

aktualisht". Përvec formalitetit të konstatuar, theksojmë se Udhëzimi rregullon rakordimin e planit buxhetor por jo kontabilitetin. Nisur nga fakti se Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik nuk ka hartuar ndonjë udhëzim tjetër të posaçëm për të trajtuar çështjen e ndryshimeve strukturore para mbylljes së vitit fiskal, gjykojmë se e ka gjykuar të mjaftueshëm se me përcaktimin se kush rakordon planin buxhetor kjo do të mbulonte dhe rregullimin kontabël të përthithjes dhe konsolidimit të pasqyrave financiare 11-mujore të Ministrive dhe programeve që pushuan së ekzistuari pas Nëndorit 2017. Konstatohet se nuk kanë gjetur rregullim çështje si:
Kush do të mbyllte pasqyrat financiare 11-mujore?! Afatin e dorëzimit të tyre, nëse duhej të përcaktohej një periudhë tranzicioni për përpunimin e të pasqyrave, për transferimin kontabël dhe fizik të inventarëve dhe aktive të qëndrueshme. Kush do të ishte personi përgjegjës për përgatitjen dhe miratimin e tyre?! Si veprohet me punonjësit e larguar apo të transferuar në Ministrinë e re me një detyrë dhe tagër tjetër?!
Këto aspekte kanë qënë objekt i auditimit financiar të KLSH në aparatin e MFE gjatë periudhës shkurt-maj 2018, duke evidentuar mos adresim të çështjeve të mësipërme dhe përgjegjësinë e DH/MFK sipas Ligjit 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

Udhëzimi nr.8 datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" është iniciuar me ngritjen e grupit të punës me Urdhrin nr. 142 dt. 17.11.2017 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e bazës rregullatore të kontabilitetit publik për një periudhë tranzitore, deri në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (IPSAS)". Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion: dosje e çështjeve të ndjekura në lidhje me kontabilitetin dhe përmirësime të tjera ligjore; nuk rezulton të jetë e plotësuar me minutat mbledhjeve të grupeve të punës apo relacione "dhënie mendim" apo versione finale të miratuara të udhëzimeve të përpiluara apo të analizës të sipërpërmëndur. Në kushtet kur prej disa vitesh është shtruar cështja se sistemit publik shqiptar i mungojnë standardet e kontabilitet të miratuara, nuk disponojmë nga DH/MFK ndonjë mbledhje të dedikuar të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, për propozimin e hartimit të një dokumenti të tillë tranzitor, duke përcaktuar çfarë konkretisht rregullon ai, cfarë ndryshimesh sjell?! Pika 2 thotë "rivënie në zbatim të rregullave në fushën e kontabiliteti publik", ndërkohë që ngrihen çështjet: *A kanë qënë të përpiluara dhe të detyrueshme për zbatim më parë këto rregulla dhe kur pushuan së zbatuari?! Cila është përcaktuar si periudhë tranzitore?! Cilat IPSA janë përshtatur/adaptuar?!*

Në këtë Udhëzim, pika 8 thuhet se "Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave në sektorin publik ka të bëjë me: *njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës; si dhe njohjen e të ardhurave në çastin e arkëtimit të tyre. Pra kemi të bëjmë me një "cash basis" të modifikuar.* Nëse ky udhëzim sjell ndryshime në njohjen trajtimin dhe mënyrën e kontabilizimit të transaksioneve të caktuara atëherë Udhëzimit i duhej të plotësoj me parashikim të një periudhë tranzicioni si cdo praktikë ndërkombëtare e Bordeve rregulluese dhe mbikqyrëse që nxjerr një standard apo letër pune shpjeguese për të shmangur konfuzion në interpretim dhe për një paraqitje të drejtë të pasqyrave financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme brenda një viti ushtrimor.

Gjithashtu, në Udhëzimin nr.23 datë 22.12.2017 pika 30, konfirmohet se baza ligjore, rregullatore për përgatitjen e pasqyrave financiare është Udhëzimi nr. 14 datë 2006, i rishikuar 2007, 2008, i Ministrit të Financave "Mbi përgatitjen dhe publikimin e Pasqyrave Financiare Vjetore për institucionet qëndrore, vendore dhe njësitë e zbatimit të projekteve për marrëveshjet me donatorët e huaj". Nga shqyrtimi i ndryshimeve të vitit 2007 dhe 2008 në Udhëzimin nr. 14 datë 28.12.2006, konstatuam se ndryshimet e vitit 2008 shfuqizuan pikat 8 dhe 9 e rubrikës I-rë, përkatësisht: "*Drejtoria e Kontabilitetit në Ministrine e Financave, mbi bazën e informacionit të*

depozituar, harton brenda datës 15 Qershor 2007 përmbledhëset e llogarive vjetore 2006 në keto nivele; Për Ministritë dhe Institucionet e tjera qëndrore; Për ISSH dhe ISKSH Për njësite e menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj; Për organet e Qeverisjes Vendore", dhe "Drejtoria e Kontabilitetit në Ministrinë e Financave mbi bazën e të gjithë informacionit të hartuar e depozituar ***bën konsolidimin e pasqyrave*** *financiare të vitit 2006 në nivel qëndror e lokal dhe i raporton ato brenda datës 15 Korrik 2007".* Udhëzimi nr.14 i datës 28.12.2006 i ndryshuar me Udhëzimin nr. 10 datë 27.2.2008, nuk parashikon një pikë se kush bën konsolidimin e pasqyrave financiar duke mbetur përsëri me Udhëzimet e përvitshme për mbyllje të llogarive të buxhetit nga Thesari. Një tjetër sqarim që nuk parashikohet nga DH/MFK është raporti/lidhja midis Udhëzimi nr. 14 datë 28.12.2006 dhe Udhëzimi nr. 8 datë 9.3.2018. A janë ata plotësues të njëri tjetrit apo ai më i hershmi shfuqizohet.

Lidhur me parimin e njohjes dhe rregjistrimit të shpenzimit. Udhëzimi nr.23 datë 22.12.2017, në pikën pikën 1/b përcakton *"Në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme përfshihen: Të gjitha shpenzimet publike të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të rregjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2017, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave (accrual basis)".* Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018, në pikën 37, përcakton *"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, para përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor, janë të detyruara të rakordojnë, vetëm për të dhënat mbi bazë cash (cash basis), me degën e thesarit të juridiksionit që i mbulon. Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet. Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët".* Ndërkohë në pikën 42, gjejmë të cilësuar "*Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara (commitment), për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", në varësi të natyrës së tyre*".
Këto cilësime i gjejmë në shkelje të Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, neni 61 ku thuhet se shpenzimi njihet në momentin e ndodhjes pra jo të pagesës. Fakti që nuk ka fonde disponibël për pagesë nuk është arsye që këto shpenzime të njihen si shpenzime të periudhave të ardhshme pasi ato në të vërtetë kanë ndodhur.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit, të rishikojë menjëherë Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" me qëllim jo vetëm harmonizimin e tij me ligjin për menaxhimin e sistemin buxhetor dhe udhëzime të tjera në fushën e kontabilitetit, por edhe për të prerë rrugën e praktikave që sjellin ligjërimin e krijimit të detyrimeve të prapambetuara.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e Kryetarit të Bordit të KBFP, të analizojë përgjegjësinë individuale për përfshirjen në Udhëzimin nr.8 të cilësimeve që konstatohen në kundërshtim me kërkesat e Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për organizimin dhe funksionimin e DH/AB, konstatohet se, nuk ka një analizë të plotë në sektorin publik nga ana e DH/AB për njësitë të cilat plotësojnë

kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që të paraqesin drejtë nivelin e shtrirjes së këtij shërbimi dhe cilësinë e tij në rang kombëtar. Raporti i pasqyruar nga DH/AB mbi sistemin dhe mbulimin me auditim për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme është bazuar vetëm në 119 njësi (entitete publike) dhe pa patur një analizë për një mbulim të plotë lidhur me këtë funksion. Në këtë raport, nuk përcaktohen kapacitetet audituese dhe mbulimi me auditim në shkallë sistemi, me njërën nga format e përcaktuara në nenin 10 "Organizimi i shërbimit të Auditimit të Brendshëm" të Ligjit 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik*" dhe në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*", i ndryshuar pikat 1 dhe 7, ku përcaktohet se "*Njësitë publike brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të bëjnë organizimin e njësive të auditimit të brendshëm*", kështu nuk arrijmë të shprehemi me bindje sa % të njësive që duhet të mbulohen me shërbim auditimi të brendshëm përfaqësohen nga numri 119 mbi të cilën përgatitet raporti vjetor.

Në kampionin prej 106 njësish që financohen nga Buxheti i Shtetit ku përfshihen Ministritë, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Institucionet e Pavarura të ngritura me ligj, u konstatua se në 24 prej tyre nuk ka mbulim me shërbimin e auditimit të brendshëm në njërën nga format e përcaktuara nga ligji. Kështu në Bashki si Poliçan, Has, Pukë, Konispol, Rrogozhinë Pustec dhe Delvinë nuk ka struktura të AB ndërsa në Bashkitë Cërrik, Belsh dhe Kurbin, është miratuar ngritja e strukturës AB, por nuk ka filluar plotësimi i strukturës përkatëse me auditues, fakt që tregon se 18% të njësive të pushtetit vendor nuk kanë mbulim me shërbim AB, ky tregues është më i lartë 30% nëse do të merrnim në konsideratë njësitë e qarkut dhe të prefekturës (12 njësi) të cilat nuk realizojnë mbulimin me auditim me një nga mënyrat e përcaktuara në ligj. Gjithashtu, konstatohet se në 15 Institucione të Pavarura, nuk realizohet mbulimi me shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njërës nga format e parashikuara në ligj.
Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet numër 9-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

1.1 Rekomandimi: DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj, të analizojë mbulimin me auditim të brendshëm për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme me njërën nga format e përcaktuara në bazën ligjore. Transaprenca e një analize të tillë jo vetëm do të ndërgjegjësojë aktorët dhe faktorët që garantojnë shtrirjen e plotë të auditimit të brendshëm në sektorin publik, por do të krijojë premisat për rritjen e rolit të këtyre strukturave për një menaxhim financiar sipas kërkesave të kohës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se gjatë vitit 2017, 38 njësi të auditimit të brendshëm, nga njësitë e sektorit publik që financohen nga buxheti i shtetit dhe që raportojnë pranë DH/AB ose 32% e totalit të njësive, e zhvillojnë veprimtarinë e tyre me më pak se tre audituesi, situatë në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektoin publik*", ku përcaktohet se: "*Njësia e AB përbëhet nga jo më pak se tre punonjës përfshirë dhe drejtuesin e njësisë"*. Po ashtu, konstatohen 7 njësi të auditit të brendshëm me drejtues të paçertifikuar dhe 24 njësi të auditit të brendshëm me 1/3 ose më shumë të punonjësve të pacertifikuar. Pra konstatohet se në një masë prej 45%, strukturat e auditimit të brendshëm edhe aty ku janë ngritur, nuk garantohen nga kapacitete njerëzore dhe profesionale. Kjo situatë (e pranishme më shumë në organet e pushtetit vendor dhe njësitë e varësisë) mund të cënojë arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit të brendshëm në shkallë sistemi.
Nga të dhënat e konsoliduara deri në fund të vitit 2017, referuar 119 njësive të qeverisjes qendrore, pushtet vendor, institucione të pavarura dhe shoqëri publike që raportojnë pranë

DH/AB, veprimtaria mbulohet nga 400 audituesose 93% e numrit të planifikuar. Nga këta të çertifikuar janë 308 audituesose 77% e numrit të punonjësve të përfshirë në këto struktura dhe 92 audituesose të pa çertifikuar ose 23%. Detajuar si 36 punonjës në proçes çertifikimi dhe 56 punonjës që nuk e zotërojnë këtë çertifikatë, por që duhet të ndjekin procesin e çertifikimit. Në rang kombëtar, sipas evidencave të vëna në dispozicion nga DH/AB rezulton se me rritjen e numrit të njësive AB të ngritura në sektorin publik, niveli i audituesve të çertifikuar në këto struktura, ka rënë nga 90% në 77% në dy vitet e fundit. Jashtë sektorit publik janë aktualisht rreth 1600 audituesose të çertifikuar (1911[15] audituesose të çertifikuar nga të cilët vetëm 308 të punësuar në sektorin publik). Kjo flet për qarkullim të shpeshtë të stafit të AB, punësimin vetëm për efekt të plotësimit të kriterit të çertifikimit apo emërimeve dhe largimeve politike.

Në raportin vjetor të KBFP për njësitë e qeverisjes së përgjithshme gjejmë të cituar faktin se 10 njësi kanë drejtues të paçertifikuar por asnjë iniciativë apo tërheqje vëmëndje për titullarët e njësive përkatëse, ndërkohë që duhet theksuar se nga evidencat del se ky numër është 15 njësi, përfshi këtu dhe njësitë e krijuara me 1 audituesose në strukturë, apo 2 specialistë + 1 përgjegjës apo 1 specialist + 1 përgjegjës ku asnjë audituesose i punësuar nuk është i çertifikuar: Të gjitha këto njësi janë në shkelje të Ligjit nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 11 pika b[16].

Nga ana tjetër, analiza e të dhënave të raportuara nga strukturat audituese, rezulton se, nga këta 400 audituesose, 162 kanë eksperiencë pune në auditim deri në 5 vjet dhe 238 mbi 5 vjet punë si audituesose ose 59 % e audituesve (238/400). Fakti që raportohet i grupuar numri i audituesve deri në 5 vjet, *nuk jep informacion të saktë të punonjësve të përfshirë në këto struktura me vjetërsi nën 3 vite pune, për të gjykuar nivelin profesional real të rekrutimit dhe zbatimin e kriterit të punësimit në strukturat e AB.*

Në raportin vjetor të sistemit KBFP për vitin 2017 DH/AB konkludon me opinionin se:" *…Vihet re interesi në rritje i punonjësve të rinj për t'u punësuar në strukturat audituese. Kjo shihet si një frymë e re, e përshtatur me zhvillimet teknologjike dhe energjinë që karakterizon brezat e rinj. Ata janë një gjeneratë e re që në bashkëpunim me audituesit me përvojë do të realizojnë në të ardhmen nivel gjithnjë e në rritje të cilësisë së punës së audituesve", opinion që n*ë gjykimin tonë nuk është i saktë dhe serioz. Në vënd të vënies së theksit në çështjen e ekzistences së strukturave të ngritura në shkelje të ligjit, të punësimit formal apo në shkelje të ligjit dhe me tregues performance shumë të dobët, flitet për të si një çështje politikash punësimi për brezat e rinj.

2.1 Rekomandimi: Analiza dhe raporti vjetor për sistemin KBFP, duhet të bazohen në një lexim real të të dhënave që raportohen nga strukturat e AB, duke qënë gjithmonë të qartë për të sjellë në vëmendje të Qeverisë dhe Kuvendit të rasteve ku strukturat janë ngritur në shkelje të ligjit, bëjnë punësime formale apo në shkelje të ligjit (me persona të pacertifikuar dhe që nuk plotësojnë kriteret për realizimin e këtyre funksioneve) dhe me tregues performance shumë të dobët.

2.2 Rekomandimi: Raporti i shkeljeve të konstatuara pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë të bëhet për cdo rast duke rekomanduar edhe tërheqjen e vëmendjes për Titullarët ku evidentihen këto shkelje.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi Nga auditimi i Planeve Strategjike të Auditit të Brendshëm të Institucioneve Qëndrore u konstatua se në 12 (dymbëdhjetë) prej tyre kishte mospërputhje në numrin e subjekteve për tu audituar mes planeve strategjike individuale të njësive dhe atij të

[15] Sipas rregjistrit të Audituesve të Certifikuar të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

[16] Ligji nr.114/2015, neni 11, pika 2.b) drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i certifikuar si "Audituesi brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si audituesi brendshëm ose i jashtëm;

konsoliduar, si p.sh Ministria e Punëve të Jashtme (tani Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Integrimit Evropian, Ministira e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Kulturës, Ministria e Energjitikës dhe Industrisë, Ministira e Mirqënies Sociale dhe Rinisë, Ministira e Mjedisist, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Punëve te Brëndshme. Nga auditimi i Planeve Strategjike të auditit të brendshëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, u konstatua se në 10 (dhjetë) prej tyre kishte mospërputhje me numrin e subjekteve për tu audituar, përkatësisht Bashkia Gramsh, Bashkia Mat, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Elbasan, Bashkia Tepelenë, Bashkia Divjakë, Bashkia Skrapar, Bashkia Lushnje, Bashkia Durrës, Bashkia Berat.

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se, 19 njësi të auditit të brendshëm (nga 90 të kampionuara), nuk kanë zbatuar afatin e dërgimit të planeve me një diapazon nga 1 ditë në 4 muaj (rasti i Albkontrollit). Me vonesë janë paraqitur planet nga njësitë e auditimit të DPD, Shoqëria e parë financiar e zhvillimit, DPT, Posta Shqiptare, etj.

Gjithashtu, gjatë auditimit u konstatua se, ka subjekte të cilat gjatë vitit kryejnë rishikim të planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm. Nga auditimi i dosjeve të NJAB që kanë bërë ndryshime të planeve vjetore u konstatua se, problematika më e madhe qëndronte në paraqitjen e këtyre ndryshimeve, konkretisht nga 18 institucione 8 prej tyre nuk kishin bashkangjitur memon argumentuese mbi ndryshimet e ndodhura ndërsa në pjesën tjetër u konstatuan raste të detajimit të planit fillestar si dhe raste të tjera të mosdetajimit të këtij plani dhe nuk është i qartë shkaku për ndryshimin e planit vjetor të miratuar. Manuali i Auditit të Brendshëm, pika 3.5 "*Rishikimi i planeve strategjikë dhe vjetor të auditimit të brendshëm"* ka parashikuar mënyrën se si duhet të operohet në rastet e ndryshimeve në plane, konkretisht: *Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NjAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit, (atje ku krijohet). Të gjithë planet vjetorë dhe strategjikë të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t'i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra.* Nga të dhënat e auditimit të realizuar në subjektin ISSH, konstatuam pasaktësi lidhur me të dhënat e raportuara nga DH/AB, referuar ndryshimeve strukturore të ndodhura si dhe ndryshimit të planeve si pasojë e këtyre ndryshimeve. Po kështu konstatohet se subjekti FSDKSH, ka raportuar 19 auditime të realizuara ndërkohë që në evidencat e DH/AB ky subjekt raportohet me realizim të 22 auditimeve. Pra të dhënat e konsolidura dhe të pasqyruara nga ana e DH/AB në raportin vjetor, përmbajnë pasaktësi dhe mbartin gabime si të strukturave të auditimit që raportojnë edhe të gabimeve njerëzore gjatë përpunimit dhe konsolidimit.

3.1 Rekomandimi: DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj, të rishikojë dhe të unifikojë formatin e shkresave shoqëruese të raportimit të ndryshimit të planit vjetor pranë DH/AB për gjatë vitit raportues, duke kërkuar cilësimin në numër dhe në përmbajtje të auditimeve që ndryshojnë dhe argumentimin e ndryshimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: DH/AB shprehet raport se "*...Përveç vlerësimit të jashtëm të cilësisë, vlerësimet e brendshme janë një element shumë i rëndësishëm i cili siguron monitorimin dhe mbikqyrjen e punës së audituesve në vijimësi.* DH evidenton*: se 40 njësi AB ose **30%** e sistemit AB nuk garantojnë sigurojnë kontrollin e vlerësimin e cilësisë"*. Nga shqyrtimi i evidencave të vëna në dispozicion rezultojnë 22 njësi me 1 audites dhe 26 njësi me 2 audites pra gjithsej 48 njësi ose **40%** e sistemit AB janë në shkelje të Ligjit nr.114/2015 dhe nuk garantojnë kontrollin e brendshëm të cilësisë. Në vijim, grupi i auditimit ka shqyrtuar evidencat duke marrë në konsideratë dhe faktorin "*aftësi dhe kapacitete profesionale*" ku evidentojmë se për 15 njësi që vërtetë plotësojnë kriterin ligjor 2+1 të audituesve të punësuar por raporti: audites të

paçertifikuar kundrejt numrit total audituesish është mbi 1/3 sipas kriterit ligjor. Këto njësi jo vetëm që janë në shkelje të VKM nr.83 dt.3.2.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", por duhen të merren në konsideratë kur flasim për vlerësim të cilësisë së auditimit dhe efiçensën e tij.

Kemi konstatuar se 15 njësi AB, raportojnë një realizim plani 100-200% por me tregues performance shumë të dobët si psh: *përqindja mesatare e zbatimit të rekomandimeve prej 36% dhe gjetje në vlerë prej 17 milion lekë në total*. Raste të tilla si:
1) K.sha me asnjë gjetje në vlerë nga auditi i brendshëm ndërkohë që nga raporti i auditimit të KLSH vetëm vlera e një gjetje me dëm ekonomik në një marrëdhënie kontraktore është 41.5 milion lekë,
2) Bashkia Kuçovë, Vorë me zero rekomandime në dy vjet,
3) Bashkia Kolonjë, me realizim 200% të planit të auditimit por vetem me 11 rekomandime që do të thotë që ka patur dhe auditime me as edhe 1 (një) gjetje dhe rekomandim. Fakti që kjo njësi ka kryer 28 auditime në 12 muaj koha mesatare për një auditim ka qënë 0.4 muaj pra në më pak se 10 ditë lind pyetja a kanë qënë këto angazhime auditimi apo inspektime?
4) Bashkia Dibër me 0% rekomandime të zbatuara**,**
5) Bashkia Malësia e Madhe në 14 auditime (175% realizimi plani) ka dhënë gjithsej 13 rekomandime pra më pak se 1 (një) rekomandim për auditim dhe për më tepër raporton vetëm 1 (një) të zbatuar**.**
Këto fakte, duhet të silleshin në vëmëndje në Raportin vjetor të KBFP dhe të paraqiteshin në analizë dhe opinion me profesionalizëm dhe transparencën e duhur në funksion të zbatimit të përgjegjësisë ligjore që kjo drejtori ka për përpilimin e këtij raporti.
Nëse këto 15 njësi, ku efiçensa shumë e ulët është evidente, i shtohen numrit të njësive të raportuara më lart si njësi që nuk garantojnë sigurimin e cilësisë së auditimit e çojnë në 63 njësi apo **53% të sistemit të AB ku sistemi i sigurimit të cilësisë mungon ose nuk funksion, rrjedhimisht ky sistem është ineficent.** E llogaritur mbi bazën e kostos mesatare për një audites sipas Planit Strategjik 2017-2020: 1300.6 lekë, **totali i kostos së auditimeve të kryera nga njësitë e mësipërme është 26,012 mijë lekë dhe treguesi i dobishmërisë së auditimit do të ishtë 0.18 lekë/1 lekë të shpenzuar** (duke supozuar se dëmet e vlerësuara janë të arkëtueshme).
Gjithashtu ineficencë totale konstatohet në 10 njësi AB të cilat nuk kanë raportuar asnjë aktivitet si psh: Universiteti i Tiranës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Klos, Prrenjas, Tropojë etj të cilat kanë kryer **zero** aktivitet përgjatë vitit 2017, njësi këto me një numër punonjësish prej 12 audites (paga vjetore e përllogaritur 16,380 mijë lekë).

4.1 Rekomandimi: DH/AB në mënyrë të menjëhershme duhet të analizojë me profesionalizëm dhe në thellësi çështjen e efektivitetit dhe eficensës së njësive AB dhe të reflektojë këtë analizë dhe rezultatet e saj në opinionet e dhëna në raportin vjetor të KBFP.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Bazuar në të dhënat e raportuara pranë DH/AB për vitin 2017, strukturat e 119 njësive të auditimit të brendshëm përmes 400 audituesve që ushtrojnë funksionet në to, kanë konstatuar një nivel dëmi ekonomik në shkallë sitemi prej 7,848,500 mijë lekë, vlerë që krahasuar me vitin 2016, është 3.7 herë më e lartë. Megjithatë, analiza tregon se në këtë vlerë shuma prej 6,029,000 mijë lekë i përket një auditimi të kryer nga NJAB e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në auditimin e ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, fakt që tregon se në shkallë sistemi niveli i shkeljeve të konstatuara vetëm 1,819,500 mijë lekë dhe më i ulët se viti 2016 ose më i ulti në 5 vitet e fundit. Edhe në numër 6.286 rastet e konstatuara për gjatë vitit 2017, janë më të ulta se numri prej 9.421 rastet e raportuara për vitin 2016.

Tabela.1 Vlera e dëmit në nivel total për një periudhë 5 vjeçare, shprehur në 000/lekë me ARRSH.

Gjetjet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Totali (në vlerë)	3.199.964	4.321.991	20.138.457	68.789.045	2.111.308	7.848.500
Totali (në numër)	4.698	3.556	4.441	4.186	9.421	6.286
Numri i audituesve	391	387	351	352	386	400

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar grupi i auditimit

Tabela.2 Vlera e dëmit në nivel total për një periudhë 5 vjeçare, shprehur në 000/lekë pa ARRSH.

Gjetjet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Totali (në vlerë)	3.199.964	4.321.991	20.138.457	68.789.045	2.111.308	**1.819.500**
Totali (në numër)	4.698	3.556	4.441	4.186	9.421	6.286
Numri i audituesve	391	387	351	352	386	400

NJAB e MIE përbëhet nga 8 audites e cila ka konstatuar 6,029,000 mijë lekë gjetje me dëm ekonomik në gjithsej 38 auditime të realizuara gjatë vitit 2017, ndërsa pjesa tjetër e gjetjeve me dëm ekonomik prej 1,819,500 mijë lekë i përket 118 NJAB të tjera që në përbërje të tyre kanë 392 audites dhe kanë realizuar 1322 auditime. Vlera e dëmeve të konstatuara nga strukturat e auditimit të brendshëm nuk është tregues domethënës për efiçencën e sistemit, kjo referuar literaturës apo praktikave ndërkombëtare. Megjithatë, në kushtet e Shqipërisë duhet të lexohet si ineficencë dhe varësi e plotë e këtyre strukturave nga titullarët e institucioneve, nëse i referohemi gjetjeve me dëme ekonomik të konstatuara nga audituesit e jashtëm shtetëror (KLSH), në po të njëjtat subjekte.

Gjatë këtij viti nga audituesit e brendshëm janë konstatuar 18 raste për investigim të mëtejshëm nga njësi të specializuara, kryesisht strukturat e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, AKU, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, P.Sh sha, Albpetrol, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor dhe Bashkia Kukës. Pesë prej këtyre rasteve i janë drejtuar për investigim të mëtejshëm Drejtorisë së Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pesë raste prokurorive të rretheve përkatëse, rastet e tjera i janë drejtuar titullarëve të njësive publike, Agjensisë së Prokurimit dhe Drejtorive të Policisë së Qarqeve përkatëse.

Në konkluzion, opinioni i dhënë në Raportin vjetor të KBFP nga DH/AB: "*Gjetjet me dëm ekonomik kanë një rritje të konsiderueshme krahasuar me gjetjet e vitit të mëparshëm. Kjo si pasojë e frymës Qeverisëse për të luftuar korrupsionin. Gjithashtu, ndikim ka patur dhe rritja e aftësisë profesionale të audituesve të brendshëm, thellimi i njohurive në fushat specifike, ashtu edhe në aksesin e pakufizuar në përdorimin e dokumentacioneve dhe informcaioneve në subjektet e audituara*" nuk qëndron dhe është i bazuar mbi një analizë sipërfaqësore duke lënë të patrajtuar çështjen eficencës dhe perfomancës së njësive sipas karakteristikave të tyre (njësi qëndrore, vendore apo të pavaruara) bazuar në numër gjetjesh kundrejt problematikave të ngritura nga auditimi i jashtëm (KLSH). Kjo do të shërbente si një instrument sinjalizues për mungesën e theksuar të pavarësisë dhe kompetencën e NjAB-ve dhe rrjedhimisht dhënien e rekomandimeve relevante për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në zbatim të ligjit të MFK neni 18, pika 3.

5.1 Rekomandimi: DH/AB të bëjë një analizë të drejtë dhe të plotë të nivelit dhe llojit të gjetjeve në raport me shtrirjen e strukturës AB në sektorin publik dhe në reflektim të rekomandimeve të KLSH si audites i jashtëm. Të raportojë drejt pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nivelin e performancës së strukturave AB dhe eficençës së punës së tyre. Plotësia dhe saktësia e raportimit mbi këtë sistem është jo vetëm obligim ligjor por edhe përgjegjshmëri ndaj funksioneve që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Konstatohet se në Manualin e Auditit të Brendshëm, publikuar në vitin

2016, nuk është përcaktuar qartë çështja e zbatimit të rekomandimeve e as mënyra e raportimit të tyre. Ndjekja në dinamikë e zbatimit të rekomandimeve është një nga treguesit thelbësor të performancës dhe eficensës së auditimit të brendshëm për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik. Kjo mangësi zbeh rolin e auditimit të brendshëm si mbështetës i titullarit të institucionit në arritjen e objektivave të njësisë dhe bie ndesh me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin publik*", nenit 6, "*Roli i auditimit të brendshëm*", gërma "ç", ku përcaktohet *"ç) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna*", nenit 14, "*Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm*" gërma "iv", ku përcaktohet, "*iv) veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar*;", si dhe nenit 24 "*Përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm"*, gërma "ë", ku përcaktohet se: "*ë) analizon rekomandimet e dhëna në raportet vjetore të njësive të auditimit të brendshëm*".
Nga auditimi u konstatua se, në formularin nr. 4, "*Rekomandimet e dhëna nga NJAB për periudhën (...)*", pasqyrohen të dhënat për rekomandimet ***e pranuara dhe të zbatuara*** gjithsej, sipas prioriteteve, ***por nuk pasqyrohen të dhënat për rekomandimet e papranuara dhe arsyet se pse***. Po ashtu nga auditimi i dosjeve u konstatua se, pjesa më e masdhe e njësive publike totalin e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak nuk janë hedhur fare ose janë të pasakta.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria DH/AB të shprehet qartë me anë të një udhëzuesi mbi domosdoshmerinë e një auditimi vjetor për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, auditim i cili duhet të analizojë statusin e rekomandimeve, shkaqet dhe përgjegjësitë e moszbatimit të tyre. Ky instrument shikohet nga ne, si një mënyrë për të ndërgjegjësuar strukturat drejtuese lidhur me rëndësinë e cilësisë së rekomandimeve të AB dhe shkallën e zbatimit të tyre si vlerë e shtuar në arritjen e objektivave të institucionit dhe si tregues i matjes së eficenses së funksionit AB.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm DH/AB, është organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm. Për vitin 2017, janë kryer 5 vlerësime të cilësisë, nga kjo strukturë në bashkëpunim me ekspertë të SIGMAS-s, në Ministrinë e Shëndetësisë, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, në Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe në bashkitë Berat dhe Fier. Sipas intervistave përzgjedhja është bazuar në metologji por nuk specifikohen kriteret e përzgjedhjes. Gjatë auditimit, u shqyrtuan të gjitha dosjet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë, dhe u konstatua se kishte mungesë në inventarin e letrave të punës. Duke qenë se rezulatet e vlerësimit janë opinione që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e standarteve, ligjit dhe praktikave më të mira profesionale dhe zbatueshmerinë e përgjegjësive nga ana e titullarit mbi kryerjen e shërbimit të AB-së është e nevojshme që këto dokumente, të jenë pjesë e dosjeve në mënyrë që të arrihet dhënia e sigurisë së arsyeshme mbi punën e kryer.
Po ashtu theksojmë nevojën e pranisë së të gjithë dokumentave zyrtare të auditimit në dosje, si projekt raporte dhe raporte finale. Gjithashtu nevojën e unifikimit të opinionit të dhënë në fund, duke shmangur në këto kushte situatën e konstatuar me ARRSH-në, ku në dy projekt- raporte janë dy rezultate të ndryshme, njëherë me ngjyrë të verdhë e cila vlerëson përputhjen e pjesshme me kriterin, por përmirësim të nevojshëm në fusha të caktuara dhe herën tjetër ngjyrë portokalli që vlerëson përputhjen në disa fusha që kërkojnë përmirësime kritike (të domosdoshme) duke mos formalizuar një opinion përfundimtar zyrtar për vlerësimin e kryer.
Bazuar në pikën 7.2.1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm publik "*Vlerësimi i jashtëm i cilësisë i kryer nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB*", ku përcaktohet se "*Sruktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë NJAB, si më poshtë: - të paktën një herë në 5 vjet; ....."* DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin

në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB në përputhje me standardet ndërkombëtare të miratuara gjatë vitit 2017 duhej të kishte vlerësuar jo më pak se 23 NJAB (119:5). Fakti që, gjatë këtij viti nga DH/AB, janë kryer vetëm 5 kontrolle të cilësisë ose rreth 22% e detyrimit të përcaktuar sipas manualit, tregon se kjo strukturë me kapacitetet që ka e ka të pamundur të arrijë përmbushjen e objektivit prej 23 vlerësime të jashtëme të cilësisë.
Nga auditimi konstatohet, DH/AB nuk ka hartuar programin vjetor për vlerësimin e jashtëm të cilësisë për periudhën deri në dhjetor 2017 pasi deri në përfundim të këtij auditimi nuk na u paraqit një dokument i tillë, çka bën të mos japim siguri mbi metodën e përdorur për kryerjen e misioneve dhe përputhshmërinë me Manualin përkatës.
Po ashtu DH/AB ka për detyrë krijimin dhe përditësimin çdo vit të regjistrit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së NJAB-ve, ku duhet të përfshihen të dhënat lidhur me:
- numrin e subjekteve,- statusin organizativ të NjAB,- nivelin e riskut,- frekuencën e kryerjes së vlerësimeve të jashtme,- nivelin e kualifikimit të stafeve të NJAB-ve,- numrin e rekomandimeve të dhëna NJAB-ve për përmirësim,- vlerësimet e jashtme kryer nga KLSH apo vlerësues të kualifikuar të pavarur. Grupit të auditimit ky regjistër iu dërgua elektronikisht por u konstatua se nuk arrijmë të marrim informacion mbi totalin e njësive publike që kanë ngritur strukturën AB, për frekuencën e kryerjes së vlerësimeve të tyre apo riskun. Më shumë ky regjistër vjen në formën e një database me institucionet ku është kryer vlerësimi. Nga ana e grupit të auditimit, gjykojmë të arsyeshme se DH/AB duhet të ketë një pasqyrë të përditësuar të të gjitha njësive publike lidhur me vlerësimin e cilësisë dhe planifikimin e saj, në zbatim të gërmës a, të nenit 24 "*Përgjegjësitë e DH/AB*" me qëllim realizimin e monitorimit të veprimtarisë në nivel kombëtar.

7.1 Rekomandimi: DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB të studiojë me përgjegjësi kapacitetet audituese që ka dhe duhet të ketë për mbulimin e detyrave funksionale që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe t'i propozojë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, gjetjen e rrugëve efektive për realizimin e objektivit për 23 vlerësime të jashtme të cilësisë çdo vit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: auditimi në lidhje me çertifikimin e audituesve të brendshëm publik, u konstatua se DH/AB ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në rregulloren e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 37, datë 16.03.2016. Nga auditimi u konstatua se i gjithë dokumentacioni që lidhet me mbledhjet e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe dokumentacioni që lidhet me zhvillimin e procesit të certifikimit të Audituesve të Brendshëm sikundër përcaktohet në nenet 6 dhe 8 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 37, datë 10.03.2016 "*Për miratimin e Rregullores për procedurat e certifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar, ***është inventarizuar por nuk është dorëzuar në Arkivin e Ministrisë*** nga Sekretari i KKAB dhe nga nëpunësi përgjegjës për procesin e certifikimit të Audituesve të Brendshëm, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6, ku përcaktohet se Sekretari i KKAB është përgjegjës për: "*Arkivimin në fund të çdo procesi certifikimi të të gjithë dokumenatve që lidhen më zhvillimin e mbledhjeve të Komisionit*" dhe me pikën 10 të nenit 8, ku përcaktohet se, nëpunësi përgjegjës për procesin e certifikimit të AB, është përgjegjës për: "*Dorëzimin në përfundim të çdo procesi certifikimi të dokumenteve në arkivin e Ministrisë së Financave, në përputhje me ligjet në fuqi".*
Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të nenit 23 të Rregullores nr. 37, datë 10.03.2016, është përcaktuar se: me shkresën nr.13169, datë 26.09.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të DH/AB&MFK është caktuar Komisionin i asgjësimit të fletoreve të testeve paraprake, të provimit dhe riprovimit, i ndryshuar me shkresën nr.13199/1 datë 29.09.2017 (është ndryshuar njëri prej anëtarëve të këtij komisioni), i përbërë prej z.B. L Drejtor i DH/AB, S. B, specialist në DH/AB dhe D. E, specialist në sektorin e Shërbimeve. Ky komision ka mbajtur procesverbalin e

datës 23.10.2017 mbi procesin e asgjësimit të materialeve dhe fletoreve të procesit të certifikimit për sezonin 2016-2017, ku ka cilësuar numrin e fletoreve për secilin test paraprak, për provimin dhe riprovimin me shkrim dhe për modulin specifik. Në këtë procesverbal cilësohet se ky Komision ***ka bërë numërimin e fletoreve*** dhe më pas ***asgjësimin e tyre nëpërmjet procesit të grisjes***. I gjithë ky proces është dokumentuar vetëm nëpërmjet një procesverbali në trajtë narrative, pa prova të tjera justifikuese mbështetëse dhe të besueshme, si fotografi apo video të këtij procesi, për të garantuar siguri dhe besueshëri. Konstatohet se, në nenin 23 të rregullores nr. 37, datë 10.03.2016, është përcaktuar se: "*Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e çertifikimit dorëzohen dhe ruhen në protokollin e Ministrisë së Financave në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletoreve të provimeve dhe riprovimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 3 muaj nga data e dhënies së provimit/riprovimit. Asgjësimi i tyre bëhet nga një komision prej tre anëtarësh, të caktuar me urdhër nga struktura përgjegjëse për kualifikimin në përbërje të të cilit janë dy punonjës të strukturës përkatëse për kualifikimin dhe një punonjës i strukturës përgjegjëse për shërbimet në Ministrinë e Financave. Deri në asgjësimin e tyre, fletoret administrohen nga struktura përgjegjëse për kualifikimin".*
Ky përcaktim nuk është në përputhje me Kreun II-E "*Ekspertiza e vlerës së ruajtjes së dokumenteve të Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*" të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 15 të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*", nenet 32-35, ku përcaktohen detyrimet e subjekteve shtetërore të cilat hartojnë listën konkrete të dokumenteve të tyre me rëndësi historike dhe me afat ruajtje të përkohshme, si dhe përcaktojnë afatet e ruajtjes për këto të fundit sipas modelit nr. 11, si dhe mënyra e asgjësimit të dokumenteve sipas listës së veçimit. Mënyra e asgjësimit e përcaktuar në këtë Rregullore është e gabuar dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 35 të "*Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shipërisë*", ku përcaktohet se, *asgjësimi i dosjeve të përfshira në listën e veçimit, bëhet nga arkivi, apo sekretari-arkivi i subjektit shtetëror apo jo shtetëror ....* dhe për asgjësimin e tyre mbahet procesverbal sipas modelit.12. të përcaktuar në këto norma. Asgjësimi brenda 3 muajve pas përfundimit nuk lejon të kryhet auditim përputhshmërie mbi mënyrën se si është kryer procesi.

8.1 Rekomandimi: DH/AB të marrë masa të mënjëherëshme për arkivimin e dokumentacionit që lidhet me veprimtarinë e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe me dokumentimin e procesit të certifikimit të Audituesve të Brendshëm.

Menjehërë dhe në vijimësi

8.2 Rekomandimi: Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e përgjegjësit për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së AB të shfuqizojë nenin 23 të rregullores nr. 37, datë 10.03.2016 i cili specifikon se "Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e çertifikimit dorëzohen dhe ruhen në protokollin e Ministrisë së Financave në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletoreve të provimeve dhe riprovimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 3 muaj nga data e dhënies së provimit/riprovimit si dhe të urdhërojë veçimin dhe asgjësimin e dokumentacionit të përkohshëm në përputhje me normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Menjehërë

9. Gjetje nga auditimi Nga auditimi për ushtrimin e funksioneve të DH/AB lidhur me hartimin dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të çertifikuar konstatohet se: DH/AB mban regjistrin për audituesit e brendshëm që certifikohen si "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik", të emërtuar "Regjistri Themeltar i Audituesve të Brendshëm për çdo vit akademik" në të cilin përshkruhen: *Numri rendor që fillon me numrin 1, numri i*

amzës që fillon me numrin 0001, periudha e trajnimit, emri atësia mbiemri, modulet e trajnimit nga 1 në 5 (6 deri vitin e kaluar), data e lëshimit të certifikatës, vlerësimi dhe nënshkrimi i audituesit. Nga auditimi u konstatua se forma dhe përmbajtja e Regjistrit të Audituesve të Brendshëm përmban informacion të limituar. Regjistri duhet të emërtohet *"Regjistri Kombëtar i Audituesve të Brendshëm të Certifikuar", për periudhën ....,* ashtu siç është përcaktuar në ligj, dhe të përmbajë informacion agregat në vite. Kjo do të mundësojë një pamje më të përgjithshme dhe me detaje të nevojshme për çdo person të përfshirë në sistemin e certifikimit të audituesve të brendshëm publik në Shqipëri, si dhe do ta bëjë këtë regjistër më të sigurt dhe më pak të cenueshëm prej manipulimit, apo ndërhyrjeve abuzive. Përcaktimi i vlerës dhe i afatit të ruajtjes të Regjistri Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të Çertifikuar, si një dokument zyrtar i cili duhet të pasqyrojë të dhënat kryesore që përmban çertifikata me të cilën pajisen audituesit e çertifikuar si emrin atësinë mbiemrin, numrin e amzës, datën e lëshimit të certifikatës, vlerësimin e komisionit dhe nënshkrimin e audituesit të certifikuar dhe i shërben poseduesit të saj për të gjithë kohën që ai është i punësuar duhet të bëhet në përputhje me pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "*Për Arkivat*". Ky regjistër, krahas publikimit në faqen zyrtare të internetit në rubrikën përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke ruajtur të dhënat personale të personave, duhet të protokollohet dhe të ruhet në arkivë, si dokument i ruajtjes së përhershme dhe të shtohet me listën e audituesve të çertifikuar çdo vit.

Nga auditimi u konstatua se regjistri sipas të cilit DH/AB kryen administrimin e të dhënave të audituesve që kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional, nuk rezulton të garantojë saktësi të plotë të të dhënave, e reflektuar kjo në pamundësinë e DH/AB për identifikimin e personave që nuk kanë mundur të plotësojnë detyrimin për kryerjen e 80 orëve trajnim në dy vite, krahasuar me vitin e pjesëmarrësve në vitin e mëparshëm (grupi i auditimit identifikoi 6 raste, për të cilat nuk kishte të dhëna mbi mos kryerjen e trajnimit në programin e mëparshëm, për të plotësuar 80 orë trajnimi në dy vite), jo në përputhje të plotë me nenin 3, 5, 7, 11 dhe 14 të Rregullores së Trajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar sipas Urdhrit nr. 3, datë 08.01.2016 të Ministrit të Financave.

9.1 Rekomandimi: Me qëllim që të përmirësohet mbajtja e Regjistrit Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të çertifikuar dhe të përmbajë një informacion të plotë dhe të pa cënueshëm nga manipulimet apo ndërhyrjet, DH/AB të rishikojë formatin e këtij regjistri dhe ta paraqesë për miratim tek Ministri i Financave dhe Ekonomisë, si një dokument të ruajtjes së përhershme.

Menjëherë

9.2 Rekomandimi: DH/AB të dorëzojë në Arkivin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Regjistrin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të Çertifikuar të përditësuar deri në sezonin e fundit të çertifikimit.

Menjëherë

9.3 Rekomandimi: DH/AB të marrë masat për përditësimin e të dhënave të Rregjistrit Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të Çertifikuar me audituesit e larguar, si dhe audituesit që nuk përmbushin detyrimin për kryerjen e 80 orëve trajnim në dy vite, sipas nenit 5 të Rregullores së Trajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, duke saktësuar në bazën rregullative edhe statusin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Programin e Trajnimit të Vijueshëm Profesional, janë përzgjedhur për kryerjen e trajnimeve edhe punonjës të DH/KBFP dhe/ose anëtarë të KKAB, pozicione këto që kanë si përgjegjësi edhe administrimin e të dhënave të audituesve, vlerësimin e jashtëm të këtyre strukturave, mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e vendimeve lidhur me audituesit e brendshëm në sektorin publik. Gjithashtu, referuar kapaciteteve të Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, evidentohet nevoja për

kryerjen e një planifikimi të ngarkesës që këto struktura kërkojnë, në mënyrë që pjesëmarrja në to të punonjësve të drejtorisë, të mos ndikojnë në kryerjen e detyrimeve kryesore të DH/KBFP.

10.1 Rekomandimi. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjatë përzgjedhjes së trajnerëve dhe anëtarëve të KKAB, të marrë masat për identifikimin e saktë të kapaciteteve dhe ngarkesës që kërkon angazhimi në këto struktura duke marrë në konsideratë përmbushjen e detyrave funksionale kryesore që këta punonjës kanë, si dhe gjithashtu garantimin e ndarjes së përgjegjësive adminstrative, vlerësuese mbikëqyrëse dhe vendimarrëse të anëtarëve të tyre, mbi audituesit në sektorin publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me planin e aktiviteteve në kuadër të *shtyllës 5 të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020,* Drejtoria e Harmonizimit nuk ka mundur të kryejë implementimin e sistemit të MFK në asnjë nga njësitë e përzgjedhura pilot për vitin 2017, edhe pas ndryshimeve të kryera në numrin dhe llojin e tyre, duke mos përgatitur relacione shpjeguese dhe duke mos e prezantuar këtë çështje si mosrealizim objektivi në Raportin Vjetor 2017. Mosrealizimi i një nga aktiviteteve kryesore të DH/MFK, evidenton mangësitë që ekzistojnë në planifikimet e kësaj drejtorie, të cilat ndikojnë edhe në progresin e pritshëm të objektivave të strategjisë së Menaxhimit Te Financave Publike 2014-2020. Konstatojmë gjithashtu mungesë të analizës dhe evidencave të zbatimit të kritereve në përzgjedhje të njësive "pilot". Kështu, përzgjedhja e Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Ministrisë së Brendshme, të cilat janë institucione të cilat kanë qenë pjesë e dy projekteve të mëparshme si njësi pilot të realizuara me ekspertë të huaj, evidenton formalizmin në proces dhe lë të paqartë arsyet pse këto njësi klasifikohen si njësi pa sistem modern të MFK, edhe pse renditja e tyre në rankimet e pyetësorëve të vetëvlerësimit është e kënaqshme.

11.1 Rekomandim: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për kryerjen dhe dokumentimin në përputhje me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të planifikimit dhe implementimit të sistemeve të MFK në institucionet pilot, në mënyrë që të realizohen pritshmëritë e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike në fushën e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e MFK i cili udhëzon *"Llogaritjen e numrit të njësive publike që do të monitorohen nga çdo punonjës i DH/MFK duke ndarë ditët e punës në dispozicion për një vit të caktuar që DH/MFK ka planifikuar të shpenzojë për vizitat në terren, si dhe duke u nisur nga kohëzgjatja e një vizite në terren.",* dhe sipas përqindjes: *50% njësi publike nga grupi "i performuesve të dobët", 25% nga "performuesit mesatar|, 25% nga "performuesit e mire" DH/MFK* nuk rezulton të ketë kryer dhe dokumentuar një analizë e tillë për përzgjedhjen e njësive që janë monitoruar. Gjithashtu, u konstatua se në përzgjedhjen e njësive për monitorim, nuk janë marrë në konsideratë: *rezultatet e pyetësorëve të institucioneve varësi të Kryeministrisë (grupi 87), rezultatet e pyetësorëve të Këshillave të Qarkut, njësitë shpenzuese të mëdha*; institucione këto që janë përfshirë sipas grupeve përkatëse, në raportin vjetor të KBFP.
Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me aneksin 9, pika 2 e Manualit të MFK ku citohet se: *"Dy javë para datës së vizitës në terren, DH/MFK, i dërgon shkresë kreut të subjektit me kërkesën për të përgatitur dokumentet përkatëse dhe të caktojë një person kontakti në njësi për të ndihmuar ekspertin e DH/MFK, për shembull të sigurojë dokumentet për ekspertin, të organizojë takime dhe kështu me radhë.",* shkresat për njoftimin e kryerjes së vizitës në terren janë dërguar nga DH/ MFK, në të njëjtën date, ku konkretisht për Bashkinë Elbasan, Peqin, Cërrik, MFE, Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, njoftimi është dërguar 5 ditë përpara fillimit të

punës në terren, ndërsa për Bashkinë Durrës- Shijak; Kamëz- Krujë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Avokatin e Popullit, më shumë se 1 muaj përpara fillimit të punës në terren.
Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e Menaxhimit Financiar i cili citon "*Në përfundim të vizitës në terren punonjësi i DH/MFK kryen një vlerësim të përgjithshëm mbi besueshmërinë e procesit të vetë vlerësimit të njësisë publike: 100-75%- Vetëvlerësim i besueshëm dhe 74%-0%- Vetëvlerësim jo i besueshëm, i cili përfshihet në raportin vjetor të KBFP"*, këto konkluzione të monitorimit mbi besueshmërinë e pyetësorëve nuk janë bërë pjesë e raportit të KBFP. Gjithashtu, vizitat në terren nuk janë shoqëruar me letrat e punës dhe dokumentime të tjera, në kundërshtim me aneksit 9 *"Metodologjia dhe lista e kontrollit për vizitat në terren",* pika 3.
Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me pikën 2.2.2 të Manualit të Menaxhimi Financiar, monitorimet e njësive publike nga Dh/MFK kryen në një periudhë shumë të reduktuar kohore(mars-maj) periudhë kjo kur duhet bërë dhe konsolidimi i rezultateve me qëllim rankimin e njësive dhe paraqitjen e tyre në Raportin Vjetor të KBFP. Pra monitorimet kryhen vetëm për efekt të raportit vjetor, dhe jo si një monitorim i vazhdueshëm nga ana e DH/MFK me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë, standardeve dhe udhëzimeve, i cili është një nga detyrimet kryesore të kësaj drejtorie, cituar në manual.
Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e MFK i cili citon se: "Në përfundim të vizitës në terren, *hartimin nga punonjësit e DH/MFK të raportit për njësinë publike përkatëse, në të cilin krahas vlerësimit do të specifikohen edhe rekomandime konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të MFK. Ky raport i dërgohet zyrtarisht njësisë publike, e cila përgatit planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, të miratuar nga NA e njësisë publike. Një përmbledhëse e raporteve të vizitave në terren, bëhet pjesë e raportit vjetor të KBFP, në një kapitull të veçantë",* DH/MFK pas përfundimit të monitorimeve në terren, rezultatet e tyre publikohen në raportin vjetor të KBFP, dhe më pas raportet i dërgohen njësive të monitoruara së bashku me pasqyrat e planit të tyre për zbatimin e rekomandimeve dhe implementimet në zbatim të përmirësimit të sistemeve të MFK. Në monitorimet e vitit 2016, raportet u janë dërguar njësive në nëntor të vitit 2017, dhe në këto raporte, jo në të gjitha rastet ishte vendosur niveli i besueshmërisë pas monitorimit; nuk ishin plotësuar pasqyrat sipas së cilave punonjësit përgjegjës për monitorimin duhet të bëjnë dokumentim të krahasimeve të pyetësorëve të dorëzuar nga njësia me situatën reale; por ishin bashkëlidhur vetëm rekomandimet e lëna për njësinë. Konstatojmë se edhe për monitorimet e kryera për pyetësorët e vitit 2017, u ndoq e njëjta praktikë. Raportet në përfundim të monitorimeve nuk u dërguan në njësitë e monitoruara, nuk u protokolluan dhe nuk ju vunë në dispozicion grupit të auditimit deri në fund të këtij auditimi edhe pse rezultatet e këtyre monitorimeve janë përfshirë në Raportin vjetor të KBFP për vitin 2017. Në këtë raport nuk shohim që DH të shprehet për raste kur vlerësimi i tyre ishte korrigjues nga ai i vetëvlerësimit.
Nga auditimi u konstatua se manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit udhëzon se ndjekja e rekomandimeve do të kryhet në monitorimin e ardhshëm të institucioneve, por referuar numrit të monitorimeve të kryera gjatë një viti, si dhe metodologjisë sipas së cilës kjo përzgjedhje kryhet, ndjekja e rekomandimeve do të mund të realizohet disa vite më vonë (*mesatarisht 115 njësi publike që dorëzojnë pyetësorë/mesatarisht 15 monitorime në vit = 7 vjet. Pra ndjekja e rekomandimeve do të kryhet pas më shumë se 5 vitesh*).

12.1 Rekomandim: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për kryerjen e monitorimeve duke ju referuar plotësisht kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, me qëllim raportimin sa më të plotë dhe të saktë të nivelit të besueshmërisë dhe parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara gjatë vizitave në terren.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me nenin 18, pika 1 e Ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ku citohet se "...*Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga **njësitë e varësisë**, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji*", dhe urdhrin nr. 89 të Ministrit të Financave "*Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike",* pika 3. II ku citohet se "*Raporti vjetor i konsoliduar për kontrollin e brendshëm hartohet bazuar në një sistem pikëzimi për çdo tregues të përcaktuar në këtë dokument (sipas formularit të kërkuar në Aneksin 1) dhe për çdo njësi qendrore apo vendore të monitoruar gjatë vitit, p.sh. për njësitë qendrore raportet që dorëzohen duhet të paraqiten në nivel grupi, i cili përfaqësohet nga mesatarja e pikëve të të gjithë sistemit (njësi qendrore + njësitë e varësisë), ndërsa për njësitë vendore do të jetë mesatarja e pikëve të njësisë: Bashki/Këshill qarku (aparat vendor + njësitë e varësisë).*", rezultoi se në dokumentacionin e dërguar pranë kësaj drejtorie nuk ka evidenca nëse në pyetësorët dhe raportet e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm nga njësitë e nivelit të parë të qeverisjes së përgjithshme janë kryer raportime në mënyrë të konsoliduar, pra duke përfshirë rezultatet edhe për njësitë e varësisë. Gjithashtu, edhe në kryerjen e monitorimeve për besueshmërinë e pyetësorëve, verifikimet e stafit të DH/MFK janë kryer vetëm për institucionin e përzgjedhur, pavarësisht se sipas kuadrit të sipërpërmendur, rezultatet e pyetësorit duhet të përfshijnë edhe njësitë e varësisë së institucionit në fjalë.

13.1 Rekomandim: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të marrë masa për plotësimin e procedurave, udhëzuesve me anekse shpjeguese për të siguruar një raportim të saktë të pyetësorëve përgatitur nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në mënyrë që ato të përfshijnë jo vetëm institucionin qëndror por edhe njësitë e varësisë në zbatim të ligjit dhe udhëzimit përkatës. Këto ndryshime të reflektohen edhe në procedurat e për kryerjen e monitorimeve në terren për vlerësimin e besueshmërinë së pyetësorëve me qëllim verifikimin e konsolidimit të pyetsorëve të dërguar nga njësitë e varësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Me paraqitjen e pikëve dhe rankimin e njësive të analizuar për të 20 indikatorët bëhet një paraqitje dhe analizë e sistemit të kontrollit në të 4 komponentët e tij, analizë mbi të cilën konkludohet nga Drejtoria e Harmonizimit (DH) se: ***"Opinion i Përgjithshëm:*** *Nga analiza e përgjithshme e këtyre indikatorëve, ne mund të arrijmë një konkluzion paraprak mbi komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Treguesit e mësipërm lidhen kryesisht me komponentin e aktivitetit të kontrollit, që përfshin ekzistencën e rregullave dhe procedurave të shkruajtura të proceseve kryesore si: të prokurimeve, të kontratave, urdhër-shpenzimeve, etj. Nga analiza e përgjithshme, rezulton që ka kontrolle efektive të ndërmarra nga ana e institucioneve, ku mesatarisht efektiviteti i tyre për njësitë e qeverisjes së përgjithshme **është 87%.** Megjithatë, në disa indikator apo tregues specifik lind nevoja për marrjen e masave për përmirësime të vazhdueshme në periudhat e ardhshme".*

Nga shqyrtimi i të dhënave, databaza e indikatorëve të dërguar nga Drejtoria e Thesarit dhe Drejtoria e Buxhetit sipas Urdherit nr. 89 si dhe databaza e indikatorëve të MFK dhe AB të përpunuara dhe administruara nga DH, konstatojmë se opinioni i mësipërm është dhënë në përfundim të përpunimit të të dhënave të **126 njësive** nga të cilat: 11 Ministrive të linjës, 61 Bashkive, 26 Institucioneve të pavarura; 17 njësi të grupit 87-në varësi të Kryeministrit dhe 11 njësi shpenzuese me buxhet të madh. Pra, paraqitja dhe vlerësimi i efiçenses së indikatorëve të performancës dhe opinioni për nivelin e funksionimit të sistemeve të kontrollit është bazuar në gjithsej 126 njësi nga 1253 njësi shpenzuese[17] ose 10% e numrit gjithsej. Duke vazhduar më tej me shkallën e mbulimit të vlerësimit dhe onitorimit të sistemit të njësive të qeverisjes së

[17]*Burimi: Sistemi i Pagesave -Drejtoria e Thesarit- Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

përgjithshme, konstatojmë se indikatorët e Ministrive të linjës dhe rankimi i tyre përfaqëson vetëm situatën e sistemeve të kontrollit të brendshëm për aparatet e Ministrive dhe jo për njësitë e varësisë bazuar në shqyrtimin e raporteve dhe pyetsorëve të dorëzuar nga ministritë e linjës dhe intervista me specialistë të DH që përpunojnë këta pyetsorë. Konkretisht, pyetsori i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është plotësuar vetëm për aparatin e kësaj ministrie dhe nuk ka informacion për njësitë e varësisë. Në relacionin shoqërues flitet për ndryshimet strukturore të Ministrisë së Financave në fund të vitit 2017 me përthithjen e disa programeve të Ministrive të cilat më pas pushuan së ekzistuari por nuk ka asnjë koment apo shënim konkret se si ky proces ndikoi në 5 komponentët e menaxhimit financiar duke filluar me: analizën dhe azhornimin e risqeve që do të sillte ky ndryshim në burimet njerëzore, sistemet e komunikimit dhe informimit, monitorimit, kontabilitetit, inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme (transferimi nga librat kontabël të një ministrie te tjetra), delegimin dhe dorëzimin e detyrave, dhe rrjedhimisht gjykojmë se nuk janë pasqyruar në vetëvlerësimin e MFE.
Të pyetur nëse gjatë monitorimeve të verifikimit të besueshmërisë së pyetsorëve është parashikuar verifikimi nëse këta pyetësor janë konsoliduar me vetëvlerësimet e njësive të varësisë, përsëri përgjigja është se një verifikim i tillë nuk bëhej sepse "çdo njësi varësie funksionon më vete me titullarë përgjegjës më vete".[18] Në kuadër të testimeve, iu kërkua Nëpunësit zbatues të MFE[19] të na vihen në dispozicion pyetsorët e njësive të varësisë me qëllim llogaritjen e efektivitetit të ministrive të linjës, me gjithë njësitë e tyre të varësisë por këta pyetsorë nuk na u vunë në dispozicion sipas. Për sa më lartë, vlerësimet e paraqitura në raportin vjetor të KBFP janë përpiluar <u>në kundërshtim me Pika II, paragrafi 4 i Metodologjisë së vlerësimit të performancës së njësive publike" miratuar me Urdhërin nr. 89 dt. 28.12.2015.</u> Në gjykimin tonë, raportit <u>i mungon një tregues efektiviteti për të 126 njësitë e marra në analizë dhe i llogaritur mbi bazën e rezultateve të performancës të 20 indikatorëve</u>**.** Ky tregues, do të mund të ekstrapolohej më pas në nivel sistemi publik në bazë dhe të peshës specifike apo faktorit të rëndësisë që këto 126 zënë në buxhetin e shtetit, për të paraqitur drejtë dhe me transparencë situatën e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik.

<u>14.1 Rekomandim:</u> DH/KBFP duhet menjëherë të rishikojë proceset e punës, metodologjine e vizitave në terren, trajnimin e punonjësve të caktuar për monitorim dhe përpunim të pyetsorëve të vetëvlerësimit, të azhornojë gjurmën e auditimit në lidhje me procesin e monitorimit dhe pilotimit me qëllim zbatimin në përputhje të plotë me Metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.89 dt.28.12.2015.

Menjëherë dhe në vijimësi

<u>15. Gjetje nga auditimi:</u> Në lidhje me mënyrën e zbatimit të "Metodologjia e vlerësimit të performancës" e miratuar me Urdhërin nr. 89 të Ministrit të Financave dt. 28.12.2015 konstatojmë se: Nga shqyrtimi i të dhënave të paraqitura në raport DH përdor një numër të ndryshëm indikatorësh për grup-njësi të ndryshme rrjedhimisht numër pikësh potenciale maksimale (600= 20indikatorë*30pikë)" të ndryshme. Metodologjia përcakton 23 indikatorë shoqëruar me anekset përkatëse udhëzuese për mënyrën e llogaritjes të secilit prej tyre. Këta indikatorë, plotësohen nga titullarët e njësive publike ose specialisti përgjegjës në DH/AB[20]. Në këtë metodologji nuk përcaktohen kufizime nëse për grup njësi të ndryshme duhen aplikuar indikatorë të ndryshëm apo ato mund të përjashtohen për shkak të mungesës së të dhënave.
Nga shënimet shpjeguese të tabelave të indikatorëve, grupi i auditimit nuk arrin dot në konkluzionin nëse disa indikatorë lihen jashtë vlerësimit për mungesë të dhënash apo për shkak të performancës së ulët? Në konfirmim të sa më lartë, grupi i auditimit ka bërë një përllogaritje

[18] *Intervistë, E-mail: 2 specialiste të DH/MFK*
[19] *E-mail dt. 01.06.2018 dërguar Zj. Roza Naumi- Drejtore Financës pranë MFE*
[20] *Urdhëri nr.89 i Ministrit të Financve dt.28.12.2015, pjesa II*

të treguesit të përformancës së sistemi KBFP bazuar në nivelin maksimal 600 të pikëve të mundshme, pa marrë parasysh këtu gabime të mundshme në përpunim[21], saktësi dhe besueshmëri në raportim[22] të cilat janë trajtuar në pikat e tjerat të këtij auditimi. Rezultati për çdo komponent dhe 126 njësi paraqitet si më poshtë ku treguesi i efektivitetit të menaxhimit të Buxhetit është në nivel nën 50%; Thesari 65%'; auditi i brendshëm 63% dhe MFK 88%.
Ndryshe nga Raporti i KBFP për vitin 2016, në paraqitjen e rezultateve të rankimit të Ministrive të linjës mungon analiza krahasimore në total për cdo ministri. Nëse do të bëhej kjo do ishte lehtësisht e lexueshme se **në të gjitha ministritë ka ulje të pikëve në total të 20 indikatorëve (ose 6% krahasuar me vlerësimin mesatar të një viti më parë)**. Nëse kjo analizë do të bëhej dhe rezultatet e saj do të paraqiteshin në raport, do të dukej qartë se indikatorët me ndikim më te madh në vlerësimin mesatar në rënie janë ato të: Thesarit -12% dhe Buxhetit -13%: Indikatori 1 "Dorëzimi në kohë i faturave në Thesar" ; Indikatori 4. "Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar" dhe Indikatori 10. "Krijimi i detyrimeve të reja".

15.1 Rekomandim: DH në rolin e saj udhëheqës si harmonizuese, zhvilluese e metodologjive, bazës ligjore, manualeve etj., duhet bëjë një analizë dhe vlerësim të indikatorëve pas vitit të dytë të aplikimit të tyre. Kjo analizë duhet të ketë si objektiv vlerësimin bazuar në eksperiencën e deritanishme në grumbullim, përpunim, shpjegim, problematika reale të ardhura nga AB, auditi i jashtëm (KLSH) dhe rekomandimeve të SIGMA; të vlerësojë nëse ato janë relevante, efektive dhe paraqesin me transparencë realitetin e sistemeve të kontrollit për të gjithë njësitë e qeverisjes publike; të identifikojë nëse ka paqartësi me Anekset dhe shpjegimet e tyre për mënyrën e llogaritjes së indikatorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.2 Rekomandim: Në funksion të qëllimit të dhe objektivit që Raporti vjetor i KBFP ka, DH duhet të sigurojë të dhënat dhe të kryejë analizë dhe paraqitje krahasimore të progresit të zhvillimit të sistemeve të kontrollit dhe performancës së sektori publik. Kjo në përputhje dhe me objektivat e përcaktuar në Strategjinë e MFP 2014-2020.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me indikatorët e menaxhimit të Buxhetit dhe operacioneve të Thesarit; Sipas Urdhërit nr. 89 dt.28.12.2015, Drejtoria e Thesarit dhe Drejtoria e Buxhet janë përgjegjëse për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e indikatorëve respektivë tek DH, për efekt konsolidimi në Raportin vjetor të KBFP. Me qëllim testimin e të dhënave dhe treguesve të paraqitur në Raportin vjetor i cili më pas do të bëhet pjesë e Raportit të zbatimit të Buxhetit të shtetit sipas Ligjit nr. 9936 dt. 26.6.2008, ju kërkua specialistëve të DH të na përcillej materiali i dërguar nga Drejtoritë e Thesarit dhe Buxhetit. Nga informacioni i marrë, u konstatua se përveç përcjelljes së tabelave të indikatorëve në format Excel, nga specialistet e drejtorisë së Buxhetit dhe Thesarit tek specialistet e MFK, nuk përcillet ndonjë analizë mbi monitorimin, vlerësimin e indikatorëve Thesar, Buxhet dhe problematika të dala gjatë vitit me qëllim përpilimin e rekomandimeve që më pas do të diskutohen e miratohen në Parlament. Përjashtim bën vetëm indikatori 7: Raporti fakt/plan i shpenzimeve korente" i shoqëruar me një shpjegim për vlerësimin mesatar në rang ministrie linje.
Për sa i përket saktësisë së vlerësimit të indikatorëve, nga shkëmbimi i informacioneve me rezultatet e auditimit financiar të KLSH për aparatin e MFE (përfunduar maj 2018) kemi konstatuar pasaktësi në në indikatorin "krijimi i detyrimeve të reja" ku MFE vlerësohet me 30 pikë maksimale për 0% fatura gjendje të papaguara më 31.12.2017. Kështu, informacioni i marrë nga grupi me burim Drejtoreshën e Financës së MFE, rezulton se shuma e faturave të prapambetura më 31.12.2017 ishte 30 milion lekë por që pas testimeve të po këtij grupi

[21] *Trajtuar si pikë e vecantë mbi testimin e aplikacionit PIFC dhe procesit të punes së përpunimit të pyetsorëve.*
[22] *Trajtuar si pikë e vecantë"Mbi monitorimet besueshmërisë e MFK"*

konstatohet se kjo vlerë është shumë e madhe. Në objektin e këtij auditimi, ky informacion vë në diskutim saktësinë e vlerësimit të indikatorit dhe përgjegjshmërinë në paraqitjen e tij dhe analizën e tij. Për dy grup indikatorët e mësipërm, DH në rolin e saj si konsoliduese e të dhënave bën vetëm një përmbledhje mekanike të shifrave dhe një analizë të thjeshtë statistikore krahasimore me një vit më parë dhe në disa raste identifikon performuesin më të mirë apo më të dobët. Në gjykimin e grupit të auditimit, DH/MFK nuk kryen kontrollo analitike për të siguruar saktësinë e tyre pavarësisht se kush e ka përgjegjësinë e përpilimit të tyre. Minimalisht duhet të bëhet një analizë mbi korrelacionin e indikatorëve: psh: nëse ka kontrata të dorëzuara me vonesë ekziston rreziku i krijimit të faturave të prapambetura. Për më tepër, analiza e indikatorëve si variabla të njeri tjetrit nxjerr në pah dhe subjektivizmin në vlerësim të indikatorëve të MFK dhe AB-së. Si mund të jetë situata e aktiviteteve të kontrollit, mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut kaq perfekte kur ende jemi në nivele 53% dhe 21% të dorëzimit të faturave dhe kontratave dhe në njësi ku performojnë mbi mesataren në AB dhe MFK. Grupi i auditimit ka përpiluar hartën e performancës së disa indikatorëve ku ilustron rastet me vlerësime maksimale në elementët e kontrollit por jo të zbatimit dhe operacioneve.

16.1 Rekomandim: DH/MFK duhet që nenjëherë të rishikojë metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik, mënyrën e komunikimit dhe koordinimit midis drejtorive përgjegjëse, relacionet dhe analizat shoqëruese. Të implementojë kontrolle analitike që të sigurojë saktësinë e informacionit të marrë nga këto Drejtori me përgjegjësinë e njësisë që konsolidon të dhënat që paraqiten në Raportin vjetor e më pas në Parlament nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me indikatorët e performancës së auditimit të brendshëm[23]: Indikatorët e AB kanë si synim matjen e performancës së strukturave të njësisë së auditit të brendshëm, mirë-funksionimin, efikasitetin dhe efiçencën e tyre në sektorin publik. Gjatë auditimit u konstatua se:

Indikatori 16 i llogaritur sipas udhëzimeve në Aneksin 19 nuk parashikon vlerësim për njësitë që i kanë audituesit në proçes certifikimi dhe lë vend për gjykim dhe ndërhyrje në vlerësimin përfundimtar. Nga vlerësimi i 28 njësive AB ose 24% e gjithë njësive të AB: Përqindja e devijimit në kampion me 65% vetëm për grupin e Bashkive, e cila e aplikuar në totalin e njësive të vlerësuara 61, do të ndryshonte velrësimin e përgjithshëm të indikatorit nr.16 nga 53% në 44% .

Indikatori 20 i llogaritur sipas udhëzimeve në Aneksin 23 çon në rezultate dhe vlerësim të gabuar (mbivlerësim). I llogaritur sipas aneksit 23: Indikatori"Kapacitetet e burimeve njerëzore të auditimit të brendshëm" =Pozicione vakante të AB/ numrin total të AB të miratuar në strukturën e njësisë publike (%). Nëse në një njësi (bashki etj) struktura e AB-së miratohet nga titullari me 2 auditues, kjo njësi nuk raporton vende vakant edhe pse sipas Ligjit nr.114/2015 njësia duhet të ngrihet me 2+1 auditues, rrjedhimisht indikatori për këtë njësi llogaritet 2/2= 100% dhe vlerësohet me 30 pikë maksimale. Në këtë mënyrë indikatori nuk realizon realizon objektivin e tij sipas Metodologjisë pika 4.1: "vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitit të njësisë publike me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi". Në gjykimin e grupit të auditimit, ky indikator duhet të riformulohet për të vendosur një nivel të poshtëm "jo më pak se 3" për të vlerësuar drejtë njësitë që janë në shkelje të ligjit nr.114/2015, aq më tepër që ky është i vetmi indikator që bën vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të të aktivitetit të titullarëve të njësive

[23] *Struktura përgjegjëse e **harmonizimit te auditimit te brendshëm**, monitoron në nivel vjetor funksionimin e veprimtarise te strukturave te auditimit te brendshem ne sektorin publik. Ky monitorim kryhet nëpermjet analizës së përgjigjeve të pyetsorëve vjetorë të vetvleresimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, të cilat depozitohet cdo fillim viti pranë kësaj strukture.*

publike në lidhje me AB. Pavarësisht kufizimeve në buxhet dhe kapacitete për të ngritur një NjAB me tre specialistë, njësia raportuese nuk mund të vlerësohet me pikët maksimale.

Indikatori 19: Cilësia e raporteve të audituesve të brendshëm e përpiluar sipas Aneksit 22, në fakt plotësohet nga punonjësit e DH/AB pas leximit të 115 raporteve vjetore të dërguara nga NjAB-të. Pasi raportet shpërndahen midis 3 specialistëve, lexohen dhe në gjykimin e tyre bëhet vlerësimi në pikë sipas kësaj tabele: 0 - 2% : 30 pikë / 3 - 5% : 25 pikë/ 6 - 25%:15 pikë/ 26-50%:10 pikë/ 51-75%: 5 pikë/ 76-100%: 0 pikë. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me përpunim të dhënash dhe intervalet në përqindje janë të pakuptimta. Në përmbledhje, vlerësimi i këtij indikatori për 77 njësi rezulton me mesatarisht 19 pikë. Në gjykimin tonë, përtej vlerësimit që mund të bëjnë 3 specialistë të cilët kryejnë edhe shumë detyra të tjera, mbi formatin dhe përmbajtjen e raporteve vjetore të AB-ve do të ishte më efektive dhe efiçiente kombinimi i këtij indikatori më një tregues tjetër cilësie dhe dobisë së punës së AB: ai i zbatimit të rekomandimeve. Ky indikator është i miratuar në Metodologjinë e vlerësimit të perfomancës dhe i rekomanduar nga SIGMA në pasaportën e indikatorëve.

Diferenca në treguesit e performancës së disa indikatorëve të paraqitur në raport; opinione të shoqëruar me referencë të komponentëve të vecantë të MFK dhe jo të sistemit KBFP në tërësinë e tij; aplikimi i kritereve pikësh maksimale të ndryshme për grupe të ndryshme njësish, paaftësi për të mbledhur të dhëna të plota për të gjithë grup-indikatorët sidomos ato në lidhje me zbatimin e Buxhetit; mungesa e aplikimit të faktorëve të rëndësisë për indikatorë të ndryshëm dhe aplikimi i një mesatareje të thjeshtë e bën jo transparente evidentimin e pikave të dobta të sistemeve të kontrollit duke mos shtuar vlerë në raportin vjetor në funksion të objektivit të tij ligjor. Mungesa e analizës së performuesve "më të dobët" në sistem; mungesa e një reference dysheme në vlerësim (kemi njësi të vlerësuara me 100 pikë nga 600 të mundshme) pa asnjë analizë dhe masa konkrete ndaj titullarit të tyre apo propozime nga DH dhe Bordi i KBFP për parashikim të masave organizative dhe disiplinore në Ligji nr. 10 296 në lidhje me ngritjen, funksionimin e sistemeve të kontrollit.

17.1 Rekomandimi: DH/AB duhet të propozojë rishikimin e menjëhershëm të anekseve dhe shpjegimeve të dhëna në to me qellim përmirësimin e cilësisë së përpunimit të tyre, rritjen e saktësisë dhe relevancës së vlerësimit. DH/AB në mënyrë të menjëhershme duhet të analizojë me profesionalizëm dhe në thellësi çështjen e efektivitetit dhe eficensës së njësive AB dhe të reflektojë këtë analizë dhe rezultatet e saj në opinionet e dhëna në raportin vjetor të KBFP. Është e rëndësishme që aktiviteti i auditimit të brendshëm të marrë reagime nga palët kyçe të interesit mbi efektivitetin e auditimit dhe të bëjë rregullime të nevojshme dhe ti përcjellë tek të gjitha njësitë e AB dhe jo vetëm tek ato njësi që kanë qënë pjesë e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.2 Rekomandimi: DH/AB në rolin e saj si harmonizuese e metodologjive dhe monitoruese e sistemeve KBFP ku një nga shtyllat është AB, duhet menjëherë të rishikojë metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik për komponentin AB, për të marrë në konsideratë matës relevant sasior dhe cilësor të efektivitetit dhe efiçencës.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.3 Rekomandimi: DH/KBFP të shqyrtojë mundësinë e automatizimit të procesit të përpunimit të dhënave të indikatorëve dhe pyetsorëve kjo në përfitim të analizave të mirëfillta ekonomike, cilësisë së raportimit dhe nxjerrjes së konkluzioneve të drejta dhe relevante. Mungesa e një databaze me mundësi përpunimi të dhënash standarde dhe të specifikuara e shoqëruar me subjektivizmin që shoqëron disa nga indikatorët ka sjellë në raport rezultate analizash me impakt minimal në nxjerrjen e konkluzioneve të plota, transparente dhe të qëndrueshme mbi gjendjen e sistemeve të kontrollit në sistemin publik.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Pas shqyrtimit të të gjithë indikatorëve të performancës dhe vlerësimit të sistemit të kontrollit brendshëm finaciar publik i dhënë mbi to, grupi i auditimit gjykon se përveç disa ndryshimeve pozitive me shtim të numrit të njësive të analizuara (26 institucione të pavarura dhe 11 njësi të grupit-87 në varësi të Kryeministrit), Raporti vjetor i KBFP për vitin 2017 ka mangësi në prezantim të situatës dhe në cilësi -përmbajtje. Me një mbulim ende të limituar të njësive të analizuara (10% e numrit total të njësive shpenzuese), me një analizë të thjeshtë statistikore nga ana e Drejtorive përgjegjëse e bën këtë raport të paplotë dhe jo efektiv në: 1) objektivin e tij për të "ofruar një garancie të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efiçente me kalimin e kohës"[24] dhe në 2) përmbushjen e përgjegjësive ligjore sipas Ligjit nr. 10 296 dt. 8.7.2010 i ndryshuar, neni 6.

18.1 Rekomandimi: DH/KBFP duhet të azhornojë gjurmën e auditimit të procesit të hartimit të Raportit vjetor KBFP ku të përcaktohet formati dhe procesi i propozimeve për ndryshime në të në mënyrë që ato të diskutohen paraprakisht me Drejtoritë dhe njësitë nga të cilat duhet të sigurohet informacioni si dhe të miratohen nga Bordi i KBFP per relevancën dhe impaktin e tyre.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik nëpërmjet Drejtorisë së MFK, përgjigjet për azhornimin e metodologjisë së kontabilitetit publik me zhvillimet bashkëkohore dhe ndjekjen e procesit të zbatimit të strategjisë së qeverisë për implementimin e standardeve të kontabilitetit publik. Në dokumentin "Analiza vjetore mbi veprimtarinë e DH/MFK", pjesa e I-rë, pika 1) Akte ligjore/nënligjore në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar, DH/MFK konfirmon realizimin e:
1) Hartimit të Udhëzimit nr.23 datë 22.12.2017 "Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit për vitin 2017", si një detyrim ligjor i përvitshëm, në të cilën përcaktohen afatet dhe procedurat e nevojshme për mbylljen e llogarive vjetore nga njësitë publike dhe konsolidimi i tyre nga ana e Ministrisë së Financave. Ky udhëzim përgatitet në bashkëpunim me Drejtorinë e Thesarit dhe Buxhetit. Nga shqyrtimi i neneve të këtij udhëzimi konstatojmë se ky udhëzim si një detyrim i përvitshëm i Ministrisë, jo vetëm **nuk përbën ndonjë përmirësim të legjislacionit në fushën e kontabilitetit por disa nene të tij janë në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e buxhetit të sistemit buxhetor dhe akteve nënligjore të tij si më poshtë:**
19.1. Në pjesën e parë, pika1.b konstatojmë se MFE udhëzon që *"të gjitha shpenzimet publike të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të rregjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2017, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave*" **bie në kundërshtim me Ligjin nr.9936 dt. 26.06.2008**, neni 61 ku përcaktohet metoda e njohjes së shpenzimit: "*Metoda e shpenzimeve dhe e të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me: a) njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës*;". Për më tej në këtë udhëzim parashikohen masa disiplinore në rastet kur kërkesat e këtij Udhëzimi nuk zbatohen nga ana e nëpunësve autorizues dhe zbatues: pika 39 e udhëzimit "Nëpunësi I Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nëpërmjet këtij udhëzimi MFE autorizon mosrregjistrimin e faturave në raste kur nuk ka fonde disponibël, raste të cilat gjithashtu bien në kundërshtim me Nenin 40 "E drejta për të kryer shpenzime", Neni 50 " Angazhimet buxhetore", Neni 51 "Menaxhimi I shpenzimeve", Neni 52 "Kryerja e shpenzimeve". **Kjo praktikë autorizon mosrregjistrim të faturave në mungesë të fondeve**

[24]*Urdhëri nr.89 dt.28.12.2015 Pjesa I. Pika 2 dhe 4*

duke krijuar detyrime të reja të prapambetura, dhe cënon vërtetësinë e pasqyrave financiare.

Në pjesën e katërt të Udhëzimit nr.23 dt.22.12.2017 konstatojmë se në pikën 19 dhe 20 të tij **autorizohet njohja dhe rregjistrimi i faturave të lidhura me shërbime apo punime të papërfunduara dhe të pamarra në dorëzim**. Që të dy këto pika që aktualisht janë në kundërshtim njëra tjetrën për sa i përket k*riterit të njohjes së shpenzimit (para apo pas marrjes në dorëzim të punimit), mbi të gjitha janë në shkelje të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.*

Udhëzimi nr. 23 dt. 22.12.2017, pika 20 citon: "*Në rastet kur institucioni provon shpenzimin e ndodhur gjatë muajit dhjetor 2017 (fatura sipas pikës 19) brenda kufirit të fondeve disponibël, por procedurat e marrjes në dorëzim të shërbimeve po të punimeve të kryera zgjasin përtej datës 29.12.2017, atëherë dega e thesarit pranon njohjen dhe rregjistrimin në SIFQ të shpenzimeve* për *llogari të vitit 2017" dhe* Pika 19: "*Bazuar në fondet buxhetore në dispozicion, NA të njësive të qeverisjes së përgjithshme do të urdhërojnë kryerjen e shpenzimeve në degët e thesarit ….e cila kryen kontrollet sipas legjislacionit në fuqi lidhur me vlefshmërinë e fondeve dhe ekzistencën e dokumentacionit që provon shpenzimin e ndodhur dhe të marrë në dorëzim brenda dt. 28.12.2017"***.** Pavarësisht se pika 24 e Udhëzimit parashikon një rakordim mbi statusin e punimeve dhe sistemimet përkatëse ky është një kontroll pas faktit dhe le hapësirë për rregjistrim të faturave të pavlefshme për shërbime të pakryera apo punime që nuk janë marrë në dorëzim.

19.2. Në Udhëzimin nr.23 i hartuar si pjesë e aktivitetit të DH/MFK në zbatim të përgjegjësisë së saj për zhvillimin dhe harmonizimin e metodologjisë dhe bazës ligjore në fushën e kontabiliteti, konstatohet vetëm një ndryshim krahasuar me Udhëzimin e një viti më parë në nenin 27 ku shtohet paragrafi " *Për të gjitha Ministritë dhe institucionet për të cilat gjatë vitit 2017 ndryshuan fushat e mbulimit dhe përgjegjësitë në zbatim të VKM-ve përkatëse, gjë që u reflektua edhe në ndryshimet e programeve buxhetore në Aktin Normativ nr.3, datë 06.11.2017, rakordimi i planit për buxhetin e vitit 2017 me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të bëhet me ministritë dhe institucionet që i administrojnë këto fonde aktualisht*". Pra, **Udhëzimi rregullon rakordimin e planit buxhetor por jo kontabilitetin**. Nisur nga fakti se DH/MFK nuk ka hartuar ndonjë udhëzim tjetër të posaçëm për të trajtuar çështjen e ndryshimeve strukturore para mbylljes së vitit fiskal, konkludojmë se DH/MFK ka gjykuar të mjaftueshëm se me përcaktimin se kush rakordon planin buxhetor kjo do të mbulonte dhe rregullimin kontabël të përthithjes dhe konsolidimit të pasqyrave financiare 11-mujore të Ministrive dhe programeve që pushuan së ekzistuari pas Nëntorit 2017. Kështu çështje si: kush do të mbyllte pasqyrat financiare 11-mujore, afati i dorëzimit të tyre nëse duhej të përcaktohej një periudhë tranzicioni për përpunimin e të pasqyrave, për transferimin kontabël dhe fizik të inventarëve dhe aktive të qëndrueshme, kush do të ishte personi përgjegjës për përgatitjen dhe miratimin e tyre: punonjësi i larguar apo i transferuar në Ministrinë e re me një detyrë dhe tagër tjetër kanë mbetur të patrajtuara dhe kanë qënë objekt i auditimit financiar të KLSH në aparatin e MFE gjatë periudhës shkurt-maj 2018, gjetjet e të cilit evidentojnë çështjet më lartë dhe përgjegjësinë e DH/MFK sipas Ligjit 10296.

Në konkluzion, kontributi i DH/MFK për çështjet e kontabilitetit dhe raportimit financiar është një objektiv i pa arritur në rolin e saj udhëheqës metodologjik. Nuk ka informacion nëse pasqyrat financiare të shtetit më 31.12.2017 pasqyrojnë saktë dhe drejtë gjendjen e financave dhe aktiveve publike.

19.3. Në pjesën IV të Raportit vjetor të KBFP, "Detyra të tjera" pika 4 – DH/MFK shprehet se është realizuar gjithashtu ky objektiv. Me kërkesën e grupit të auditimit na u vu në dispozicion një kopje e kësaj analize që në fakt është produkt bashkëpunimi në kuadër të projektit me Bankën Botërore, PULSAR, BMF, SAFE dhe SECO "Zhvillimi i Raportimit Financiar në Sektorin Pulik Shqiptar". Pavarësisht kontributit të përfaqësimit të DH/MFK, nuk gjejmë të

shprehur dhe dokumentuar shkallën e përafrimit të Udhëzimit nr.8 i dt.9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",* si udhëzim tranzitor deri në miratimin e plotë të IPSAS i propozuar dhe miratuar 7 muaj më vonë kësaj analize. Ndërkohë, konstatojmë se DH/MFK ka kontribuar në shqyrtimin dhe dhënë mendime në lidhje me Ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" nr.25/2018. Qëllimi i ndryshimeve ligjore ishte përmirësimi i standardeve për kontabilitetin dhe raportimin financiar, përafrimi i tyre me direktivën nr. 2013/34/BE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 26 qershor 2013 "Lidhur me pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet që kanë të bëjnë me lloje të caktuara të ndërrmarrjeve.." duke mbështetur kështu angazhimet strategjike të vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky ndryshim është parashikuar si fazë e parë e përgatitjes së standardeve të kontabilitetit publik i parashikuar në Strategjnë e MFP 2014-2020. Nga shqyrtimi i neneve të direktivës dhe neneve të Ligjit të ri të kontabilitetit rezulton një përafrim i plotë i 11 neneve dhe i pjesshëm për 27 neneve nga 164 gjithsej. Aktualish ky ligj nuk sjell asnjë përmirësim në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar publik dhe ndryshimet janë inciuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit kështu që fakti se DH/MFK ka dhënë mendime nuk mund të konsiderohet kontribut në funksion të arritjes së objektivit të Drejtorisë për zhvillimin e kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik.

Në lidhje me vazhdimësinë e punës së DH/MFK në fushën e kontabilitetit nën përgjegjësinë që i jep Ligji 10296 dt.08.07.2010 i ndryshuar, është raportuar se në aktivitetet e planifikuara për vitin 2018, kjo drejtori do të përfshihet në projektin e Bankës Botërore për hartimin dhe implementimin e fazave deri në implementimin e plotë të IPSAS në të gjithë sistemin publik. Gjithashtu në analizën vjetore të drejtorisë dhe Raportin vjetor të KBFP, drejtoria shprehet për angazhimin e saj në zhvillimin e kontabilitetin publik dhe privat. Ndërkohë në bazë të ligjit në fuqi të kontabilitetit dhe ligjit të miratuar në Mars 2018 dhe që pritet të hyjë në fuqi më 1.1.2018 ngarkohet Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit si një organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik me detyrën që: a) të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe në koherencë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Nga pikëpamja e rregullshmërisë së dokumentimit të këtij procesi kemi konstatuar se në dosjen e vënë në dispozicion nga punonjësit e DH/MFK nuk rezulton të ketë një dokumentim të relacioneve apo memove të brendshme të analizave apo komenteve në kontribut të hartimit të draft-udhëzimeve pavarësisht komunikimeve me e-mail midis specialistëve gjatë procesit. Me kërkesë të përsëritur, dosja është plotësuar gjatë procesit të auditimit me një kopje të Udhëzimit nr. 23 (ende e pa publikuar deri në fund të muajit Prill), kopje të Urdhërit për krijimin e grupit të punës për përgatitjen e Udhëzimit nr.8, ndërsa shënimet e minutave të grupit të punës janë të pazbardhura dhe të padokumentuara zyrtarisht).

19.1 Rekomandimi: DH/MFK duhet të jetë e qartë që detyrimi ligjor i punës së saj (scope) është kontabiliteti publik. Përfshirja e çështjeve të kontabilitetit privat si një nga objektivat e DH-së është i pabazuar dhe shkakton mbivendosje, konfuzion dhe inefiçensa.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me Standardet e Kontabilitetit Publik në Strategjinë MFP 2014-2020 thuhet se: *Qëllimi i standardeve është të përmirësojnë cilësinë e raportimit të përgjithshëm financiar nga institucionet e sektorit publik, duke çuar në vlerësime më të informuara të vendimeve të Qeverive për alokimin e burimeve, duke rritur në këtë mënyrë transparencën dhe përgjegjshmërinë. Megjithëse plani kohor i strategjisë aktuale është deri në vitin 2020, do të merren masa përgatitore me qëllim miratimin gradual të këtyre standardeve ndërkombëtare.* Deri në fund të periudhës së auditimit (qershor 2018) ende nuk është përmbushur masa e 1: krijimi i një strukture/funksioni të vecantë për kontabilitetin publik pranë

Ministrisë së Financave për mbikqyrjen e kontabilitetit në qeveri në përgjithësi dhe kalimin bazuar në SEKP në vecanti. Raporti vjetor i KBFP për vitin 2017 citon se do të ngrihet një sektor me tre specialistë në strukturën e DH/KBFP gjatë vitit 2018. Ndërkohë Bordi i Mbikqyrjes së KBFP tashmë i krijuar prej 2016, nëse do të kishte funksionuar jo vetëm me 3 mbledhje gjithësej, do të kishte filluar punën e tij me grumbullimin e gjithë udhëzimeve në vite për të unifikuar së paku referimin e neneve[25] të Kushtetutës, ligjeve dhe VKM ku ato bazohen.
Në lidhje me bashkëpunimin me KLSH për çështje të kontabilitetit, konstatojmë se Bordi i KBFP nuk ka zbatuar pikën të rregullores ku thuhet se ai duhet të ftojë përfaqësues të KLSH në rastet kur trajtohen çështje të kontabilitetit.
Parashikimet dhe fazat e implementimit të IPSAS, në kuadër të projektit duhet të bëhen transparente dhe objektivat afat-shkurtër dhe afat-mesëm të drejtorisë në lidhje me kontabilitetin të ndërtohen në terma konkretë mbi to. Referuar pasaportës së indikatorëve të përpiluar nga SIGMA, DH/MFK duhet të parashikojë raportimin e ecurisë së implementimit të IPSAS.

20.1 Rekomandimi: Parashikimet dhe fazat e implementimit të IPSAS, në kuadër të projektit duhet të bëhen transparente dhe objektivat afat-shkurtër dhe afat-mesëm të drejtorisë në lidhje me kontabilitetin të ndërtohen në terma konkretë mbi to. Referuar pasaportës së indikatorëve të përpiluar nga SIGMA, DH/MFK duhet të parashikojë raportimin e ecurisë së implementimit të IPSAS.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pas ndryshimit të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 në atë nr. 110/2015, datë 15.10.2015, konkretisht neni 18 i tij, pika 1, janë përjashtuar nga përgjegjësia për përgatitjen së pyetësorëve të vetëvlerësimit dhe raportit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe dorëzimin e tyre tek nëpunësi i parë autorizues, **njësitë publike të përfshira në pikën 2, të nenit 3**: *Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.* Referuar fushës së zbatimit të ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për përgatitjen e sistemeve të kontrollit të brendhsëm, i cili përfshin: njësitë e qeverisjes së përgjithshme; shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme; njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare; raportimi pranë Nëpunësit të Parë Autorizues dhe DH/MFK, kufizohet vetëm tek njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në ndryshim me ligjin e auditimit të brendshëm ku fusha e zbatimit dhe raportimi pranë DH/AB është e njëjtë. Si rezultat, raportimi i DH/MFK për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, kryhet nga analizimi i te dhënave për rreth 125 njësi publike (njësitë e mëdha të qeverisjes së përgjithshme), nga një total prej mbi 1200 insitutionesh që rezultojnë nga të dhënat e buxhetit. Referuar problematikave të konstatuara më sipër në këtë material, për garantimin e kryerjes së konsolidimit të të dhënave të institucioneve të varësisë në pyetësorët dhe raportet e njësisë qëndrore, numri i njësive që monitorohen dhe raportohen nga DH/KBFP bëhët edhe më i vogël, dhe si rezultat më pak gjithëpërfshirës. Kështu, referuar rëndësisë së njëjtë të këtyre dy drejtorive, si pjesë të DH/KBFP, dhe raportimin mbi situatën e Kontrollit të Brendshëm, sigurimi i një informacioni thelbësor, edhe pse jo të hollësishëm nga një numër më i gjerë i institucioneve përgjegjëse për krijimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në raportimin vjetor të KBFP garanton një pamje më të plotë, të saktë dhe gjithëpërfshirëse të këtij dokumenti.

[25] *Neni 78: "1 Kuvendi vendos me shumicën e votive, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përvec rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar..*
Neni 83

21.1 Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si institucion përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, të marë masat për përgatitjen dhe shpërndarjen e pyetësorëve të vecantë dhe të personalizuar sipas grupeve, për institucionet e varësisë, shoqëritë tregtare, OJF, autoritetet e përbashkëta apo institucione të tjera të financuara nga buxheti i shtetit apo që kanë në përdorim asete shtetërore, në mënyrë që këto institucione, si njësi të sektorit publik përgjegjëse për zbatimin e ligjit të MFK, të bëhen pjesë e raportit të KBFP dhe të monitorohen nga DH/MFK për funksionimin sa më të mirë dhe efikas të sistemeve të tyre në zbatim të manualit dhe ligjit të MFK.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se regjistrat e administruara nga DH/MFK për Nëpunësit Autorizues dhe Zbatues të njësive publike, përmbajnë një sërë pasaktësish, e evidentuar kjo në strukturën dhe përmbajtjen e të dhënave, në kundërshtim me nenin 26, pika 1. dh e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", ku përcaktohet detyrimi i kësaj drejtorie për administrimin dhe monitorimin e tyre. Nga inspektimi i këtyre regjistrave, u konstatua se regjistrat janë të organizuar në Excel, por me pamundësi përpunimi të dhënash, për shkak të formatit dhe organizimit të tyre; u konstatua duplikim të dhënash për të njëjtat institucione; mungesë e plotë e informacionit mbi arsimimin, pozicionin e punës; mungesë e datave dhe shkresave konfirmuese për N.Z; mungesë e informacionit të plotë në rastet e nëpunësve të deleguar për një periudhë të përkohshme (mungesë në aplikimin e kontrolleve për sinjalizimin në mbarimin e afatit të delegimit); mangësi në përditësimin e të dhënave si dhe pamundësi për monitorimin e kriterit ligjor mbi arsimimin e NZ, në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit të ndryshuar të MFK

22.1 Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për përgatitjen e regjistrave të saktë dhe të plotë duke përditësuar të dhënat, në mënyrë që të kryhet përpunimi dhe monitorimi i këtyre dokumentacioneve në përputhje me nenin 12 dhe 26 të Ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DH/MFK nuk disponon një regjistër apo dokument përmbledhës mbi trajnimet që janë kryer dhe pjesëmarrësit përkatës ndër vite, në mënyrë që të evidentohen saktësisht nevojat për trajnim dhe të shmangen praktikat formale për to, referuar detyrimit ligjor të drejtorisë, cituar në nenin 26, pika 1 c. " *DH/MFK është përgjegjëse për përcaktimin e nevojave dhe udhëheqjen e trajnimeve e të trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë publike".* Gjithashtu, rezulton se për trajnimet e kryera në bashkëpunim me ASPA-n , roli i punonjësve të DH/MFK kufizohet vetëm në përgatitjen e materialeve dhe prezantimin e tyre, si të kontraktuar nga ASPA, duke mos u përfshirë në aspektin organizativ të tyre, identifikimin e pjesëmarrësve, administrimin e dokumentacionit, etj. Trajnimet janë kryer duke mos marë parasysh historikun e trajnimeve të mëparshme në njësitë e trajnuara, nevojat për trajnim; gjithashtu pjesëmarrësit në trajnime jo në të gjitha rastet janë identifikuar nga DH/MFK, duke kryer trajnime rutinë dhe me tematika të njëjta vit pas vite.

23.1 Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për krijimin e një dokumenti përmbledhës në formë regjistri për administrimin e të dhënave mbi pjesëmarrësit dhe tematikat e trajnimeve ndër vite, në mënyrë që të identifikohen saktë nevojat për trajnim sipas institucioneve, duke lënë mënjanë praktikat formale në kryerjen e trajnimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Harmonizimit nuk rezulton të kryejë dhe dokumentojë në mënyrë të plotë dhe koncize konsolidimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit të dërguara nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme sipas shkresave përkatëse, në kundërshtim me nenin 26, pika 3 i cili citon se : *"Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për MFK ndihmon nëpunësin e parë autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të MFK dhe për përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e KBFP, ku përmblidhet informacioni i marrë, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.",* reflektuar kjo, në mangësitë dhe diferencat e evidentuara në sistemin PIFC me paraqitjen e rezultateve në mënyrë progresive në raportin vjetor të KBFP.

24.1 Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për përditësimin e sistemit PIFC me pyetësorin e ri në përputhje me manualin e MFK, në mënyrë që të dokumentohet saktë konsolidimi i të dhënave të gjeneruara nga njësitë, si dhe të monitorohet në mënyrë konçizë dhe të plotë progresi i komponentëve përkatës sipas vetëvlerësimit në raportin e KBFP.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Në përputhje programit të auditimit nr.301/1 dt.19.03.2018 "Mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brenshëm Financiar Publik, u shqyrtuan dhe u verifikuan veprimet dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit dhe strukturave të saj në lidhje me rekomandimet e përcjella me Vendimin nr.144 datë 30.09.2017, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit: *"Për Auditimin e kryer në Drejtorinë e Harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, mbi "Dhënien e opinionit në raportin e buxhetit të shtetit për AB dhe MFK"*. U mor në shqyrtim dhe Plani i masave dërguar nga Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik nga i cili rezultoi se: nga 15 rekomandime, DH ka pranuar plotësisht 1 (një) rekomandim, ka pranuar pjesërisht 3 (tre) rekomandime dhe 11 (njëmbëdhjetë) rekomandime nuk janë pranuar. Në raportimin 6 mujor "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH" dërguar me shkresë dt.01.05.2018 konstatojmë se DH dhe drejtuesit e saj kanë paraqitur më shumë argumenta në mbështetje të mospranimit të rekomandimeve të KLSH duke rezultuar me vetëm 1 (një) rekomandim të pranuar dhe zbatuar pjesërisht. Duke u nisur nga fakti se jemi në një rast unikal, referuar të gjitha auditimeve të realizuara nga KLSH, ku subjekti i audituar ka pranuar vetëm 1 rekomandim, megjithëse nuk ka kundërshtuar asnjë nga gjetjet dhe konstatimet e grupit të auditimit, ballafaqimi i qëndrimeve është bërë më i zgjeruar. Qëndrimi i grupit të auditimit reflekton dhe situatën e konstatuar gjatë këtij auditimit dhe mundohet të theksojë jo vetëm neglizhenvën por ajo që është më evidente është papërgjegjshmëria e strukturave të Drejtorisë së Harmonizimit të cilat megjithëse ashtu si grupi i auditimit, konstatojnë paligjshmëri në ngritjen dhe funksionim e njësive të AB, apo formalitet në raportimin e situatës së MFK, sistem që akoma nuk ka arritur të kuptohet dhe mbetet larg për implementim, nuk kanë vepruar për të përmirësuar situatën ose të paktën për të raportuar drejt nivelet e AB dhe MFK.

Nr.	Rekomandimi	Statusi	Opinioni i grupit të auditimit KLSH
1.	Drejtoria e Harmonizimit të luajë një rol udhëheqës në drejtim të monitorimit më të kujdesshëm të treguesve të realizimit të planit nga Njësitë e AB, duke forcuar kërkesat për të raportuar edhe arsyet e ndryshimeve apo devijimeve nga planifikimi fillestar. Të ketë një	Pranuar pjesërisht	Kjo pikë është trajtuar edhe në auditimin e aktivitetit për vitin 2017 ku janë paraqitur gjetje dhe konstatime mbi mangësitë, pasaktësitë në raportim të planeve dhe ndryshimeve të tyre, në formatet e kërkesave dhe arsyet e paraqitura për ndryshime.

	uniformitet në trajtimin e auditimeve me temë zbatimi i rekomandimeve, duke eliminuar problematikën e konstatuar.		Për sa i përket pjesës së rekomandimit mbi auditimet tematike "për zbatimin e rekomandimeve" konstatojmë se nuk janë bërë ndryshime në formatin e evidencave për të dalluar këto angazhime ndërkohë që institucionet raportojnë auditime të kryera të llojit "mbi zbatimin e rekomandimeve". Gjithashtu, argumentimi i menaxhimit të DH/AB në lidhje me këtë çështje është i paqartë se c'pjesë e "kuadrit rregullator" përcakton se: " *..asnjë njësi auditimit nuk mund të planifikojë dhe realizojë auditime të veçanta për ndjekjen e rekomandimeve*". Ndërkohë Ligji 114/2015, neni 6, neni 14 parashikon "*..dhe lloje të tjera të auditimeve*", duke mos e kufizuar mundësinë e kryerjes së auditimeve tematike, ose me kërkesë të titullarit, për zbatimin e rekomandimeve. Sipas Manualit të AB pika 2.6.1 parashikon detyrimin e titullarit për raportimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të AB. Gjithashtu, duke qënë një indikator i rëndësishëm i efektivitetit të NJAB (pasaporta e indikatorëve sipas SIGMA) paraqitja e tyre mbetet e rëndësishme për të dalluar këtë angazhim nga angazhimet tematike me kërkesë të titullarit; **Në gjykimin tonë, DH/AB mbetet në mosveprim duke sjellë coroditje të njësive AB, të cilat vazhdojnë të realizojnë dhe raportojnë misione të zbatimit të rekomandimeve. Nga ana tjetër nëse vërtetë sipas manualit nuk duhet të ketë auditim për zbatim rekomandimesh, atëherë numri i raportuar i zbatimit të rekomandimeve duhet të zbritej nga numri total i auditimeve të realizuara dhe treguesit do të jepnin një pamje tjetër për realizmin e planit vjetor në rang kombëtar.** **Në këtë rast DH/AB duhet të kishte tërhequr vëmendjen për titullarët (minimalisht) e të gjitha strukturave të cilët jo vetëm kanë realizuar më shumë se 1 auditim për zbatim rekomandimesh por edhe i kanë deklaruar në aktivitetin vjetor.** **Qasja më pozitive, në auditimin e fundit, për domosdoshmërinë e ndërhyrjes dhe rregullimit të kësaj problematike, tregon se jo vetëm gjetja por edhe rekomandimi i**

			vjetshëm i KLSH, ishte në rilevancën e problemit.
2.	Koordinimin e punës së auditimit të brendshëm me strukturën përgjegjëse për inspektimin financiar me qëllim forcimin e punës së organeve të inspektimit dhe trajtimit me profesionalizëm të rasteve të denoncuara. Transparenca dhe njoftimi i publikut për rastet e trajtuara është me rëndësi për të rritur jo vetëm rolin, por edhe besueshmërinë ndaj kësaj strukture**.**	Pranuar pjesërisht	Nga verifikimi i dokumentacionit të trajnimeve të vijueshme si: listeprezenca dhe temat e trajtuara në 4 Modulet e trajnimeve të vijueshme nuk u konstatua pjesmarrje e specialistëve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar. Gjithashtu nga komunikimi me Drejtoren e Përgjithshme të DH/KBFP në lidhje me këtë pikë nuk konfirmojmë se janë kryer mbledhje apo takime të posaçme midis dy departamenteve në lidhje me rolin, përgjegjësitë e secilës palë. **Në gjykimin tonë ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar. Fakti që edhe për rekomandimet të cilat janë pranuar struktura DH/AB, nuk ka vepruar tregon indiferencën jo për rekomandimin e KLSH, por për të kuptura rëndësinë e problematikave të ngritura nga KLSH, në drejtim të forcimit të rolit të AB si një nga shtyllat kryesore të lidhura me përmirësimin e Menaxhimit të Financave Publike.**
3.	Është e nevojshme të bëhen plotësime në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", I ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", lidhur me një formulim më të plotë të fushës së zbatimit të ligjit. MFE të marrë masa me qëllim zbatimin e plotë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, duke përfshirë sipas karakteristikave specifike të tyre shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme; dhe duhet të shprehet në kuadër ligjor për zbatimin nga institucionet e pavarura të cilat krijojnë apo shpenzojnë fonde publike. Nisur nga fakti se ndryshimet e këtij ligji sapo kanë ndodhur, mund të rritet roli aktiv i DH/MFK pranë MFE, për një kuptueshmëri sa më të lartë të shtrirjes dhe funksionimit të MFK edhe përmes përgatitjes së një udhëzimi unifikues.	Pranuar pjesërisht	Në dokumentin "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit 2016" të DH/KBFP dt. 01.05.2018 nuk paraqitet ndonjë plan konkret veprimi në lidhje me qartësimin e fushës së zbatimit dhe rolin e DH/MFK dhe se si kjo drejtori i ka asistuar në mënyrë të vazhdueshme institucionet e pavarura me qëllim implementimin e kërkesave ligjore. Kështu shoqëritë tregtare me kapital shtetëror vazhdojnë të mos raportojnë pranë kësaj drejtorie formularët e vetëvlerësimit të MFK. Mbetet i paqartë racionaliteti në legjislacion, midis detyrimit për të raportuar aktivitetin e NJAB dhe jo gjendjen e MFK-së nga këto njësi të pavarura kur që të dyja janë dy shtylla të sistemit KBFP. Kjo çështje, e fushës së zbatimit të Ligjit 10296 dhe roli i DH/KBFP janë trajtuar përsëri në raportin e auditimit të vitit 2017. **Nga ana tjetër justifikimi se ndryshimet ligjore sapo janë bërë dhe nuk mund të kërkohen amendime është jo vetëm naiv por reflekton se këto struktura nuk arrijnë vetë të kuptojnë MFK e MFK.**

4.	Drejtoria për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të verifikojë regjistrin e nëpunësve zbatues lidhur me statusin e institucioneve, konfirmimet e nëpunësve zbatues, kriterin e arsimit të lartë dhe kriterin e vartësisë direkte nga titullari me qëllimin eliminimin e kundërshtive me ligjin, si edhe përditësimin e informacioneve të përmbajtura në regjistrin e nëpunësve zbatues	Pranuar	DH/MFK, në përfundim të periudhës kalimtare dy-vjeçare mbi implementimin e kërkesave ligjore për nëpunësin zbatues, ju ka dërguar shkresën nr. 17416, datë 1.12.2017 të gjitha institucioneve të qeverisjes së përgjithshme me qëllim marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të nëpunësit zbatues me punonjës që përmbushin kriteret. Gjithashtu, është njoftuar edhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e kritereve të nëpunësit zbatues, të përcaktuara në nenin 12 si dhe marrjen e masave për rishikimin e të gjithë atyre nëpunësve civilë në pozicione pune të nëpunësit zbatues të cilët nuk përmbushin kriteret. Përsa i përket cilësisë dhe rregullsisë së mbajtjes dhe përditësimit të rregjistrit të nëpunësit zbatues, bazuar në rregjistrin të vënë në dispozicion me datë 11/4/2018, janë konstatuar disa pasaktësi që nuk lënë mundësi për raportime të plota e të sakta në numër, dhe për më tepër në vlerësim dhe kontroll plotësim kriteresh arsimimi. **Në gjykimin tonë ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i zbatuar.**
5.	Të rishikohen treguesit e përcaktuar në Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015, vlerësimi i performancës për vitin 2016, për të qënë më përfaqësues dhe dhënë një pamje të drejtë të funksionimit të sistemit të auditimit të brendshëm dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik.	I papranuar	Aktualisht, raporti vjetor i KBFP për vitin 2017 nuk ka në përmbajtjen e tij një vlerësim nëse indikatorët e performancës janë testuar apo vlerësuar nga DH/MFK dhe AB për efektivitetin e tyre. Gjerësisht, problematika e disa indikatorëve në lidhje me mënyrën e përpunimit të tyre, mënyrën e llogaritjes është evidentuar edhe gjatë auditimit të aktivitetit për vitin 2017. Në gjykimin tonë rekomandimi nuk është kuptuar në thelbin e tij pasi, rasti i Bashkisë Sarandë është vetëm një shëmbull i problematikës në lidhje me mënyrën e llogaritjes së indikatorit[26] të performancës së AB-së gjë që con në një vlerësim jo të drejtë (mbivlerësim) të tij. **Në gjykimin tonë, DH mbetet në mosveprim** duke marrë në konsideratë vazhdimësinë e problematikës gjatë vitit 2017 dhe impaktin e tij në saktësinë e raportimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në Kuvend.
6.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të	I	Në argumentin e tij për mospranim të

[26]Aneksi23 :Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të pa plotësuara= Pozicione vakante të audituesve të brendshëm/ numrin total të audituesve të miratuar në strukturën e njësisë publike (%)

	rishikojë organizimin dhe funksionimin e Bordit të KBFP, me qëllim kthimin e tij në një strukturë që i shërben përmirësimit të menaxhimit të sistemit të MFK në shkallë vendi, duke synuar një pjesëmarrje më të reduktuar por më efektive dhe vecanërisht këshilluese në fushën e kontrollit. Të ndryshoj raporti ekspert i jashtëm/ punonjës Ministrie, raport që ndikon jo vetëm në funksionimin e kësaj strukture por edhe në eliminimin e konfliktit që ekziston nga kryerja e funksionit të anëtarit nga drejtuesit e lartë të kësaj Ministrie.	papranuar	rekomandimit të KLSH-së, menaxhimi vijon me përshkrimin e aktivitetit të Bordit KBFP përgjatë vitit 2017. Aktiviteti i këtij Bordi konsiston në vetëm dy mbledhje, njëra nga të cilat ka qënë objekt i auditimit të mëparshëm. Kryerja e aktivitetit si detyrim i Ligjit nuk është një argument relevant për mospranimin e rekomandimit në lidhje me efektivitetin e këtij aktiviteti dhe konfliktin e mundshëm të interesit apo funksionit të anëtarëve të këtij Bordi për të siguruar pavarësinë dhe objektivitetin e vendimeve të tij. Disa anëtarë të Bordit të KBFP me funksione specialist apo drejtues në DH kryejnë funksione në zbatim të ligjit 10296 dhe 114/2015 ndërkohë marrin pjesë dhe vlerësojnë këto aktivitete apo raporte për të cilat ata vetë janë përgjegjës për hartimin e tyre. Pavarësisht aktivitetit, struktura e këtij Bordi nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017 dhe deri në momentin e përfundimit të këtij auditimi dhe në gjykimin tonë **DH/KBFP mbetet në mosveprim të qartësimit dhe shmangies së konfliktit që ekziston nga kryerja e funksionit të anëtarit nga roli i tij si mbikqyrës.**
7.	DH/MFK, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për monitorimet në vend të institucioneve publike bazuar në pyetsorët e vetëvlerësimit, të dokumentojë procedurat e ndjekura dhe problematikat e hasura për cdo njësi të monitoruar. Monitorimet të realizohen në institucione të cilat vlerësohen me një nivel risku të lartë apo të moderuar, duke larguar nga praktikat formale të realizimit të këtyre procedurave.	I papranuar	Në lidhje me procedurën e ndjekur për monitorimet e pyetsorëve të vetëvlerësimeve për vitin 2017, është konstatuar se dosja e monitorimeve të kryera ka mungesa të theksuara në lidhje me dokumentat që do të reflektonin dhe evidentonin punën e kryer duke filluar që me procesin e planifikimit të këtyre monitorimeve mbi bazë vlerësimin e riskut deri në rezultatet e monitorimeve. **Në gjykimin tonë edhe në këtë pikë, pavarësish një rritje në numër të monitorimeve krahasuar me vitin 2016, procesi mbetet i mangët dhe nuk lë vend për vlerësim të përputhshmërisë së aktivitetit të kësaj Drejtorie.**
8.	Me qëllim që të sigurohet mirefunksionimi i Komiteteve të Auditimit si organe këshilluese pranë titullarit, si një hallkë shtesë për rritjen e pavarësisë funksionale të strukturave të auditimit të brendshëm, të rishikohet VKM nr.160, dt.02.03.2016 " Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike" mbi të cilin ngrihen , funksionojnë dhe raportojnë	I papranuar	Problematika e ngritur është konstatuar dhe gjatë auditimit të vitit 2017. Në kuadër të Ligjit 114/2015 dhe VKM nr.160 dt.02.03.2013, konstatojmë se gjendja e Komiteteve të Auditimit, mënyra e raportimit të tyre apo monitorimi i aktivitetit mbetet e pambuluar apo trajtuar edhe gjatë periudhës 6 mujore pas auditimit të vitit 2016 dhe rekomandimit respektiv të

	Komitetet e Auditimit, duke adresuar me kujdes problematikat e konstatuara. Vëmendje të shtuar duhet të ketë deklarimi i konfliktit të interesit që cënon objektivitetin e këtyre strukturave.		KLSH. Kështu, konstatojmë se: -Numri i Komiteteve të ngritura mbetet po 8-të; Nuk ka ndonjë një udhëzim për detyrimin që KAB duhet të raportojnë tek DH/AB, -Nuk ka një analizë nga DH/AB, në vijim të rekomandimit të KLSH-së për përmirësime ligjore apo nënligjore për të rritur eficiensen e këtyre KAB-ve, nxitjen e ngritjes së tyre specifikisht në institucione qëndrore me shumë njësi varësie. Vetë Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ka jo funksional KAB e krijuar në 12.04.2016 dhe nuk raporton asnjë aktivitet të KAB-së në raportin e analizës vjetore për vitin 2017. - Struktura e DH/AB të mos ketë në fokus vlerësimin e konfliktit të interesit të personave që përshihen në këto struktura, dhe më e pakta që mund të bëjnë është të angazhojnë strukturat përgjegjëse për vlerësimin e konfliktit të interesit. **Në gjykimin tonë, DH/AB mbetet në mosveprim në lidhje me këtë rekomandim, pasi megjithëse nga auditimi është vënë në dijeni të problematikave që kanë krijuar ngërc në funksionimin e Komiteteve të cilat do të siguronin jo vetëm pavarësinë e strukturave AB por do të realizonin edhe një vlerësim të pavaruar të punës audituese, nuk ka marrë masa për të zhbllokuar situatën.**
9.	Të përcaktohet një procedurë e brëndshme që të sigurojë formalizimin e procesit të konsolidimit dhe miratimit të Planit Strategjik dhe Vjetor të sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Të kërkohet që procesi i hartimit të këtyre planeve, edhe në njësitë, të ketë për bazë një vlerësim risku të kujdesshëm dhe jo formal.	I papranuar	Gjatë auditimit për aktivitetin e vitit 2017, konstatojmë se procesi i konsolidimit të planeve strategjike dhe vjetore të sistemit të AB nuk ka ndryshuar. Planet hidhen manualisht dhe mbahen në formë elektronike në Excel. Nga raporti vjetor dhe analiza vjetore e drejtorisë konstatohet se vlerësimi i riskut mbetet një aktivitet problematik, i cekët dhe formal. **Gjykojmë se mbetet i nevojshme një rishikim i procesit të konsolidimit të planeve dhe i ndarjes së detyrave për të lënë kohë analizave dhe këshillimit e më pas monitorimit gjatë vitit për zbatimin e këtyre planeve.**
10.	Te rishikohen treguesit mbi të cilët monitorohet dhe raportohet aktiviteti i AB, duke vënë theksin dhe mbi tregues të cilët reflektojnë vlerën e shtuar të strukturave të auditimit të brendshëm. Të plotësohen treguesit lidhur me nivelet e rikuperimit të	I papranuar	Gjatë punës audituese të aktivitetit të vitit 2016, evidenca dhe raporti i vënë në dispozicion u analizuan dhe testuan duke arritur në të njëjtin konkluzion me atë të grupit të auditimit të vitit të kaluar, se treguesit dhe indikatorët nuk janë

	efekteve financiare në buxhet si dhe të harmonizohet dhe standardizohet praktika e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit të brendshëm në shkallë sistemi kjo do të rrisë ndergjegjësimin dhe kulturën menaxheriale të drejtuesve në njesitë e sektorit publik.		përfaqësues i cilësisë së punës së auditit të brendshëm dhe vlerë e shtuar për menaxhimin dhe njësinë ku ata operojnë. Gjetjet, mangësitë në llogaritje, shpjegimet e anekseve të AB dhe vlerësimi i tyre me shkallë të lartë subjektivizmi, i janë paraqitur drejtimit të DH.AB në Akt-konstatimin nr. 4.
11.	Përcaktimin e qartë të përgjegjësive mbikqyrëse dhe vendimmarrëse të Komisioni i Kualifikimit të AB në procesin e zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm si lidhur me Trajnimin e Vijueshëm të detyrueshëm dhe Certifikimin e Audituesve të Brendshëm në Sektorin publik, përgjegjësi që duhet të jenë të ndara nga detyrat ekzekutive dhe administrative të Drejtorisë së Harmonizimit të AB në MFE.	I papranuar	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e aktivitetit të KKAB, nuk u konstatua ndryshime në procedura apo rregullore. KKAB, përveç përcaktimeve në Ligjin 114/2015, ka funksionuar dhe ushtruar kompetencat mbështetur në kuadrin rregullator neë fuqi ku parashikohet që KKAB të kryejë funksion mbikëqyrës të procesit të trajnimit dhe çertifikimit të audituesve dhe bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për auditimin e brendshëm në MFE. Specialistët e DH/AB janë të gjithë të përfshirë në procesin e certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm e më pas të hartimit të relacioneve të vlerësimit të procesit, cilësisë së trajnerëve dhe më pas bëjnë vlerësimin me pikë të njësive AB që ata vetë kanë trajnuar e certifikuar.
12.	DH/AB të rishikojë dhe të përditësojë Rregjistrin e Audituesve të Brendshëm të Certifikuar dhe të trajnuar me qëllim që ky dokument të përmbajë informacion të dobishëm dhe të nevojshëm që të pasqyroje situatën e zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm në kohë, por njëkohësisht të shërbeje si dokument dhe bazë të dhënash për të siguruar analiza të zhvillimit për të ardhmen.	I papranuar	Konstatojmë së forma dhe përmbajtja e Regjistrit të Audituesve të Brendshëm përmban informacion të limituar. Regjistri duhet të integrohet me Regjistrin e Audituesve të Brendshëm të Certifikuar për periudhën dhe të përmbajë informacion progresiv dhe elementë të sigurtë identifikues të AB të certifikuar. Ky regjistër duhet të integrohet me rregjistrin e trajnimit të vijueshëm për të ndjekur rastet që nuk janë në përmbushje të detyrimit të TVP. Regjistri është dokument zyrtar, dhe si i tillë duhet të protokollohet në fund të çdo viti në zyrën e protokollit të MFE, krahas publikimit në faqen zyrtare të internetit në rubrikën përkatëse. Përsa më sipër gjykojmë se Regjistri duhet rishikuar dhe të ndërtohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjit për AB dhe akteve të tjera rregulluese nënligjore. Ky regjistër në përfundim të çdo sezoni çertifikimi duhet plotësuar dhe depozituar në zyrën e arkivës të Institucionit.
13.	Ministria e Financave dhe Ekonomise të	I pranuar	Shpjegojmë se është e pa konceptueshme

	marrë masa, duke iu drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me qëllim verifikimin e konfliktit të mundshëm të interesit për anëtarët e Komiteteve të Auditimit, Bordit te Menaxhimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publik. Në rast se nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk do të konstatohet veprim lidhur me këtë rekomandim brenda afatit 20 ditor, kur duhet të prezantojë planin e veprimit për sa është rekomanduar, KLSH të adresojë pranë ILDKPKI kërkesën për verifikimin e konfliktit të interesit në rastet e specifikuara me lart.	pjesërisht	që strukturat që merren me garantimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, pjesë e të cilave është edhe zbatimi i rregullave të etikës dhe parandalimi i konfliktit të interesit nuk kanë arritur të lexojnë cfarë kemi cilësuar në raportin e auditimit për vitin 2016. Konflikti i interesit është një koncept i gjerë që lidhet si me konfliktin në funksione dhe përgjegjësi edhe konfliktin e mirëfilltë të personave në anagazhimin në strukturat e cilësuara në rekomandimin e KLSH. Duhet të theksojmë se përzgjedhja e personave dhe formaliteti i procedurave të konstatuara nuk lidhen me kërkesat ligjore por me papërgjegjshmëritë e personave që kanë patur detyrën dhe funksionin për të vepruar në përputhje me kërkesat që ka vendosur ligji. Vendimarrja jo në përputhje me kërkesat e specifikuar në Urdhrin e Ministrit të Financave, jo vetëm që nuk u analizua për të përcaktuar përgjegjësitë respektive por u cilësua si një rekomandim i papranueshëm, pavarësisht se cilësia e këtij Bordi lidhet me garantimin e cilësisë së punës së kontabilistëve dhe ekspertëve të autorizuar. Mosveprimi në gjykimin tonë ka krijuar premisat për ligjërimin edhe të paligjshmërive të mëtejshme për sa kohë që paligjshmëria ka fituar statusin e të paprekshmit.

Duhet të theksojmë se auditimi ka treguar se problematikat e konstatuara në auditimin e mëparshëm vijojnë të ekzistojnë dhe strukturat vegjetojnë duke mos u marrë masat e duhura për përmirësimin e situatës, dhe duke i lënë këto shtylla të menaxhimit të financave publike larg objektivave qeverisëse.

25.1 Rekomandimi: Ministri i Financave dhe i Ekonomisë si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonimisë, të analizojë qëndrimet refuzuese të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në konteksin e situatës së strukturave AB dhe MFK larg objektivave të strategjisë së menaxhimit të financave publike, dhe të nxjerrë përgjegjësitë për paligjshëmritë e konstatuara në ushtrimin e funksioneve apo në realizimin e urdhrave të deleguar.

Brenda 31.12.2018

25.2 Rekomandimi: Çështjet e konfliktit të interesit apo konfliktit të funksioneve të konstatuara nga auditimi i mëparshëm, dhe për të cilat nuk është marrë asnjë nga masat e rekomanduara, të adresohen menjëherë në ILDKPKI për ti kthyer strukturave legjitimitetin e duhur për përmbushjen me përgjegjshmëri të funksioneve dhe misioneve të adresuara.

Menjëherë

F. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 153/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar për personat përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Ministri i Financave dhe i Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonimisë dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6-muaj" deri në "Largim nga shërbimi civil" sipas përgjegjësisë të drejtuesve, pas analizimit të gjetjeve të këtij raporti auditimi.

OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik e cila përfshin aktivitetin e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në opinionin tonë, për shkak të rëndësisë dhë përhapjes së çështjeve të përmendura në bazën për opininion e kundërt të përputhshmërisë, aktiviteti i kësaj strukture, nuk kanë qenë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, ku përmendim ligjet për auditin e brendshëm, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor si dhe aktet nënligjore përkatëse, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **Opinionit të kundërt mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së DH me kuadrin ligjor dhe rregullator.**

Bazat për Opinionin e kundërt të Përputhshmërisë

Nga auditimi është konstatuar se megjithëse është njësia që udhëheq metodologjikisht dhe jo vetëm, implementimin e kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", menaxhimi financiar dhe sistemet e kontrollit të brendshëm nuk janë dizenjuar saktë dhe nuk kanë funksionuar në aktivitetin e kësaj strukture të rëndësishme.

Në përfundim të auditimit të proceseve të punës, mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit rezultojnë mangësi dhe dobësi në disa elementë të MFK. Pavarësisht objektivave të vendosur për vitin 2017, organizimi i strukturave AB dhe MFK rezulton të jetë jo i përshtatshëm për dimensionet dhe për karakterin e aktivitetit të Drejtorisë. Konstatohet se brenda Drejtorisë ka patur vende vakant gjatë vitit, ndërkohë që pretendohet mungesë kapacitetesh si risku kryesor në realizimin e objektivave. Delegimi i detyrave rezulton të jetë praktikë jo e rregulluar, sidomos në rastet e lëvizjeve të stafit. Të gjithë punonjësit janë në nivel specialisti pa hierarki raportuese apo eksperience dhe rëndësisë së detyrave që ata kryejn. Ngarkesa e secilit punonjës sipas përshkrimeve ë punës nuk është rishikuar në mënyrë që të sigurojë ngarkesë të drejtë për secilin në funksion të eficensës së drejtorisë dhe cilësisë së produkteve së saj. Risku operacional në këtë rast konsiderohet i lartë.

Eshte ndërtuar rregjistri i risqeve por nga shqyrtimi i tij dhe i ngjarjeve të rëndësishme të ndodhura në sektorin publik gjatë vitit 2017, rezulton që ky rregjistër është një dokument pasiv dhe nuk është shqyrtuar në mënyrë dinamike, kjo me impakt lënien jashtë vëmëndjes dhe mosmenaxhimin e situatave si: *ristrukturimi i Ministrive të linjës ku DH në rolin e saj si udhëheqëse metodologjike duhej të kishte paraprirë këtë proces kompleks, me udhëzues mbi rregullimet kontabël të transaksioneve financiare të lidhura me procesin.* Nuk është azhornuar

ky rregjistër për të reflektuar efektet e qeverisë teknike në realizimin e objektivit të implementimit të sistemeve moderne pilot MFK. Objektiv ky i parealizuar.

Është parashikuar risku i mungesës së kapaciteteve në burime njerëzore në lidhje me realizimin e objektivit të përmirësimeve ligjore dhe metodologjike në fushën e kontabiliteit publik por nga problematika e udhëzimeve të nxjerra, me shkelje dhe jo të harmonizuara ndërmjet tyre, që sjellin konfuzion në zbatimin e parimeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar, në gjykimin tonë këtij risku duhet ti shtohet gjithshtu dhe risku i mungesës së profesionalizmit dhe ekpertizës. Drejtoria e Harmonizimit ka përgatitur regjistrin e risqeve të proceseve por nuk gjejmë procedura të monitorimit të këtyre risqeve dhe kontrolle analitike në funksion të cilësisë së përmbushjes së objektivave.

Pas viteve të para të ngritjes dhe konsolidimit si Drejtori, shtylla e tretë e sistemit KBFP është shndërruar në një zyrë statistikore dhe e dedikuar për procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm. Kjo situatë mbështetur nga një Bord KBFP pothuaj inekzistent, reflekton një risk të lartë strategjik referuar ekzistencës së saj.

Mbi raportin vjetor për gjëndjen e MFK në sektorin publik: Nisur nga auditimi i procesit të monitorimit për efekt të përgatitjes së raportit vjetor, si dhe të konstatimeve nga auditimet e realizuara nga KLSH, për efekte të zbatimit të buxhetit të vitit 2017, arrijmë në konkluzionin se opinioni i dhënë në Raportin Vjetor, lidhur me funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, nuk reflekton situatën reale të implementimit të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", pasi kampioni i përzgjedhur nuk është përfaqësues, metodologjia e monitorimit nuk është aplikuar sic duhet dhe ajo që është më e rëndësishmja bazohet në përpunimin e pyetësorëve të vetëdeklarimit të njësive të sektorit publik. Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk reflekton kapacitete teknike dhe profesionale që të garantojnë monitorimin e vazhdueshëm dhe ndërhyrje të menjëhershme për përmirësimin e situatës. Përqëndrimi i aktivitetit monitorues për një periudhë 3 mujore ngre problemin e efektivitetit të këtyre strukturave dhe ineficenca në organizimin e punës. Fokusi në realizimin e trajnimeve përmes ASPAS, ndërkohë që ky është një aspekt i përgjegjësive funksionale të punonjësve të kësaj strukture, reflekton edhe papërgjegjshmëri menaxherale.

Mbi raportin vjetor për gjëndjen e AB në sektorin publik: Nga auditimi është konstatuar se nga ana e strukturave të harmonizimit të AB, nuk ka një analizë të plotë mbi nivelin e shtrirjes së auditit të brendshëm në sektorin publik, nuk ka një numër të saktë të njësive të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që të paraqesin drejtë nivelin e shtrirjes së këtij shërbimi dhe më pas për të kaluar në vlerësimin e cilësisë së tij në rang kombëtar. Raporti Vjetor mbi Auditimin e Brendshëm në sektorin publik, bazohet në përpunimin e 119 strukturave AB, të cilat raportojnë pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm. Nga evidencat e vëna në dispozicion rezultojnë 22 njësi me 1 auditues dhe 26 njësi me 2 auditues pra gjithsej 48 njësi të ose 40% e sistemit AB janë në shkelje të Ligjit nr.114/2015. Përfshirë këtu dhe 15 njësi me eficensë shumë të ulët (zero rekomandime apo gjetje përgjatë vitit 2017) e con në 53% nivelin ku sistemi i sigurimit të cilësisë mungon ose nuk funksion. Gjithashtu janë konstatuar shkelje të përhapura të ligjit nr.114/2015 dt. 15.10.2015, neni 11 në ngritje të strukturave AB dhe VKM nr.83 dt. 3.2.2016, në punësimet jo sipas kritereve ligjore dhe formale duke shkaktuar ineficensë të sistemit të auditit të brendshëm duke mos realizuar qëllimin dhe detyrimin ligjor dhe duke shpenzuar në mënyrë jo eficente fondet publike të vëna në dispozicion. Në rang kombëtar, sipas evidencave të vëna në dispozicion nga DH/AB rezulton se me rritjen e numrit të njësive AB të ngritura në sektorin

publik, niveli i audituesve të çertifikuar në këto struktura, ka rënë nga 90% në 77% në dy vitet e fundit. Jashtë sektorit publik janë aktualisht rreth 1600 audites të çertifikuar (1911[27] audites të çertifikuar nga të cilët vetëm 308 të punësuar në sektorin publik). Kjo flet për qarkullim të shpeshtë të stafit të AB, punësimin vetëm për efekt të plotësimit të kriterit të çertifikimit apo emërimeve dhe largimeve politike.

Referuar treguesit të dobishmërisë së aktivitetit të AB ai rezulton 14.9 leke/1 lekë të shpenzuar duke përfshirë këtu një gjetje të Ministrisë së Ekonomisë dhe Infrastruktures. Nëse kjo gjetje me dëm ekonomik do të përjashtohej nga llogaritja treguesi i dobishmërisë për gjithë sistemin AB (118 njësi) do të ishte 3.4 lekë /1 lekë kosto auditimi të shpenzuar. Treguesi i dobishmërisë së strukturave të AB brënda njësive publike të caktuara është shumë herë më i vogël krahasuar treguesit të dobishmërisë së gjetjeve të audituesit të jashtëm publik, po për të njëjtat struktura, fakt që tregon se varësia e strukturave AB nga titullarët është jo vetëm çështje organizative. Është i dyti vit që nga ana e KLSH, ngrihet problemi që ndryshimet dhe përmirësimet ligjore kanë forcuar dhe theksuar kompetencat e titullarëve për shërbimin e auditimit të brendshëm por nuk sigurojnë pavarësinë, cilësinë e auditimit rrjedhimisht ngritjen e një strukture eficente dhe efektive në shërbim të mirëmenaxhit të fondeve publike.

Përgjegjësitë e drejtuesve të Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Pubik

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi, ndër të cilat përmenden: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Ligji nr. 114/2015 datë 15.10.2015 "Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik", dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, dhe përgatitja e Raportit Vjetor lidhur me nivelin e AB dhe shtrirjes së MFK në rang kombëtar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme dhe dhënien e opinionit nëse aktiviteti i Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik është kryer në përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

[27] Sipas rregjistrit të Audituesve të Certifikuar të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

VI. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Pjesë përbërëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit është dhe dokumentacioni në Ankeset 1 – 4, në vijim të këtij raporti.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

VII. ANEKSE.

Aneksi 1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm

Në përputhje programit të auditimit nr. 301/1 dt.19.03.2018 "Mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, pika E: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm" dhe në zbatim të: *Ligjit nr. 154/2014 dt. 19.2.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" Neni 15 gërma j; Neni 16, pika 1; Neni 25 pika ç; Neni 30 pika 1 dhe 2,* u shqyrtuan dhe u verifikuan veprimet dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit dhe strukturave të saj në lidhje ne vendimin nr. 144 dt. 30.09.2017, i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit: "Për Auditimin e kryer në Drejtorinë e Harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, mbi "Dhënien e opinionit në raportin e buxhetit të shtetit për AB dhe MFK". Gjithashtu, u morën në shqyrtim dhe; Plani i masave dërguar nga Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik nga e cila rezulton se: nga 15 rekomandime, DH ka pranuar plotësisht 1 (një) rekomandim dhe ka pranuar pjesërisht 3 (tre) rekomandime dhe 11 (njëmbëdhjetë) rekomandime nuk janë pranuar. Në vijim janë paraqitur të gjitha rekomandimet e verifikuara dhe opinioni i grupit të auditimit për statusin e zbatimit të rekomandimit. Në raportimin 6 mujor "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH" dërguar me shkresë nr. dt. 01.05.2018 konstatojmë se DH dhe drejtuesit e saj kanë paraqitur më shumë argumente në mbështetje të mospranimit të rekomandimeve të KLSH duke rezultuar me vetëm 1 (një) rekomandim të pranuar dhe zbatuar pjesërisht. Në vijim janë paraqitur të gjithë rekomandimet e verifikuara me statusin deri në datën e përpilimit të këtij Akt-verifikimi 14.06.2018.

I. Rekomandime të pranuara plotësisht ose pjesërisht

1.1 Drejtoria e Harmonizimit të luajë një rol udhëheqës në drejtim të monitorimit më të kujdesshëm të treguesve të realizimit të planit nga Njësitë e AB, duke forcuar kërkesat për të raportuar edhe arsyet e ndryshimeve apo devijimeve nga planifikimi fillestar. Të ketë një uniformitet në trajtimin e auditimeve me temë zbatimi i rekomandimeve, duke eliminuar problematikën e konstatuar. Afati: Deri në Dhjetor 2017

Ky rekomandim **është pranuar pjesërisht** me komentin e menaxhimit si vijon: "*Bazuar në kapitullin IV të Manualit të AB, është përcaktuar qartë që në realizimin e planit gjatë vitit mund të ketë ndryshime të vlerësimit të riskut ose problematika të dala që kërkojnë zgjidhje nga titullari i njësisë publike, për të përmirësuar proceset e qeverisjes, administrimit të riskut dhe proçese vetë kontrollit. Duke qenë proçes monitorimi, <u>zbatimi i rekomandimeve nuk do të planifikohet</u> dhe <u>nuk do të raportohet si angazhim i veçantë</u>. Megjithatë, ky proçes do të jetë në fokus të përmirësimit, nga ana e DH/AB, e cila do të <u>monitorojë</u> në mënyrë të vazhdueshme realizimin dhe devijimet e planit nga NJAB-së".* Në dokumentin " Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH" dt. 01.05.2018, menaxhimi shton se: "*... Në kuadrin rregullator është përcaktuar se asnjë njësi auditimi <u>nuk mund të planifikojë dhe të realizojë auditime të veçanta për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna</u>..... DH/AB ka të përcaktuar në ligj dhe luan rregullisht rol udhëheqës në drejtim të monitorimit të të gjithë veprimtarisë së AB, me qëllim që kjo veprimtari të jetë gjithnjë e më shumë në përputhje me standardet ndërkombëtare".*

Opinioni i grupit të auditimit:

Bazuar në dokumentacionin e dosjes së ndryshimeve të planeve vjetore të vëna në dispozicion nga DH/AB, konstatohet se gjatë vitit 2017 janë protokolluar gjithsej 18 kërkesa për ndryshim plani auditimesh nga të cilat vetëm 13 janë të shoqëruara me shpjegime. Gjithsesi, mbetet e paqartë se si DH/AB mund të monitorojë ndryshime të tjera që mund të jenë bërë nga njësi të

tjera por që mund të mos kenë njoftuar, pra mungon një element kontrolli që do të garantonte saktësinë e shifrës së realizimit të planit të auditimeve që paraqitet në raportin vjetor të KBFP ku gjejmë njësi me realim plani mbi 200%.
Kjo pikë është trajtuar edhe në auditimin e aktivitetit për vitin 2017 ku janë paraqitur gjetje dhe konstatime mbi mangësitë, pasaktësitë në raportim të planeve dhe ndryshimeve të tyre, në formatet e kërkesave dhe arsyet e paraqitura për ndryshime. **Kjo pjesë e rekomandimit edhe pse është pranuar nuk gjejmë të jetë ndërmarrë ndonjë veprim për harmonizim të formateve, mënyrës së raportimit dhe kontrollit për saktësinë e raportimit dhe DH/AB përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit mbetet në mosveprim.**
Për sa i përket pjesës së rekomandimit mbi auditimet tematike "për zbatimin e rekomandimeve" që ato të paraqiten si auditime të veçanta dhe jo pjesë e zërit "shërbime këshillimi", konstatojmë se nuk janë bërë ndryshime në formatin e evidencave për të dalluar këto angazhime ndërkohë që institucionet raportojnë auditime të kryera të llojit "mbi zbatimin e rekomandimeve". Gjithashtu, argumentimi i menaxhimit të DH/AB në lidhje me këtë çështje është i paqartë se c'pjesë e "kuadrit rregullator" përcakton se: " ..*asnjë njësi auditimit nuk mund të planifikojë dhe realizojë auditime të veçanta për ndjekjen e rekomandimeve*". Ndërkohë Ligji 114/2015, neni 6, neni 14 parashikon "..dhe lloje të tjera të auditimeve", duke mos e kufizuar mundësinë e kryerjes së auditimeve tematike, ose me kërkesë të titullarit, për zbatimin e rekomandimeve. Sipas Manualit të AB pika 2.6.1 parashikon detyrimin e titullarit për raportimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të AB. Pika 4.1.13 e Manualit të AB në përputhje me Standardin 2440 parashikon " *Audituesit e brendshëm vlerësojnë përshtatshmërinë, efektivitetin dhe afatet e veprimeve të ndërmarra nga menaxhimi për adresimin e çdo rekomandimi të auditimit. Kjo njihet si "ndjekja e procedurave" dhe mund të bëhet pjesë e angazhimit të auditimit për vitin që vjen, kur një gjë e tillë është përfshirë në planin strategjik të auditimit të brendshëm, ose si një angazhim i veçantë, nëse nuk është planifikuar ndonjë angazhim auditimi në atë sistem*"
Në përputhje me standardet e AB-së: 2010 "Planifikimi" dhe 2030 "Menaxhimi i burimeve", monitorimi i zbatimit të rekomandimeve, edhe pse mund të mos planifikohet si një angazhim i veçantë, NJAB duhet të planifikojë kohën ditë-njerëz për monitorimin e rekomandimeve të lëna që do të ndiqen dhe raportohen në bazë të rëndësisë, riskut të vlerësuar[28].
Gjithashtu, duke qenë një indikator i rëndësishëm i efektivitetit të NJAB (pasaporta e indikatorëve sipas SIGMA) identifikimi, paraqitja e tyre mbetet e rëndësishme për të dalluar këtë angazhim nga angazhimet tematike me indicie apo me kërkesë të titullarit; **Në gjykimin tonë, DH/AB mbetet në mosveprim në lidhje me këtë rekomandim dhe rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.**

1.2 Koordinimin e punës së auditimit të brendshëm me strukturën përgjegjëse për inspektimin financiar me qëllim forcimin e punës së organeve të inspektimit dhe trajtimit me profesionalizëm të rasteve të denoncuara. Transparenca dhe njoftimi i publikut për rastet e trajtuara është me rëndësi për të rritur jo vetëm rolin, por edhe besueshmërinë ndaj kësaj strukture. Afati: Menjëherë dhe në vijimësi
Rekomandimi **është pranuar pjesërisht** i shoqëruar me komentin e menaxhimit si vijon: "*Përcaktimin në gërmën d të nenit 14 të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, ku specifikohet raportimi menjëherë në formë të shkruar te titullari I njësisë publike dhe tek Ministri i Financave, i cili ka në varësi strukturën e inspektimit financiar publik, kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e NJAB përbëjnë vepër penale, është një dispozitë shteruese. Nuk është detyrë dhe përgjegjësi e strukturave të AB të raportojnë në lidhje me ecurinë e këtyre investigimeve. Megjithatë shprehemi se të gjitha raportet e inspektimit financiar janë të*

[28]*Standardi 2500- Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve dhe Manuali i Auditimit të brendshëm pika 4.13.1&2*

publikuara në ëëë.financa.gov.al dhe ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm. Ndërkohë DH/AB do të përfshijë edhe me tej në trajnimin e vijueshëm të audituesve të brendshëm strukturën e inspektimit financiar për të diskutuar lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e secilës palë në këtë drejtim.". Në dokumentin "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit 2016", dt. 01.5.2018, menaxhimi i DH/AB shton se: "*Në të gjitha Programet e Trajnimit të Vijueshëm Profesional për AB janë përfshirë dhe trajtuar tema specifike mbi trajtimin e rasteve të mashtrimit dhe korrupsionit dhe komunikimin ndërmjet funksioneve të AB, Inspektimit Financiar dhe KLSH. E gjitha kjo për të qartësuar rolin dhe përgjegjësitë e audituesve në trajtimin e rasteve të dyshuara për mashtrim dhe korrupsion*".

Opinioni i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të trajnimeve të vijueshme si: listeprezenca dhe temat e trajtuara në 4 Modulet e trajnimeve të vijueshme nuk u konstatua pjesmarrje e specialistëve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar. Gjithashtu nga komunikimi me Drejtoren e Përgjithshme të DH/KBFP në lidhje me këtë pikë nuk konfirmojmë se janë kryer mbledhje apo takime të posaçme midis dy departamenteve në lidhje me rolin, përgjegjësitë e secilës palë.

Në lidhje me transparencën, faqja zyrtare e Drejtorisë së Inspektimit Financiar nuk është e disponueshme (kërkimi i dt. 22.5.2018- 13.6.2018), gjithsesi numri i raporteve të publikuara nga kjo drejtori nuk është objekt i këtij auditimi për të konfirmuar plotësinë dhe nivelin e transparencës së publikimeve. Gjithsesi, vlerësuar mbi bazë të evidencave të vëna në dispozicion më 05.05.2017 (format Excel) nga specialistja e DH/AB, rezulton se janë përcjellë në Drejtorinë e Inspektimit Financiar nga AB-të vetëm 4 raste për investigim nga 19 raste të raportuara gjatë vitit 2016. **Në gjykimin tonë ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

1.3 Është e nevojshme të bëhen plotësime në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", I ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", lidhur me një formulim më të plotë të fushës së zbatimit të ligjit. MFE të marrë masa me qëllim zbatimin e plotë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, duke përfshirë sipas karakteristikave specifike të tyre shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme; dhe duhet të shprehet në kuadër ligjor për zbatimin nga institucionet e pavarura të cilat krijojnë apo shpenzojnë fonde publike. Nisur nga fakti se ndryshimet e këtij ligji sapo kanë ndodhur, mund të rritet roli aktiv i DH/MFK pranë MFE, për një kuptueshmëri sa më të lartë të shtrirjes dhe funksionimit të MFK edhe përmes përgatitjes së një udhëzimi unifikues. Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi pranohet pjesërisht i shoqëruar me komentin e menaxhimit si vijon**: "***Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 i ndryshuar, në nenin 3 përcakton qartë fushën e zbatimit të tij. Ky ligj ngarkon me përgjegjësi për zbatimin dhe implementimin e sistemit të MFK të gjitha njësitë e përfshira në këtë nen. Për sa i përket rritjes së rolit të DH/MFK, në rritjen e nivelit të kuptueshmërisë së koncepteve dhe funksionit të MFK, DH/MFK asiston në mënyrë të vazhdueshme këto institucione me qëllim implementimin e kërkesave ligjore".*

Opinioni i grupit të auditimit

Në dokumentin "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit 2016" të DH/KBFP dt. 01.05.2018 nuk paraqitet ndonjë plan konkret veprimi në lidhje me qartësimin e fushës së zbatimit dhe rolin e DH/MFK dhe se si kjo drejtori i ka asistuar në mënyrë të vazhdueshme institucionet e pavarura me qëllim implementimin e kërkesave ligjore. Kështu shoqëritë tregtare me kapital shtetëror vazhdojnë të mos raportojnë apo dorëzojnë pranë kësaj drejtorie formularët e vetëvlerësimit të MFK. Mbetet i paqartë racionaliteti në legjislacion,

midis detyrimit për të raportuar aktivitetin e NJAB dhe jo gjendjen e MFK-së nga këto njësi të pavarura kur që të dyja janë dy shtylla të sistemit KBFP.

Kjo çështje, e fushës së zbatimit të Ligjit 10296 dhe roli i DH/KBFP janë trajtuar përsëri në raportin e auditimit të vitit 2017. **Në gjykimin tonë ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

Në mënyrë analoge dispozitat përkatëse ligjore për fushat e zbatimit dhe raportimit të MFK dhe AB, paraqiten si më poshtë:

	Ligji 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"	**Ligji .10 296, Datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"**	**Ligji 10 296, datë 08.07.2010 "I ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015"**
Fusha e zbatimit të ligjit	**Neni 3** **Fusha e zbatimit të ligjit** Ky ligj zbatohet në njësitë e sektorit publik, ku, sipas këtij ligji, përfshihen: a) njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe çdo institucion tjetër që kryen funksione publike; b) shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financ ohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme; c) njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare	**Neni 3** **Fusha e zbatimit të ligjit** Ky ligj zbatohet në njësitë e sektorit publik, ku, sipas këtij ligji, përfshihen: 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme. 2.Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe Autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. 3. Njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare.	**Neni 3** **Fusha e zbatimit të ligjit** Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku sipas ligjit përfshihen: 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme. 2. Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. 3. Njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare**.**
Përgjegjësia e raportimit	**Neni 14** **Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për**: a) organizimin e angazhimeve të AB, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji; b) hartimin e Kartës së Auditimit, akteve të tjera specifike për fusha të veçanta të AB, në zbatim të këtij ligji dhe akteve të tjera në zbatim të tij, si dhe dërgimin e tyre për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e AB; c) **hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e AB dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e AB, pas miratimit nga titullari i njësisë publike;** **ç) përgatitjen e raportit vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB**	**Neni 18** **Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm** 1.Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikave **1 dhe 2 të nenit 3** të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një **deklaratë** **dhe raportin përkatës** **për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve** **të brendshme të njësisë** publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual.	**Neni 18** **Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm** 1.Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës **1 të nenit 3** të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një **deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që** mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual.

1.4 Drejtoria për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të verifikojë regjistrin e nëpunësve zbatues lidhur me statusin e institucioneve, konfirmimet e nëpunësve zbatues, kriterin e arsimit të lartë dhe kriterin e vartësisë direkte nga titullari me qëllimin eliminimin e kundërshtive me ligjin, si edhe përditësimin e informacioneve të përmbajtura në regjistrin e nëpunësve zbatues. Afati : Menjëherë

Rekomandimi **është pranuar** shoqëruar me komentin e menaxhimit **se: "***Lidhur me rekomandimin përkatës, për Nëpunesit Zbatues (NZ) që ushtrojnë funksionin në më shumë se një institucion, sqarojmë se bëhet fjalë për ato institucione ku pozicioni i NZ është vakant dhe përkohësisht mbulohet nga NZ i institucionit epror me qëllim mos pengimin e veprimtarisë financiare. Për sa i përket institucioneve të cilat janë mbyllur dhe nuk ushtrojnë më aktivitet ekonomik, DH/MFK nuk është e informuar për këto institucione. Për sa më sipër do të mbahet në konsideratë një bashkëpunim akoma më i ngushtë me Drejtorinë e Buxhetit dhe të Thesarit*

në MFE. Kriteret e përshkruara në nenin 12 të ligjit te MFK zbatohen me rigorozitet nga ana e DH/MFK. Rastet e evidentuara i përkasin periudhës para miratimit të ligjit të ri të MFK. Në vazhdimësi, në përfundim të periudhës kalimtare dy-vjeçare te parashikuara ne ligj (neni 32), DH/MFK do të marrë masat për evidentimin e të gjithë institucioneve, NZ e të cilave nuk përmbushin kriteret dhe do të bëhet njoftimi i institucioneve përkatëse që të marrin masa për zëvendësimin e tyre me punonjës të cilët i plotësojnë kriteret ligjore".

Opinioni i grupit të auditimit:

DH/MFK, në përfundim të periudhës kalimtare dy-vjeçare mbi implementimin e kërkesave ligjore për nëpunësin zbatues, ju ka dërguar shkresën nr. 17416, datë 1.12.2017 të gjitha institucioneve të qeverisjes së përgjithshme me qëllim marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të nëpunësit zbatues me punonjës që përmbushin kriteret. Gjithashtu, është njoftuar edhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e kritereve të nëpunësit zbatues, të përcaktuara në nenin 12 si dhe marrjen e masave për rishikimin e të gjithë atyre nëpunësve civilë në pozicione pune të nëpunësit zbatues të cilët nuk përmbushin kriteret. Për këtë qëllim, me kërkesën e DAP, ju është përcjellë edhe lista e plotë ku evidentohen nëpunësit civilë në pozicione pune me funksione të nëpunësit zbatues të cilët nuk përmbushin kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010.

Përsa i përket cilësisë dhe rregullsisë së mbajtjes dhe përditësimit të regjistrit të nëpunësit zbatues, bazuar në regjistrin të vënë në dispozicion me datë 11/4/2018, janë konstatuar disa pasaktësi që nuk lënë mundësi për raportime të plota e të sakta në numër, dhe për më tepër në vlerësim dhe kontroll plotësim kriteresh arsimimi. Gjetjet në lidhje me regjistrin e NA dhe NZ i janë paraqitur menaxhimit të DH në Akt-konstatimin nr. 3 dt. 8.6.2018. **Në gjykimin tonë ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i zbatuar.**

II. Rekomandime të papranuara

2.1 Të rishikohen treguesit e përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015, vlerësimi i performancës për vitin 2016, për të qenë më përfaqësues dhe dhënë një pamje të drejtë të funksionimit të sistemit të auditimit të brendshëm dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik. Afati: Deri në Dhjetor 2017.

Ky rekomandim **nuk është pranuar** nga DH/ KBFP. Në dokumentin "Plan veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH" menaxhimi argumenton mospranimin e rekomandimit si vijon: "*..metodologjia e Monitorimit të performancës është përdorur për herë të parë në vitin 2016, dhe kërkon kohën e duhur për të testuar efektivitetin e saj në vlerësim. Gjithashtu, sqarojmë se në raportin përfundimtar në lidhje me këtë rekomandim ka pasaktësi. Analizohet vlerësimi sipas kësaj metodologjie i NJAB në Bashkinë Sarandë. Sqarojmë se kjo NJAB ka të miratuar një strukturë me dy AB, të cilët janë të çertifikuar, të trajnuar dhe me eksperiencë të gjatë profesionale. Miratimi i strukturës sipas akteve ligjore nuk është përgjegjësi e NJAB. Në këto kushte kjo NJAB nuk mund të vlerësohet negativisht ose me më pak pikë"*

Opinioni i grupit të auditimit:

Aktualisht, raporti vjetor i KBFP për vitin 2017 nuk ka në përmbajtjen e tij një vlerësim nëse indikatorët e performancës janë testuar apo vlerësuar nga DH/MFK dhe AB për efektivitetin e tyre bazuar kjo në eksperiencën e këtyre drejtorive nëpërmjet: komunikimit me njësitë; asistenca e ofruar në përgjigje të kërkesave vetë njësisë apo cilësinë e raportimit të formularëve të vetëvlerësimit të konsoliduar, problematika të dala nga vlerësimet e jashtme të kryera, etj. Gjerësisht, problematika e disa indikatorëve në mënyrën e përpunimit të tyre, mënyrës së llogaritjes është evidentuar edhe gjatë auditimit të aktivitetit për vitin 2017 me efekte në në vlerësimin e treguesit të efektivitetit të perfomancës së sistemeve të kontrollit në sektorin publik. Këto problematika të konstatuara janë paraqitur në Akt-konstatimin nr. 4 dt. 14.06.2018.

Përsa i përket rastit të marrë në shqyrtim në Bashkinë Sarandë, ky konstatim i grupit të auditimit, nuk është kundërshtuar si i pasaktë në observacionet e DH pas dërgimit të projekt raportit të audimit për vitin 2016. Gjithashtu, argumenti që struktura e NjAB-së Sarandë është e miratuar nga titullari i vetë njësisë nuk justifikon: - shkeljen e Ligjit 114/2015 ku përcaktohet numri minimal i një njësie AB, - subjektivizmin dhe pasaktësinë e rezultatit të indikatorit. (Në llogaritje merret e mirëqenë se nuk ka vende vakante) si dhe - impaktin në saktësinë dhe pasqyrimin e drejtë të situatës së KBFP i konkluduar dhe raportuar në raportin vjetor të KBFP përgatitur nga kjo drejtori në zbatim të Ligjit 10296 i ndryshuar. Në gjykimin tonë rekomandimi nuk është kuptuar në thelbin e tij pasi, rasti i Bashkisë Sarandë është vetëm një shembull i problematikës në lidhje me mënyrën e llogaritjes së indikatorit[29] të performancës së AB-së gjë që çon në një vlerësim jo të drejtë (mbivlerësim) të tij dhe më pas të vlerësimit përfundimtar për njësinë (mbivlerësim). **Në gjykimin tonë, DH edhe pse ky rekomandim nuk është pranuar mbetet në mosveprim** duke marrë në konsideratë vazhdimësinë e problematikës gjatë vitit 2017 dhe impaktin e tij në saktësinë e raportimit të Ministrit të Financave më komisionin parlamentar.

2.2 Ministria e Financave dhe Ekonomisë të rishikojë organizimin dhe funksionimin e Bordit të KBFP, me qëllim kthimin e tij në një strukturë që i shërben përmirësimit të menaxhimit të sistemit të MFK në shkallë vendi, duke synuar një pjesëmarrje më të reduktuar por më efektive dhe veçanërisht këshilluese në fushën e kontrollit. Të ndryshoj raporti ekspert i jashtëm/ punonjës Ministrie, raport që ndikon jo vetëm në funksionimin e kësaj strukture por edhe në eliminimin e konfliktit që ekziston nga kryerja e funksionit të anëtarit nga drejtuesit e lartë të kësaj Ministrie. Afati: Menjëherë

Rekomandimi nuk është pranuar *shoqëruar me komentin e menaxhimit si vijon: "Mënyra e organizimit të Bordit KBFP është përcaktuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 28. Në zbatim të ligjit për MFK, u hartua dhe miratua Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 68, datë 08.06.2016 "Për krijimin e Bordit të KBFP". Në gjykimin tonë përbërja e Bordit të KBFP me anëtarë nga MFE dhe anëtarë me përvojë në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, kontabilitetin, dhe në fushën e auditimit të brendshëm është e nevojshme për arsye se ky përfaqësim është gjithëpërfshirës në implementimin dhe mbarëvajtjen e sistemit të KBFP. Anëtarët e MFE disponojnë informacionin e nevojshëm mbi kontrollin e brendshëm si dhe adresojnë problematikat e ndryshme me të cilat përballen institucionet gjatë implementimit të këtij sistemi...".*

Opinioni i grupit të auditimit: Në argumentin e tij për mospranim të rekomandimit të KLSH-së, menaxhimi vijon me përshkrimin e aktivitetit të Bordit KBFP përgjatë vitit 2017. Aktiviteti i këtij Bordi është trajtuar si një pikë e veçantë në auditimin e vitit 2017, ku edhe jemi shprehur mbi përputhshmërinë, efektivitetin e këtij aktiviteti i cili konsiston në vetëm dy mbledhje, njëra nga të cilat ka qënë objekt i auditimit të mëparshëm. Kryerja e aktivitetit si detyrim i Ligjit nuk është një argument relevant për mospranimin e rekomandimit në lidhje me efektivitetin e këtij aktiviteti dhe konfliktin e mundshëm të interesit apo funksionit të anëtarëve të këtij Bordi për të siguruar pavarësinë dhe objektivitetin e vendimeve të tij.

Disa anëtarë të Bordit të KBFP me funksione specialist apo drejtues në DH kryejnë funksione në zbatim të ligjit 10296 dhe 114/2015 ndërkohë marrin pjesë dhe vlerësojnë këto aktivitete apo raporte për të cilat ata vetë janë përgjegjës për hartimin e tyre. Kështu punonjësit e DH i gjejmë si: trajnues të kontraktuar nga ASPA; hartues tezash; korrigjues provimesh; anëtar komisioni çertifikimi; anëtar Bordi Mbikëqyrës KBFP apo anëtar Bordi Mbikëqyrjes Publike. Pavarësisht

[29]Aneksi23 :Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të pa plotësuara= Pozicione vakante të audituesve të brendshëm/ numrin total të audituesve të miratuar në strukturën e njësisë publike (%)

aktivitetit, struktura e këtij Bordi nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017 dhe deri në momentin e përfundimit të këtij auditimi dhe në gjykimin tonë **DH/KBFP mbetet në mosveprim të qartësimit dhe shmangies së konfliktit që ekziston nga kryerja e funksionit të anëtarit nga roli i tij si mbikëqyrës.**

2.3 DH/MFK, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për monitorimet në vend të institucioneve publike bazuar në pyetsorët e vetëvlerësimit, të dokumentojë procedurat e ndjekura dhe problematikat e hasura për çdo njësi të monitoruar. Monitorimet të realizohen në institucione të cilat vlerësohen me një nivel risku të lartë apo të moderuar, duke larguar nga praktikat formale të realizimit të këtyre procedurave. Afati: Në vijimësi
Rekomandimi nuk është pranuar shoqëruar me komentin e menaxhimit në dokumentin ‘ *Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së “ date 01.05.2018, si vijon “DH/MFK, dokumenton të gjithë procesin e realizimit të monitorimeve në terren ...*” si dhe “ *Institucionet për monitorim përzgjidhen në bazë të metodologjisë së vizitave në terren (të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.06 “Për miratimin e Manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”) ku formula është 50% e institucioneve që kanë performuar dobët, 25% e institucioneve që kanë një performancë mesatare dhe 25% e institucioneve që kanë një performancë të mirë. Pasi ndahen në këto tre kategori,nga secila kategori përzgjidhen ato njësi të cilat kanë një nivel risku më të lartë”.*
Opinioni i grupit të auditimit:
Në lidhje me procedurën e ndjekur për monitorimet e pyetësorëve të vetëvlerësimeve për vitin 2017, është konstatuar se janë dërguar shkresat për njoftim monitorimi në njësitë e zgjedhura për monitorim, megjithatë dosja e monitorimeve të kryera ka mungesa të theksuara në lidhje me dokumentat që do të reflektonin dhe evidentonin punën e kryer duke filluar që me procesin e planifikimit të këtyre monitorimeve mbi bazë vlerësimin e riskut deri në rezultatet e monitorimeve. Deri në përfundim të këtij auditimi. Kur raporti është dërguar për miratim te Ministri i Financave dhe Ekonomisë nuk janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit raportet e monitorimit, observacionet, takimet e kryera me njësitë si proces ballafaqimi apo diskutimi me justifikimin e ngarkesës së punës dhe prioritetit dhe se ato do të përpilohen pas mbarimit të Raportit vjetor. Raportet e monitorimeve janë pjesë e Raportit final por mbetet e pamundur, testimi i këtij informacioni për saktësinë, plotësinë dhe eficensën e monitorimeve të kryera si një aktivitet tepër i rëndësishëm i DH/MFK që do të jepte një siguri të arsyeshme mbi efektivitetin e sistemit të KBFP. Kjo pikë dhe problematikat e konstatura në auditimin e vitit 2017 është trajtuar gjerësisht dhe paraqitur te menaxhimi i DH me Akt konstatimin nr. dt .8.6.2018. **Në gjykimin tonë edhe në këtë pikë, pavarësish një rritje në numër të monitorimeve krahasuar me vitin 2016, procesi mbetet i mangët dhe nuk lë vend për vlerësim të përputhshmërisë së aktivitetit të kësaj Drejtorie në kuadër të përmbushjes së rolit të saj si monitorues i sistemit të MFK në zbatim Ligjit** nr. 10296, neni 26, pika 2.

2.4 Me qëllim që të sigurohet mirëfunksionimi i Komiteteve të Auditimit si organe këshilluese pranë titullarit, si një hallkë shtesë për rritjen e pavarësisë funksionale të strukturave të auditimit të brendshëm, të rishikohet VKM nr.160, dt.02.03.2016 " Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike" mbi të cilin ngrihen , funksionojnë dhe raportojnë Komitetet e Auditimit, duke adresuar me kujdes problematikat e konstatuara. Vëmendje të shtuar duhet të ketë deklarimi i konfliktit të interesit që cënon objektivitetin e këtyre strukturave. Afati: Mars 2018
Rekomandimi nuk është pranuar me argumentin se: “*DH/AB në hartimin e VKM nr. 160, datë 02.03.2016 " Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”, ka analizuar dhe përshtatur publikime të Institutit të*

Audituesve të Brendshëm (IIA) në Florida të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Duke qenë se vendimi ka reflektuar një nga praktikat me të mira të funksionimit të Komiteteve të Auditimit të Brendshem mendojme se ndryshimi i propozuar është i panevojshëm. Roli i auditimit të brendshëm është të japë këshilla dhe rekomandime për titullarin e njësisë publike dhe ky Komitet është në funksion të këtij misioni dhe në mbështetje tëpunës së njësisë së auditimit të brendshëm për të rritur pavaresinë e kësaj strukture. Duke qënë se krijimi i këtyre strukturave ishte në vitin e pare të funksionimit, mendojmë se akoma nuk mund të dalim me analiza tëmirefillta në lidhje me efektivitetin e funksionit të tyre"

Opinioni i grupit të auditimit:

Pavarësisht se rekomandimi nuk është pranuar nga ana e subjektit, problematika e ngritur është konstatuar dhe gjatë auditimit të vitit 2017. Në kuadër të Ligjit 114/2015 dhe VKM nr. 160 dt. 02.03.2013, konstatojmë se gjendja e Komiteteve të Auditimit, mënyra e raportimit të tyre apo monitorimi i aktivitetit mbetet e pambuluar apo trajtuar edhe gjatë periudhës 6 mujore pas auditimit të vitit 2016 dhe rekomandimit respektiv të KLSH. Kështu, konstatojmë se:

-Numri i Komiteteve të ngritura mbetet po 8-të ; Nuk ka ndonjë një udhëzim për detyrimin dhe mënyrën se si këto Komitete Auditimi duhet të raportojnë tek DH/AB,

-Nuk ka një analizë nga DH/AB, në vijim të rekomandimit të KLSH-së për përmirësime ligjore apo nënligjore për të rritur eficiensen e këtyre KAB-ve, nxitjen e ngritjes së tyre specifikisht në institucione qëndrore me shumë njësi varësie. Vetë Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ka jo funksional KAB e krijuar në 12.04.2016 dhe nuk raporton asnjë aktivitet të KAB-së në raportin e analizës vjetore për vitin 2017.

- Në kuadër të rolit të saj monitorues DH/AB, nuk ka kryer ndonjë monitorim apo analizë mbi cilësinë e punës së KAB ekzistuese, vlerën e tyre të shtuar nëse ka për të justifikuar vlerën për para të shpenzuar nga buxheti për këto struktura.

Gjithashtu sjellim në vëmendje pjesë nga pjesë nga raporti i auditimit për vitin 2016: "*Në Vendimin nr. 160 datë 2.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Njësitë Publike", përcaktohen ndër të tjera kompetencat dhe përbërja e këtyre organizmave. Gjykojmë se kriteret e strukturave që jo vetëm do të monitorojnë punën e njësive të auditimit për të garantuar pavarësinë por edhe cilësinë e rekomandimeve, rol këshillimor për dhënie të një garancie të arsyeshme Titullarëve të institucioneve publike, potencialisht nuk mund te garantojnë kapacitete ekspertizë në nivelin e nevojës për të.... Në rastet kur këto Komitete janë krijuar kemi përsëritje të ekspertëve të përfshirë në këto Komitete që reflekton potencialisht mungesën e kapaciteteve për të siguruar një mision të plotë në dhënien e garancive të arsyeshme lidhur me procesin. Nga analiza e emrave që qarkullojnë në këto struktura, konstatojmë edhe problematikën që një pjesë e tyre shfaqen në pozicionin e drejtuesit të njësisë së auditimit në institucionet e tyre dhe anëtarit të Komitetit të Auditimit në një institucion tjetër po të të njëjtit rang. Në kushte konflikti interesi gjykohet prezenca e titullarit të njësisë së Auditimit të Prokurorisë së Përgjithshme në Komitetin e Auditimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ujërave. Në këto kushte, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave duhet të analizojë objektivisht situatën e krijuar, dhe kërkojmë që të vendosë kërkesa dhe kritere specifike për të mënjanuar rastet e konfliktit të interesit, në fakt e në dukje por duke siguruar ruajtjen e niveleve të lartë të profesionalizmit të përfaqësuesve"*. Për shkak të ndryshimeve të ndodhura, shkrirja dhe riorganizimi i ministrive mund të ketë tejkaluar rastet e përmenduara, por kjo nuk do të thotë që struktura e DH/AB të mos ketë në fokus vlerësimin e konfliktit të interesit të personave që përshihen në këto struktura, dhe më e pakta që mund të bëjnë është të angazhojnë strukturat përgjegjëse për vlerësimin e konfliktit të interesit. **Në gjykimin tonë, DH/AB mbetet në mosveprim në lidhje me këtë rekomandim.**

2.5 Të përcaktohet një procedurë e brendshme që të sigurojë formalizmin e procesit të konsolidimit dhe miratimit të Planit Strategjik dhe Vjetor të sistemit të auditimit të

brendshëm në sektorin publik. Të kërkohet që procesi i hartimit të këtyre planeve, edhe në njësitë, të ketë për bazë një vlerësim risku të kujdesshëm dhe jo formal. Afati : Deri Mars 2018

Ky rekomandim **nuk është pranuar** me komentin e menaxhimit si vijon: "*Plani i konsoliduar strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së NJAB në sektorin publik është një material i bazuar mbi planet e miratuara të NJAB. Ky plan vlerësohet nga DH/AB si një dokument i rëndësishëm mbi të cilin analizohet veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik. Në hartimin e ligjit, i cili i është shpërndarë për mendim grupeve të interesit, është vlerësuar që ky dokument duhet të dërgohet për informacion te Ministri i Financave, si dhe autoriteti përgjegjës për bashkërendimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Bazuar në Kapitullin III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, është përcaktuar qartë që plani duhet të bazohet në një vlerësim sa më real të riskut të njësive publike"*

Gjatë auditimit për aktivitetin e vitit 2017, konstatojmë se procesi i konsolidimit të planeve strategjike dhe vjetore të sistemit të AB nuk ka ndryshuar. Planet hidhen manualisht dhe mbahen në formë elektronike në Excel. Specialistja përgjegjëse, për konsolidimin e planeve vjetore por dhe më pas e të gjithë evidencave në lidhje me realizimin e aktivitetit vjetor të AB ku ajo asiston rast pas rasti njësitë, sidomos ato të krijuara rishtaz për mënyrën se si përpilohen këto plane strategjike mbi bazë të vlerësimit të riskut. Nga raporti vjetor dhe analiza vjetore e drejtorisë konstatohet se vlerësimi i riskut mbetet një aktivitet problematik, i cekët dhe formal. Gjatë auditimit u shqyrtuan me zgjedhje rreth 90 plane strategjike dhe vjetore dhe në shumë prej tyre pjesa e risqeve të identifikuar ishte thjeshtë një perifrazim teorik i llojeve të risqeve i pakonkretizuar sipas natyrës dhe funksionit të njësisë. Në trajnimet e vijueshme shumë tema ndërtohen dhe paraqiten me fokus vlerësimin e risqeve dhe hartimin e regjistrit të riskut, rolit të koordinatorit të riskut etj ku specialistja është edhe trajnuese. **Gjykojmë se mbetet i nevojshme një rishikim i procesit të konsolidimit të planeve dhe i ndarjes së detyrave për të lënë kohë analizave dhe këshillimit e më pas monitorimit gjatë vitit për zbatimin e këtyre planeve dhe azhornimin dinamik të regjistrit të risqeve.**

2.6 Te rishikohen treguesit mbi të cilët monitorohet dhe raportohet aktiviteti i AB, duke vënë theksin dhe mbi tregues të cilët reflektojnë vlerën e shtuar të strukturave të auditimit të brendshëm. Të plotësohen treguesit lidhur me nivelet e rikuperimit të efekteve financiare në buxhet si dhe të harmonizohet dhe standardizohet praktika e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit të brendshëm në shkallë sistemi kjo do të rrisë ndërgjegjësimin dhe kulturën menaxheriale të drejtuesve në njësitë e sektorit publik. Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Ky rekomandim **nuk është pranuar** nga DH.AB. Gjatë punës audituese të aktivitetit të vitit 2016, evidenca dhe raporti i vënë në dispozicion u analizuan dhe testuan duke arritur në të njëjtin konkluzion me atë të grupit të auditimit të vitit të kaluar, se treguesit dhe indikatorët nuk janë përfaqësues i cilësisë së punës së auditit të brendshëm dhe vlerë e shtuar për menaxhimin dhe njësinë ku ata operojnë. Gjetjet, mangësitë në llogaritje, shpjegimet e anekseve të AB dhe vlerësimi i tyre me shkallë të lartë subjektivizmi, i janë paraqitur drejtimit të DH.AB në A.K nr. 4 dhe çështja e zbatimit të rekomandimeve është trajtuar më lart në pikën 1.1.

2.7 Përcaktimin e qartë të përgjegjësive mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse të Komisioni i Kualifikimit të AB në procesin e zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm si lidhur me Trajnimin e Vijueshëm të detyrueshëm dhe Certifikimin e Audituesve të Brendshëm në Sektorin publik, përgjegjësi që duhet të jenë të ndara nga detyrat ekzekutive dhe administrative të Drejtorisë së Harmonizimit të AB në MFE. Afati : Në vijimësi

Ky rekomandim **nuk është pranuar** me argumentin e menaxhimit si vijon: "*KKAB dhe DH/AB kanë të përcaktuar qartë në aktet ligjore në fuqi rolet dhe përgjegjësitë lidhur me procesin e*

çertifikimit si dhe trajnimit të vijueshëm. Me konkretisht, bazuar në gërmën c) dhe Ç) të pikës 14 të VKM nr.116, datë 17.02.2016 Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e KKAB ne sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit", Komisioni realizon të gjitha detyrat dhe merr vendime për procesin e çertifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në përputhje me rregulloret përkatëse të miratuara nga Ministri i Financave. Përkatësisht në nenin 6 të Rregullores për proçedurat e çertifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik", miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 37, dt. 16.3.2016, të ndryshuar dhe ne nenin 7 të "Rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve në sektorin publik" miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr .3, date 08.01.2016, janë specifikuar përgjegjësitë e KKAB"

Opinioni i grupit të auditimit

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e aktivitetit të KKAB, nuk u konstatua ndryshime në procedura apo rregullore. KKAB, përveç përcaktimeve në Ligjin 114/2015, ka funksionuar dhe ushtruar kompetencat mbështetur në: VKM nr. 116, datë 17.02.2016 "Mbi organizimin, funksionimin dhe përbërjen e KKAB dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit", Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 3, datë 01.2016, " Për miratimin e Rregullores së TVD për audituesit e brendshëm" dhe Urdhrit Nr. 37, datë 16.03.2016 " Për miratimin e procedurave për certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik" ndryshuar me Urdhër nr.26 datë 21.03.2017 si dhe Urdhër nr.136 datë 30/12/2016 për "Miratimin e pragramit te trajnimit të vijueshëm te detyrueshëm për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2017". Mbështetur në përcaktimet e akteve të mësipërme, KKAB parashikohet të kryejë funksion mbikëqyrës të procesit të trajnimit dhe çertifikimit të audituesve dhe bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për auditimin e brendshëm në MFE. Specialistët e DH/AB janë të gjithë të përfshirë në procesin e certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm e më pas të hartimit të relacioneve të vlerësimit të procesit, cilësisë së trajnerëve dhe më pas konsolidojnë raportimeve vjetore dhe bëjnë vlerësimin me pikë të njësive AB që ata vetë kanë trajnuar e certifikuar.

Gjatë periudhës së auditimit, në mbarim të mandatit 2 vjeçar të KKAB është miratuar struktura e re.

2.8 DH/AB të rishikojë dhe të përditësojë Regjistrin e Audituesve të Brendshëm të Certifikuar dhe të trajnuar me qëllim që ky dokument të përmbajë informacion të dobishëm dhe të nevojshëm që të pasqyroje situatën e zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm në kohë, por njëkohësisht të shërbeje si dokument dhe bazë të dhënash për të siguruar analiza të zhvillimit për të ardhmen. Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.

Ky rekomandim **nuk është pranuar** me argumentin e menaxhimit si vijon: "*Në pikën 2 të Nenit 15 të Rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdher te Ministrit te Financave nr. 3 dt. 08.01.2016, përcaktohet se në Regjistrin e AB-ve përfshihen të gjithë audituesit në detyrë dhe audituesit e brendshëm që nuk ushtrojnë profesonin por kanë ndjekur programin e TVP dhe të gjitha vendimet e KKAB për njohjen e trajnimeve ose publikimeve. Bazuar në këtë përcaktim të Regjistrit Kombëtar i Audituesve të Brendshëm të certifikuar nuk mund të ndërthuret me këtë regjistër. Në lidhje me të dhëna të hollësishme mbi audituesit e brendshëm në sektorin publik, theksojmë që megjithëse DH/AB i posedon nuk mund ti publikojë***.**

Opinion i grupit të auditimit.

Ligji përcakton detyrimin e DH/AB për të hartuar dhe përditësuar Regjistrin e Audituesve të Brendshëm të Certifikuar. Regjistri i audituesve të brendshëm të trajnuar është publikuar në faqen zyrtare të internetit ëëë.financa.gov.al . Konstatojmë së forma dhe përmbajtja e Regjistrit të Audituesve të Brendshëm konstatojmë që përmban informacion të limituar. Regjistri duhet të integrohet me Regjistrin e Audituesve të Brendshëm të Certifikuar për periudhën dhe të përmbajë informacion progresiv dhe elementë të sigurtë identifikues të AB të certifikuar. Ky

regjistër duhet të integrohet me regjistrin e trajnimit të vijueshëm për të ndjekur rastet që nuk janë në përmbushje të detyrimit të TVP. Regjistri është dokument zyrtar, dhe si i tillë duhet të protokollohet në fund të çdo viti në zyrën e protokollit të Ministrisë së Financave, krahas publikimit në faqen zyrtare të internetit në rubrikën përkatëse të Ministrisë së Financave. Përsa më sipër gjykojmë se Regjistri duhet rishikuar dhe të ndërtohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin II të Ligjit për Auditin e Brendshëm dhe Aktivitete të tjera rregulluese nënligjore ku detyrimisht të evidentohen të dhëna për: niveli i shkollimit, vitet e punës në total dhe ato në njësi AB; të dhëna personale (përfshirë NID); informacion në rast se ka c'rregjistrim nga regjistri kombëtar etj. Ky regjistër në përfundim të çdo sezoni çertifikimi duhet plotësuar dhe depozituar në zyrën e arkivës të Institucionit.

2.9 Në vijim të problematikës së evidentuar nga auditimi, Ministria e Financave dhe Ekonomise të rishqyrtoje zbatimin e VKM nr. 786, date 09.11.2016 " Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anetarëve, si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike", duke vlerësuar pozicionin e çdo anëtari në këtë bord. Afati: Menjëherë

*Ky rekomandim **nuk është pranuar** me argumentin e menaxhimit si vijon: "Për sa i përket këtij rekomandimi, nuk është kompetencë e DHKBFP, zbatimi dhe monitorimi i VKM nr. 789, dt. 9.11.2016, si dhe vlerësimi i përbërjes së këtij bordi, i cili është përzgjedhur sipas rregullave në fuqi. Ndërkohë, në gjykimin tone procedura e përzgjedhjes është bërë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në këtë VKM, dhe mbështetur në urdhrin nr.115, dt. 01.12.2016 "Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtareve të BMP dhe për ngritjen e komisionit ad-hoc"*

2.10 Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa, duke iu drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me qëllim verifikimin e konfliktit të mundshëm të interesit për anëtarët e Komiteteve të Auditimit, Bordit te Menaxhimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publik. Në rast se nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk do të konstatohet veprim lidhur me këtë rekomandim brenda afatit 20 ditor, kur duhet të prezantojë planin e veprimit për sa është rekomanduar, KLSH të adresojë pranë ILDKPKI kërkesën për verifikimin e konfliktit të interesit në rastet e specifikuara me lart. Afati : Menjëherë

Ky rekomandim **është pranuar pjesërisht** me argumentin e menaxhimit: "*Në strukturat e përmëndura, nga ana jonë nuk është konstatuar asnjë konflikt interesi. Në këtë raport nuk është paraqitur asnjë rast konkret i konfliktit të interesit por vetëm një gjykim i përgjithshëm. Përbërja dhe përzgjedhja e këtyre organeve është përcaktuar më së miri në aktet ligjore në fuqi. Vlen të përmendet, që një pjesë e mirë e këtyre akteve ligjore janë dërguar për mendim prane KLSH, në momentin e hartimit te tyre, duke marrë në konsideratë sugjerimet e përshtatshme. Gjithsesi, MFE do bashkëpunoje ne vazhdimësi me ILDKP për të verifikuar rastet e mundshme të konfliktit te interesit".*

Opinion i grupit të auditimit

Shpjegojmë se është e pa konceptueshme që strukturat që merren me garantimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, pjesë e të cilave është edhe zbatimi i rregullave të etikës dhe parandalimi i konfliktit të interesit nuk kanë arritur të lexojnë cfarë kemi cilësuar në raportin e auditimit për vitin 2016. Konflikti i interesit është një koncept i gjerë që lidhet si me konfliktin në funksione dhe përgjegjësi edhe konfliktin e mirëfilltë të personave në anagazhimin në strukturat e cilësuara në rekomandimin e KLSH. Duhet të theksojmë se përzgjedhja e personave dhe formaliteti i procedurave të konstatuara nuk lidhen me kërkesat ligjore por me papërgjegjshmëritë e personave që kanë patur detyrën dhe funksionin për të vepruar në

përputhje me kërkesat që ka vendosur ligji. Për të qënë më specifik po sjellim përsëri në vëmendje pjesët respektive të trajtuara në Raportin e auditimit për vitin 2016, me shpresën se strukturat do dijnë të lexojnë konfliktet funksionale që cënojnë sistemet e kontrolleve të brendshme por edhe konfliktet e interesit për persona të caktuar për të cilët përfshirja në strukturat respektive lidhen me marrëdhënie të ndërsjellat interesash akademike dhe familjare.

Pjesë nga Raporti i Auditimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar, 2016*: "Bordi i Menaxhimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (BMKBFP), krijuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 82, datë 02.10.2014, nuk ka funksionuar asnjëherë gjatë periudhës që ishte në fuqi. Me Urdhrin nr. 68 datë 08.06.2016 "Për krijimin e Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" është shfuqizuar Urdhri nr. 82, datë 02.10.2014, dhe është përcaktuar përbërja e bordit që kryesohet nga Ministri i Financave dhe përbëhet nga anëtaret si vijon: znj. G. P, nëpunësi i parë autorizues; znj. K. H, Drejtor i Përgjithshëm i DHKBFP, znj. M. Dh, Drejtor i Përgjithshëm i Buxhetit; z. L. S, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit; znj. E. L, eksperte; Z. J. N, ekspert; Z. E. B, ekspert. Gjykojmë se <u>një formatim i tillë i bordit me pjesëmarrje të gjerë të nëpunësve që kanë detyrim dhe obligim të funksioneve të tyre mbikëqyrjen por edhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, i japin karakteristikat e një bordi formal që nuk arrin të prodhojë një oponencë të nevojshme për të sjellë rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale por edhe të reflektojnë aspektet kryesore për ndërhyrje.</u> Në gjykimin tonë ka nevojë që të vlerësohet edhe konflikti i interesit i personave të emëruar në këtë bord, në mënyrë që kjo përbërje të garantojë realizmin e objektivit dhe misionit që ka kjo strukturë".*

Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFK, në cilësinë e Sekretariatit të Bordit të KBFP, paraqet pranë këtij bordi problematikat e ndryshme të njësive publike, ndërkohë që drejtori i strukturës që përbën sekretariatin dhe përgatit Raportin vjetor për sistemet është pjesëmarrës në bord me të drejtë vote. Nënpunësi i parë autorizues është nënpunësi ku raportojnë të gjitha njësitë publike lidhur me nivelin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimin financiar, ndërkohë që miraton raportin për të cilin ka përgjegjësi direkte për mirëfunksionimin e sistemeve. Ndërkohë pjesë të funksionimit të sistemeve janë edhe drejtori i thesarit dhe drejtori i buxhetit të cilët japin siguri për sistemet për të cilat menaxhojnë dhe duhet të japin llogari. Në Bord të KBFP ekziston konflikti i interesit për shkak të lidhjes familjare (një anëtar është motra e zv. Ministrit të Financave) por dhe lidhjeve të pune apo akademike të tilla që mund të cënojnë objektivitetin dhe paanshmërinë në vendime (një anëtar është edhe udhëheqëse e doktoraturës së drejtores se Drejtorisë së Harmonizimit).

"*Bazuar në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, neni 3* ***Mbikëqyrja publike***[30] *dhe VKM nr. 786, datë 09.11.2016 "Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Rastet e Shkarkimit të Anëtarëve, si dhe Rregullat e Organizimit e të Funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike" rezulton se Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave, me një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë dhe se përzgjedhja e Kryetarit dhe 3 anëtareve te tij kryhet nga një komision ad-hoc i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave, i cili ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe të hartojë listën*

[30] *Neni 3 Mbikëqyrja publike* 1. Mbikëqyrja e profesionit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese realizohet nga bordi i mbikëqyrjes publike, si drejtpërdrejt, duke mbikëqyrur të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, ashtu edhe përmes mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë. 2. Qëllimi i sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese është të rrisë sigurinë, që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik. *Neni 6 Raportimi* 1. Bordi i dërgon Ministrit të Financave, një herë në vit, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, një raport me shkrim, në të cilin bëhet një përmbledhje e jepen detaje për problemet e hasura nga audituesit ligjorë, masat e marra dhe zgjidhjet e dhëna. 2. Raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore. Me Urdhrin nr. 115, datë 01.12.2016 "Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe për ngritjen e Komisionit Ad Hoc". Anëtarët e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve të emëruar në urdhrin e mësipërm kanë qenë:

a) Zj.K. H, Drejtor i Përgjithshëm i Harmonizimit të KBFP;

b) Z. B. L, Drejtor i Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm;

c) Zj.V.J, Drejtor i Menaxhimit të Reformave në Fushën e MFK.

Në memon e datës 26.01.2017, "Mbi miratimin e Kandatëve për anëtarë të Bordit të Mbikëqyrjes Publike", përgatitur nga Komisioni Ad hoc është hartuar lista e kandidatëve nga institucionet publike dhe nga institucionet e arsimit të lartë me vlerësimin përkatës sipas kritereve të vendosura nga urdhri nr. 115 sipër cituar. Kandidatët e paraqitur janë nga institucionet publike:

1. ***D. F*** *(Drejtor i DH/MFK); 2.* ***A. B*** *3.* ***D. A***

Nga institucionet e arsimit të lartë:

1. ***E.L*** *(anëtare e Bordit të KBFP); 2.* ***A. B****; 3.* ***L.L****; 4.* ***I. Sh***

Komisioni ka hartuar listën e kandidatëve duke sugjeruar 4 prej tyre si anëtarë bordi. Në pikën 6 të urdhrit nr. 115, përzgjedhja e kandidatëve do bëhet në bazë të dokumentacionit të paraqitur pranë Ministrisë së Financave të vlerësuar nga Komisioni ad-hoc si më poshtë:a) Arsimi 35 pikë

b) Përvoja profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor 35 pikë; c) Kualifikime në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor 30 pikë. Komisioni ad hoc shqyrtoi 7 kandidatët e kualifikuar për shqyrtim duke i vlerësuar si vijon:

Nr.	***Kandidatët***	***Arsimi (35 pikë)***	***Përvoja profesionale në fushën e kontabilitetit ligjor(30pikë)***	***Kualifikime në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor(30pikë)***	***Totali***	***Komente***	***Përllogaritja e pa saktë***
1	***D.F***	*25*	*30*	***35***	***90***		***Kualifikime në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor***
2	***A.B***	*20*	*25*	***35***	***80***		***Kualifikime në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor***
3	***L.A***	*25*	*25*	*20*	*70*		
4	***E.L***	*30*	*25*	*30*	*85*		
5	***A. B***	*25*	*15*	*10*	*50*	*- Mungon përvoja e mjaftueshme në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor* *- Mungon kualifikimi i duhur në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor*	
6	***L. L***	*35*	*25*	*20*	*80*	*- Mungon kualifikimi i duhur në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor*	
7	***I. Sh***	*35*	*25*	*20*	*80*	*- Mungon kualifikimi i duhur në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor*	

Me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 27, datë 24.03.2017 "Për emërimin dhe mandatimin e Kryetarit dhe Anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike" është emëruar Kryetar Bordi, z. D. F dhe anëtarë si vijon:

1. zj. A. B, propozuar nga Ministri i Financave

2. z. L. A, propozuar nga Ministri i Financave,

3. Zj. E. L, propozuar nga Ministri i Financave, përzgjedhur nga institucionet e arsimit të lartë, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës,
4. z. K. M, propozuar nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, pranë Kuvendit të Shqipërisë, me shkresë nr. prot. 385/1, datë 02.03.2017. "Dërgohet Vendimi i Komisionit për Ekonominë dhe Financat për anëtar të Bordit të Mbikëqyrjes Publike". Nga auditimi është konstatuar përllogaritje e pasaktë me impakt në totalin e pikëve për kriterin "Kualifikime në fushën e kontabilitetit dhe auditimit ligjor" i cili sipas urdhrit nr. 115 duhej vlerësuar maksimalisht me 30 pikë, por që ndërkohë për kandidatët, z. D. F dhe zj. A. B, është vlerësuar me 35 pikë."
Për sa cituar më sipër, në raport është paraqitur shumë qartë dhe e bën lehtësisht të lexueshme faktin që jemi në kushtet e konfliktit të interesit për sa kohë që vlerësimi është bërë nga struktura të lidhura pra drejtor/vartës apo kolegë pavarësisht kërkesave dhe kritereve të vendosura nga Ministri i Financave për garantimin e cilësisë së këtij procesi. Rrjedhimisht dhe dukshëm e reflektuar kjo dhe në vlerësimin që është bërë jo në përputhje me nivelet e kërkuara për një Bord që do të garantonte mirëfunksionimin e profesioneve në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Nga ana tjetër ngarkimi i drejtorit të DH/MFK i cili përgjigjet për monitorimin e funksionimit të menaxhimit financiar, kontrollit, kontabilitetit dhe raportimit financiar me detyrën e kryetarit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike janë në kushtet e konfliktit të funksionit përtej faktit nëse ka konflikt interesi në këtë rast. Në gjykimin tonë, argumenti për mospranimin e plotë të rekomandimit nuk qëndron dhe **Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar është përgjegjëse për mos veprim për të eliminuar minimalisht konfliktin e interesit të konstatuar nga auditimi**.

Aneksi nr. 2 : Aktiviteti i auditit të brendshëm, procesi i certifikimit dhe Komitetet e Auditimit

B. Mbi strukturën e Auditimit të Brendshëm dhe funksionimin e strukturave të tij në zbatim të Ligjit 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"
Shërbimi i auditimit të brendshëm është organizuar dhe funksionon nëpërmjet njësive të auditimit të brendshëm
Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm e kryen veprimtarinë e vet bazuar në Ligjin nr. 114/2015 i cili i vendos strukturat e Auditimit të Brendshëm në varësi të drejtpërdrejtë të titullarit të njësisë publike.
Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik mbështetet në një kuadër ligjor, i cili është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuara. Bazë e këtij kuadri rregullator janë:

- Ligji nr 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",
- Manuali i Auditimit të Brendshëm,
- Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm si dhe
- Aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.

Kjo veprimtari realizohet nëpërmjet zbatimit të Planeve Strategjike dhe Vjetore, të miratuara nga Titullarët përkatës të njësive publike,për një periudhë tre vjeçare (1+2 vjet) ku përcaktohen prioritetet e menaxhimit, objektivat, fushat me risk të lartë që rrezikojnë realizimin e objektivave, treguesit e matjes së performancës, në përputhje me burimet në dispozicion.
Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar (DPHKBF), në muajin dhjetor 2016, ka përgatitur planin e konsoliduar strategjik dhe vjetor 2017 - 2019, të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.
Analiza e veprimtarisë së auditimit të brendshëm është kryer nga konsolidimi i të dhënave të raporteve vjetore të 115 njësive të auditimit të brendshëm (NJAB) nga 119 NJAB që funksionojnë në sektorin publik. Për vitin 2017, nuk kanë raportuar NJAB e ngritura në

Qendrën Spitalore Elbasan, Qendrën Spitalore Korçë, Qendrën Spitalore Fier dhe Universitetin e Tiranës.
Në këto raporte janë analizuar rezultatet e veprimtarisë të auditimit të brendshëm, kufizimet me të cilat janë përballur audituesit dhe prioritetet për të ardhmen, bazuar në mënyrën standarde të raportimit të përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.
Planet e miratuara nga NJAB janë përgatitur bazuar në përcaktimet e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".
Gjatë konsolidimit të këtyre planeve është vënë re se 9 NJAB nuk i janë përmbajtur kërkesave më minimale në hartimin e këtij materiali, kërkesa këto të përcaktuara në bazën rregullatore të sipërcituar. NJAB, të cilat nuk kanë paraqitur relacion shpjegues për evidencat janë NJAB-të në: Bashkinë Dibër, Bashkinë Mat, Bashkinë Krujë, Bashkinë Librazhd, Bashkinë Maliq, Bashkinë Kukës, Bashkinë Tropojë, Bashkinë Prrenjas dhe Bashkinë Fushë-Arrëz.
Ligji përcakton Ministrin e Financave përgjegjës për: a) bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësitë e sektorit publik, të përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji; b) përcaktimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm dhe komiteteve të auditimit në sektorin publik, duke i propozuar Këshillit të Ministrave nxjerrjen e aktit nënligjor për këtë qëllim; c) miratimin e politikave, manualeve, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditimit të brendshëm për përshtatjen dhe përafrimin e tyre me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të auditimit të brendshëm; ç) emërimin dhe lirimin nga detyra të anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, sipas të nenit 21 të këtij ligji; d) paraqitjen në Këshillin e Ministrave, brenda muajit maj të çdo viti, të raportit vjetor për auditimin e brendshëm, si pjesë e raportit vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik. Për të ushtruar këto përgjegjësi, Ministri i Financave mbështetet nga Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave. Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, funksionon në bazë të Ligji nr. 114/2015 "*Për Auditimin e brendshëm në Sektorin Publik*", miratuar më 22.10.2015.

Funksionet dhe roli i DH/AB përcaktohen në nenin 24 të Ligjit 114/2015, dhe në mënyrë më të detajuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Urdhra dhe Udhëzime të Ministrit të Financave të nxjerra në kuadrin e gjithë sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Shqipëri.
DH/AB në mënyrë më specifike ka këto detyra:
1. Zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizuar në fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar;
2. Harton dhe propozon përmirësimin e legjislacionit kryesor dhe mbështetës për auditimin e brendshëm në sektorin publik;
3. Harton dhe propozon politikat, manualet, procedurat, udhëzimet dhe rregulloret për auditimin e brendshëm për përshtatjen dhe përafrimin e tyre me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të auditimit të brendshëm;
4. Përgatit dhe administron planin e konsoliduar strategjik e vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësitë publike;
5. Paraqet, brenda muajit maj të çdo viti, te Ministri i Financave raportin për funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, pjesë e raportit vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik;
6. Harton dhe zbaton manualin për vlerësimin e cilësisë, e cila përfshin procesin e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të auditimit të brendshëm;
7. Administron metodat e hartuara, në mbështetje të manualit të auditimit, për fusha specifike të auditimit të brendshëm, të paraqitura nga njësitë e auditimit të brendshëm;

8. Analizon rekomandimet e dhëna në raportet vjetore të njësive të auditimit të brendshëm;
9. Harton,zhvillon dhe administron politikat kombëtare për certifikimin e audituesve të brendshëm , si dhe trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm, në bazë të praktikave bashkëkohore në fushën e auditimit të brendshëm;
10. Harton dhe përditëson Regjistrin Kombëtar të audituesve të brendshëm të certifikuar.

1. Zhvillimi, ndryshimet dhe përditësimi i kuadrit që rregullon veprimtarinë e Auditit të Brendshëm në sektorin publik në Shqipëri.

1.1 Komitetet e Auditimit

Ligji nr. 114/2015, date 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", përcakton në *nenin 7, **parimet e përgjithshme*** të funksionimit të auditimit të brendshëm dhe përkatësisht "*ç) pavarësisë dhe objektivitetit, i cili nënkupton pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë audituese dhe dhënien e mendimeve e të gjykimeve objektive gjatë kryerjes së auditimit.*"
Në nenin 13 "Komiteti i Auditimit të Brendshëm" përkufizohet si: *.... organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm ....* Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.
Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, por në nenin 12 përcaktohet se ..*Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për b) vendimmarrjen e krijimit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësinë publike përkatëse"*, cka do të thotë që ngritja e këtyre strukturave është lenë e hapur në gjykim të titullarëve.
Komiteti i Auditimit është organ që krijohet për të siguruar pavarësi shtesë për auditimin e brendshëm dhe ndihmesë për të dhe si i tillë duhet të ketë të siguruar pavarësinë e tij si organ këshillimor.
Bazuar në VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "*Për mënyrën e funksionimet kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike*", *në pikën 4, është përcaktuar se: "Anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm emërohen me urdhër të titullarit të njësisë publike, si ..."*, pra emërimi lihet në ***diskrecion të Titullarit të Institucionit,*** pa ndonjë procedurë të mirë përcaktuar mbi vlerësimin e profesionalizmit dhe kapaciteteve që do përfshihen në këto Komitete duke prekur konceptin e pavarësisë së plotë, të synuar nga ligjvënësi. Deri dhjetor të vitit 2017 në njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë krijuar dhe funksionojnë 8 Komitete Auditimi në Institucionet e mëposhtme:

	Ministria/Institucioni	***Urdhër krijimi***	***Data e krijimit***	***Raportuar***
1	*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*	*Nr. 47*	*12.04.2016*	
2	*Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ujrave*	*Nr. 9*	*18.01.2017*	*x*
3	*Ministria e Punëve të Jashtme*	*Nr. 393*	*15.09.2016*	*x*
4	*Ministria e Drejtësisë*	*Nr. 2239/2*	*06.04.2016*	*x*
5	*Ministria e Energjisë dhe Industrisë*	*Nr. 180*	*01.06.2016*	
6	*Ministria e Mbrojtjes*	*Nr. 882*	*09.05.2016*	*x*
7	*Instituti i Statistikave*	*Nr. 1118*	*23.09.2016*	
8	*Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*	*Nr. 107*	*23.05.2016*	*x*

Shumë titullarë institucionesh nuk e kanë gjykuar të nevojshme ngritjen e Komiteteve të Auditimit, pavarësisht numrit të konsiderueshëm të njësive të varësisë dhe detyrimit ligjor për sigurimin e shërbimit të AB dhe ngritjen e komiteteve të AB, sikundër janë rastet e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Arsimit apo Ministrisë së Brendshme, të cilat kanë në varësi të tyre shumë njësi publike pjesë e sistemit buxhetor.

Nga sa më sipër konstatohet se krijimi i këtyre komiteteve ka mbetur fakultativ dhe në gjykimin e titullarëve të njësive publike. Megjithatë DH/AB me shkresën nr. 2944, datë 13.02.2018 ka kërkuar nga njësitë publike informacion për veprimtarinë e Komiteteve të AB të cilit i janë përgjigjur vetëm 5 prej tyre. Nuk kanë paraqitur informacion Komitetet e Auditimit të Ministrisë së Financave, (i cili nuk ka funksionuar gjatë vitit 2017), të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Institutit të Statistikës. Për këtë çështje DH/AB ka mbajtur dhe vazhdon të mbajë një qëndrim pasiv duke argumentuar se ngritja e këtyre strukturave dhe sigurimi i informacionit mbi funksionimin e tyre nuk është detyrë e saj dhe nuk mund tu imponohet, ashtu sikundër as të kërkoj informacion nëse ka institucione që i kanë ngritur dhe nuk kanë raportuar pranë tyre apo jo. Këto pretendime bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 të LAB "*Përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB*", ku përcaktohen funksionet e kësaj strukture e përkatësisht: "*a)zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizimit në fushën e auditimit të brendshëm publik, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar*". Në përmbushje të këtij funksioni, DH/AB për të zbatuar strategjinë e harmonizimit në fushën e AB dhe për të bërë monitorimin e kësaj veprimtarie në nivel kombëtar, duhet të grumbullojë të gjitha informacionet e nevojshme për veprimtarinë e AB për vitin raportues, përfshirë edhe atë për veprimtarinë e Komiteteve të Auditimit dhe ta bëjë pjesë të Raportit mbi veprimtarinë e AB.

Krijimi i Komiteteve të Auditimit bazohet në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", ndërsa mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e tyre bazohet në VKM nr. 160, datë 02.03.2016.
Në nenin 13 të këtij ligji është përcaktuar se ky komitet është organ i pavarur, monitorues e këshillues për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për NJAB; duke siguruar pavarësinë e AB; duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor; duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit; duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit; duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit. Këto komitete e shtrijnë autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.
Në pikën 2, të këtij neni është përcaktuar se: "*Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë*" dhe në pikën 3 është përcaktuar se: "*Mënyra e funksionimit,kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të KM, me propozim të Ministrit të Financave*".
Në zbatim të kësaj pike (të nenit 13), Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komiteteve të Auditit të Brendshëm një njësitë publike*", ku janë përcaktuar roli dhe autoriteti i Komitetit të AB, përbërja dhe funksionimi, si dhe kompetencat dhe raportimi.
Në Kreun II-të "*Përbërja dhe funksionimi i KAB*", të këtij vendimi, pika 2, është përcaktuar se, "*Njësitë publike, të cilat kanë varësi funksionale nga një organ epror dhe kanë në strukturën e tyre NJAB nuk krijojnë komitete, por mbikëqyren nga komiteti i organit epror*".

Nga sa më sipër konstatohet se, as në ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 dhe as në VKM nr. 160, datë 02.03.2016, që trajtuam më sipër, nuk janë përcaktuar kritere të qarta dhe të matshme për krijimin e Komiteteve të Auditimit, e për rrjedhojë megjithëse kanë kaluar mbi tre vite nga miratimi i ligjit të ri për Auditimin e Brendshëm, janë krijuar vetëm 8 Komitete Auditimi, nga të cilat vetëm 5 prej tyre kanë raportuar në DH/AB. Gjykojmë se është e nevojshme të përcaktohen me dispozitë ligjore kriteret që duhet të plotësojnë njësitë publike për të krijuar Komitet Auditimi, afatet për krijimin e tyre dhe marrëdhëniet që duhet të kenë me DH/AB në Ministrinë e Financave.

Në VKM 160, datë 02.03.2016 "*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komiteteve të Auditit të Brendshëm një njësitë publike*", janë përcaktuar roli dhe autoriteti i komitetit të AB, përbërja dhe funksionimi, si dhe kompetencat dhe raportimi.
Në pikën 3, të kreut të III-të këtij Vendimi, ku janë përcaktuar kompetencat dhe raportimi i Komitetit të Auditimit është përcaktuar se: "*Komiteti i Auditimit të Brendshëm duhet të përgatisë, në fund të çdo viti, një raport përmbledhës për titullarin e njësisë publike, për veprimtarinë vjetore të komitet*it.", por në asnjërën nga dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij komiteti, nuk cilësohet detyrimi i tyre për të raportuar në DH/AB në Ministrinë e Financave.
Për sa më sipër gjykojmë se duhet bërë një përmirësim ligjor për mënyrën e raportimit të komiteteve të auditimit të brendshëm, me qëllim që raportimi i këtyre strukturave të mos mbetet vetëm pronë e njësisë publike por të përgjithësohet nga DH/AB në shkallë sistemi duke evidentuar dhe përgjithësuar problematikat e trajtuara prej tyre lidhur me konstatimet që kanë të bëjnë me pavarësinë e AB, me planet strategjike e vjetore dhe për rrjedhojë në pikën 3 të Kreut III të VKM 160 datë 02.03.2016, në fund të fjalisë "*.... KAB duhet të përgatitë, në fund të çdo viti, një raport përmbledhës për titullarin e njësisë publike, për veprimtarinë vjetore të komitetit…",* të shtohet një fjali me këtë përmbajtje: "***Një kopje e këtij raporti përmbledhës ti dërgohet DH/AB, brenda muajt shkurt të vitit pasardhës***"

Përsa i përket përbërjes së Komiteteve të Auditimit, në Vendimin nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Njësitë Publike", përcaktohen ndër të tjera kompetencat dhe përbërja e këtyre organizmave. Kështu në pikën 4 të Kreut II *"Përbërja dhe funksionimi i Komiteteve të Auditimit të Brendshëm" janë përcaktuar Anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm emërohen me urdhër të titullarit të njësisë publike si më poshtë:*

a) Një ekspert në fushën e auditimit të brendshëm
b) Një ekspert në fushën e legjislacionit
c) Një ekspert nga fusha e menaxhimit financiar dhe kontrollit
Të cilët sipas përcaktimeve të pikës 5 duhet të plotësojnë
   a) Të jetë shtetas shqiptar
   b) Të ketë integritet moral dhe profesional
   c) Të mos jetë i dënuar penalisht
   d) Të zotërojë të paktën një diplomë Master i shkencave ose Master i arteve, apo të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 10 vjet përvojë pune në fushën përkatëse, ose një gradë apo titull shkencor dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse

Nga analiza e emrave që qarkullojnë në këto struktura, konstatojmë problematikë që një pjesë e tyre shfaqen si anëtar në më shumë se një Komitet , si psh tek KA i Ministrisë së Financave dhe në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë si dhe në Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Drejtësisë. Nga ana e grupit të auditimit kjo gjykohet si kufizim i mundësive për pjesëmarrës të tjerë, në pozicionin e drejtuesit të njësisë së auditimit në institucionet e tyre dhe anëtarit të Komitetit të Auditimit në një institucion tjetër po të të njëjtit rang.

Disa aspekte që kërkojnë vëmendje, lidhur me kornizën që rregullon krijimin dhe funksionimin e KAB. Në Ligjin për AB është përcaktuar se Komitetet e Auditimit të Brendshëm kanë rol "... ***monitorues e këshillues për titullarin*** e njësisë publike, ...", sipas VKM nr. 160, Kreu i I-rë, pika 1, përcaktohet se: "*Roli i Komitetit të Auditimit të Brendshëm është të monitorojë, të ofrojë këshilla e rekomandime objektive për Titullarin e njësisë publike, në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe të mbështesë njësinë e auditimit në përmbushjen e*

përgjegjësive të saj". Në kreun III "*Kompetencat dhe raportimi i KAB*", pika 1, jepen kompetencat
a) shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e kartës së auditimit të brendshëm, b)shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve për planin strategjik e vjetor të auditimit, c)monitorimin e performancës së auditimit të brendshëm, duke përfshirë përputhshmërinë e veprimtarisë me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuara për tu zbatuar në Shqipëri...e) të shqyrtuar dhe siguruar mbikëqyrje mbi krijimin dhe përditësimin, efektivitetin e vlerësimit dhe menaxhimit të riskut si dhe praktikat e raportimit të riskut në njësinë publike ....
Në Nenin 24, të Ligjit 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", përcaktohen përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm. *Struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm ushtron këto funksione:*
a) zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizuar në fushën e auditimit të brendshëm publik, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar; b) harton dhe propozon përmirësimin e legjislacionit kryesor dhe mbështetës për auditimin e brendshëm në sektorin publik; c) harton dhe propozon politikat, manualet, procedurat, udhëzimet dhe rregulloret për auditimin e brendshëm për përshtatjen dhe përafrimin e tyre me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të auditimit të brendshëm; ç) përgatit dhe administron planin e konsoliduar strategjik e vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësitë publike; d) paraqet, brenda muajit maj të çdo viti, te Ministri i Financave raportin për funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, pjesë e raportit vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik; dh) harton dhe zbaton manualin për vlerësimin e cilësisë, e cila përfshin procesin e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të auditimit të brendshëm; e) administron metodat e hartuara, në mbështetje të manualit të auditimit, për fusha specifike të auditimit të brendshëm, të paraqitura nga njësitë e auditimit të brendshëm; ë) analizon rekomandimet e dhëna në raportet vjetore të njësive të auditimit të brendshëm; f) harton, zhvillon dhe administron politikat kombëtare për certifikimin e audituesve të brendshëm, si dhe trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm, në bazë të praktikave bashkëkohore në fushën e auditimit të brendshëm.
Shikojmë që funksionet që i janë atribuuar Komiteteve të Auditimit, rrjedhin nga funksionet dhe përgjegjësitë që ka Struktura përgjegjëse e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave lidhur me sistemin e auditimit të brendshëm në nivel kombëtar. Rrjedhimisht dhe logjikisht arrijmë të themi se kjo strukturë patjetër duhet të formalizojë komunikimin më KA të njësive për të rritur cilësinë e konsolidimit të raporteve dhe ndjekjes së rekomandimeve, duke qenë se të dyja operojnë mbi një emëruas të përbashkët. Si dhe të shmanget logjika e të justifikuarit pas mos specifikimit të kësaj detyre në ligj.

2. Organizimi dhe funksionimi i Njësive të Auditimit të Brendshëm.

Konstatojmë se Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm nuk ka një informacion të plotë për të gjitha njësitë që duhet të jenë subjekte të këtij ligji, por deklarojnë vetëm njësitë të cilat raportojnë pranë kësaj strukture. Mungesa e të dhënave për të gjitha njësitë, subjekte të këtij ligji, e bën analizën e kësaj strukture jo të plotë, dhe nuk reflekton saktë shtrirjen e Audituesit të Brendshëm në sektorin publik. Auditimi i sektorit publik sipas raportimit që bëhet pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm mbulohet nga 115 Njësi Auditimi të Brendshme. Siç është rithënë në krye nga 119 që funksionojnë4 njësi nuk kanë raportuar, pra rezultojnë të dhëna për 115 njësi.

Me Vendimin nr. 83 datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*", në pikën 1, përcaktohet se njësitë e auditimit të brendshëm krijohen në

a. Ministritë e linjës, institucionet e varësisë të organizuara me degë territoriale dhe bashkitë,
b. Çdo institucion tjetër që kryen funksione publike, shoqëritë tregtare, organizatat jo fitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme si dhe njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike sipas një marrëveshje ndërkombëtare, të cilat kanë në vit njëkohësisht jo më pak se 400 milion lekë të ardhura financiare dhe 300 punonjës përgjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së tyre, me përjashtim të rasteve kur ngritja e njësisë së auditimit të brendshëm parashikohet nga një ligj i veçantë.

Sipas pikës 7 të po këtij Vendimi përcaktohet se Njësitë publike brenda 6 muajve nga data e hyrjes së fuqi të këtij vendimi, të kryejnë organizimin e brendshëm për njësinë e auditimit të brendshëm.

Zbatimi i kësaj kërkese nuk është ndjekur në mënyrë të plotë nga DH/AB, duke argumentuar se nuk është detyrë edhe përgjegjësi e tyre, por në gjykimin tonë struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB, ka përgjegjësi sipas kërkesave të nenit 24 të LAB për monitorimin e veprimtarisë së AB në nivel kombëtar.

Konstatojmë se nuk ka një analizë të plotë në shkallë sistemi nga ana e DH/AB për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që kjo njësi të jap ndihmesën e saj për ngritjen dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në rang kombëtar. Po kështu konstatohet se, DH/AB nuk ka të dhëna të sakta lidhur me mbulimin me auditim për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme me qëllim që të përcaktohen kapacitetete audituese dhe nevojat për mbulim me auditim në shkallë sistemi me njërën nga format e përcaktuara në nenin 10 "*Organizimi i shërbimit të Auditimit të Brendshëm*" të Ligjit 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik*" i cili përcakton se:

1. Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në vijim:

a) kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e auditimit të brendshëm, kur ka një të tillë të parashikuar në strukturën organizative të njësisë publike;

b) kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e auditimit të brendshëm e institucionit epror, në rastet kur në strukturën organizative të njësisë publike nuk është parashikuar njësia e auditimit të brendshëm;

c) në rastet kur asnjë nga opsionet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b", të këtij neni, nuk është i mundur të realizohet, shërbimi i auditimit të brendshëm kryhet nga njësia e auditimit të brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse. Marrëveshja miratohet paraprakisht nga Ministri i Financave;

ç) kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm me kontraktim, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion kanë miratuar Akt-Marrëveshje për auditim Institucionet: Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor me MF, Agjencia Telegrafike Shqiptare me Ministrinë e Mjedisit, ISSH me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Qendra Kombëtare e Kinematografisë dhe Ministria e Kulturës, Bashkia Dropull me Bashkine Finiq, Bashkia Pustec me Bashkinë Devoll (mungon bashkangjitur Akt-Marrëveshja mes dy institucioneve), Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit dhe Minstria e Financave, Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike me Ministrinë e Financave, Sekretariati Teknik Këshilli Kombëtar i Ujit me Ministrinë e Punëve

të Brendshme, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit me Ministrinë e Financave (tek pala sipërmarrëse mungon emër mbiemër), Autoriteti i Konkurrencës me Ministrinë e Mjedisit.

Nga auditimi i përputhshmëri të dokumentacionit të vënë në disopopzicion konstatohet se, mbi Akt-Marrëveshjen mes Ministrisë së Financave dhe Inspektoriatit Qendror në përgjigje Ministria e Financave ka specifikuar nevojën se duhet rishikuar, por ky dokument nuk ka firmën e Sekretarit të Përgjithshëm. Mbi këtë çështje nuk ka informacion të mëvonshëm se çfarë ka ndodh. Gjithashtu shkresa miratuese e Akt-Marrëveshjes mes Bashkive Dropull dhe Libohovë nuk ka firmën e Ministrit të Financave.

2.1 Mbi mbulimin me auditim

Nga auditimi për organizimin dhe funksionimin e DH/AB, konstatohet se, nuk ka një analizë të plotë në shkallë sistemi nga ana e DH/AB për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që kjo njësi të jap ndihmesën e saj për ngritjen dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në rang kombëtar. Po kështu konstatohet se, DH/AB nuk ka të dhëna të sakta lidhur me mbulimin me auditim për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme me qëllim që të përcaktohen kapacitetet audituese dhe nevojat për mbulim me auditim në shkallë sistemi me njërën nga format e përcaktuara në nenin 10 "Organizimi i shërbimit të Auditimit të Brendshëm" të Ligjit 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik*" dhe në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*",i ndryshuar pikat 1 dhe 7, ku përcaktohet se "*Njësitë publike brenda 6 muajve nga data e hyrjes së fuqi të këtij vendimi, të kryejnë organizimin e brendshëm për njësinë e auditimit të brendshëm***"**
Nga auditimi u konstatua se, për 106 Institucione që financohen nga buxheti i Shtetit ku përfshihen Ministritë, Institucionet e Pavarura dhe të ngritura me ligj si dhe Bashkitë në 10 prej tyre auditimi i fondeve publike është rregulluar me Akt-Marrëveshje, në përputhje me nenin 10, pika "c" të ligjit 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm", dhe 29 prej tyre nuk kanë rregulluar shërbimin e auditimit të brendshëm në njërën nga format e përcaktuara nga ligji, nga të cilat 14 Bashki dhe 15 Institucione të pavarura dhe të ngritura me ligj.
Për institucionet që kanë organizuar shërbimin e auditimit të brendshëm duke krijuar njësitë e auditimit të brendshëm u konstatua se, nga krahasimi i numrit të angazhimeve me numrin e audituesve të planifikuar rezultoj se në disa prej tyre ngarkesa është e ulët që varion nga 1.3 në 2.6 auditime/auditues, si p.sh Bashkitë Tiranë 2.1, Shijak 1.6, Elbasan, 1.8 Fier 2.6, Bulqizë 2.6, Devoll 2.5, Dibër 2.6, Mat 2.3, Kuçovë 1.6,Tropojë 1.3, Ura Vajgurore 1.3 dhe Fushë Arëz 2.6, Himarë 2.5, Malësi e Madhe 2.6, Maliq 2.3, RTSh 2, etj po kështu u konstatuan edhe raste ku ngarkesa e angazhimeve për audituesh është tepër e lartë si p.sh Bashkitë Delvinë 11, Gramsh 9, Lezhë 8, Librazhd 9, Prrenjas 7, Skrapar 8 etj. Konstatohet se, në planet e auditimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të FSDKSH-së nuk është përfshirë shërbimi i auditimit të brendshëm për 412 Qendra Shëndetësore të cilat financohen nga buxheti i Shtetit dhe paraqesin pasqyrat financiare çdo vit.
Si përfundim, gjykojmë se numri i auditimeve të planifikuara për tu kryer nuk është në raport me numrin e njësive të qeverisjes së përgjithshme që financohen nga buxheti Shtetit.

3. Auditimi i Brendshëm në raportin për zbatimin e Buxhetit të vitit 2017

Analiza e veprimtarisë së auditimit të brendshëm është kryer nga konsolidimi i të dhënave të raporteve vjetore të 115 njësive të auditimit të brendshëm (NJAB) nga 119 NJAB që sipas të dhënave që kanë strukturat e Njësisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, funksionojnë

në sektorin publik. Për vitin 2017, nuk kanë raportuar NJAB të ngritura në Qendrën Spitalore Elbasan, Qendrën Spitalore Korçë, Qendrën Spitalore Fier dhe Universitetin e Tiranës. (119-4) Në këto raporte janë prezantuar rezultatet e veprimtarisë vjetore të auditimit të brendshëm, sfidat me të cilat ky shërbim është përballur dhe prioritetet për të ardhmen, sipas një formati të standardizuar raportimi, të përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

3.1 Mbi planifikimin strategjik dhe vjetor të konsoliduar të Auditimit të Brendshëm

Përsa i përket planifikimit dhe realizimit të veprimtarisë

Bazuar në të dhënat e marra nga Raporti mbi funksionimin e SKBFP në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2017 specifikohet se Njësitë e Auditimit të Brendshëm që në fazën e planifikimit të punës për programimin e subjekteve dhe përcaktimit të tematikave të auditimit për vitin 2017, mbështeten në disa kritere si:

- Vlerësimi sa më real i riskut dhe përfshirja në planin e subjekteve me risk të lartë;
- Sugjerimet e titullarëve të njësive publike;
- Gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga auditimet e mëparshme.

Por nga auditimi konstatohet se mungon një analizë se si ky planifikim apo sa përqindë e planit vjen nga secili prej këtyre komponentëve. Po ashtu sikundër është trajtuar në vijim, në raportet e marra nga njab konstatohet një problematik e përsëritur e pothuaj të gjitha njësive mbi raportimin e gjetje/rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (thuajse 90% të rasteve).

Përsa i përket përgatitjes së planeve strategjikë dhe vjetorë për vitin 2017:

Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave, si udhëheqëse metodologjike dhe harmonizuese e standarteve të auditimit të brendshëm duhet të koordinojë veprimtarinë e auditimit të brendshëm në të gjithë njësitë publike, të zhvilloj, administroj dhe zbatoj strategjinë e harmonizuar në fushën e auditimit të brendshëm publik, si dhe të monitoroj këtë veprimtari në nivel kombëtar.

Referuar analizës vjetore të kësaj strukture, specifikohet se hartimi i planit strategjik dhe vjetor të konsoliduar vjen si rezultat i komunikimit, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit të DH/AB dhe NJAB-ve në ministritë e linjës, në institucionet qendrore në varësi të tyre, në stukturat e pushtetit vendor dhe në institucionet e pavaruara; harmonizimin e punës audituese dhe vlerësimin e veprimtarisë të NJAB të të gjithë subjekteve.

Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën 10 Tetor të çdo viti.

Planet pas dhënies së mendimit të KA-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm. Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se, nga 90 subjektet objekt auditimi 19 prej tyre nuk kanë zbatuar afatin e dërgimit të këtyre dokumenteve zyrtar. Konkretisht bëhet fjalë për:

Nr	Emërtimi i institucionit	NrProt.	Data
1	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Nr 5158 Prot.	25.10.2016
2	Ministria e Punëve të Brendshme	Nr 6849/3 Prot.	21.10.2016
3	Autoriteti Portual Durrës	Nr 135/2 Prot.	25.10.2016
4	Ministria e Financave Drejtoria e Përgjith. e Doganave	Nr 25784/2 Prot.	04.11.2016

5	Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit	Nr 7685 Prot	04.11.2016
6	Ministria e Financave Drejtoria e Përgjith. e Tatimeve	Nr 36691 Prot	08.11.2016
7	Bashkia Vau Dejës	Nr 2303/1 Prot.	21.10.2016
8	Bashkia Tiranë	Nr 32967/1 Prot	31.10.2016
9	Drejtoria e Përgjith. e Taksave Tiranë	Nr 11722/94 Prot	31.10.2016
10	Bashkia Tropojë	Nr 4316 Prot.	01.12.2016
11	Albcontrol	Nr 485 Prot	01.03.2017
12	Ministria e Shëndetësisë	Nr 4895 Prot.	24.10.2016
13	Ministria e Shëndetësisë Elbasan	Nr 1817 Prot.	21.10.2016
14	Albpetrol	Nr 6938 Prot.	21.10.2016
15	Posta Shqiptare	Nr 3560 Prot.	02.11.2016
16	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit Hekurudha Shqiptare	Nr 840 Prot.	04.11.2016
17	Prokuroria e Përgjithshme	Nr 3595 Prot.	30.11.2016
18	Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier	Nr 3154 Prot.	25.11.2016
19	Bashkia Krujë	Nr 4843 Prot.	15.11.2016

Mbi hartimin e tyre: Hartimi i planit strategjik duhet ti përmbahet diagramës së Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm. Nga auditimi me zgjedhje i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit, të dërguara pranë DH/AB u konstatua se , nga 30 raporte pesë ishin me relacion të vakët dhe katër pa relacion fare. Konkretisht, Bashkia Fushë-Arrëz, Maliq, Kukës dhe Gramsh përmbajnë relacion të vakët me informacion të cunguar në lidhje me misionin, vizionin, objektivat strategjike, strategjinë e auditimit të njësive respektive, si dhe në lidhje me vlerësimin e riskut, auditimet prioritare që duhen bërë dhe shpërndarjen e burimeve të planit vjetor të secilës prej këtyre bashkive.

Bashkia Kolonje përmban relacion të vakët me informacion të pakët në lidhje me vlerësimin e riskut, auditimet prioritare që duhen bërë dhe shpërndarjen e burimeve të planit vjetor të kësaj bashkie.

Bashkia Tropoje, Universiteti i Durrësit, Bashkia Prrenjas, Bashkia Dibër, AMF, ISSH kanë mungesë të plotë të relacionit. ***Baza e planit të konsoliduar ishin të dhënat e prezantuara nga vetë njësitë publike*** në planet strategjike dhe vjetore të miratuara nga titullarët e njësive publike. Pra nuk ka informacion shtesë nga ana e njësive publike lidhur me kriteret e përdorura për të bërë klasifikimin e riskut në nivelet i lartë, i mesëm, i ulët. Mbi bazën e nivelit të planifikuar të riskut përcaktohet numri i auditimeve gjithsej që subjekti do të kryhej.

Grupi i auditimit gjykoj të arsyeshme testimin e risqeve të parashtruara nga ana e njësive publike duke krahasuar nivelin e risqeve të përcaktuara në planet individuale të secilit subjekt me ato të paraqitura në planin e konsoliduar.

Nga auditimi mbi planet strategjik të auditit të brendshëm të Institucione Qendrore u konstatua se në 12 (dymbëdhjetë) prej tyre kishte mospërputhje me numrin e subjekteve për tu audituar mes planeve strategjike individuale të njësive dhe atij të konsoliduar, si p.sh Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Integrimit Europian, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Kulturës, Ministria e Energjitikës dhe Industrisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Punëve te Brendshme.

Në 2 (dy) prej tyre kishte mospërputhje me nivelin e riskut, përkayësisht në Ministrinë e Punëve të Jashtme u konstatua se kishte mospërputhje me nivelin e riskut "Ambasada Athinë-Greqi", "Romë-Itali" dhe "Tokio-Japoni" dhe në Ministrinë e Drejtësisë kishte mospërputhje me nivelin e riskut "Avokatura e Shtetit".

Nga auditimi rezultoi që në 92% të ministrive u konstatua mosrakordime që konsistojnë në mospërputhje me numrin e subjekteve për tu audituar. Në 8% të Ministrive nuk kishte devianca.

Njëkohësisht auditimi mbi planet strategjik të Auditit të Brëndshëm të Bashkive u konstatua se në 10 (dhjetë) prej tyre kishte mospërputhje me numrin e subjekteve për tu audituar,

përkatësisht Bashkia Gramsh, Bashkia Mat, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Elbasan, Bashkia Tepelenë, Bashkia Divjakë, Bashkia Skrapar, Bashkia Lushnje, Bashkia Durrës, Bashkia Berat.
Në 2 (dy) prej tyre kishte mospërputhje me nivelin e riskut, konkretisht Bashkia Gramsh u konstatua se kishte mospërputhje me nivelin e riskut "Agjensia e Shërbimeve Publike" dhe "Sektori Finances" dhe në Bashkinë Elbasan kishte mospërputhje me nivelin e riskut "Drejtoria e Prokurimeve Publike". Nga auditimi rezultoi që në 52% të bashkive u konstatua mosrakordime që konsistojnë në mospërputhje me numrin e subjekteve për tu audituar. Në 48% të bashkive nuk kishte devianca.
Përsa më sipër grupi i auditimit, nuk shpreh dot siguri të arsyeshme përsa i përket mënyrës së hartimit të planit të konsoliduar, nëse është kryer në formën e një ***inkorporimin mekanik të këtyre planeve në*** Planin e Konsoliduar Strategjik dhe Vjetor apo është përpunuar informacioni i dhënë nga njësitë publike dhe në rastet e ndryshimeve nuk kishte komente nga ana e njësive publike.

Mbi ndryshimet e ndodhura në planet vjetore
Gjatë auditimit u konstatua se, ka subjekte të cilat gjatë vitit kryejnë rishikim të planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm. Konkretisht janë dërguar 18 shkresa për ndryshim planesh si më poshtë vijojnë:

Nr	Subjekti	Shkresa	Ndryshimi	Në terma
1	DPT	Nr.15654 datë 4.7.2017	Me memo është argumentuar nevoja e ndryshimit në plan për shkak të Kapaciteteve të Burimeve Njerëzore, si rrjedhojë e mopunësimit të një punonjësi; bashkangjitur gjendet edhe pasqyra e planit të rishikuar	Nga 9 ne 8
2	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit	Nr. 1019/2, datë 26.09.2017	Me memo është argumentuar nevoja e ndryshimit në plan për shkak të zhvendosjes në kohë e angazhimeve të konsulencës për shkak të Riskut&Kostos; bashkangjitur pasqyra e planit të rishikuar	6 auditime dhe 3 sherb e konsulencës jo
3	Autoriteti Portual Durrës	Nr. 2504 datë 16.10.2017	Me memo është argumentuar nevoja e ndryshimit në plan për shkak të ndryshimit të Strukturës Organizative. Nuk ka pasqyrën dhe as ndryshimet e ndodhura në plane	
4	MBZHR	Nr.7813, datë 26.10.2017	Me memo është argumentuar nevoja e ndryshimit në plan për shkak të shtesës në auditim të verifikimit të ankesave; Mungojnë pasqyrat e planit fillestar dhe të rishikuar	+5 verifikim ankesash
5	FSDKSH	Nr.5073/3, date 20.10.2017	Mungon një memo për argumentimin e ndryshimeve të ndodhura, po ashtu dhe pasqyra me planin fillestar për te kuptuar ndryshimet	Ne 12
6	Universiteti Bujqësor i Tiranës	Nr. 2016/1, datë 20.10.2017	Mungon një memo për argumentimin e ndryshimeve të ndodhura; bashkangjitur pasqyrat me planin fillestar dhe të ndryshuar	Nga 6 ne 5
7	Universiteti i Mjekësisë Tiranë	Nr. 1898/3, datë 20.10.2017	Urdhër titullari për ndryshim, mungon argumentimi i ndryshimit; bashkangjitur pasqyrat me planin fillestar dhe të ndryshuar	Nga 9 nga 11
8	Bashkia Krujë	Nr.6190, datë 20.10.2017	Mungonnjë memo për argumentimin e ndryshimeve të ndodhura; bashkangjitur pasqyra me planin e ndryshuar, por	Nga … në 6

			mungon fillestari	
9	Bashkia Korcë	Nr. 4776, datë 17.10.2017	Mungon një memo për argumentimin e ndryshimeve të ndodhura; mungojnë pasqyrat me planin e ndryshuar dhe fillestarin	Marrim si info nr 3 parealizuardhe 1 eshte shtese
10	Bashkia Kamëz	Nr 5639/1 dt 29.09.2017	Mungon një memo për argumentimin e ndryshimeve të ndodhura; bashkangjitur pasqyra me planin e ndryshuar, por mungon fillestari	Ne 10
11	Bashkia Dropull	Nr. 1438/2, datë 06.09.2017		
12	Bashkia Libohovë	Nr.359, datë 06.09.2017	Me memo është argumentuar nevoja e ndryshimit në plan, bashkangjitur janë pasqyrat me planin e ndryshuar dhe fillestarin.	Ne 21
13	Bashkia Finiq	Nr. 537, dayë 03.03.2017		
14	Bashkia Lushnjë	Nr. 7179, datë 04.09.2017	Memo argumentuese të ndryshimit në plan, si rrjedhojë e auditimit të KLSH është kryer zëvendësim në subjektin e audituar, bashkangjitur pasqyrat me planin e ndryshuar dhe fillestarin.	14 ndryshim ne subject auditimi
15	INSTAT	Nr. 1001/2, datë 12.04.2017	Memo	7 ne… nuk arrin të kuptohet
16	OST	Nr.5891, datë 31.10.2017	Mungon një memo për argumentimin e ndryshimeve të ndodhura; bashkangjitur pasqyra me planin e ndryshuar, por mungon fillestari	10 në 12+1 zbatim rek
17	Ministria e Mbrijtjes Drejtoria e RezervaveMaterialetëShtetit	Nr.1333/4, datë 22.01.2018	Memo argumentuese të ndryshimit në plan, mungojnë pasqyrat me planin e ndryshuar dhe fillestarin.	….. Ne 5
18	MBZHRU	Nr. 375/2, datë 15.2.2018	Mungon memo argumentuese të ndryshimit në plan, mungojnë pasqyrat me planin e ndryshuar dhe fillestarin.	Ska bashkangjit

Nga auditimi i dosjeve me ndryshimet e kryera në plane u konstatua se, problematika më e madhe qëndronte në paraqitjen e këtyre ndryshimeve, konkretisht nga 18 institucione 8 prej tyre nuk kishin bashkangjitur memon argumentuese mbi ndryshimet e ndodhura ndërsa në pjesën tjetër u konstatuan raste të detajimit të planit fillestar si dhe raste të tjera të mosdetajimit të këtij plani. Çka bën që lexuesi të konfondohet mbi kuptueshmërinë e situatës se çfarë ka ndodhur me këto ndryshime nëse plani ka ardh me mosrealizim/tejkalim.

Manuali i Auditit të Brendshëm, pika 3.5 *Rishikimi i planeve strategjikë dhe vjetor të auditimit të brendshëm* ka parashikuar mënyrën se si duhet të operohet në rastet e ndryshimeve në plane, konkretisht: *Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NjAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit, (atje ku krijohet).*
Të gjithë planet vjetorë dhe strategjikë të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t'i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra.
Përsa më sipër, gjykojmë se DH/AB duhet të ndihmojnë njësitë e auditit të brendshëm pranë njësive publike nëpërmjet përgjithësimit të mangësive të konstatuara në raportimet e tyre lidhur me hartimin e planeve strategjike dhe vjetore, me qëllim që ato të argumentojnë shkaqet e lindjes së nevojave për ndryshime, mënyrën e pasqyrimit të këtyre ndryshimeve dhe të raportimit periodik të tyre, duke unifikuar formatet e shkresave shoqëruese të ndryshimeve në plan.
Nga auditimi u konstatua, nga ana e ISSH është dërguar shkresa për ndryshim plani pranë DH/AB për vitin 2017, me nr. 9013 prot dhe datë 08.11.2017 në të cilën është specifikuar

ndryshimi i strukturës organizative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore që sjell si pasojë ndryshim në planin e auditimeve të njësisë.
Shkresë e cila gjatë auditimit pasi është kërkuar nga grupi i aditimit nuk na është vendosur në dispozicion, së bashku me shkresën dërguese të planit strategjik dhe vjetor të ISSH, dërguar prej subjektit me shkresën nr. 7076/1 prot datë 07.11.2016.
Nga auditimi u konstatua se, nga evidencat e marra nga ana e DH/AB FSDKSH figuron me realizim gjithsej të 22 auditimeve ndërkohë që nga të dhënat e siguruara përmes auditimeve paralele figuron ne realizim të 19 auditimeve.
Çka dëshmon se të dhënat e pasqyruara nga ana e DH/AB nuk janë të axhornuara dhe për pasoje as të besueshme.

C. Mbi aktivitetin e Auditimit të Brendshëm, përputhshmëria ligjore dhe vlerësimi i strukturave audituese

Realizimi i planeve: Grupi i auditimit gjatë punës së vet, mbështetur në evidencat e marra nga njësia konstatoj se, për 122 njësi publike që kanë raportuar pranë DH/AB, (numri i referohet periudhës përpara ristrukturimit të Qeverisë), 15 prej tyre nuk kanë dërguar plane pranë Njësisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, ndërsa për 107 njësit janë ato që kanë bashkangjitur planet (pjesë e tyre janë edhe Ministria e Ekonomisë, Integrimit dhe Mirëqënies të cilat janë ministri jofunksionale tanimë) përsa i përket realizimit të planit të, bazuar në të dhënat e konsoliduara të marra nga ana e DH/AB u konstatua se, në 46 raste ndeshëm mos realizim të planeve të auditimit ndërsa në 61 raste u ndeshëm me tejkalim të tij. Konkretisht në tabelën si vijonë:

Institucioni	Plani vjetor	Realizimi	Diferenca(- +)
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	22	27	+ 5
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise	20	38	+18
Ministria e Bujqesise dhe Zhvill. Rural	18	23	+5
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	20	22	+2
Ministria e Drejtesise	25	41	+16
Ministria e Mbrojtjes	35	46	+11
Ministria e Brendshme	23	29	+6
Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	15	11	-4
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	19	22	+3
Ministria e Kultures	14	14	0
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	12	10	-2
Drejt.Pergj.Doganave	16	15	-1
Drejt.Pergj.Tatimeve	9	24	+15
Inst.Sig.Shoqerore	24	23	-1
Sheb.Komb.Punesimit	20	15	-5
Sherbimi Social Shteteror	12	12	0
Autoriteti Kombetar i Ushqimit	8	9	+1
AZHBR	8	9	-+
Drejt.Pergj.Burgjeve	18	26	+8
Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive	29	14	-15
Drejtoria e Rezervave	9	5	-4
Drejt.Pergjith.Policise	28	28	0
Autoriteti Portual Durres	11	11	0
D.P.Transportit Rrugor	10	11	+1
Enti Komb.Banesave	10	9	-1
ALBCONTROL	6	2	-4
ALUIZNI	23	4	-19

Drejtoria e Sherbimeve Qeveritare	8	4	-4
Universiteti I Tiranes	5	0	-5
Universiteti Politeknik I Tiranes	4	0	-4
Universiteti Bujqesor Tiranes	6	6	0
Universiteti Mjekesise	9	11	+2
Universiteti "A.Moisiu" Durres	17	5	-12
Kuvendi I RSH	4	4	0
Zyra Adm.Buxhetit Gjygjesor	11	11	0
SHISH	29	29	0
Prokuroria e Pergjithshme	13	12	-1
Instituti I Statistikave	9	7	-2
Fondi i Sg. Kujdesit Shendetesor	22	22	0
Radio-Televizioni Shqiptar	6	5	-1
Autoriteti I Mbikqyrjes Financiare	14	10	-4
QSU Nene Tereza	21	28	+7
Q. Spitalore Vlore	6	6	0
Spitali Rajonal Gjirokaster	10	5	-5
Spitali Rajonal Durres	4	8	+4
Spitali Rajonal Elbasan	5	0	-5
Spitali Rajonal Fier	6	0	-6
Sh.a K Tirane	13	11	-2
Sh.a.A Fier	18	27	+9
Sha O. Tirane	10	12	+2
O. sha	21	19	-2
H. Sh sha	12	11	-1
P.Sh sha	18	21	+3
Ujesjelles Kanalizime Korce	7	7	0
Ujesjelles Kanalizime Tirane	10	12	-2
Ujesjelles Kanalizime Pogradec	0	4	-4
Ujesjelles Kanalizime Shkoder	6	7	+1
Ujes.Kanalizime Durres	9	13	+4
Ndermarrja e Trajtimit te Studenteve 1	5	5	0
Autoriteti Rrugor Shqiptar	10	1	-9
Bashkia Berat	12	11	-1
Bashkia Ura Vajgurore	4	5	+1
Bashkia Kucove	5	6	+1
Bashkia Skrapar	8	5	+3
Bashkia Diber	8	8	0
Bashkia Mat	7	12	+5
Bashkia Bulqize	8	10	+2
Bashkia Klos	0	0	0
Bashkia Durres	10	10	0
Bashkia Shijak	5	4	-1
Bashkia Kruje	14	6	-8
Bashkia Elbasan	13	17	+4
Bashkia Gramsh	9	6	-3
Bashkia Librazhd	9	6	-3
Bashkia Prrenjas	7	0	-7
Bashkia Fier	8	12	+4
Bashkia Patos	16	13	-3
Bashkia Roskovec	11	3	-8

Bashkia Lushnjë	14	14	0
Bashkia Divjakë	10	5	-5
Bashkia Mallakaster	9	11	+2
Bashkia Gjirokaster	6	6	0
Bashkia Tepelenë	4	5	+1
Bashkia Memaliaj	10	10	0
Bashkia Dropull	13	21	+8
Bashkia Korce	8	6	-2
Bashkia Maliq	7	9	+2
Bashkia Kolonje	14	28	+14
Bashkia Pogradec	7	10	+3
Bashkia Kukes	12	7	-5
Bashkia Tropoje	4	0	-4
Bashkia Lezhe	24	20	-4
Bashkia Shkoder	12	10	-2
Bashkia Vau Dejes	12	9	-3
Bashkia Fushë Arrëz	8	7	-1
Bashkia Malesia e Madhe	8	14	+6
Bashkia Tiranë	21	22	+1
Dr.Pergj.Tatim Taksave Vendore (B.Tirane)	6	21	+15
Bashkia Kamëz	10	10	0
Bashkia Vorë	12	5	-7
Bashkia Kavajë	10	10	0
Bashkia Vlore	10	11	+1
Bashkia Himarë	5	4	-1
Bashkia Sarande	0	8	-8
Ministrite e mbyllura			0
Ministria e Ekonomise	21	10	-11
Ministria e Integrimit	6	3	-3
Ministria e Mireqenies	19	19	0
Institucione pa plane:			
Shoqeria e Pare Financiare e Zhvillimit	-	12	
Agjensia e Ofrimit te Sherb. Pub.te Integruara	-	7	
Universiteti Shkoder	-	4	
Fondi Shqiptar I Zhvillimit	-	0	
Autoriteti Shendetesor Rajonal	-	4	
Spitali I Traumes Tirane	-	20	
Spitali Shefqet Ndroqi Tirane	-	4	
Spitali Rajonal Shkoder	-	2	
Spitali Rajonal Kukes	-	8	
Spitali Rajonal Korçe	-	0	
Spitali Rajonal Berat	-	0	
A. G sha	-	9	
Bashkia Devoll & B.Pustec	-	10	
Bashkia Mirdite	-	4	
Bashkia Selenicë	-	4	

Përsa i përket realizimit të planit sipas llojit për vitin 2017, bazuar në evidencat e marra prej DH/AB u konstatua se, nuk kishim informacion mbi planin me ndryshime gjatë vitit çka bën të pamundur të nxjerrim të saktë realizimin final dhe së dyti.

Së dyti, bazuar në raportin e konsoliduar u konstatuan diferenca mes shifrave tona (marr nga evidencat e DH/AB) dhe shifrave të paraqitura në këtë raport, konkretisht detajuar në tabelën më poshtë vijojnë:

	Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit
		A. të përputhshmërisë	A. të performancës	A. financiare	A. tek.Informacionit	A. të kombinuara		
Planifikimi	**1342**	362	114	144	14	686	22	
Plani me ndryshimet gjate vitit	**1358**							
Realizimi	**1355**	400	64	144	6	578	14	149
Realizimi sipas raportit	**1360**	403	65	144	6	579	14	149

Mbi formatin e zbatimit të rekomandimeve: Gjatë auditimit të kryer, u konstatua në pasqyrën 5 *"Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin"* që shoqëron raportin vjetor të NJAB-ve në pjesën statusi i rekomandimeve është hequr kolona "*Arsyeja e moszbatimit të rekomandimit"* e për rrjedhojë NJAB-të nuk kanë dhënë shpjegime për arsyet e moszbatimit të rekomandimeve duke ndikuar në cilësinë e raportimit. DH/AB nuk duhet të kishte lejuar ndërhyrjen e NJAB-ve në formatin e raportimit të rekomandimeve (pasqyra 5).

Mbështetur në të dhënat e marra nga "*Raporti mbi funksionimin e sistemit te kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2017"*rezulton se gjatë këtij viti strukturat e auditimit të brendshëm kanë realizuar 1,360 angazhime auditimi kundrejt 1,358 angazhime auditimi të programuara (përfshi këtu ndryshimet e planeve gjatë vitit), që e shprehur në përqindje përbën 100,1% realizim të Planit Vjetor.

Nga analiza e kryer në lidhje me realizimin e planit, gjatë këtij viti ka një ndryshim të pranueshëm nga plani fillestar i miratuar, gjë që sipas DH/AB vlerësohet si një tregues pozitiv i cili dëshmon për një planifikim më të mirë të burimeve të auditimit nga ana e drejtuesve të NJAB-ve. Mbështetur në të dhënat e marra nga kjo njësi gjatë periudhës objekt auditimi konstatohet se, gjatë vitit objekt auditimi strukturat e auditit të brendshëm kanë realizuar 1,355 angazhime auditimi kundrejt 1,358 të programuara (përfshi këtu ndryshimet e planeve gjatë vitit), që e shprehur në përqindje përbën 99,70% realizim të Planit Vjetor.

Përsa i përket sigurisë që marrim nga të dhënat e paraqitura në raportin mbi funksionimin e KBP dhe DH/AB kapitulli 5 "Veprimtaria e AB" konstatohet se, në raportin e konsoliduar nuk janë pasqyruar treguesit lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e raportuara përpara periudhës së ristrukturimit të Qeverisë përkatësisht nga ish Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të barabarta, Ministria e Punëve të Jashtme, çka bën që për disa prej institucioneve të dhënat e paraqitura në raportin e konsoliduar të mos jenë bindëse dhe të besueshme për ne, pasi nuk pasqyrojnë situatën e njësive para dhe pas bashkimit. P.sh përsa i përket gjetjeve me dëm ekonomik, për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë Ekonomisë vlerat respektive ishin 480 mijë lekë dhe 1,186 mijë lekë ndërkohë që në raportin e konsoliduar dalin në zërin e përbashkët Ministri e Financave & Ekonomisë në vlerën 480 mijë lekë; për Ministrinë e Integrimit Europian, Ministrinë e Shëndetësisë nuk ka të dhëna në raportin e konsoliduar, Ministria e Mjedisit e bashkuar me Ministrinë e turizmit, Ministria e Mirqënies Sociale, Ministria e Jashtme nuk kanë asnjë informacion në lidhje me situatën përpara dhe pas riorganizimit që të kuptohet se si është kryer procesi i konsolidimit të vlerave.

Treguesit statistikorë në nivel sistemi: Në nenin 14 "*Përgjegjësia e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm*", detyron të gjitha Njësitë e Auditimit të Brendshëm për *ç) përgatitjen e*

raportit vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe përmban të dhënat e mëposhtme, por nuk kufizohet vetëm në to:

i. angazhimet e auditimit, të kryer gjatë periudhës së raportuar;
ii. shmangiet nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse;
iii. vlerësimin e sistemeve të kontrollit brenda njësisë publike dhe për rekomandimet për përmirësim;
iv. veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar.

Për vitin 2017 janë planifikuar me gjithë ndryshimet e kryera 1358 auditime nga 119 njësi auditimi të brendshëm ose 279 auditime më pak se ato të planifikuara për vitin 2016. Për kryerjen e këtyre auditimeve në këto njësi janë planifikuar të angazhohen 429 auditues të brendshëm. Sipas të dhënave "Planifikimi i auditimit sipas llojit", konstatohet se nga 1358 auditime gjithsej të parashikuara për vitin 2017, do të kryhen auditime financiare 144, auditime të përputhshmërisë 362, auditime performance 114, auditime tekonologjie informacioni 14, auditime të kombinuara 686 e numrit total si dhe shërbime këshillimi 22. Të dhëna këto që i përkasin planifikimit fillestar dhe jo të ndryshuar gjatë vitit, ndërkohë që numri total i planifikimit 1358 është planifikimi përfundimtar.

Ndërkohë që rezulton se për vitin 2017 janë realizuar 1355 auditime. Për kryerjen e këtyre auditimeve në këto njësi janë angazhuar 400 auditues të brendshëm. Bazuar në analizën sipas llojit të auditimit, konstatohet se nga 1355 auditime gjithsej, auditime financiare 144 ose 11% të totalit, auditime të përputhshmërisë 400 ose 30%, auditime performance 64 ose 5% të totalit, auditime të teknologjisë së informacionit 6 dhe auditime të kombinuara 578 ose 43% e totali. Gjithashtu dhe 14 shërbime këshillimi dhe 149 angazhime me kërkesë të titullarit. Duhet të theksojmë faktin se në formatin e ri të raportimit nuk ka një ndarje për auditimet e zbatimit të rekomandimeve duke përfshirë këto të fundit në auditime sipas llojit dhe duke krijuar një pamje jo të drejtë lidhur me numrin e auditimeve të përputhshmërisë.

Me miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm (viti 2016) janë ndryshuar dhe formatet standard të planifikimit dhe raportimit. Kjo ka ndikuar në analizën e treguesve, duke kufizuar mundësinë e përllogaritjes e më pas të shqyrtimit dhe nxjerrjes së konkluzioneve mbi bazën e krahasimeve sipas llojeve të auditimeve, realizimit të tyre në fakt në raport me planin, gjë që do të mundësonte vendimmarrje më të informuar bazuar në analizat e çfarë ka ndodhur më parë dhe pritshmëritë për periudhën e ardhshme.

Struktura që përgatit Planin Strategjik duhet të kishte parashikuar kalimin e fazës transitore midis modelit te mëparshëm të raportimit dhe modelit të ri, në mënyrë që të sigurohet në çdo kohë informacion domethënës, i kuptueshëm dhe i dobishëm. Gjithashtu duhet të theksojmë se analiza e realizimit të planit bëhet vetëm për numër duke mos pasur mundësi të verifikohet niveli i devijimeve nga auditimet e programuara në fillim të vitit, kjo për të ndjekur dhe vlerësuar edhe pavarësinë e strukturave të auditimit në nivel kombëtar.

Konstatohet se, në Manualin e Auditit të Brendshëm, publikuar në vitin 2016, nuk është përcaktuar qartë çështja e zbatimit të rekomandimeve e as mënyra e raportimit të tyre, çka ndikon në cilësinë e raportimit pasi, ndjekja në dinamikë e zbatimit të rekomandimeve, është një nga treguesit thelbësor që pasqyron rolin dhe misionin e auditimit të brendshëm për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik. Kjo mangësi zbeh rolin e auditimit të brendshëm si mbështetës i titullarit të institucionit në arritjen e objektivave të njësisë dhe bie ndesh me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin publik*", nenit 6, "*Roli i auditimit të brendshëm*", gërma "ç", ku përcaktohet *"ç) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna*", nenit 14, "*Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm*" gërma "iv", ku përcaktohet, "*iv) veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar*;", si dhe nenit 24 "*Përgjegjësitë e*

strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm", gërma "ë", ku përcaktohet se: "*ë) analizon rekomandimet e dhëna në raportet vjetore të njësive të auditimit të brendshëm*". Gjatë vitit 2017, nga 1355 auditime të evaduara, janë evidentuar nga audituesit e brendshëm 18 raste për investigim të mëtejshëm nga njësi të specializuara. Këto janë trajtuar nga 12 NJAB kryesisht të: Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, AKU, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, P. Sh sha, Albpetrol, Drejtoria e Përgjithshme e Tranportit Rrugor dhe Bashkia Kukës. Pesë prej këtyre rasteve i janë drejtuar për investigim të mëtejshëm Drejtorisë së Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pesë raste prokurorive të rretheve përkatëse, rastet e tjera i janë drejtuar titullarëve të njësive publike, Agjensisë së Prokurimit dhe Drejtorive të Policisë së Qarqeve përkatëse.

Konkretisht bëhet fjalë për :

1. Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës e cila ka dërguar pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë për subjektin Autoriteti Rrugor Shqiptar
2. Ministria e Brendshme ka dërguar pranë Inspektimi Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për subjektin Dr.Pergj. Emergjencave Civile
3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për subjektin Arsimi Profesional
4. Ministria e Mbrojtjes ka dërguar pranë Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin Komanda e Forcave Ajrore
5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për subjektet "A.Sh" , "T.N" , "B. Gj. Ë" pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor
6. Shërbimi Kombëtar I Punësimit për subjektet Qendra Ditore Polivalente Kamez dhe Qendra e Zhvillimit Shkodër ka dërguar pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tirane dhe Inspektimi Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
7. AKU për subjektet e varësisë (pa specifikuar cilat) ka dërguar pranë Agjensisë së Prokurimit Publik
8. Drejtoria e Pergj. e Burgjeve për subjektin Institucioni Ekzekutimit Vendimeve Penale Fier ka dërguar pranë Inspektimi Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
9. P sha për filialet e postës Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastër ka dërguar pranë Drejtorisë së Policisë Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastër
10. Albpetrol për subjektet Qendra e përpunimit të naftës Kucovë dhe Albpetrol ka dërguar pranë Prokurorisë
11. Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor për drejtoritë rajonale ka dërguar pranë Inspektimi Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
12. Bashkia Kukës për Drejtoria e Tregut Agro-Ushqimor ka dërguar pranë Drejtoria Juridike të Bashkisë.

Në nenin 16, janë përcaktuar përgjegjësitë e audituesve të brendshëm, të cilët janë përgjegjës për: *"....ë)raportojnë menjëherë te drejtuesi njësisë auditimit, kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e audituesve të brendshëm përbëjnë vepër penale.*", si dhe në nenin 14, janë përcaktuar përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm, i cili është përgjegjës për: *"....d)raportimin menjëherë në formë të shkruar tek titullari i njësisë publike dhe te Ministri i Financave, i cili ka në varësi strukturën e inspektimit financiar publik, kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e njësisë së auditimit përbëjnë vepër penale.*". Ndërkohë në nenin 12 të LAB, ku janë përcaktuar përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike, ***nuk ka asnjë detyrim ligjor që ata t'u drejtohen organeve të drejtësisë,*** kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e audituesve të brendshëm përbëjnë vepër penale. Kalimi i përgjegjësisë për paraqitjen e rasteve kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e

audituesit të brendshëm apo të drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm përbëjnë vepër penale, ***nga njëra strukturë e ekzekutivit tek tjetra si dhe përqendrimi i kësaj përgjegjësie tek struktura e inspektimit financiar është e padrejtë, zvarrit paraqitjen e këtyre rasteve përpara drejtësisë dhe ndikon në forcimin e luftës ndaj krimit ekonomik dhe korrupsionit***. Nëse çmohet se një parregullsi apo veprim i konstatuar përbën vepër penale, ai duhet referuar menjëherë në organin e prokurorisë nga titullari i njësisë publike të audituar, ndryshe, mund të akuzohet audituesi, përgjegjësi i NJAB dhe drejtuesi i njësisë publike për mos kallëzim krimi. Këto mangësi bien ***në kundërshtim me pikën 1, të nenit 281 të Kodit të Procedurave Penale*** ku përcaktohet se: "*Nëpunësit publik, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht,* ***detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim*** *edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale*".

Mbi organizimin e NJAB në sektorin publik: Nga auditimi konstatohet se punësimi i audituesve të brendshëm në strukturat e AB është mbështetur në nenin 11, të nr. 114/2015, datë 22.10.2015 dhe në VKM nr. 83, datë 3.2.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të NJAB në sektorin publik", i ndryshuar.

Nga të dhënat e konsoliduara deri në fund të vitit 2017 numri i NJAB në sektorin publik që raportojnë pranë Drejtorisë së Harmonizimit të AB, është 115 njësi në qeverisjen qendrore, pushtet lokal, institucione të pavarura dhe shoqëri publike. (Nga 119 – 4) Tabela e mëposhtme jep informacion të detajuar mbi ecurinë e procesit të krijimit të strukturave audituese në subjektet publike për pesë vitet e fundit:

NJAB	**Viti 2012**	**Viti 2013**	**Viti 2014**	**Viti 2015**	**Viti 2016**	**Viti 2017**
Institucione Qendrore	14	16	16	16	16	11
Institucione të Vartësisë	31	30	31	40	47	52
Prefektura & N/Prefektura	15	15	14	14	-	-
Institucione të Pavarura	8	8	8	8	6	9
Pushteti Vendor	41	37	31	25	43	47
Gjithsej	**109**	**106**	**100**	**103**	**112**	**119**

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi konstatohet se, nga një numër i konsiderueshëm i titullarëve të njësive të qeverisjes së përgjithshme, nuk kanë siguruar shërbimin e auditimit të brendshëm në njësitë e tyre në njërën nga format e përcaktuara në nenin 10 të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015. Për këtë mbajnë përgjegjësi Titullarët e njësive publike dhe struktura për harmonizimin e auditimit të brendshëm, e cila zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizuar në fushën e ABP, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar.
Përmbledhtazi sipas të dhënave që na u vunë në dispozicion nga DH/AB, për vitin 2017, në shkallë sistemi auditimi i brendshëm është organizuar në 119 njësi, veprimtaria e të cilave është parashikuar të kryhet nga 429 audites. Në fakt kjo veprimtari është mbuluar nga 400 audites ose 93% e numrit të programuar. Të dhënat gjithashtu tregojnë se nga këta të certifikuar janë 308 audites ose 77% e numrit të punonjësve të përfshirë në këto struktura dhe 92 audites të pa certifikuar ose 23%. Detajuar si 36 punonjës në proces certifikimi dhe 56 punonjës të NjAB që nuk e zotërojnë këtë certifikatë, por duhet të ndjekin procesin e certifikimit. Më hollësisht paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Numri i strukturave	**AB**		**Të certifikuar**	**Të pa certifikuar**	**Në proces**
		Plan	**Fakt**			
2016						
Ministritë	16	93	82	80	1	1

Pushteti vendor	43	125	113	59	34	20
Nivel total	**112**	**420**	**386**	**295**	**58**	**33**
2017						
Ministritë	11	71	65	64	0	1
Inst.Qendrore	32	97	91	80	3	8
Univ.&Sh.a	20	88	84	61	12	11
Inst.pavarura	9	32	29	27	0	2
Bashki	47	140	113	76	21	34
Nivel total	**119**	**429**	**400**	**308**	**36**	**56**

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar nga grupi i auditimit

Në mënyrë analitike për pesë vitet e fundit niveli i përbërjes së strukturave të AB jepet si më poshtë:

	Numri i strukturave	**Audituesë të brendshëm**		**Të certifikuar**	**Të pa certifikuar**	**Nga këta, në proces**
		Plan	**Fakt**			
NJAB viti 2012	109	406	391	320	71	
NJAB viti 2013	106	407	387	328	59	
NJAB viti 2014	100	374	351	291	60	43
NJAB viti 2015	103	395	363	328	35	
NJAB viti 2016	112	420	386	295	58	33
NJAB viti 2017	115	429	400	308	36	56

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat u konstatua se mbetet problematikë fakti se përsëri në strukturat e AB ka persona të pa certifikuar dhe kjo situatë (e pranishme më shumë në organet e pushtetit vendor dhe njësitë e varësisë) mund të cenojë në arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit të brendshëm.

Numri i lartë i punonjësve të pa certifikuar në sistem gjatë dy viteve të fundit përkatësisht 35% në vitin 2016 dhe 23% në vitin 2017, tregon se strukturat e Ab në NJAB kanë lëvizje të vazhdueshme të stafit dhe nga Titullarët nuk i kushtohet vëmendje e veçantë kritereve që duhet të plotësohen, në mënyrë që të garantohet cilësia e auditimeve. Ajo që gjykohet si problematik është fakti që çdo vit numri i audituesve të certifikuar rritet ndërkohë që numri i audituesve të punësuar të pacertifikuar vazhdon të ngelet i lartë, pavarësisht se krahasuar me një vit më parë numri i atyre në proces certifikimi është më i lartë.

Gjykojmë se njësitë publike të cilat kanë nevojë për rekrutim të audituesve të rinj të brendshëm duhet të kërkojnë angazhimin e audituesve të certifikuar nga Ministria e Financave, pasi deri në fund të vitit 2017, janë certifikuar gjithsej 1911 audituesë, ndërkohë nevojat në shkallë sistemi për audituesë të brendshëm për 119 njësia publike janë 429 punonjës, cka do të thotë se për një post pune janë certifikuar mbi 4 audituesë.

Në kuadrin ligjor në fuqi, një nga kushtet e punësimit si audituesë i brendshëm është dhe eksperienca në profesionin bazë, e diferencuar për drejtues të NJAB, audituesë të brendshëm dhe punonjës të NJAB. Sipas vjetërsisë në punë të dhënat për audituesit e punësuar në strukturat e AB-ve paraqiten në tabelën në vijim:

	Numri i audituesve	**Deri 5 vjet**	**Mbi 5 vjet**	**Të pa certifikuar**
NJAB viti 2012	391	158	233	71
NJAB viti 2013	387	164	223	59
NJAB viti 2014	351	146	205	60
NJAB viti 2015	363	135	228	35
NJAB viti 2016	386	172	214	91
NJAB viti 2017	400	162	238	92

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analiza e të dhënave të raportuara nga strukturat audituese, rezulton se 162 punonjës kanë eksperiencë pune në auditim deri në 5 vjet dhe 238 mbi 5 vjet punë si auditues. Fakti që raportohet i grupuar numri i audituesve deri në 5 vjet, *nuk jep informacion të saktë të punonjësve të përfshirë në këto struktura me vjetërsi nën 3 vite pune, për të gjykuar nivelin real të rekrutimit në strukturat e AB.*
Në formularin nr.1, "*Përbërja Profesionale dhe Niveli i Kualifikimit të Punonjësve për periudhën ...*" rezulton se pasqyrohen të dhëna për strukturën, për arsimimin të ndarë sipas specialiteteve, të dhëna për vitet e punës total si dhe si AB dhe të dhënat për certifikimin si AB. Për të qenë më e plotë kjo pasqyrë *duhet të pasqyrohen edhe të dhënat për orët e trajnimit të vijueshëm të detyrueshëm si një detyrim ligjor për çdo të punësuar në këto struktura*.

Nga analiza e përbërjes profesionale të stafit auditues të punësuar gjatë vitit 2017 vihet re që numrin më të madh e zënë specialistë të fushave ekonomike, ku 347 auditues janë ekonomistë, 40 juristë dhe vetëm 13 i përkasin disiplinave të tjera. Fusha të ndryshme të sektorit publik janë objekt i auditimit të brendshëm, për këtë është e nevojshme që në raste specifike audituesit e brendshëm të jenë të profilizuar sipas këtyre fushave. Aktualisht në 119 NJAB në sektorin publik ka dhe rate si më poshtë: NJAB e Ministrisë së Mbrojtjes ka në përbërjen e saj oficer logjistike, NJAB e Ministrisë së Mjedisit ka në përbërjen e saj inxhinier Pyjesh, NJAB e Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor ka në përbërjen e saj mjek dhe farmacist, NJAB në Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike kanë në përbërje inxhinier elektrik, etj.
Nga viti në vit, vihet re një trend në rritje e audituesve të brendshëm me profesion bazë në shkencat ekonomike, nga 337 ekonomistë të punësuar në vitin 2016 në 347 ekonomistë për vitin 2017.
Në pikën 2 nenit 11, të LAB, veç kushteve të përgjithshme, për punonjësit që punësohen në NJAB, kërkohet plotësimi i kushteve të posaçme që janë, diploma universitare e nivelit të dytë, drejtuesi i NJAB duhet të jetë i çertifikuar si "Auditues i brendshëm"dhe të ketë 5 vjet përvojë pune në profesion. Në germën "ç" të kësaj pike është përcaktuar se: "*ç)punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si "Auditues i brendshëm", por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në NJAB dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t'i nënshtrohet procedurës së çertifikimit si "Auditues i Brendshëm*". Ky përcaktim në ligj u krijon mundësi edhe punonjësve të tjerë, që plotësojnë kriteret e përgjithshme, por nuk plotësojnë kriteret e veçanta, që të futen në sistem.
Gjykojmë se një përcaktim i tillë në ligj, lë hapësirë që, sa herë bëhen ndryshime në strukturat e AB apo sa herë ndryshojnë Titullarët e njësive publike, në strukturat e AB të punësohen, pa përcaktim punonjës të pakualifikuar, që mund të ndikojnë në cilësinë e auditimeve që kryejnë.
Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit të Financave, bazuar në në nenet 10 e 26 të LAB, ka nxjerrë VKM nr. 83, datë 3.2.2016 për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendëm ku përcaktohen kriteret e krijimit të NJAB, organizimi e funksionimi i tyre dhe mënyra e sigurimit të shërbimit të auditimit nga njësitë publike që nuk i kanë ngritur këto struktura. Në fjalinë e dytë të pikës 3, të këtij vendimi është përcaktuar se: "*Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik*.", çka do të thotë se, në çdo kohë në strukturat e auditmit të brendshëm në shkallë sistemi, mund të punësohen mbi 143 audutues të brendshëm të paçertifikuar ose në 3 auditues njëri mund të punësohet i pacertifikuar.
Ky përcaktim bie në kundërshtim me germën "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", dhe tejkalon kompetencat e Këshillit të Ministrave i cili sipas nenit 26, të këtij ligji, detyrohet të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 10, 13, dhe 22, por ***jo në zbatim të nenit 11***, ku përcaktohet punësimi i audituesit të brendshëm. Punësimi i audituesve të brendshëm dhe i drejtuesve të njësive të AB është rregulluar me nenin

11 të LAB, e për rrjedhojë nuk mundet që hapësirat e krijuara nga përmbajtja e germës "ç" të nenit 11, të rregullohet me një akt nënligjor(VKM) që nuk e ka fuqinë e ligjit.
Në kuadrin ligjor në fuqi, një nga kushtet e punësimit si auditues i brendshëm është dhe eksperienca në profesionin bazë, e diferencuar për drejtues të NJAB, auditues të brendshëm dhe punonjës të NJAB. Nga analiza e të dhënave të raportuara nga strukturat audituese, rezulton se 162 punonjës kanë eksperiencë pune në auditim deri në 5 vjet dhe 238 mbi 5 vjet punë si auditues. Aktualisht në pushtetin vendor janë krijuar në 46+1 Bashki (pasi në Bashkinë Tiranë funksionon edhe Dr.e Përgjithshme e Tatim Taksave Vendore) njësi të auditimit të brendshëm, nga të cilat në 43 prej tyre kjo veprimtari funksionon normalisht. Në 3 bashki (Bashkitë: Cërrik, Belsh dhe Kurbin) kanë miratuar strukturën e auditimit, por kanë një mungesë të theksuar të kapaciteteve të stafit auditues. Ndërkohë 5 bashki relativisht të vogla (Pustec, Përmet, Këlcyrë, Finiq dhe Libohovë) kanë realizuar shërbimin e auditimit me akt-marrëveshje me njësi auditimi të njësive të tjera publike. Në 7 bashkitë e tjera (Bashkitë: Klos, Poliçan, Has, Pukë, Konispol, Rrogozhinë dhe Delvinë) janë duke bërë përpjekje për realizmin e këtij shërbimi sipas mënyrave të përcaktuara në kuadrin rregullator.

Mbi zbatimin e kritereve për ngritjen e NJAB: Gjatë këtij viti vërehet një numër relativisht i konsiderueshëm i njësive të auditimit të brendshëm, konkretisht 38 njësi ose 32% e tyre që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre me më pak se tre auditues në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektoin publik*", ku përcaktohet se : *... Njësia e AB përbëhet nga jo më pak se tre punonjës përfshirë dhe drejtuesin e njësisë,* gjithashtu konstatohet dhe një nivel relativisht i lartë i njësive që operojnë me staf të pa kualifikuar (7 njësi me drejtues të NJAB të pacertifikuar, 24 njësi me 1/3 ose më shumë të punonjësve të pacertifikuar), gjë e cila ndikon në realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve ligjore.
Shërbimi i auditimit të brendshëm nuk shtrihet në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme konkretisht nga 26 institucione të pavarura vetëm 11 prej tyre janë të mbuluar me shërbimin e auditimit të brendshëm me njërën nga format e përcaktuara në ligj, si dhe 17 njësi publike në varësi të Kryeministrisë vetëm 4 prej tyre janë të mbuluar me shërbimin e auditimit të brendshëm.<u>Përbërja e NjAB-ve</u>

Nr. Rendor	*Njësi me drejtues NjAB-ve të pacertifikuar*	*Numri*	*Pesha*
1	Spitali Shefqet Ndroqi Tirane	2	100%
2	Spitali Rajonal Fier	1	100%
3	Ujesjelles Kanalizime Pogradec	1	100%
4	Bashkia Kucove	3	100%
5	Bashkia Skrapar	1	100%
6	Bashkia Klos	1	100%
7	Bashkia Prrenjas	1	100%
	Njësi me 1/3 ose më shumë të punonjësve të pacertifikuar		
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	1	1/2
2	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	1	1/2
3	Autoriteti Shendetesor Rajonal	1	1/2
4	Spitali i Traumës Tiranë	1	1/3
5	Ujesjelles Kanalizime Tirane	1	1/3
6	Ujesjelles Kanalizime Shkodër	2	2/3
7	Autoriteti Rrugor Shqiptar	1	1/3
8	Bashkia Ura Vajgurore	1	1/2
9	Bashkia Diber	2	2/3
10	Bashkia Mat	2	2/3
11	Bashkia Bulqize	1	1/3
12	Bashkia Shijak	2	2/3
13	Bashkia Roskovec	1	1/2
14	Bashkia Lushnjë	1	1/3
15	Bashkia Divjakë	1	1/2
16	Bashkia Tepelenë	1	1/2
17	Bashkia Maliq	1	1/2

18	Bashkia Kolonje	1	1/3
19	Bashkia Pogradec	1	1/2
20	Bashkia Kukes	2	2/3
21	Bashkia Vau Dejes	2	2/3
22	Bashkia Fushë Arrëz	1	1/3
23	Bashkia Himarë	1	1/3
24	Bashkia Sarande	1	1/2

Përbërja dhe certifikimi i audituesve të NJAB në sektorin publik: *Veprimtaria e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, për zhvillimin e nivelit profesional të audituesve të brendshëm. Vlerësimi i strukturave, kapacitetet. Certifikimi i Audituesve të Brendshëm.*

Ligji për Auditimin e Brendshëm përcakton detyrime dhe përgjegjësi specifike lidhur me zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm. Ligji përcakton gjithashtu krijimin e Komisionit të Kualifikimit, si organ përgjegjës i këtij procesi. Sipas parashikimeve ligjore, më Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 17.02.2016 "Mbi organizimin, funksionimin dhe përbërjen e KKAB dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit" është krijuar KKAB si organi përgjegjës për mbikëqyrjen e certifikimin dhe trajnimin e vijueshëm të detyrueshëm të audituesve të brendshëm publik.
Urdhri i Ministrit të Financave nr. 41, datë 24.03.2016 "Për caktimin e anëtarëve të Komisionit të kualifikimit të Audituesve të Brendshëm" emëron në përbërje të KKAB

1. Znj. S. G, përfaqësuese nga fusha e auditimit të brendshëm
2. Znj. S.T, përfaqësuese nga fusha e legjislacionit në sektorin publik
3. Znj. V. K (I), përfaqësuese nga Universitetet
4. Znj. B.Sh, përfaqësuese nga fusha e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në sektorin publik
5. Znj. N.P, përfaqësuese nga struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm.

KKAB, përveç sa përcaktuar në Ligjin 114/2015, ka funksionuar dhe ushtruar kompetencat mbështetur në: VKM nr. 116, datë 17.02.2016 "Mbi organizimin, funksionimin dhe përbërjen e KKAB dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit", Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 3, datë 01.2016, " Për miratimin e Rregullores së TVD për audituesit e brendshëm" dhe Urdhrit Nr. 37, datë 16.03.2016 " Për miratimin e procedurave për certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik" ndryshuar me Urdhër nr.26 datë 21.03.2017 si dhe Urdhër nr.136 datë 30/12/2016 për "Miratimin e pragramit te trajnimit të vijueshëm te detyrueshëm për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2017".
Mbështetur në përcaktimet e akteve të mësipërme, KKAB (Komisioni i Kualifikimit të AB) parashikohet të kryejë funksion mbikëqyrës të procesit të trajnimit dhe certifikimit të audituesve dhe bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për auditimin e brendshëm në Ministrinë e Financave.
Në rregulloret përkatëse nuk ka një ndarje të qartë midis detyrave administrative të procesit dhe funksionit vendimmarrës e atij mbikëqyrës për KKAB ashtu dhe për strukturën përgjegjëse të harmonizimit për AB.
KKAB ka përgjegjësinë të shqyrtojë dhe miratojë kurrikulat e përgatitura nga trajnerët dhe njëkohësisht paraqitet si mbikëqyrës i procesit të trajnimit dhe certifikimit. (neni 13, pika f, g e Rregullores për TVD, Neni 6 i Rregullores për Certifikimin e AB). ***Po kështu KKAB ka përgjegjësinë për të miratuar Listat e Kandidatëve për certifikim, detyrë kjo që duke qenë një nga fazat e procesit , bie nën përgjegjësitë e DH/AB.***Duke sjellë në këto kushte një përplasje të detyrave të strukturave të përfshira në proces.
Gjatë vitit 2016, janë kryer mbledhje në funksion të certifikimit, trajnimit të vijueshëm të audituesve të brendshëm e të tjera. Në përfundim të mbledhjeve konkluzionet e mbledhjes dhe detyrat për të ardhmen janë reflektuar në vendimet përkatëse të Komisionit.

Mbështetur në Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe përbërjes së KKAB theksohet se:

Kryetari i KKAB zgjidhet me shumicë të thjeshtë votash. Votimi bëhet i fshehtë dhe në rast se nuk bihet dakord për zgjedhjen Kryetarin, ky i fundit caktohet nga Ministri i Financave. Mandati i Kryetarit zgjat dy vjet me të drejtë rizgjedhje.
Komisioni mblidhet në seanca të zakonshme. Në mbledhjen e parë të çdo viti miraton Kalendarin e Mbledhjeve për vitin në vijim.
Kryetari i KKAB, nëpërmjet sekretarit të KKAB, njofton të gjithë anëtarët për datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet mbledhja e ardhshme. Njoftimi përmban gjithashtu një axhendë paraprake të çështjeve që do të trajtohen dhe bëhet nëpërmjet postës elektronike, jo më vonë se 5 (pesë) ditë para zhvillimit të mbledhjes.
Mbledhja drejtohet nga Kryetari dhe në mungesë të tij nga anëtari me moshë më të madhe. Në raste të veçanta mbledhja mund të thirret me kërkesë të:

a. Ministrit të Financave;
b. Drejtorit të përgjithshëm të NJQH për AB;
c. Të paktën 3 prej anëtarëve të KKAB. Në këtë rast mbledhja organizohet brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga depozitimi i kërkesës;

Korumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve të Komisionit të Kualifikimit është jo më pak se tre anëtarë me të drejtë vote.
Gjatë zhvillimit të mbledhjes, *sekretari i KKAB mban minutat e takimit*të cilat së bashku me vendimet e marra nënshkruhen nga të gjithë pjesëmarrësit në mbledhje.
Përfundimet e çdo mbledhje pasqyrohen në një memorandum, i cili i bëhet i ditur Ministrit të Financave dhe së bashku me Procesverbalin e mbledhjes, depozitohen në protokollin e Ministrisë së Financave.
Kryetari i Komisionit të Kualifikimit nënshkruan dëshminë ”Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” sipas formatit të miratuar nga Ministri i Financave.
Gjatë vitit 2017, janë kryer mbledhje në funksion të certifikimit të audituesve të brendshëm si më poshtë vijojnë:

Me nr. 5298 prot, datë 14.04.2017 është nxjerr Urdhër Nr. 34 “Për fillimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për sezonin 2017-2018. Më pas vendimet e marra nga KKAB për vitin 2017 janë:
-Vendimi nr. 27, datë 26.05.2017 “*Për shpalljen e listës paraprake të kandidatëve për auditues të brendshëm në sektorin publik për përfshirjen e procesit të certifikimit”* dhe *“Për shpalljen paraprake të kandidatëve për trajner”.*
-Vendimi nr. 28, datë 31.05.2017 “*Miratimi i listës përfundimtare për trajner në procesin e certifikimit për auditues të brendshëm”* (mbledhja e ardhshme 02.06.2017 për hartimin e tezës së riprovimit)
-Vendimi nr .29, datë 09.06.2017 “*Për shpalljen e listës përfundimtare të kandidatëve për auditues të brendshëm në sektorin publik për përfshirjen e procesit të certifikimit”* dhe “*Shpallja e rezultateve të riprovimit për kandidatët për auditues të brendshëm për sezonin 2016-2017*” (skemi dok) (mbledhja e ardhshme nuk ka datë dhe mungon procesverbali dhe vendimi i mbledhjes së ardhshme në fjale, për provimin me gojë)
-Vendimi nr.30, datë 27.06. 2017 “*Për miratimin e programit të certifikimit për auditues të brendshëm në sektorin publik dhe kalendarin e zhvillimit të procesit*” (mbledhja e ardhshme datë 29.06 “Për hartimin e listës së kandidatëve që fitojnë auditues të brendshëm)
-Vendimi nr. 01, datë 04.09.2017 “*Crregjitrimi i 3 aplikantëve nga lista përfundimtare e kandidatëve për auditues të brendshëm në sektorin publik, shpallur fitues në procesin e certifikimit për sezonin 2017-2018”* (takimi ardhshëm datë 29.09.2017 *“Për hartimin e tezë së modulit bazë 1)*
- Vendimi nr. 02, datë 30.09.2017 “*Për hartimin e tezës së testimit në modulin bazë 1, për kandidatët për auditues të brendshëm në procesin e certifikimit në sezonin 2017-2018”* dhe

"Kryerja e procedurës së sekretimit të fletoreve" (takimi i ardhshëm pa datë, për c'sekretimin e fletoreve)
-Vendimi nr. 03., datë 11.10.2017 "*Për kryerjen e procedurës së csekretimit të fletoreve, të testimit për modulin bazë 1 dhe shpalljen e rezultateve të testimit"(takimi i ardhshëm do të zhvillohet për hartimin e tezës së testimit të njohurive të modulit bazë 2)*
-Vendimi nr. 04. datë.04.11.2017 *"Për hartimin e tezës së testimit në modulin bazë 2, për kandidatët për audituesë të brendshëm në procesin e certifikimit në sezonin 2017-2018" dhe "Kryerja e procedurës së sekretimit të fletoreve"(*takimi i ardhshëm do të zhvillohet për csekretimin)
-Vendimi nr. 05 mungon
-Vendimi nr. 06, datë 17.11.2017 *"Kryerja e procedurës së csekretimit të fletoreve"* dhe *"Shpallja e rezultateve të testimit të njohurive në modulin bazë 2*" (takimi i ardhshëm për hartimin e tezës së modulit 03"
- Vendimi nr. 07, datë 02.12.2017 *"Për hartimin e tezës së testimit në modulin bazë 3, për kandidatët për audituesë të brendshëm në procesin e certifikimit në sezonin 2017-2018"* dhe "*Kryerja e procedurës së sekretimit të fletoreve"*(takimi i ardhshëm do të zhvillohet për csekretimin)
-Vendimi nr. 08.datë 15.12.2017 *"Kryerja e procedurës së csekretimit të fletoreve*" dhe *"Shpallja e rezultateve të testimit të njohurive në modulin bazë 2"* (takimi i ardhshëm për do të zhvillohet sipas axhendës së KKAB)
Nga auditimi u konstatua se provimet sipas moduleve përkatëse nuk janë kryer në datat e përcaktuara, në kalendarin e mbledhjes nr.30, datë 27.06.2017, por një ditë më vonë.
Nga auditimi u konstatua se për sa i përket procedurës së kryerjes së vlerësimit të testeve paraprake, nuk arrijmë të marrim siguri të mjaftueshme mbi kryerjen e këtij procesi dhe nuk arrijmë të vërtetojmë pikën 1, 4, 5 të nenit 18 .

Nga të dhënat e marra prej rezultateve të testimit për secilin modul rezulton se, në modulin e parë kanë marr pjesë 48 aplikantë, në të dytin 50 në modulin e tretë kanë qenë 47. Pra në asnjë prej moduleve nuk kanë qenë prezent të gjithë aplikantët.

- Nga auditimi i procesit të certifikimit rezultoj se, mbështetur në nenin 7 pika 1 i Rregullores miratuar me Urdhër nr. 37 datë 16.03.2016 struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm *është përgjegjëse për kryerjen e analizës së nevojave për certifikim të punonjësve të punësuar në njësitë e AB* detyrë kjo e cila nuk rezulton e plotësuar nga kontrolli fizik i dosjes së certifikimit.
- Në zbatim të pikës 2 të nenit 7, e cila citon se.. DH/AB *është përgjegjëse për dërgimin për miratim të urdhërit për fillimin e procesit të certifikimit tek Ministri i Financave* është përcaktuar data 18.04.2017 për fillimin e procesit të certifikimit dhe afati për dorëzimin e dokumenatve është vendosur data 14.05.2017.
- Nga auditimi u konstatua se, për periudhën e certifikimit 2017-2018 nuk është kryer asnjë publikim nga ana e DH/AB lidhur me procesin e certifikimit për këtë periudhë, në kundërshtim të nenit 24 të Rregullores "Për procedurat e certifikimit të audituesve të brendhshëm në sektorin publik" e cila specifikon se " Struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB, publikon në faqen zyrtare të MF të gjithë informacionet në lidhje me njoftimin për aplikim, shpalljen e kandidatëve fitues, modulet e programit, leksionet, shembujt e rasteve praktik, literaturën bazë dhe të rekomanduar, datat dhe rezultatet e testeve paraprake, provimeve me shkrim dhe me gojë, riprovimeve, listën përfundmitare me kandidatët fitues dhe çdo informacion tjetër që lidhet me procesin e certifikimit." Gjithashtu, më konkretisht ajo janë trajtuar në nenin 7, pikave si më poshtë:

-Pika 9 "*Publikimin në faqen zyrtare të MF të trajnerëve të përzgjedhur, kandidatëve për audituesë të brendshëm që kualifikohen për të ndjekur procesin e certifikimit."*
-Pika 11*"Publikimi në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave të rezultateve të testeve paraprake, të provimit me shkrim, riporivimeve, provimit me gojë dhe listës përfundimtare me kandidatët fitues të titullit "Audituesë i brendshëm në sektorin publik".*
Gjithashtu në vijim të nenit 24, nuk arrijmë të marim siguri mbi mënyrën e komunikimit mes strukturës përgjegjëse për harmonizim të AB dhe Komisionit, Trajnerëve, Mbikëqyrësve dhe Kandidatë për audituesë të brendshëm duke cënuar kështu parimin e transparencës.
Në pikën 12 të nenit 7, përcaktohet se Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm është përgjegjëse për "*Kryerjen e vlerësimit të performancës së trajnerëve të zgjedhur pas përfundimit të procesit të certifikimit*", detyrë kjo që nuk rezulton të jetë kryer nga kjo njësi.
Pika 14 e po këtij neni përcakton se DH/AB është përgjegjëse për *"Përpunimin e formularëve të Vlerësimit të performancës së certifikimit, në përfundim të procesit të certifikimit dhe paraqitjen e raportit për informacion Komisionit, si dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave."* Nga auditimi konstatohet se kjo gjë nuk është kryer për certifikimet e vitit 2015-2016 dhe 2016-2017.
- Nga auditimi i dosjes së KKAB, rezuloi se nuk ishte hartuar kalendari i i veprimtarisë, në kundërshtim me pikën 6 të kreut II të VKM nr. 116 datë 17.02.2016 hartuar në mbledhjen e parë të këtij komisioni, por disa muaj më vonë, përkatësisht në mbledhjen nr.30, datë 27.06.2017.
- Po ashtu, në kundërshtim me pikën 11 e cila specifikon se ...*përfundimet e çdo mbledhje duhet të pasqyrohen në një memorandum, i cili i bëhet i ditur ministrit të financave dhe së bashku me procesverbalin e mbledhjes, depozitohen në protokollin e MF*... ky memorandumi mungonte po ashtu si dhe korrespondenca.
- Nuk rezultonte e zbatuar pika 4, e cila thekson se ... *mbledhja e KKAB thirret nga kryetari, jo më vonë se pesë ditë para mbledhjes, duke u njoftuar anëtarëve rendin e ditës, të shoqëruar me materialet përkatëse...*
Theksojmë se certifikimi i audituesve të brendshëm për periudhën 2017-2018 ka vijuar gjatë periudhës që u krye ky auditim dhe nuk janë arritur të merren përfundimet e trajnimit për këtë arsye është operuar me periudhën 2016-2017. Për këtë arsye vendimet e mbledhjeve të mëposhtme i përkasin asaj periudhë.
- Vendim nr. 22 datë 01.04.2017 për *"Hartimin e tezës për testim në modulin bazë VI të kandidatëve për audituesë të brendshëm në procesin e certifikimit në sezonin 2016-2017" dhe "Kryerja e procedurës së sekretimit të fletoreve të provimit".*
Takimi i ardhshëm do të zhvillohet më 14 Prill për ç'sekretimin e fletoreve të provimit të modulit bazë VI.
- Vendim nr. 23 datë 07.04.2017 për "*Kryerjen e procedurës së ç'sekretimit të fletoreve të testimit të Modulit bazë 6*" dhe "*Shpallja e rezultateve të testimit të njohurive në modulin bazë 6".*
Takimi i ardhshëm do të zhvillohet më 24 Prill për hartimin e bankës së pyetjeve të provimit me shkrim të procesit të certifikimit për audituesë të brendshëm.
- Për procesverbalin e datës 32 datë 24.04.2017 mungon bashkangjitur formati i Vendimit!
- Vendim nr.24 datë 29.04.2017 për "*Hartimin e tezës së provimit me shkrim për testimin e njohurive të kandidatëve për ab në sektorin publik në procesin e certifikimit 2016-2017*" dhe "*Kryerjen e procedurës së sekretimit të fletoreve të provimit".*
Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të materialeve të provimit në krye mungojnë emrat e anëtarëve të komisionit të kualifikimit.
- Vendim nr. 25 datë 12.05.2017 për "*Kryerjen e procedurës së sekretimit të fletoreve të provimit me shkrim të kandidatëve për audituesë të brendshëm në procesin e certifikimit 2016-*

2017", "Shpallja e rezultateve të provimit me shkrim"dhe "*Miratimin e temave për hartimin e tezës praktike për provimin me gojë të kandidatëve për audituesë të brendshëm në procesin e certifikimit në sezonin 2016-2017".*
Takimi i ardhshëm do të zhvillohet më 02 Qershor për hartimin e tezës së riprovimit me shkrim.
- Vendim nr. 26 datë 26.05.2017 për "*Shpalljen e rezultateve përfundimtare të provimit me shkrim të kandidatëve për të për audituesë të brendshëm në procesin e certifikimit në sezonin 2016-2017".*
Takimi i ardhshëm do të zhvillohet më 24 Prill për hartimin e bankës së pyetjeve të provimit me shkrim të procesit të certifikimit për audituesë të brendshëm.
- Vendim nr. 29 datë 09.06.2017 për "*Shpalljen e listës përfundimtare të kandidatëve për audituesë të brendshëm në sektorin publik për përfshirjen në procesin e certifikimit në sezonin 2017-2018"* dhe *"Shpalljen e rezultateve të riprovimit të kandidatëve për audituesë të brendshëm në procesin e certifikimit në sezonin 2016-2017".*
Takimi i ardhshëm do të zhvillohet për kryerjen e procedurës me gojë të kandidatëve për audituesë të brendshëm në procesin e certifikimit 2016-2017
- Vendim nr. 31 datë 29.06.2017 për "*Miratimin e rezultateve të provimit me gojë dhe listës së kandidatëve që fitojnë titullin 'Audituesë i brendshëm në sektorin publik'".*
Bshkangjjitur Vendimit ishte lista e rezultateve të provimit me gojë të kandidatëve për audituesë por mungonte lista e kandidatëve fitues të titullit.
Përfundimi i procesit të certifikimit të kandidatëve për audituesë të brendshëpër sezonin 2016-2017 është kryer me 37 kandidatë për Audituesë të Brendshëm.
Data e riprovimit me shkrim nga 01.06.2017 parashikuar në kalendar është kryer në 02.06.2017
Për periudhën 2016-2017 kandidatët i janë nënshtruar edhe provimit të modulit specifik, i cili ka qenë për kategori të veçantë të tyre (ata që nuk gëzonin statusin e nënpunësit civil dhe njohuritë e kërkuara në këtë modul i justifikojnë me trajnimet e ndjekura në ASPA).
Më Vendim nr. 6 datë 16.09.2016 është "Hartuar teza për testimin e Modulit Specifik" dhe "Kryerja e procedurës së sekretimit të fletoreve të provimit".

Nga auditimi i dosjeve të aplikantëve të përzgjedhur në procesin final, mbështetur në nenin 9, kreu III kriteret dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve, në lidhje me të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë punonjësit që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që po auditohet
- Të kenë përvojë pune 3 vjet në profesion
- Të jetë i punësuar në njësinë e auditimit të brendshëm

U konstatuan raste të mos përditësimit të librezave të punës, një rast punonjësi me kontratë, një rast pozicioni provizor dhe delegim kompetencash drejtori. Konkretisht, nga të dhënat e marra nga auditimi fizik i dosjeve rezulton si më poshtë vijon:

- Kandidatja A. S, nga auditimi i librezës së punës dhe Cv rezulton të jetë punësuar më datë 08.06.2016 dhe nuk ka më azhornime të mëpasshme të librezës së punës;
- Kandidatja J.M, nga auditimi i librezës së punës rezulton të ketë filluar në 22.07.2015 deri më 31.12.2016 kohë kur i është ndërprerë kontrata dhe ka rifilluar më 27.01.2017 dhe pas kësaj periudhe nuk ka më të dhëna në librezë, ndërkohë që në Cv rezulton punësimi për periudhën 22.07.2013-31.12.2016 ndërsa në vërtetimin e marr nga Institucioni ku punon rezulton në periudhë prove
- Kanditatja L. S nga auditimi i librezës së punës rezulton të ketë të dhëna të punësimit të periudhës 03.12.2010-05.10.2015 si pasojë e ristrukturimit dhe për emërimin e ri në periudhën 05.10.2015 por asnjë informacion për periudhën e mëvonshme, ndërkohë që në Cv informacioni është i azhornuar deri më 10.10.2016 e aktualisht kohë kur është emëruar në pozicionin aktual.

- Kandidati L. Z nga auditimi i librezës së punës rezulton se nuk ka të hedhur informacionin mbi punësimin aktual, por ka të dhëna deri më 31.10.2015 kohë kur është larguar nga pozicioni i mëparshëm, ndërkohë në Cv jepet informacion për periudhën 01.11.2015 e në vijim.
- Kandidatja V. S nga auditimi i librezës së punës rezulton të ketë të dhëna të azhornuara për periudhën deri 01.03.2011 ndërkohë në Cv janë të axhornuara deri më 06.11.2014 e aktualisht.
- Kandidati E.B rezulton të jetë punonjës me kontratë në SAB pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Për kriteret kualifikuese të AB: Nga auditimi në lidhje me çertifikimin e audituesve të brendshëm publik, u konstatua se DH/AB ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në rregulloren e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 37, datë 16.03.2016. Kriteret e kualifikimit të audituesve të brendshëm publik janë rregulluar në kapitullin e VI-të LAB, ku në nenin 19, pika 2, përcaktohet se, të drejtën për të aplikuar në procesin e çertifikimit e kanë të gjithë individët e klasifikuar në shkronjën "ç" të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, pra punonjësi, që nuk zotëron çertifikatën si "Auditues i brendshëm" , por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Gjatë kësaj periudhe ai duhet të pajiset me çertifikatën e audituesit të brendshëm, ndryshe ndërpret marrëdhëniet e punës. Sipas pikës 1, të nenit 19, të këtij ligji, Ministri i Financave ka detyrimin ligjor të përcaktojë procedurat e çertifikimit të audituesve që nuk e zotërojnë këtë çertifikatë, por ***jo të përcaktojë kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët***, pasi ato janë të përcaktuara me ligj.
Konstatohet se, pikat 2 dhe 3, të nenit 9, të "Rregullores për procedurat e çrtifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik" miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 37, datë 16.03.2016, janë në tejkalim të ligjit pasi;
- Së pari; Ministri nuk mund të vendosë kritere të tjera, veç atyre të përcaktuara në nenin 11, të LAB, sipas të cilit në strukturat e AB mund të punësohet edhe punonjës të paçertifikuar por, që kanë një përvojë pune 3 vjet në profesion dhe që kanë një diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera.
- Së dyti; germa "c" e pikës 2 të nenit 9, të kësaj rregulloreje, kufizon të drejtën e auditueve të jashtëm që duan të pajisen me çertifikatën e audituesit të brendshëm, e drejtë kjo e fituar me nenin 11, të LAB.
- Së treti; punonjësve që zotërojnë një diplomë universitare të nivelit të dytë dhe kanë përvojë pune 3 apo 5 vjet, sa ajo e caktuar me ligj, nuk mund tu kërkohet "*të vërtetojnë se kanë marrë njohuritë mbi parimet e kontabiliteti publik(deri tani nuk është miratuar ndonjë ligj për kontabilitetin publik), pasqyrat financiare, sistemin buxhetor publik, si dhe njohuritë bazë mbi aktet ligjore dhe nënligjore të sektorit publik*", pasi ata janë diplomua në fushat përkatëse që kërkon ligji dhe kanë përvojën e kërkuar profesionale. Kandidati për tu çertifikuar si auditues i brendshëm mund të jetë jurist apo i një profesioni tjetër, çka nuk mund ti kërkosh të provojë njohuri jashtë profesionit të tij.

Përsa i përket procesit të asqjësimit:
Nga auditimi u konstatua se i gjithë dokumentacioni që lidhet me mbledhjet e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe dokumentacioni që lidhet me zhvillimin e procesit të certifikimit të Audituesve të brendshëm sikundër përcaktohet në nenet 6 dhe 8 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 37, datë 10.03.2016 "*Për miratimin e Rregullores për procedurat e certifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar, ***është inventarizuar por nuk është dorëzuar në Arkivin e Ministrisë*** së Financave nga Sekretari i KKAB dhe nga nëpunësi përgjegjës për procesin e certifikimit të Audituesve të Brendshëm, në kundërshtim me

pikën 5, të nenit 6, ku përcaktohet se Sekretari i KKAB është përgjegjës për: "*Arkivimin në fund të çdo procesi certifikimi të të gjithë dokumenteve që lidhen më zhvillimin e mbledhjeve të Komisionit*" dhe me pikën 10 të nenit 8, ku përcaktohet se, nëpunësi përgjegjës për procesin e certifikimit të AB, është përgjegjës për: "*Dorëzimin në përfundim të çdo procesi certifikimi të dokumenteve në arkivin e Ministrisë së Financave, në përputhje me ligjet në fuqi".*

Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të nenit 23 të Rregullores së sipërcituar me shkresën nr. 13169, datë 26.09.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të DH/AB&MFK është caktuar Komisionin i asgjësimit të fletoreve të testeve paraprake, të provimit dhe riprovimit, i ndryshuar me shkresën nr. 13199/1 datë 29.09.2017 (është ndryshuar njëri prej anëtarëve të këtij komisioni), i përbërë prej z. B. L Drejtor i DH/AB, S.B, specialist në DH/AB dhe D. E, specialist në sektorin e Shërbimeve. Ky komision ka mbajtur procesverbalin e datës 23.10.2017 mbi procesin e asgjësimit të materialeve dhe fletoreve të procesit të certifikimit për sezonin 2016-2017, ku ka cilësuar numrin e fletoreve për secilin test paraprak, për provimin dhe riprovimin me shkrim dhe për modulin specifik. Në këtë procesverbal cilësohet se ky Komision ka bërë numërimin e fletoreve dhe më pas asgjësimin e tyre nëpërmjet procesit të grisjes. Ky proces është dokumentuar vetëm nëpërmjet një procesverbali në trajtë narrative pa prova të tjera justifikuese mbështetëse dhe të besueshme që procesi ka qenë i sigurte dhe i besueshëm.

Nga auditimi u konstatua se, në nenin 23 të kësaj Rregulloreje është përcaktuar se: "*Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e çertifikimit dorëzohen dhe ruhen në protokollin e Ministrisë së Financave në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletoreve të provimeve dhe riprovimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 3 muaj nga data e dhënies së provimit/riprovimit. Asgjësimi i tyre bëhet nga një komision prej tre anëtarësh, të caktuar me urdhër nga struktura përgjegjëse për kualifikimin në përbërje të të cilit janë dy punonjës të strukturës përkatëse për kualifikimin dhe një punonjës i strukturës përgjegjëse për shërbimet në Ministrinë e Financave. Deri në asgjësimin e tyre, fletoret administrohen nga struktura përgjegjëse për kualifikimin".*
Ky përcaktim nuk është në përputhje me Kreun II-E "*Ekspertiza e vlerës së ruajtjes së dokumenteve të Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*" të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 15 të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*", nenet 32-35, ku përcaktohen detyrimet e subjekteve shtetërore të cilat hartojnë listën konkrete të dokumenteve të tyre me rëndësi historike dhe me afat ruajtje të përkohshme, si dhe përcaktojnë afatet e ruajtjes për këto të fundit sipas modelit nr. 11, si dhe mënyra e asgjësimit të dokumenteve sipas listës së veçimit. Mënyra e asgjësimit e përcaktuar në këtë Rregullore është e gabuar dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 35 të "*Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*", ku përcaktohet se, **asgjësimi i dosjeve të përfshira në listën e veçimit, bëhet nga arkivi, apo sekretari-arkivi i subjektit shtetëror apo jo shtetëror duke i dërguar në fabrikat e letrës ose me djegie** dhe për asgjësimin e tyre mbahet procesverbal sipas modelit. 12. të përcaktuar në këto norma.

Regjistri i Audituesve të Brendshëm
Nga auditimi për ushtrimin e funksioneve të DH/AB lidhur me hartimin dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të audituesve të brendshëm të çertifikuar konstatohet se:
DH/AB mban regjistrin për regjistrimin e audituesve të brendshëm që certifikohen si "Auditues i brendshëm në sektorin publik", të emërtuar "Regjistri Themeltar i Audituesve të Brendshëm për çdo vit akademik" në të cilin përshkruhen: Numri rendor që fillon me numrin 1, numri i amzës që fillon me numrin 0001, periudha e trajnimit, emri atësia mbiemri, modulet e trajnimit nga 1 në 5 (6 deri vitin e kaluar), data e lëshimit të certifikatës, vlerësimi dhe nënshkrimi i

audituesit.
Nga auditimi u konstatua se forma dhe përmbajtja e Regjistrit të Audituesve të Brendshëm përmban informacion të limituar. Regjistri duhet të emërtohet "Regjistri Kombëtar i Audituesve të Brendshëm të Certifikuar", për periudhën ...., ashtu siç është përcaktuar në ligj, dhe të përmbajë informacion agregat në vite. Kjo do të mundësojë një pamje më të përgjithshme dhe me detaje të nevojshme për çdo person të përfshirë në sistemin e certifikimit të audituesve të brendshëm publik në Shqipëri, si dhe do ta bëjë këtë regjistër më të sigurt dhe më pak të cenueshëm prej manipulimit, apo ndërhyrjeve abuzive.
Përcaktimi i vlerës dhe i afatit të ruajtjes të Regjistri Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të Çertifikuar, si një dokument zyrtar i cili duhet të pasqyrojë të dhënat kryesore që përmban çertifikata me të cilën pajisen audituesit e çertifikuar si emrin atësinë mbiemrin, numrin e amzës, datën e lëshimit të certifikatës, vlerësimin e komisionit dhe nënshkrimin e audituesit të certifikuar dhe i shërben poseduesit të saj për të gjithë kohën që ai është i punësuar duhet të bëhet në përputhje me pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "*Për Arkovat*", neneve 21-23dhe 32-35 të "*Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*" dhe "*Listës Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Histarike Kombëtare (RHK)*", Artikulli përshkrues Nr. 287 dhe Nr. 288. Ky regjistër, krahas publikimit në faqen zyrtare të internetit në rubrikën përkatëse të Ministrisë së Financave duke ruajtur të dhënat personale të personave, duhet të protokollohet dhe të ruhet në zyrën e protokollit të kësaj Ministrie, si dokument i ruajtjes së përhershme dhe çdo shtohet me listën e audituesve të çertifikuar.
Për sa më sipër gjykojmë se regjistri ekzistues duhet rishikuar dhe të ndërtohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit për Auditin e Brendshëm dhe Akteve të tjera rregulluese nënligjore, ku detyrimisht në përfundim të çertifikimit dhe dhënies së certifikatës, të evidentohen të dhëna për: nivelin e diplomës universitare që zotëron (në profesionin ekonomist, jurist apo disiplina të tjera), përvoja e punës në profesion, vitet e punës në total dhe ato në njab, modulet, vlerësimi respektiv të dhënë nga komisioni i kualifikimit, nënshkrimi prej anëtarëve të komisionit në çdo fletë të regjistrit, informacion në rast se ka ç'rregjistrim nga regjistri kombëtar si dhe informacion në rastet e konvertimit të çertifikatave etj.
Ky regjistër në përfundim të çdo sezoni çertifikimi duhet plotësuar dhe depozituar në zyrën e protokoll arkivës të Institucionit si dokument i ruajtjes së përhershme.

Gjetjet e auditimit të brendshëm:
Për vitin 2017 nga analiza e kryer në raportimet e njësive të auditimit të brendshëm pjesë e ministrive dhe institucioneve qendrore, gjetjet kryesore në numër dhe në vlerë monetare kanë të bëjnë kryesisht me mosfunksionimin siç duhet të sistemit të prokurimeve, blerjeve dhe investimeve, sistemit të administrimit të pronës dhe pasurisë, sistemi i tatimeve, taksa dhe dogana dhe sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit. etj. ku më kryesoret përmendim gjetjet:

- Në sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe investimeve, kryesisht me nënshkrim të kontratave duke ndryshuar kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, mosndjekjen e hapave ligjorë për blerjet e vogla, blerjen e mjeteve të transportit në kundërshtim me specifikimet teknike, etj.
- Në sistemin e administrimit të pronës dhe pasurisë. Referuar raporteve të dërguara nga NJAB-të, rezulton se ka pasur probleme me procesin e vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, asgjësimit me tjetërsim të formës fillestare, marrjes së titujve të pronësisë së trojeve dhe ndërtesave, etj.
- Në sistemin e kontabilitetit. Konsiston në parregullsi të funksionimit të sistemit të kontabilitetit (dokumenta jo të besueshme), në inventarët e njësive mbahen aktive, të cilat nuk ekzistojnë dhe kanë të bëjnë me vlerën e objekteve ndërtimore të amortizuar dhe të

dëmtuara plotësisht, etj. Nga analiza rezulton që gjetjet lidhen me fushat e vlerësuara me risk të lartë që në fazën e planifikimit të veprimtarisë audituese, ato do të trajtohen në mënyrë të vazhdueshme si nga audituesit e brendshëm, subjektet e audituara ashtu edhe nga titullarët e njësive publike.

Të dhënat numerike mbi rastet e konstatuara të dëmit ekonomik, si dhe ndikimi që ato kanë pasur në buxhetin e subjekteve të audituara në mënyrë të përmbledhur jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela " Gjetjet me dëm ekonomik sipas sistemeve, viti 2017"

Nr.	Gjetjet sipas sistemit	Dëmi ekonomik (000/lekë)	Gjetje %	Gjetje në numër	Gjejtje %
1	Prokurim, blerje dhe investime	7.276.824	93%	796	13%
2	Paga, shpërblime, trajtime, komisione	56.249,28	1%	515	8%
3	Fondet e sig. shoq dhe shëndetësore	8.017,74	0%	83	1%
4	Tatime, taksa dhe dogana	291.854,4	4%	606	10%
5	Admin. prone dhe pasurie	17.520,6	0%	751	12%
6	Privatizime, shitje dhe qeradhënie	21.546,2	0%	192	3%
7	Koncesione dhe ankande	11.303	0%	32	1%
8	Legalizime, urbanistikë dhe kthim pronash	2.405,7	0%	88	1%
9	Kreditim, subvencione	24.567,8	0%	22	0%
10	Të tjera	138.207	2%	3201	51%
	TOTALI	7.848.500,4	100%	6286	100%

Në tabelën e mësipërme tregohet në mënyrë të qartë se gjatë vitit 2017, sistemi i prokurimeve, blerjeve dhe investimeve dhe tatim, taksa dhe dogana kanë pasur gjetjet me vlerë më të madhe të shkeljeve të konstatuara.

Vërehet se nga auditimet e kryera janë konstatuar 6286 raste të shkeljeve, për të cilat gjetjet llogariten në 7.848,5 milionë lekë.

Tabela, vlera e dëmit në nivel total për një periudhë 5 vjeçare, shprehur në 000/lekë.

Gjetjet	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**
Totali (në vlerë)	3.199.964	4.321.991	20.138.457	68.789/.45	2.111.308	7.848.500
Totali (në numër)	4.698	3.556	4.441	4.186	9.421	6.286
Numri i audituesve	391	387	351	352	386	400
Demi/AB	8.184	11.168	57.375	195.423	5.470	19.621

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar grupi i auditimit

Konstatojmë se viti 2017, reflekton të dhënat më të larta referuar shkeljeve financiare në sektorin publik krahasuar me vitin 2016, ndërkohë që mesatarisht niveli i dëmeve të konstatuara për një audites në vit është 19.621 mijë lekë (7.848.500/400). Nga analiza e gjetjeve me dëm ekonomik në shkallë sistemi prej 7.848.500 mijë lekë, shuma prej 6.029.000 mijë lejë i përket një auditimi të kryer nga NJAB e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në Autoritetin Rrugor Shqiptar. NJAB e MIE përbëhet nga 8 audites e cila ka konstatuar 6,029,000 mijë lekë gjetjeve me dëm ekonomik, ndërsa pjesa tjetër e gjetjeve me dëm ekonomik prej 1.819.500 mijë lekë i përket NJAB të tjera që në përbërje të tyre kanë 392 audites, e për rrjedhojë niveli i dëmeve të konstatuara për një audites në vit është 4.642 mijë lekë.

Gjatë këtij viti janë evidentuar nga audituesit e brendshëm 18 raste për investigim të mëtejshëm nga njësi të specializuara. Këto janë trajtuar nga 12 NJAB kryesisht të: Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, AKU, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, P Sh sha, Albpetrol, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor dhe Bashkia Kukës. Pesë prej këtyre rasteve i janë drejtuar për investigim të mëtejshëm Drejtorisë së Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pesë raste prokurorive të rretheve përkatëse, rastet e tjera i janë drejtuar titullarëve të njësive publike, Agjensisë së Prokurimit dhe Drejtorive të Policisë së Qarqeve përkatëse.

Mbi statusin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm: Në formularin nr. 4, "*Rekomandimet e dhëna nga NJAB për periudhën (...)*", pasqyrohen të dhënat për rekomandimet ***e pranuara dhe të zbatuara*** gjithsej, sipas prioriteteve, ***por nuk pasqyrohen të dhënat për rekomandimet e papranuara dhe arsyet se pse***. Po ashtu nga auditimi i dosjeve u konstatua se, pjesa më e madhe e njësive publike totalin e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak nuk janë hedhur fare ose janë të pasakta. Gjykojmë të nevojshme se përmirësimi i pasqyrave statistikore me të gjithë treguesit e nevojshëm do t'u shërbejnë më mirë titullarëve të njësive publike për përmirësimin e veprimtarisë dhe rritjen e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e e sektorit publik.

Është e njohur që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër përgjegjësia e auditimit të brendshëm nuk kufizohet vetëm në dhënien, por dhe në monitorimin e vazhdueshëm të rekomandimeve të lëna, pasi dhe rezultatet e punës audituese varen në një masë të madhe nga ky faktor. Në lidhje me këtë është evidentuar se niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2017 nga 47% në vitin 2016 ka arritur në 55%.

Theksojmë këtu se, shifrat e raportuara në raportin e konsoliduar në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2016 është evidentuar një rritje e konsiderueshme nga 47% e nivelit të zbatimit e evidentuar në raportin vjetor 2016 në në 68% e nivelit të zbatimit gjatë analizës së këtij treguesi në vitin 2017 nuk gjejnë mbështetje në evidencat e grumbulluara.

Bazuar në informacionin e marr nga DH/AB rezulton se, përgjithësisht rekomandimet e dhëna gjatë vitit 2017 nga NJAB që funksionojnë në njësitë publike kanë të bëjnë me:

1. Rekomandime për përmirësimin e sistemeve dhe rekomandime me karakter organizativ, të cilat janë adresuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përgatitjen e gjurmëve të auditimit, sistemin e prokurimeve publike dhe sistemin e raportimit financiar dhe kontabilitetit, grumbulluar në zërin rekomandime për përmirësim të sistemeve ku janë dhënë 2238;
2. Rekomandime për përmirësimin e proceseve të vendimmarrjes të politikave, të procedurave dhe hartimit të strategjive, të cilat ndihmojnë njësitë publike për përcaktimin sa më real të prioriteteve dhe objektivave vjetore, afatmesëm dhe afatgjatë, grumbulluar në zërin rekomandime për përmirësim të kuadrit ligjor ku janë dhënë 377;
3. Rekomandime për përmirësimin e strukturave organizative, në funksion të rritjes së efektivitetit të punës, grumbulluar në zërin rekomandime të karakterit organizativ 2975;
4. Rekomandime për korrigjimin e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve, shkeljeve dhe ruajtjen e pronës publike grumbulluar në zërin rekomandime për arkëtime ku janë dhënë 953, si dhe
5. Rekomandime që lidhen me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve në njësitë publike dhe sidomos stafit që punon në strukturat e menaxhimit financiar dhe kontrollit grumbulluar në zërin rekomandime të tjera ku janë dhënë 1798.

Tabela bashkangjitur jep informacion mbi totalin e rekomandimeve të dhëna gjatë vitit objekt auditimi.

Rekomandime sipas llojit për vitin 2017

Rekomandime sipas llojit				
Përmirësim sistemesh	Përmirësim i kuadrit ligjor	Karateri organizativ	Për arkëtime	Të tjera
2238	377	2975	953	1798

Burimi: Njësia e Harmonizimit të AB përpunuar nga grupi auditimit

Informacioni i mëposhtëm ka të bëj me shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve sipas prioritetit të tyre. Konstatohet se treguesi për zbatimin e rekomandimeve është pozitiv, pasi ato janë pranuar 99,6% dhe zbatueshmëria e tyre është në masën 55%. Monitorimi i vazhdueshëm i

këtij procesi siguron përcaktimin e afateve të sakta në planet e veprimit dhe dokumentimin e duhur të mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet NJAB dhe subjekteve të audituara.

Zbatimi i rekomandimeve për vitin 2017

Statusi i rekomandimeve			
Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Rekomandime në proces zbatimi
8371	8341	4625	3918

Burimi: Njësia e Harmonizimit të AB përpunuar nga grupi auditimit

Këto rekomandime i referohen gjetjeve të konstatuara dhe kanë synim përmirësimin e sistemeve përkatëse, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për
zgjidhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen.
Në raportin e konsoliduar i referohen analizës së rekomandimeve të dhëna, konkretisht specifikohet se:
Gjatë analizës së rekomandimeve të dhëna janë evidentuar disa mangësi në lidhje me cilësinë e tyre, ku ndër më kryesoret mund të përmendim:
1. Në disa raste formulimi i rekomandimeve është parashkruar si zbatim i aktit ligjor në fuqi. Ky formulim nuk mund ti rekomandohet subjekteve të audituara por duhet të bëhet adresim konkret i rekomandimit, bazuar në mos respektimin e procedurave apo sistemeve përkatëse të ngritura nga njësia publike.
2. Rekomandime të vështira për t'u realizuar, pasi audituesit nuk arrijnë të bëjnë dallimin midis rekomandimeve me ndikim financiar dhe atyre pa ndikim financiar.
3. Rekomandime që nuk tregojnë se çfarë, si dhe kur duhet bërë, nuk propozojnë zgjidhje të qartë për problemin, apo të përmendin zgjidhje alternative të tij.
4. Rekomandime që nuk bazohen logjikisht tek gjetjet dhe pasojat përkatëse, ndërkohë që ato duhet të përqendrohen në ndërmarrjen e veprimeve specifike konkrete që synojnë korrigjimin e çështjeve.
Ndërkohë nga auditimi konstatohet se kjo analizë nuk na është vendosur në dispozicion dhe as nuk ka të dhëna të evidentuara me raste specifike.

Vlerësimi i Jashtëm i Cilësisë: Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm (DH/AB), është organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm.
Këto kontrolle kryhen bazuar në Standardet e Auditimit të Brendshëm, si *Standardi 1312 ....Vlerësimet e jashtme duhet të kryhen të paktën një herë në 5 vjet nga* ***një vlerësues i kualifikuar dhe i pavarur ose nga një skuadër vlerësuesish nga jashtë organizatës dhe*** *Standartet Ndërkombëtare të Auditit të Brendshëm të IIA të cilat përkufizojnë se çdo NJAB duhet të kenë në vlerësim të jashtëm të cilësisë të paktën një herë* ***në 5 vjet nga një shqyrtues i kualifikuar i pavarur jashtë organizatës.***
Qëllimi i misionit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë është të sigurojë përputhshmërinë e aktivitetit të NjAB me grupin e Standardeve dhe kuadrin e praktikave profesionale si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e kësaj veprimtarie në të ardhmen.

Gjatë vitit 2017 kjo drejtori ka hartuar dhe miratuar (me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 22 datë 06.03.2017) Metodologjinë e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, mbi bazën e të cilit kryejnë procedurat e vlerësimit të jashtëm.
Implementimi i kësaj metodologjie u realizua nga DH/AB me bashkëpunimin dhe mbështetjen e ekspertëve të SIGMA.
Qëllimi*: Monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara të auditimit.*

Sipas planifikimit të paraqitur në analizën vjetore të DH/AB&MFK janë parashikuar të kryhen për vitin 2017 katër (4) Vlerësime të Jashtme (Pilot) nga DH/AB në bashkëpunim me Ekspertë të SIGMA-s pranë Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Bashkisë Kamëz dhe Bashkisë Durrës dhe dhjetë (10) Vlerësime të Jashtme nga DH/AB pranë Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Transportit, Bashkisë Berat, Bashkisë Fier, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor; subjekte këto të përzgjedhura për implementimin e metodologjisë së vlerësimit të jashtëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm.
Për vitin 2017 janë kryer 5 kontrolle të cilësisë, nga DH/AB në bashkëpunim me ekspertë të SIGMAS-s, ku si bazë përzgjedhje ka shërbyer frekuenca e vlerësimit dhe këto janë kryer në institucionet si Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Urban, Bashkia Berat, Bashkia Fier dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar.
Gjatë auditimit, u shqyrtuan të gjitha dosjet e kontrollit të cilësisë, dhe u konstatua mungesë në inventarin e dosjes e letrave të punës, si burim informacioni i përdorur nga grupi i vlerësimit; po ashtu edhe mungesë (në disa raste e plotë në disa e pjesshme) e intevistave të kryera me drejtuesit apo stafin e NjAB-ve.
Duke qenë se rezulatet e vlerësimit janë opinione që kanë të bëjnë me zbatueshmerinë e standarteve, ligjit dhe praktikave më të mira profesionale dhe zbatueshmerinë e përgjegjësive nga ana e titullarit mbi kryerjen e shërbimit të AB-së parashikojmë nevojën që këto dokumente të jenë pjesë e dosjeve në mënyrë që të arrihet dhënia e sigurisë së arsyeshme mbi punën e kryer.
Po ashtu theksojmë nevojën e pranisë së të gjithëdokumentave zyrtare tëauditimit në dosje, si projekt raporte dhe raporte finale. Gjithashtu nevojën e unifikimit të opinionit të dhënë në fund, duke shmangur në këto kushte situatën e kryer me ARRSH-në, ku në dy projekt raporte janë dy rezultate të ndryshme, njëherë me ngjyrë të verdhë e cila sinjifikon përputhjen e pjesshme me kriterin, por përmirësim të nevojshëm në fusha të caktuara dhe herën tjetër ngjyrë portokalli qësinjifikon përputhje në disa fusha që kërkojnë përmirësime kritike (të domosdoshme) duke konfonduar në këto rrethana lexuesin e raportit.
Detajuar si më poshtë vijonë:

- Nga dosja e vlerësimit të jashtëm të cilësisë në drejtorinë e auditit të brendshëm në *Ministrinë e Shëndetësisë* u konstatua se DH/AB kishte dal në përfundimin përputhje e pjesshme me Standartet Ndërkombëtare.
  Nga auditimi i dosjes rezultuan problematika si nga 7 intervista të kryera pjesë e inventarit të dosjes janë vetëm 2, gjithashtu është dërguar plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve por nuk është mbajt në kontakt situata e mëvonshmne me këto rekomandime.
- Nga dosja e vlerësimit të jashtëm të cilësisë në drejtorinë e auditit të brendshëm në *Bashkinë Berat* u konstatua se, DH/AB kishte dal në përfundimin përputhje në disa fusha me Standardet Ndërkombëtare. portokalli
  Nga auditimi i dosjes u konstatua se, nga 6 intervista me titullar plus me stafin e AB të kryera pjesë e inventarit të dosjes janë vetëm 2, gjithashtu është dërguar plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve në afat, por nuk është mbajtur në kontakt situata e mëvonshme e këtyre rekomandimeve.
- Nga dosja e vlerësimit të jashtëm të cilësisë në drejtorinë e auditit të brendshëm në *Ministrinë e Zhvillimit Urban* u konstatua se, DH/AB kishte dal në përfundimin përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare dhe përmirësim në standarde dytësore.
  Nga auditimi i dosjes u konstatua se, pjesë e inventarit të dosjes nuk është asnjë nga intervistat e kryera, gjithashtu është dërguar plani veprimi për zbatimin e

rekomandimeve në afat, por nuk është mbajtur në kontakt situata e mëvonshme e këtyre rekomandimeve.

- Nga dosja e vlerësimit të jashtëm të cilësisë në drejtorinë e auditit të brendshëm në *Bashkinë Fier* u konstatua se, DH/AB kishte dal në përfundimin përputhje të pjesshme me Standartet Ndërkombëtare. (verdhe) ndërsa tek projekt raporti që Bashkia ka nisur të firmosur në DH/AB opinion i përgjithshëm mbart ngjyrë portokalli.
  Nga ana tjetër u konstatua se, me shkresën nr. 15711/2 datë 29.12.2017 është nis projekt raporti në Bashkinë Fier, mungon raporti final i auditit të brendshëm, si dhe në pyetësorin e vetëvlerësimit të jashtëm të cilësisë nuk janë vendos vlerësimet me ngjyrë.
- Nga dosja e vlerësimit të jashtëm të cilësisë në drejtorinë e auditit të brendshëm në *ARRSH* u konstatua se, DH/AB kishte dal në përfundimin se nuk funksionon plotësisht në me Standartet Ndërkombëtare, por nuk është cituar ngjyra sikundër kërkohet nga Metodologjia udhëzuese.
  U konstatua mungesë e projekt raportit të auditimit, prezente ishte vetëm shkresa përcjellëse por materiali bashkangjitur jo.

Si konkluzion, gjatë monitorimeve të kryera nga DH/AB janë përcaktuar fushat që kishin nevojë për përmirësim dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse për përafrim të veprimtarisë me standardet ndërkombëtare. Ndër gjetjet më të rëndësishme në këtë proces vlerësimi u evidentuan: **Planifikimi** (*1. Autorizimi;2. Deklarata e pavarësisë),* **Procesi i vlerësimit të jashtëm** *1.Programi i vlerësimit; 2. Takimi fillestar; 3. Projekt-raporti),* **Monitorimi i progresit (***1. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve; 2.Plani i veprimit),* **Kriteret e vlerësimit (***1.Kriteret kryesore; 2. Kriteret dytësore; 3.Pyetësori)*
Shmangia në planifikim dhe realizim e angazhimeve të auditimit në fushat/sistemet e njësisë publike, pjesë e organigramës dhe fokusimi tek angazhimet e auditimit të subjekteve të varësisë.
Karta e auditimit, si akt administrativ që përcakton statusin organizativ, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit nuk ishte në përputhje me strukturën e parashikuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm (MAB).
Implementimi i ngadaltë i procedurave të përcaktuara në MAB (e rishikuar), lidhur me planifikimin, raportimet periodike, sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe monitorimin e progresit të rekomandimeve të adresuara.
Përfshirja e audituesve të brendshëm në disa raste në veprimtari operacionale të ndryshme ngaveprimtaria e auditimit të brendshëm, gjë që bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi tëauditimit të brendshëm.
Përfshirja në grupe auditimi i ekspertëve të jashtëm jo audituesve, financierë të subjekteve të varësisë, duke krijuar mundësi për konflikte të mundshme interesi. Në këtë vlerësim është paturparasysh që këta ekspertë janë subjekt auditimi.

Bazuar në pikën 7.2.1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm publik "*Vlerësimi i jashtëm i cilësisë i kryer nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB*", ku përcaktohet se "*Sruktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë NJAB, si më poshtë: - të paktën një herë në 5 vjet; ....."* DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB në përputhje me standardet ndërkombëtare të miratuara gjatë vitit 2017 duhej të kishte vlerësuar jo më pak se 23 NJAB (119:5). Fakti që, gjatë këtij viti nga DH/AB, janë kryer vetëm 5 kontrolle të cilësisë ose rreth 22% e detyrimit të përcaktuar sipas manualit, tregon se kjo strukturë me kapacitetet që ka e ka të pamundur të arrijë përmbushjen e objektivit prej 23 vlerësime të jashtëm të cilësisë. Duke e vlerësuar si një tregues shumë të rëndësishëm sigurimin e cilësisë së punës së auditimit të brendshëm, është e nevojshme që struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, të studiojë me përgjegjësi kapacitetet që ka për mbulimin e detyrave funksionale që rrjedhin nga neni 24 i

LAB dhe t'i propozojë Ministrit të Financave gjetjen e rrugëve më efektive për realizimin e këtij detyrimi.
Mbështetur në Metodologjinë e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për auditimin e brendshëm në sektorin publik, specifikohet (paragrafi 9, fq 4) se: *Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të diskutojë me bordin për,*
- Formën dhe shpeshtësinë e vlerësimeve të jashtme;
- Kualifikimet dhe pavarësinë e vlerësuesit ose skuadrës së vlerësuesve të jashtëm, duke përfshirë çdo konflikt të mundshëm interesi.
Gjykojmë se, për realizimin e këtij procesi në mënyrë sa më efektive, të plotë dhe të paanëshme është e nevojshme të përcaktohen kriteret minimale të kualifikimit që duhet të plotësojnë vlerësuesit ose skuadra e vlerësimit të jashtëm.
Nga auditimi u konstatua se, grupet e vlerësimit të cilësisë plotësonin kushtet e kërkuara prej SNA si dhe të vendosura në Metodologji *të mos*:
- ketë konflikt interesi real ose në dukje,(vërtetuar përmes deklaratave të pavarësisë)
- jetë pjesë e organizatës që do të vlerësohet
- jetë në varësi të organizatës në të cilën bën pjesë NJAB
Nga auditimi u konstatua se, në Metodologjinë e Kontrollit të cilësisë, Kapitulli I "Planifikimi" specifikohet se DH/AB përgatit programin vjetor të vlerësimit të jashtëm të cilësisë në bazë të:
- Frekuencës, të paktën një herë në 5 vjet
- Bazuar në vlerësimin e riskut
- Ankesat
- Çështjeve të ngritura në media
- Kërkesave të NJAB
Nga auditimi konstatohet, DH/AB nuk ka hartuar programin vjetor për vlerësimin e jashtëm të cilësisë për periudhën deri në dhjetor 2017 pasi deri në përfundim të këtij auditimi nuk na u paraqit një dokument i tillë, çka bën të mos japim siguri mbi metodën e përdorur për kryerjen e misioneve.
Po ashtu DH/AB ka për detyrë krijimin dhe përditësimin çdo vit të regjistrit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së NJAB-ve, ku duhet të përfshihen të dhënat lidhur me:
- numrin e subjekteve,
- statusin organizativ të NjAB,
- nivelin e riskut,
- frekuencën e kryerjes së vlerësimeve të jashtme,
- nivelin e kualifikimit të stafeve të NJAB-ve,
- numrin e rekomandimeve të dhëna NJAB-ve për përmirësim,
- vlerësimet e jashtme kryer nga KLSH apo vlerësues të kualifikuar të pavarur.
Grupit të auditimit ky regjistër iu dërgua elektronikisht por u konstatua se nuk arrijmë të marrim informacion mbi totalin e njësive publike për frekuencën e kryerjes së vlerësimeve të tyre apo riskun. Më shumë ky regjistër vjen në formën e një database me institucionet ku është kryer vlerësimi.
Nga ana e grupit të auditimit, gjykojmë të arsyeshme për të patur një pasqyrë të përditësuar të të gjitha njësive publike lidhur me vlerësimin e cilësisë, nga ana e DH/AB duhet të ketë të dhëna të përditësuara për të gjitha njësitë në zbatim të gërmës a, të nenit 24 "*Përgjegjësitë e DH/AB*" me qëllim realizimin e monitorimit të veprimtarisë në nivel kombëtar.

Mbi mbulimin me auditim: Nga auditimi u konstatua se, për 106 Institucione që financohen nga buxheti i Shtetit ku përfshihen Ministritë, Institucionet e Pavarura dhe të ngritura me ligj si dhe Bashkitë në 10 prej tyre auditimi i fondeve publike është rregulluar me Akt-Marrëveshje, në përputhje me nenin 10, pika "c" të ligjit 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm", dhe 29 prej

tyre nuk kanë rregulluar shërbimin e auditimit të brendshëm në njërën nga format e përcaktuara nga ligji, nga të cilat 14 Bashki dhe 15 Institucione të pavarura dhe të ngritura me ligj.
Për institucionet që kanë organizuar shërbimin e auditimit të brendshëm duke krijuar njësitë e auditimit të brendshëm u konstatua se, nga krahasimi i numrit të angazhimeve me numrin e audituesve të planifikuar rezultoj se në disa prej tyre ngarkesa është e ulët që varion nga 1.3 në 2.6 auditime/audituesi, si p.sh Bashkitë Tiranë 2.1, Shijak 1.6, Elbasan, 1.8 Fier 2.6, Bulqizë 2.6, Devoll 2.5, Dibër 2.6, Mat 2.3, Kuçovë 1.6,Tropojë 1.3, Ura Vajgurore 1.3 dhe Fushë Arëz 2.6, Himarë 2.5, Malësi e Madhe 2.6, Maliq 2.3, RTSh 2, etj po kështu u konstatuan edhe raste ku ngarkesa e angazhimeve për audituesi është tepër e lartë si p.sh Bashkitë Delvinë 11, Gramsh 9, Lezhë 8, Librazhd 9, Prrenjas 7, Skrapar 8 etj.
Konstatohet se, në planet e auditimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të FSDKSH-së nuk është përfshirë shërbimi i auditimit të brendshëm për 412 Qendra Shëndetësore të cilat financohen nga buxheti i Shtetit dhe paraqesin pasqyrat financiare çdo vit.
Si përfundim, numri i auditimeve të planifikuara për tu kryer nuk është në raport me numrin e njësive ekonomike që financohen nga buxheti Shtetit, dhe hartojnë dhe paraqesin pasqyra financiare mbi veprimtarinë e tyre.

Mbi trajnimin e vijueshëm profesional zhvilluar nga DH/AB: Në zbatim të urdhrit nr. 3, datë 08.01.2016 *"Për miratimin e rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik",* ku specifikohet se *"Trajnim i Vijueshëm i Detyrueshëm është formë e zhvillimit profesional e organizuar nga NJQH për AB çdo vit mbi bazë leksionesh me prezantime ose/dhe të kombinuar me raste praktike, temat dhe forma e të cilit përcaktohen në programin e hartuar për këtë qëllim. Kohëzgjatja e trajnimit të vijueshëm të detyrueshëm është jo më pak se 40 orë trajnimi në vit.",* Drejtoria e Harmonizimit në Ministrinë e Financave është përgjegjëse për koordinimin e punës dhe organizimit të këtyre trajnimeve, sipas nevojave të njësive publike.
Për vitin 2017, me urdhrin numër 136, datë 30.12.2016, Ministri i Financave ka miratuar programin e trajnimit të vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik. Ky trajnim është planifikuar në 4 module, sipas aneksit nr.2:
Krahasuar me vitin e kaluar ku kryesisht ishin zhvilluar tema mbi rolin e AB dhe mënyrën e përgatitjes së raporteve, vihen e re tematika më të detajuara dhe në përputhje me manualin e përmirësuar të kësaj Drejtorie. Në lidhje me tematikat e trajtuara nga referuesit përkatës, neni 11 i rregullores përcakton se *"Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, bën çdo vit identifikimin dhe analizën e nevojave për trajnim të audituesve të brendshëm të punësuar në sektorin publik, bazuar në temat e paraqitura nga njësitë e auditimit të brendshëm si pjesë e planit vjetor si dhe bazuar në regjistrin e trajnimit."*, ku konstatohet se referuar kryerjes së trajnimeve të përbashkëta për të gjitha ministritë në një modul dhe të gjitha njësitë vendore në një modul të përbashkët, nuk rezulton të plotësojë nevojat e këtyre institucioneve, referuar përmasave të tyre të ndryshme si dhe kualifikimit të stafit i cili varion nga një bashki në tjetrën, apo nga një ministri në tjetrën, treguar kjo edhe në rezultatet e pyetësorëve të vetëvlerësimit apo raportet e tyre dërguar pranë kësaj drejtorie. Gjithashtu, në lidhje me nevojat e njësive, nga auditimi nuk konstatohet të jenë kryer dhe dokumentuar analizimi i nevojave të njësive në formë raporti apo analize.
Në zbatim të nenit 3 të rregullores, pika *"Audituesi të brendshëm në detyrë, për qëllime të kësaj Rregulloreje janë të gjithë audituesit e brendshëm të sektorit publik, të cilët janë certifikuar si "Audituesi të Brendshëm në Sektorin Publik" dhe ushtrojnë funksionin e audituesit të brendshëm në njësitë publike", pjesë e trajnimit do të jenë vetëm audituesit e certifikuar*." Nga kthimet e përgjigjeve të institucioneve publike vërehet se në disa raste emrat e dërguar janë edhe audituesi të pa certifikuar. Nga Drejtoria e Harmonizimit është përgatitur një regjistër për të gjithë audituesit në total të cilët kanë ndjekur trajnimin në harkun vjeçar 2016-2017, kështu nuk është

kryer krahasimi për audituesit të cilët janë certifikuar në vitin 2016**, për të evidentuar kështu nëse ka patur raste të audituesve të sapo certifikuar që nuk kanë ndjekur 80 orëve**.
Në fund të programit të trajnimit të vijueshëm profesional u trajnuan 313 auditues, nga rreth 350 që ishin përfshirë në programin paraprak. Ndryshimet vijnë kryesisht si pasojë e punonjësve të AB të punësuar rishtaz në auditimin e brendshëm, të larguar nga puna, të dalë në pension, me raport mjekësor, etj.
Në lidhje me nenin 14 pika 4, dhe nenin 5 ku specifikohen përgjegjësitë e strukturës për harmonizimin e AB, u konstatua se regjistri i audituesve pjesëmarrës në TVP, paraqiste mangësi lidhur me pajisjen ose jo të certifikatës së AB nga ana e audituesve, datat përkatëse; emri i pjesëmarrësve në shumë raste nuk ishte i njëjtë me atë të regjistrit të AB; nuk kishte informacion në regjistër për audituesit që nuk ishin më në pozicionin e AB, apo të emëruar rishtaz si dhe nuk ishte në mënyrë progresive ndër vite, për të evidentuar kryerjen e orëve të përcaktuara në kuadrin ligjor. Drejtoria e Harmonizimit kishte përgatitur në formë liste emërore audituesit rishtaz të punësuar në AB, në pension apo që nuk ishin më punonjës te auditit të brendshëm, dhe jo duke e pasqyruar këtë informacionin në mënyrë të saktë në regjistër. Kështu, grupi i auditimit mori në shqyrtim të dhënat e audituesve të trajnuar n vitin 2017 dhe krahasoi ato me pjesëmarrësit e një viti më parë. Në përfundim të këtij procesi, rezultuan 6 punonjës të cilët ishin pjesëmarrës në trajnimin për vitin 2017, por jo në vitin paraardhës për të plotësuar detyrimin prej 80 orësh në dy vite. Këta punonjës, nuk ishin përmendur as në komentet e vendosur në dispozicion nga DH/MFK për audituesit e larguar, punësuar rishtaz apo me raport mjekësor. Përveç tyre, nga krahasimi që ne bëmë mes regjistrit të trajnimit për dy vite dhe pjesëmarrjes në trajnimin e vitit 2017, rezultoi se Drejtoria e Harmonizimit nuk kishte identifikuar 6 raste, të cilët nuk përmbushin asnjë kriter justifikues për mos ndjekjen e trajnimit në vitin 2018 dhe plotësimin e detyrimit për kryerjen e 80 orëve trajnim në dy vite:

Në nenin 7, përcaktohet përgjegjësia e KKAB për trajnimin e vijueshëm profesional:
Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm është përgjegjës për:
1) Shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve për programin e trajnimit të përgatitur nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm
2) Miratimin e trajnerëve në përshtatje me temat e programit të trajnimit
3) Shqyrtimin dhe miratimin e materialeve të trajnimit
7) Shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për audituesit e brendshëm në detyrë të cilët nuk kanë ndjekur trajnimin sipas përcaktimeve ligjore
8) Informimin e ministrit të Financave në përfundim të programit të trajnimit, nëpërmjet raportit përmbledhës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit

Konstatohet se në mbledhjet e zhvilluara nga KKAB , në zbatim të nenin 7, nuk rezulton të jetë zbatuar plotësisht pika 1 e nenit 7 të rregullores "*Shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve për programin e trajnimit të përgatitur nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm",* pasi në këto mbledhje anëtarët e KKAB kanë miratuar vetëm emrat e trajnerëve dhe prezantimet përkatëse, pa lënë rekomandime për programin e trajnimit. Me vendimin nr. 18, datë 15.02.2017, KKAB ka kryer miratimin paraprak të trajnerëve të përfshirë në procesin e trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në detyrë për vitin 2017, ku është kërkuar plotësimi me disa dokumentacione për disa kandidatë me qëllim vërtetimin e eksperiencës së punës, në përputhje me nenin 13, pika 2 e rregullores së trajnimit. Në këtë mbledhje, vendimi përkatës ka dalë me 3 vota, nga 5 që janë anëtarët e KKAB pasi 2 nga anëtarët e KKAB, punonjës të Ministrisë së Financës, dhe një prej tyre i Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, janë kandidatë për trajnerë në procesin e trajnimi të vijueshëm profesional. Në mbledhjen e radhës, Komisioni ka dalë me vendimin nr. 19, datë 20.02.2017, ku dhe janë miratuar kandidatët për trajnerë si dhe materialet e prezantimit për 4

modulet e trajnimit të vijueshëm profesional sipas orëve përkatëse sipas së cilave do të zhvillohet ky proces. Në programin e trajnerëve janë përfshirë edhe 2 punonjës të DH/KBFP me respektivisht rreth 72 dhe 57 orë trajnimi në total.
Kështu, konstatohet se punonjësit e DH/AB, përgjegjës për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e jashtëm të auditimit në sektorin publik, kanë qenë në disa raste edhe në rolin e trajnerëve të trajnimit të vijueshëm profesional dhe anëtarë të KKAB (komision që është përgjegjës edhe për përzgjedhjen e trajnerëve të certifikimit), pozicione që lidhen me administrimin, mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e vendimeve lidhur me audituesit e brendshëm në sektorin publik.

Aneksi nr.3: Aktiviteti i DH/MFK në lidhje me monitorimet dhe pilotimet e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin. Procesi perpunimit të pyetsorëve dhe rregjistrat e NA dhe NZ.

Mbi funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit
Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 161, datë 05.10.2017 është e organizuar sipas strukturës si më poshtë:

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit	**5**
Drejtor	1
Specialist	4

Nga auditimi u konstatua se referuar periudhës objekt auditimi, struktura faktike e DH/MFK është plotësuar sipas urdhrit të mësipërm dhe nuk rezultojnë vakanca në personelin e drejtorisë.
Detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj drejtorie janë përcaktuar në ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, manualin "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe rregullore të tjera që udhëzojnë veprimtarinë për çështje specifike të DH/MFK. Në përmbledhjen e detyrimeve dhe detyrave përcaktuar nga këto dokumente, drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin është përgjegjëse për:
1. Përgatitjen e ligjeve, udhëzimeve, metodikave për fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucionet e sektorit publik;
2. Përgatitjen, shpërndarjen dhe azhornimin e strategjive dhe udhëzimeve metodologjike për menaxhimin financiar dhe kontrollin në pajtim me standardet ndërkombëtare të pranuara për kontrollin e brendshëm, rregulloret e zbatueshme dhe praktikat e mira të Bashkimit Evropian;
3. Organizimin e seminareve të ndërgjegjësimit dhe trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në institucionet e sektorit publik;
4. Koordinimin e ngritjes dhe zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në institucionet e sektorit publik;
5. Drejtoria e Harmonizimit siguron monitorimin sistematik të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik me qëllim mbledhjen e informacionit për të përmirësuar metodologjinë dhe standardet e punës.
6. Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) ndihmon Nëpunësin e Parë Autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të MFK dhe për përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik.
7. Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, bashkëpunon me Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm gjatë përgatitjes së raportit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (KBFP).
8. Përgjigjet për azhornimin e metodologjisë së kontabilitetit publik me zhvillimet bashkëkohore dhe ndjekjen e procesit të zbatimit të strategjisë së qeverisë për implementimin e standardeve të kontabilitetit publik.

Për vitin 2017, plani i aktivitetit të kësaj drejtorie ishte organizuar si më poshtë:

1) Vijimi i progresit në funksionimin e sistemit të KBFP në NJQP

Lidhur me këtë çështje, drejtoria ka synuar finalizimin e raportit vjetor mbi funksionimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku në bazë të përpunimit të të dhënave të komponentëve të MFK nga pyetësorët e vetëvlerësimit, si dhe vizitave në terren nga punonjësit e drejtorisë, konkludohet me rekomandimet përkatëse.

2) Zbatimi i një sistemi modern të MFK-së në gjashtë institucione pilot (Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Bashkia Vlorë, Bashkia Gjirokastër, Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës) bazuar me përvojën e fituar nga projekti i mëparshëm.

Ky objektiv ka qenë një ndër më kryesorët e drejtorisë, për implementimin e koncepteve dhe instrumenteve të MFK-së në NJQP sipas praktikave më të mira për ngritjen e një sistemi të shëndoshë të MFK nëpërmjet përgatitjes së rregulloreve dhe procedurave të brendshme, regjistrit të risqeve, manualet e punës, hartat e proceseve dhe gjurmët e auditimit për një menaxhim më efektiv të fondeve publike.

3) Rritja e ndërgjegjësimit të administratës publike dhe nivelit drejtues të njësive publike mbi rolin dhe rëndësinë e sistemit të MFK-së;

Për realizimin e këtij objektivi drejtoria ka planifikuar kryerjen e trajnimeve dhe informimeve të njësive të qeverisjes vendore, Ministrisë së Financave, menaxherëve te niveleve të ndryshme, seminare ndërgjegjësimi me drejtues të lartë, etj në bashkëpunim me ASPA.

4) Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e Kontabilitetit në Shqipëri

Në lidhje me këtë pikë, është synuar përmirësimi raportimit financiar në sektorin publik në zbatim të projektit "*Për përmirësimin e kontabilitetit në sektorin publik*", dhe vijimin e bashkëpunimit me Bankën Botërore, në projektin *"Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar në shoqëritë tregtare"* si dhe bashkëpunimi me universitetet për përmirësimin e kurrikulave të tyre me synim rritjen e profesionalizmit të ekspertëve të fushës dhe administratës tatimore.

Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

Në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2019 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , neni 28 i tij përcakton krijimin e Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, për mbikëqyrjen e cështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik. Sipas përcaktimeve të këtij ligji, me urdhrin nr.68, datë 08.06.2016 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të bordit të kontrollit të brendshëm financiar publik", është përcaktuar krijimi i bordit i kryesuar nga:

Ministri i Financave, z. A.A, dhe anëtarët si më poshtë:

Znj. G.P në cilësinë e nëpunësit të parë autorizues,

Znj. K. H, me detyrë Drejtore e përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik,

Znj. M.Dh me detyrë Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave,

Z. L. S me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave,

Znj. E. L ekspert për fushën e MFK,

z. J. N ekspert për fushën e Kontabilitetit

Z.E.B për fushën e auditit të brendshëm.

Pika 3 e nenit 28 të ligjit për MFK, përcakton se "Bordi shqyrton nevojën për miratimin e legjislacionit shtesë apo për përmirësimin e kuadrit rregullator të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik" si dhe në pikën 4 të këtij neni se "Bordi diskuton rreth raportit vjetor per Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik përpara se të miratohet nga Ministri i Financave" ku struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në MFE

siguron shërbimin e sekretariatit për veprimtarinë e bordit.
Sipas procesverbalit të mbajtur në datën 16.05.2017, është zhvilluar mbledhja e parë e këtij Bordi me pjesëmarrjen e 7 anëtarëve, nga 8 që është numri total i tyre. Në këtë mbledhje është diskutuar mbi raportin vjetor të vitit 2016 dhe problematikat e identifikuara në inspektimet mbi vlerësimet e situatës së menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik.
Mbledhja e dytë e këtij Bordi është zhvilluar me pjesëmarrjen e 6 anëtarëve sipas procesverbalit në datën 27.12.2017, dhe sipas axhendës është diskutuar mbi rishikimin e bazës ligjore në fushën e financave publike, ku më hollësisht janë trajtuar: Draft Udhëzimi për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, draft udhëzimi i kontabilitetit publik, zhvillimet e projektit mbi reformën e kontabilitetit publik (IPSAS), Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm, Programin e Trajnimit të Vijueshëm profesional të Audituesve të Brendshëm.
Mbledhja e ardhshme e këtij bordi është planifikuar të zhvillohet në Shkurt të vitit 2018, por deri në fund të periudhës objekt auditimi (Maj 2018), **nuk rezulton të jetë zhvilluar ende.**
Në zbatim të pikës 7 të nenit 28 të këtij ligji, masa e shpërblimit të anëtarëvë të këtiJ bordi është kryer në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.06.2012 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qverisjes qendrore", i ndryshuar, është kryer sipas 2 Memove përkatëse likuidimi i pagesës së anëtarëve të bordit.
Sipas me urdhrin nr.68, datë 08.06.2016 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të bordit të kontrollit të brendshëm financiar publik *ky bord do të mblidhet një herë në 3 muaj, pra 4 mbledhje në vit*. Gjithashtu, në pikën 2 "Mënyra e organizimit dhe funksionimit të bordit të KBFP), cështja d, përcakton se *"Gjatë shqyrtimit të cështjeve të kontabilitetit publik, Bordi fton të marrë pjesë si vëzhgues në takim edhe përfaqësues nga Kontrolli i lartë i Shtetit, si institucion përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare vjetore për njësitë publike".* Në mbledhjen e datës 27 Dhjetor, në të cilën është diskutuar mbi rishikimin e disa udhëzimeve, ku ndër të tjera edhea ato që lidhen me kontabilitetin, nuk rezulton të jetë ftuar të marrë pjesë në mbledhje asnjë ekspert i KLSh, sic udhëzohet në rregullore. Gjithashtu, duke gjykuar aktivitetin dhe funksionin e këtij Bordi, i cili lidhet me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm, pjesëmarrja e përfaqësuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk duhet të kufizohet vetëm për cështjet që lidhen me kontabilietin pasi sipas ligjit nr. 154/2014
"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 2 trajton qëllimin e Gjithashtu, konstatohet se në mbledhjet e KBFP evidentohet mungesa e një eksperti të jashtëm dhe dy prej tyre në mbledhjen e dytë. Duke qenë se DH/KBFP është përgjegjëse për kryerjen e rolit të një sekretariati, nuk na janë vendosur në dispozicion evidenca për njoftimin e tyre në mbledhjet e këtij bordi.
Gjithashtu, raporti aktual i anëtarëve të këtij Bordi, është 3 të jashtëm dhe 4 punonjës të ministrisë dhe Ministri. Në këto kushte, nuk garantohet një pavarësi funksionale, për vlerësuesit dhe monitoruesit e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.
Nga auditimi i përputhshmërisë së aktivitetit të DH/MFK, grupi i auditimit rezultoi në çështjet e mëposhtme.

1. Analiza e sistemit sipas pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike.

A-Nga auditimi u konstatua se referuar detyrimit të Drejtorisë së Harmonizimit për konsolidimin e raporteve dhe pyetësorëve të vetëvlerësimit të njësive publike, sipas nenit 26, pika 3 i cili citon se *"Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ndihmon nëpunësin e parë autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe për përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit publik, ku përmblidhet informacioni i marrë, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.",* u analizuan të dhënat e raportuara në

Raportin Vjetor të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, kreu II , çështja 2.1 *"Analiza e sistemit sipas pesë komponentëve të MFK bazuar në pyetësorët e vetëvlerësimin e njësive publike". Njësitë Publike dërgojnë pranë Drejtorisë së Harmonizimit, pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën e cilësisë si dhe raportin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, brenda muajit shkurt.* Këto pyetësorë, Drejtoria e Harmonizimit, i siguron në formatin excel nga njësitë, dhe më pas i konsolidon në sistemin Access PIFC, në mënyrë që të gjenerojë të dhënat statistikore për raportin vjetor, si dhe të kryejë krahasime në rezultatet edhe me vitet e kaluara. Nga auditimi u konstatua se për shkak të ndryshimit të formatit të pyetësorit të vetëvlerësimit, me miratimin e manualit të ri të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, sipas urdhrit nr. 108, datë 17.11.2016 i Ministrit të Financave, ky ndryshim nuk u shoqërura me një përshtatje të atij ekzistues në sistemin PIFC. Për këtë arsye, në dy vitet e fundit, punonjësit e kësaj Drejtorie i hedhin vetë manualisht të dhënat e gjeneruara nga subjektet sipas çdo pyetësori, proces ky që nuk garanton një cilësi të lartë për shkak të mungesës së sigurisë mbi gabimet e mundshme, për vetë përmbajtjen e detajuar që kanë këta pyetësorë, si dhe tanimë nuk sigurohen dot të dhënat në mënyrë të zgjeruar, sipas komenteve për çdo pyetje, pasi punonjësit konsolidojnë vetëm rezultatin në pikë. Pas konsolidimit të të dhënave në PIFC, DH/MFK përgatit rezultatet për raportin vjetor për kapitullin I dhe II, ku kryhet edhe renditja e njësive sipas grupeve. Këtu nuk përfshihen njësitë shpenzuese të trajtuara në raportin e KBFP. Për të analizuar shifrat e këtij raporti për efektivitetin e sistemit, rankimin e institucioneve, vlerësimin e numrit të njësive që janë përgjigjur me 4, 3, 2 apo 1 pikë sipas pyetjeve respektive, grupi i auditimit krahasoi dhe rillogariti shifrat e vënë në dispozicion nga njësia në sistemin PIFC, në formë elektronike si dhe shifrat e raportuara në raportin vjetor të KBFP për njësitë publike. Gjithashtu, në mënyrë rastësore u siguruan disa pyetësorë të dërguar shkresërisht pranë DH/MFK, konkretisht: 8 Ministri Linje, 12 Bashki dhe Këshilla Bashkiakë, 10 Institucione të Pavarura, 11 institucione nga grupi 87, 5 njësi shpenzuese të mëdha. Nga analizimi i rezultateve sipas pyetësorëve përkatës, u konstatua se ekzistonin diferenca mes të dhënave të dërguara shkresërisht nga njësitë publike, me ato të konsoliduara në sistemin PIFC nga punonjësit e DH/MFK. Në sistemin PIFC rezulton të jenë hedhur të dhëna për 126 institucione (nga 127 që janë në raportin vjetor) ku nuk janë konsoliduar të dhënat për bashkinë Kavajë. Kryesisht rezultoi se të dhënat për rankimin e institucioneve janë marë nga shkresat e dërguara nga njësitë, (përveç diferencave të konstatuara si më poshtë) duke mos përdorur të dhënat e konsoliduara në PIFC, pavarësisht se sipas punonjësve, ato konsolidohen për efekt të përgatitjes së raportit të KBFP. Këto diferenca lidheshin me rezultatin total të vetëvlerësimit, si dhe me rezultate në brendësi të pyetjeve por pa efekt në vlerësimin final. Megjithatë, referuar rëndësisë së konsolidimit të pikëve në PIFC për kryerjen e analizave në raportin e KBFP për vlerësimin e numrit të pyetjeve të vlerësuara me 4, 3, 2, apo 1 pikë në totalin e pyetësorit, apo lidhur vetëm me komponentë të veçantë, mungesa e saktësisë në hedhjen e të dhënave, ndikon në rezultatet finale.

U konstatua se të dhënat e dërguara nga njësitë shkresërisht në protokollin e Ministrisë së Financës, nuk janë të njëjta me ato të konsoliduara në sistemin PIFC, për institucionet si më poshtë[31]:

Institucioni	**Shkresa e Pyetësorit të Vetëvlerësimit**
Këshilli i Qarkut Berat	Dy shkresa: nr. 251, prot në M.F datë 26.02.2018 dhe 17.04.2018
Këshilli i Qarkut Elbasan,	shkresa nr. 17640/60, datë 1.3.2018
Bashkia Peqin	shkresa nr. 17640, datë 7.2.2018.
Bashkia Librazhd	shkresa nr. 17640/80, datë 28.12.2017
Bashkia Tepelenë	shkresa nr. 17640/146, datë 3.4.2018
Bashkia Kavajë	shkresa nr.17640/159, datë 9.5.2018
Bashkia Përrenjas	shkresa pa nr, datë 12.3.2018

[31] Trajtuar më hollësisht në anekset e mëposhtme sipas pyetjeve përkatëse dhe njësive me diferenca

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	shkresa nr.1057, prot datë 1.03.2018
Agjencia e Prokurimit Publik	shkresa nr.17640, prot datë 28.02.2018
Sekretariati Teknik i Ujit	shkresa nr. 17640/40, prot datë 28.02.2018
Departamenti i Administratës Publike	shkresa nr. 17640/86, prot datë 28.02.2018
Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	shkresa nr. 17640/82, prot datë 28.02.2018
Shërbimi Informativ Shtetëror	shkresa nr. 17640/39, prot datë 28.02.2018
Avokati i Popullit	shkresa shkresës nr. 93, datë 28.02.2018
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	shkresa nr. 17640/75, prot datë 28.03.2018
Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	shkresa nr. 17640/142, prot datë 27.03.2018
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	shkresa pa nr, datë 23.02.2018
Ministria e Brendshme	shkresa nr. 1760/100, prot datë 1.3.2018
MIE	shkresa nr. 17640/144, prot datë 28.03.2018
MZHR	shkresa nr. 17640/119, prot datë 12.03.2018
MASR	pa shkresë përcjellëse

Gjithashtu, u krye krahasim mes të dhënave të dërguara nga njësia në protokoll, me të dhënat e përdorura për efekt të raportit vjetor të KBFP, ku konstatohet se punonjësit e drejtorisë nuk janë referuar të dhënave që janë hedhur në sistemin PIFC, por pyetësorëve që janë dërguar shkresërisht pranë DH/MF nga njësitë përkatëse. Përjashtim bëjnë njësitë e mëposhtme, në të cilat paraqiten me diferenca në shifrat e raportuara nga njësitë në protokollin e MFE, me ato të përdorura në raportin vjetor:

Institucioni	**Vlerësimi sipas shkresës**	**Vlerësimi në raportin KBFP[32]**
Bashkia Përrenjas	89	95
ISUV	136	146
Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	147	139
Agjensia e Prokurimit Publik	147	148
Sekretariati Teknik i Ujit	136	138
Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	141	145

Edhe pse masa e devijimit të rezultateve nuk është në dukje materiale, referuar faktit që qëllimi i raportit vjetor të drejtorisë është vlerësimi i situatës së menaxhimit financiar dhe kontrollit në vend, duke krahasuar atë edhe me vitet e mëparshme; dhe ndryshimi nga viti në vit nuk është i një mase të lartë, e bën edhe më të rëndësishëm nevojën për një saktësi të nivelit të lartë në shifrat e konsoliduara.

Në raportin vjetor të KBFP evidentohet se "*efektiviteti i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit llogaritet mbi bazën e pyetësorëve të vetëvlerësimit i cili përmban 39 pyetje. Çdo pyetje vlerësohet me pikë nga 1-4, ku vlerësimi minimal është 1 dhe vlerësimi maksimal është 4. Efektiviteti i përgjithshëm i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit llogaritet si mesatare e pikëve të pyetësorit të vetëvlerësimit për të gjitha njësitë publike të marra në analizë.",* ndërsa për llogaritjen në % të efektivitetit sipas komponentëve, në raport nuk është parashikuar mënyra se si do të kryhet kjo analizë, por nga pyetësorët me punonjësit e DH/MFK, u konkludua se do të llogaritet nëpërmjet numrit total të pikëve të vetëvlerësimit sipas pyetjeve përkatëse/ pikët maksimale të mundshme. Kështu, grupi i auditimit kreu një rillogaritje të vlerësimit në pikë të paraqitura nga DH/MFK në sistemin PIFC dhe shifrat e përdorura në raport për llogaritjen e komponentëve të MFK, duke i krahasuar me rezultatet e pasqyruara në raportin vjetor të KBFP, ku u konstatuan si më poshtë:

Në pikë

Mjedisi i Kontrollit

[32] Pikët e renditura si raporti KBFP i referohen rezultateve të vendosura në dispozicion nga DH/MFK për efekt të indikatorëve në komponentët e MFK.

	PIFC	Raporti KBFP	Totali mundshëm[33]	Efektiviteti PIFC	Efektiviteti Indikator
Ministri	670	669	704	0.9517	0.9502
Bashki	3158	3156	3840	0.8223	0.8084
K. Q[34]	697	698	768	0.9075	0.9088
Bashki+KQ	3855	3854	4608	0.8365	0.8249
Grupi 87	1013	1023	1088	0.9310	0.9402
Pavarura	**1587**	1588	1664	0.9537	0.9543
Pavarura +Grupi 87	2600	2611	2752	0.9447	0.9487
Total Mjedisi	**7125**	**7134**	**8064**	**0.8835**	**0.8777**

Në përqindje:

Grupi i Institucioneve	% sipas Raportit	% në bazë të rillogaritjes nga audituesi (indikator)	% të dhënave sipas sistemit PIFC
Ministri	95%	95.02%	95%
Bashki[35]	83.5%	82.49%[36]	83.65 %[37]
Pavarura + Grupi 87	94.8%	94.87%	94.47%[38]
Efektiviteti i Mjedisit të Kontrollit	91.1%	87.77%[39]	88.35%

Në lidhje me vlerësimin sipas pikëve të dhëna nga njësitë për këtë komponent në sistemin PIFC, sipas grupeve u konstatua se: Pikët ne total si dhe përqindja e tyre në totalin e përgjigjeve të vlerësuara sipas pikëve për komponentin e mjedisit të kontrollit është:

Në pikë:

Mjedisi i Kontrollit (PIFC: pyetja 1-16)					
Vlerësimi 4,3	**4**	**3**	**2**	**1**	**Totali i mundshëm**
1862	1258	604	127	27	2016
0.9236	0.6240	0.2996	0.0629	0.0133	

Në përqindje:

Pikët e vlerësimit	% sipas Raportit	% të dhënave sipas sistemit PIFC
4	64.7%	62.4%
3	29.6%	29.96%
2	6.2%	6.29%
1	1.1%	1.39%

Referuar nën komponontëve të të Mjedisit të Kontrollit, u krye ri llogaritja e pikëve sipas nën komponentit dhe vlerësimit, në pikë dhe në % të totalit, ku rezultuan:

Në pikë

Mjedisi i Kontrollit (PIFC)					Totali i mundshëm
Vlerësimi për të gjithë komponentin (1-16)	**4**	**3**	**2**	**1**	**2016**
	1258	604	127	27	
	0.6240	0.2996	0.0629	0.0133	
Pyetja 1-4	255	182	52	15	504
	0.5059	0.3611	0.1031	0.0297	
Pyetja 5-6	182	58	12		252
	0.7222	0.2301	0.0476		
Pyetja 7-8	176	63	12	1	252
	0.6984	0.25	0.0476	0.0039	
Pyetja 9-13	424	171	28	7	630
	0.6730	0.2714	0.0444	0.0111	

[33] Ky total lidhet me vlerësimin për efekt të sistemit PIFC, pra për 60 bashki dhe 126 institucione në total, ndërsa totali I përdorur për llogaritjen e indikatorëve është 61 bashki dhe 127 institucione për shkak të mos hedhjes së të dhënave për Bashkinë Kavajë në sistem

[34] Duke qenë se për Këshillat e Qarkut nuk ka të dhëna tek indikatorët e MFK, u morën të dhënat e KQ dërguar shkresërisht dhe elektronikisht në DH/MFK

[35] Në këtë tabelë, grupi Bashki sipas Raportit ka kuptimin Bashki dhe Këshilla Qarku

[36] Ne vlerësimin e indikatorëve nga DH/KBFP janë përfshirë dhe Këshillat e Qarkut

[37] Ne sistemin PIFC kodet janë plotësuar për 60 bashki, dhe 12 Këshilla Qarku

[38] Në sistemin PIFC të dhënat janë plotësuar për 17 institucione të grupit 87 dhe 26 institucione të pavarura

[39] Për vlerësimin e komponentit, u shtuan të dhënat e Këshillave të Qarkut për efektin total, dhe të dhënat e tjera u morën nga indikatorët

Pyetja 14-16	221	130	23	4	378
	0.5846	0.3439	0.0608	0.0105	

Krahasuar këto rezultate me ato të paraqitura në raportin vjetor të KBFP:

Në %

	Pikët e vlerësimit	**% sipas Raportit**	**% të dhënave sipas sistemit PIFC**
Vendosja e objektivit(1-4)	4	51.4%	50.59%
	3	36.7%	36.11%
	2	10.5%	10.31%
	1	3%	2.97%
Etika profesionale dhe personale (5-6)	4	73.4%	72.2%
	3	23.4%	23%
	2	4.8%	4.7%
	1	0%	0%
Struktura organizative (7-8)	4	71.8%	69.8%
	3	25.4%	25%
	2	4.8%	4.7%
	1	0.4%	0.3%
Stili i punës së drejtuesve(9-13)	4	68.4%	67.3%
	3	27.6%	27.1%
	2	4.5%	4.4%
	1	1.1%	1.1%
Politika e burimeve njerëzore (14-16)	4	59.4%	58.4%
	3	34.9%	34.3%
	2	6.2%	6%
	1	1.1%	1%

Menaxhimi i Riskut

Krahasimi i rezultateve me ato të rillogaritura në sistemin PIFC, me ato që rezultojnë nga të dhënat e indikatorëve të vendosur në dispozicion nga DH/MFK si dhe të dhënat finale në raportin vjetor të KBFP për Menaxhimin e Riskut rezultojnë:

Në pikë

Menaxhimi i Riskut					
	PIFC	Indikator	Totali mundshëm	Efektiviteti PIFC	Efektiviteti Indikator
Ministri	221	220	264	0.8371	0.8333
bashki	973	986	1440	0.6756	0.6734
K.Q	214	215	288	0.7430	0.7465
Bashki+KQ	1187	1201	1728	0.6869	0.6855
Grupi 87	308	307	408	0.7549	0.7524
Pavarura	524	525	624	0.8397	0.8413
Pavarura +Grupi 87	832	832	1032	0.8062	0.8062
Total Mjedisi	2252	2253	3024	0.7447	0.7391

Në %

Grupi i Institucioneve	**% sipas Raportit**	**% sipas të dhënat e indikatorëve**	**% të dhënave sipas sistemit PIFC**
Ministri	83.75%	83.33%	83.71%
Bashki	69.5%	68.55%	68.69%
Pavarura + Grupi 87	81.5%	80.62%	80.62%
Efektiviteti i Menaxhimit të riskut	-[40]	73.91%	74.47%

[40] Nuk ka informacion në Raportin vjetor të KBFP

Në pikë

	Menaxhimi i riskut (PIFC)				Totali i mundshëm
Pyetja 17-22	4	3	2	1	754
	267	287	123	77	
	0.354111	0.380637	0.16313	0.102122	

Krahasimi i shifrave me raportin KBFP:

Në %

Pikët e vlerësimit	% sipas Raportit	% të dhënave sipas sistemit PIFC
4	35.9%	35.4%
3	38.6%	38%
2	16.5%	16.3%
1	10.3%	10.2%

Aktivitetet e Kontrollit

Krahasimi i rezultateve me ato të rillogaritura në sistemin PIFC, me ato që rezultojnë nga të dhënat e indikatorëve të vendosur në dispozicion nga DH/MFK si dhe të dhënat finale në raportin vjetor të KBFP për Aktivitetet e Kontrollit rezultojnë:

Në pikë

Aktivitetet e Kontrollit					
	PIFC	**Indikator**	**Totali mundshëm**	**Efektiviteti PIFC**	**Efektiviteti Indikator**
Ministri	283	284	308	0.9188	0.9220
bashki	1307	1311	1708	0.7779	0.7675
K.Q	286	286	336	0.8511	0.8511
Bashki+KQ	1593	1597	2016	0.7901	0.7921
Grupi 87	418	429	476	0.8781	0.9012
Pavarura	674	686	728	0.9258	0.9423
Pavarura +Grupi 87	1092	1115	1204	0.9069	0.9260
Total Mjedisi	**2968**	**2996**	**3528**	**0.8412**	**0.8425**

Në përqindje

Grupi i Institucioneve	% sipas Raportit	% sipas të dhënat e indikatorëve	% të dhënave sipas sistemit PIFC
Ministri	91.8%	92.2%	91.88%
Bashki	80.8%	79.21%	79.01%
Pavarura + Grupi 87	84.8%	92.6%	90.69%
Efektiviteti i aktivitetit të kontrollit	**87.6%**	**84.25%**	**84.12%**

Në pikë

Aktivitetet e Kontrollit (PIFC)						
Pyetja 23-29	**5**	**4**	**3**	**2**	**1**	
	1	534	197	90	56	878
	0.0011	0.6082	0.2243	0.1025	0.0637	

Krahasimi të dhënave me Raportin KBFP:

Në përqindje

Pikët e vlerësimit	% sipas Raportit	% të dhënave sipas sistemit PIFC
4	61.5%	60.8%
3	22.7%	22.43%
2	10.4%	10.25%
1	6.5%	6.3%

5[41]	-	0.1%

Informim Komunikimi

Krahasimi i rezultateve me ato të rillogaritura në sistemin PIFC, me ato që rezultojnë nga të dhënat e indikatorëve të vendosur në dispozicion nga DH/MFK si dhe të dhënat finale në raportin vjetor të KBFP për Informim Komunikimin rezultojnë:

Në pikë

Informim Komunikim					
	PIFC	**Indikator**	**Totali mundshëm**	**Efektiviteti PIFC**	**Efektiviteti Indikator**
Ministri	250	251	264	0.9469	0.9507
bashki	1264	1288	1440	0.8777	0.8797
K.Q	264	275	288	0.9166	0.9548
Bashki+KQ	1528	1563	1728	0.8842	0.8921
Grupi 87	378	391	408	0.9264	0.9583
Pavarura	597	609	624	0.9567	0.9759
Pavarura +Grupi 87	975	1000	1032	0.9447	0.9689
Total Mjedisi	**2750**	**2814**	**3024**	**0.9093**	**0.9232**

Në përqindje

Grupi i Institucioneve	**% sipas Raportit**	**% sipas të dhënat e indikatorëve**	**% të dhënave sipas sistemit PIFC**
Ministri	94.5%	95%	94.69%
Bashki	88.25%	89.21%	88.4%
Pavarura + Grupi 87	94.5%	96.9%	94.47%
Efektiviteti i Informim Komunikimit	**-**	**92.32%**	**90.93%**

Në pikë

Informim Komunikim (PIFC)					**Totali i mundshëm**
Pyetja 30-35	**4**	**3**	**2**	**1**	
	531	180	41	4	756
	0.7023	0.2380	0.0542	0.0052	

Krahasimi me raportin KBFP:

Në përqindje

Pikët e vlerësimit	**% sipas Raportit**	**% të dhënave sipas sistemit PIFC**
4	71.4%	70.23%
3	24.2%	23.8%
2	5.5%	5.4%
1	0.5%	0.5%

Monitorimi

Krahasimi i rezultateve me ato të rillogaritura në sistemin PIFC, me ato që rezultojnë nga të dhënat e indikatorëve të vendosur në dispozicion nga DH/MFK si dhe të dhënat finale në raportin vjetor të KBFP për Monitorimin rezultojnë:

Në pikë

Monitorim					
	PIFC	**Indikator**	**Totali mundshëm**	**Efektiviteti PIFC**	**Efektiviteti Indikator**
Ministri	167	167	176	0.9488	0.9488

[41] Gabimisht është hedhur një pyetje e vlerësuar me 5 pikë në sistemin PIFC

Bashki	787	795	960	0.8197	0.8145
K.Q	144	148	192	0.75	0.7708
Bashki+KQ	931	943	1152	0.8081	0.8073
Grupi 87	225	235	272	0.8272	0.8639
Pavarura	356	358	416	0.8557	0.8605
Pavarura +Grupi 87	581	593	688	0.8444	0.8619
Total Mjedisi	**1679**	**1703**	**2016**	**0.8328**	**0.8380**

Krahasimi me raportin KBFP

Në përqindje

Grupi i Institucioneve	**% sipas Raportit**	**% sipas të dhënat e indikatorëve**	**% të dhënave sipas sistemit PIFC**
Ministri	94.8%	94.88%	94.88%
Bashki	80.8%	80.7%	80.8%
Pavarura + Grupi 87	84.8%	86.19%	84.47%
Efektiviteti i Monitorimit	**-**	**83.28%**	**83.8%**

Në pikë

Monitorimi					**Totali i mundshëm**
Pyetja 36-39	4	3	2	1	504
	272	164	31	37	
	0.5396	0.3253	0.0615	0.0734	

Në përqindje

Pikët e vlerësimit	**% sipas Raportit**	**% të dhënave sipas sistemit PIFC**
4	54.8%	53.96%
3	33.1%	32.5%
2	6.3%	6.1%
1	7.5%	7.3%

B- Gjithashtu, u konstatua se në raportin vjetor të KBFP, drejtoria nuk është shprehur me një analizë në planifikimin dhe raportimin e të dhënave për njësitë që janë përfshirë rishtaz në këtë raport. Kështu, zgjedhja e subjekteve me buxhet të madh që janë përfshirë në raport për herë të parë për vitin 2017, ka qenë rastësore, pasi punonjësve nuk janë bërë me dije nëpërmjet urdhrave paraprakë për ndryshime në organizimin e raportit vjetor dhe gjithashtu e njëjta gjë vërehet edhe në njësitë e përzgjedhura, për të cilat nga ana e DH/MFK nuk janë njohur me kriteret sipas së cilave është kryer përzgjedhja e tyre. Së dyti, referuar ndryshimeve të organizimit të njësive të qeverisjes së përgjithshme, si dhe subjekteve të përfshira në raportin vjetor të drejtorisë, nuk është kryer një analizë e njësive të cilat janë krijuar rishtaz në vitin 2017 (referuar numrit total të institucioneve të përfshira nën grupin "Të pavarura", total: 47 institucione), apo mbi konsolidimin e kryer për ministritë e përthithura (nga 14 në 11), referuar edhe analizave që janë kryer në mënyrë progresive, për të cilat duhet të kryhet një paragraf përshkrues për njësitë në të cilat bëhet krahasimi,në raportin vjetor të KBFP, kreu II , çështja 2.1, lidhur me komponentët e MFK.

2. Monitorimi mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Implementimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucionet pilot për vitin 2017.

DH/MFK në kuadër të implementimit të një sistemi modern të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, bazuar në eksperiencën e fituar, nga projekti i binjakëzimit, kishte parashikuar në planin vjetor për vitin 2017 implementimin e këtij sistemi në 6 institucione pilot të përzgjedhura (MPB, MTI, Bashkia Vlorë, Bashkia Gjirokastër, Autoriteti i Konkurrencës dhe Avokati i Popullit). Ky proces do të fillonte gjatë muajit maj dhe do të vazhdonte deri në fund të vitit 2017, por sipas DH/MFK për shkak të qeverisë teknike ky proces nuk mundi të realizohej.

Gjithashtu, nga ana e drejtorisë është vendosur se për shkak të ristrukturimit të ministrive, u reduktua numri i institucioneve të përzgjedhura si dhe është shtuar Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe në përfundim u vendosën për implementim institucionet : MB, MIE, Bashkia Vlorë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar; ku gjatë muajit dhjetor janë zhvilluar takimet vetëm me Autoritetin Rrugor Shqiptar, ndërsa për institucionet e tjera nuk është proceduar më tej me implementimin. Për institucionet të cilat u zgjodh të mos kryhej implementimi, nuk janë përgatitur relacione shpjeguese për arsyet e mos e implementimit të MFK për vitin 2017 tek to.
Gjithashtu, evidentohet se në institucionet pilot të përzgjedhura është përfshirë edhe Autoriteti i Rrugor dhe Ministria e Brendshme, institucione këto të cilat kanë qenë pjesë e dy projekteve të mëparshme të realizuara nga drejtoria me ekspertë të huaj, përkatësisht: *"Projektit të Binjakëzimit për Zhvillimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, financuar nga Bashkimi Europian 2009*" në të cilin është zhvilluar testimi pilot i kuadrit ligjor për MFK (para miratimit) në Ministrinë e Brendshme, si dhe në projektin *"Mbështetje për Ministrinë e Financave të Shqipërisë për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të fondeve publike*" përfitues i së cilit ka qenë Autoriteti Rrugor Shqiptar. Pra, Drejtoria e Harmonizimit nuk ka mundur të realizojë planin për vitin 2017 për përfundimin e implementimit në institucionet pilot, edhe pas reduktimit dhe ndryshimit të njësive të përzgjedhura. Gjithashtu, përfshirja e institucioneve të cilat kanë qenë më parë pjesë e projekteve për implementimin e sistemit të MFK me asistencë të huaj, evidenton mos realizimin e qëllimit të pilotimit të MFK në to dhe rezultatet e raportuara të projekteve; si dhe formalitetin sipas së cilit kryhet përzgjedhja e institucioneve pilot.

3. Monitorimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe përgatitja e raportit vjetor për gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrollin në sektorin publik.

Në funksion të nenit 25 dhe 26 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit ka kryer monitorimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në disa institucione për të vlerësuar nga afër ecurinë e zbatimit të nenit 18 të ligjit të MFK ku thuhet se Nëpunësi Autorizues duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Financave pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën dhe raportin mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Bazuar në manualin e MFK, Kapitulli II "Rolet dhe Aktorët në Sistemin e MFK-së", pika 2.2.2 përcakton se *"DH/MFK është gjithashtu përgjegjëse për monitorimin sistematik të sistemeve të MFK-së në njësitë publike. Ajo e kryen këtë monitorim nëpërmjet aktiviteteve që realizon vetë, në bashkëpunim me njësi të tjera publike, si dhe bashkarisht me DH/AB. Ky monitorim kryhet për dy qëllime:*

- *Grumbullimin e informacioneve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë, standardeve dhe udhëzimeve*
- *Përgatitjen e raportit vjetor për NPA dhe Ministrinë e Financave mbi statusin e përgjithshëm të MFK-së."*

Për kryerjen e monitorimeve janë njoftuar institucionet e mëposhtme me shkresat nr. 6176, datë 28.03.2018:

1. **Bashkia Durrës- Shijak**, për kryerjen e monitorimit në datat 30 Prill- 4 Maj 2018
2. **Bashkia Elbasan- Peqin- Cërrik**, për kryerjen e monitorimit në datat 3-6 Prill 2018
3. **Bashkia Gjirokastër- Libohovë,**për kryerjen e monitorimit në datat 10-13 Prill 2018
4. **Bashkia Pogradec- Devoll** për kryerjen e monitorimit në datat 23-27 Prill 2018
5. **Bashkia Kamëz- Krujë** për kryerjen e monitorimit në datat 30 Prill- 4 Maj 2018
6. **Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë** për kryerjen e monitorimit në datat 16-20 Prill

7. **Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme** për kryerjen e monitorimit në datat 16-20 Prill 2018
8. **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** për kryerjen e monitorimit në datat 30 Prill- 4 Maj
9. **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** për kryerjen e monitorimit në datat 3-6 Prill
10. **Ministria e Mjedisit dhe Turizmit** për kryerjen e monitorimit në datat 3-6 Prill
11. **Avokati i popullit** për kryerjen e monitorimit në datat 30 prill- 4 Maj
12. **Autoriteti i konkurrencës** për kryerjen e monitorimit në datat 16-20 Prill
13. **Prokuroria e Përgjithshme** për kryerjen e monitorimit në datat 30 Prill- 4 Maj
14. **Kontrolli i Lartë i Shtetit** për kryerjen e monitorimit në datat 10-13 Prill

Në zbatim të kuadrit të sipërcituar, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionet dhe materialet lidhur me monitorimet e kryera nga DH/MF, ku rezultoi se:
3. a- Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me nenin 18, pika 1 e Ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ku citohet se "*Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga **njësitë e varësisë**, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji*", dhe urdhrin nr. 89 të Ministrit të Financave "*Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike"*, pika 3. II ku citohet se "*Raporti vjetor i konsoliduar për kontrollin e brendshëm hartohet bazuar në një sistem pikëzimi për çdo tregues të përcaktuar në këtë dokument (sipas formularit të kërkuar në Aneksin 1) dhe për çdo njësi qendrore apo vendore të monitoruar gjatë vitit, p.sh. për njësitë qendrore raportet që dorëzohen duhet të paraqiten në nivel grupi, i cili përfaqësohet nga mesatarja e pikëve të të gjithë sistemit (njësi qendrore + njësitë e varësisë), ndërsa për njësitë vendore do të jetë mesatarja e pikëve të njësisë: Bashki/Këshill qarku (aparat vendor + njësitë e varësisë).",* rezultoi se në dokumentacionin e dërguar pranë kësaj drejtorie nuk ka evidenca nëse në pyetësorët dhe raportet e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm nga njësitë e nivelit të parë të qeverisjes së përgjithshme, mbi raportimin në mënyrë të konsoliduar, pra duke përfshirë rezultatet edhe për njësitë e varësisë. Specifikisht, u mor në shqyrtim pyetësori i vetëvlerësimit i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila ka qenë subjekt monitorimi nga DH/MFK për besueshmërinë e pyetësorit, dhe rezultoi se pyetësori është kryer për "Aparatin e Ministrisë së Financës" dhe monitorimi nuk ka kërkuar apo verifikuar nëse përfshinte institucionet e varësisë në përputhje me manualin. Nga intervista me punonjësit e DH/MFK, ata janë të paqartë në lidhje me konsolidimin dhe përfshirjen e njësive të varësisë në vetëvlerësimin nga institucionet qendrore, e reflektuar kjo edhe në konsolidimin e kryer nga ta për raportin vjetor të KBFP, ashtu edhe në monitorimet e kryera për besueshmërinë e pyetësorëve.
3. b- Për përzgjedhjen e institucioneve që do të monitorohen, manuali i MFK udhëzon*"Llogaritjen e numrit të njësive publike që do të monitorohen nga çdo punonjës i DH/MFK duke ndare ditët e punës në dispozicion për një vit të caktuar që DH/MFK ka planifikuar ë shpenzojë për vizitat në terren, si dhe duke u nisur nga kohëzgjatja e një vizite në terren.", dhe* sipas përqindjes: 50% njësi publike nga grupi "i performuesve të dobët", 25% nga "performuesit mesatar|, 25% nga "performuesit e mirë". Nga auditimi nuk rezulton të jetë kryer dhe dokumentuar një analizë e tillë për përzgjedhjen e njësive që do të monitorohen. I vetmi dokumentacion që na u vu në dispozicion është memoja përcjellëse për planin e monitorimeve drejtuar Sekretares së Përgjithshme të MFE, ku vetëm janë listuar subjektet që do të

monitorohen dhe datat përkatëse. Gjithashtu, u konstatua se në përzgjedhjen e njësive për monitorim, nuk janë marrë në konsideratë:
-rezultatet e pyetësorëve të institucioneve varësi të Kryeministrisë (grupi 87), rezultatet e të cilave në raportin vjetor janë përfshirë në grupin e institucionet e pavarura;
-rezultatet e pyetësorëve të Këshillave të Qarkut, të cilat në raportin vjetor janë përfshirë në grupin e bashkive;
-njësitë shpenzuese të mëdha, rezultatet e së cilave kanë qenë një risi në raportin vjetor të KBFP për vitin 2017.
3. c- Nga auditimi u konstatua se shkresat për njoftimin e kryerjes së vizitës në terren janë dërguar nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në të njëjtën datë, në kundërshtim me aneksin 9 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, i cili në pikën 2) Organizimi i vizitave në terren, çështja "Si realizohen vizitat (përgatitja, vizita rezultati)", ku citohet se *" Dy javë para datës së vizitës në terren, Drejtoria e Harmonizimit të MFK, i dërgon shkresë kreut të subjektit me kërkesën për të përgatitur dokumenatet përkatëse dhe të caktojë një person kontakti në njësi për të ndihmuar ekspertin e DH/MFK, për shembull të sigurojë dokumentet për ekspertin, të organizojë takime dhe kështu me radhë."*. Konkretisht për Bashkinë Elbasan Peqin Cërrik, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, njoftimi është dërguar 5 ditë përpara fillimit të punës në terren, ndërsa për Bashkinë Durrës- Shijak; Kamës- Krujë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Avokatin e Popullit, Prokurorinë e Përgjithshme, më shumë se 1 muaj përpara fillimit të punës në terren.
3. d -Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e Menaxhimit Financiar nuk janë përgatitur materialet për konkludimet e monitorimit, përcaktuar në manual si: "*Në përfundim të vizitës në terren punonjësi i DH/MFK kryen një vlerësim të përgjithshëm mbi besueshmërinë e procesit të vetë vlerësimit të njësisë publike, i cili përfshihet në raportin vjetor të KBFP. Vlerësimi i përgjithshëm në përputhje me manualin është si më poshtë:*

% e vlerësimeve pozitive të pyetjeve të veçanta nga lista	**Vlerësimi i përgjithshëm**
100-75%	*Vetë-vlerësim i besueshëm*
74-0%	*Vetë -vlerësim jo i besueshëm*

Nga auditimi u konstatua se vizitat në terren, nuk janë shoqëruar me dokumentacionet përkatëse, protokolle takimesh, apo letra pune sipas aneksit 9 *"Metodologjia dhe lista e kontrollit për vizitat në terren",* pika 3, rezultati i të cilave konfirmon nivelin e besueshmërisë së rezultuar nga pyetësorët e vetëvlerësimit dhe verifikimit të kryer në terren.
3.e- Nga auditimi u konstatua se monitorimet e njësive publike janë kryer në një periudhë shumë të reduktuar kohore, referuar afateve për dërgimin e pyetësorëve pranë drejtorisë (në fund të muajit shkurt), si dhe afatit për përfshirjen e rezultateve në raportin vjetor të KBFP (fund të muajit maj) dhe si rezultat, kjo periudhë duhet të përfshijë edhe konsolidimin e rezultateve, në mënyrë që të kryhet përzgjedhja në metodologjinë e sipërcituar (*50% njësi publike nga grupi "i performuesve të dobët", 25% nga "performuesit mesatar|, 25% nga "performuesit e mirë"*), dhe si rezultat ky monitorim kryhet vetëm për efekt të raportit vjetor, dhe jo në një monitorim të vazhdueshëm të kryer nga DH/MFK mbi grumbullimin e informacioneve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë, standardeve dhe udhëzimeve, i cili është një nga detyrimet kryesore të kësaj drejtorie, cituar edhe në kuadrin ligjor të sipërpërmendur.
3. f -Në përfundim të vizitës në terren, Manuali i MFK udhëzon "*hartimin nga punonjësit e DH/MFK të raportit për njësinë publike përkatëse, në të cilin krahas vlerësimit do të specifikohen edhe rekomandime konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të MFK. Ky raport i dërgohet zyrtarisht njësisë publike, e cila përgatit planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, të miratuar nga NA e njësisë publike. Një përmbledhëse e raporteve*

të vizitave në terren, bëhet pjesë e raportit vjetor të KBFP, në një kapitull të vecantë", por në kundërshtim me manualin, Drejtoria e Harmonizimit pas përfundimit të monitorimeve në terren, rezultatet e tyre publikohen në raportin vjetor të KBFP, dhe më pas raportet i dërgohen njësive të monitoruara së bashku me pasqyrat e planit të tyre për zbatimin e rekomandimeve dhe implementimet në zbatim të përmirësimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në monitorimet e vitit 2016, raportet u janë dërguar njësive në nëntor të vitit 2017, dhe në këto raporte, jo në të gjitha rastet ishte vendosur niveli i besueshmërisë së marrë nga vetëvlerësimi; nuk ishin plotësuar pasqyrat sipas së cilave punonjësit të bëjnë dokumentim të krahasimeve të pyetësorëve të dorëzuar nga njësia me situatën reale; por ishin bashkëlidhur vetëm rekomandimet e lëna për njësinë. Konstatojmë se edhe për monitorimet e kryera në periudhën objekt auditimi, u ndoq e njëjta praktikë. Raportet në përfundim të monitorimeve nuk u dërguan në njësitë e monitoruara, nuk u protokolluan dhe nuk ju vunë në dispozicion grupit të auditimit deri në fund të këtij auditimi, edhe pse rezultatet e këtyre monitorimeve janë përfshirë në raportin vjetor të KBFP për vitin 2017. Në këtë raport nuk shohim që DH/MFK të shprehet për raste kur vlerësimi i tyre ishte korrigjues nga ai i vetëvlerësimit.

3. g - Në lidhje me ndjekjen e rekomandimeve të rezultuara gjatë monitorimit dhe raportit vjetor të KBFP, manuali udhëzon se ky proces do të kryhet në monitorimin e ardhshëm të njësive, por nisur nga numri i monitorimeve të kryera gjatë një viti, si dhe metodologjia sipas së cilës kjo përzgjedhje kryhet, ndjekja e rekomandimeve i përket një periudhe shumë të largët dhe që do të realizohet disa vite me vonë (*mesatarisht 115 njësi publike që dorëzojnë pyetësorë/mesatarisht 15 monitorime në vit = 7 vjet. Pra ndjekja e rekomandimeve do të kryhet pas më shumë se 5 vitesh*).

Mbi Regjistrin e NA dhe NZ sipas nenit 26, pika dh e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015

Nga auditimi u konstatua se referuar përgjegjësisë së Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit mbi krijimin dhe përditësimin e regjistrit të nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësive publike, sipas nenit 26, pika 1. dh e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, grupi i auditimi shqyrtoi dy regjistrat sipas së cilave administrohen të dhënat e nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësive publike. Nga analizimi i tyre, u konstatua se ekzistonin problematika në saktësi dhe plotësinë e regjistrave, ku më hollësisht:

-regjistrat janë të organizuar në excel, por me pamundësi përpunimi të dhënash, për shkak të formatit dhe paraqitjes të tyre në këto dokumente;

- të dhënat e pasqyruar për subjektet nuk janë të unifikuara në emërtime dhe përmbajtje

-u konstatua duplikim të dhënash për të njëjtat institucione;

-mungesë e plotë e informacionit mbi arsimimin, pozicionin e punës, etj; (që përbëjnë dhe kriteret në emërimin e N.Z);

-mungesë e datave dhe shkresave konfirmuese për N.Z;

-mungesë e informacionit të plotë në rastet e nëpunësve të deleguar për një periudhë të përkohshme (mungesë në aplikimin e kontrolleve për sinjalizimin në mbarimin e afatit të delegimit) ;

-mangësi në përditësimin e të dhënave (ekzistojnë N.A dhe N.Z të konfirmuar, por të pa azhornuar në regjistrat përkatës)

Nga auditimi u konkludua se, referuar qëllimit për të cilin nevojiten këto dokumente, sipas kuadrit ligjor të sipërcituar, këto regjistra nuk plotësojnë kriteret minimale të ruajtjes dhe organizimit të dokumenteve elektronike.

Mbi trajnimet e zhvilluara nga DH/MFK

Nga auditimi u konstatua se në zbatim të detyrimit të Drejtorisë së Harmonizimit të MFK, për*"Organizimin e seminareve të ndërgjegjësimit dhe trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në institucionet e sektorit publik",* DH/MFK ka zhvilluar një sërë trajnimesh në lidhje me tematika të ndryshme të lidhura me komponentët e MFK, të cilat përgatiten dhe referohen nga stafi i drejtorisë.
Në Memon e datës 24.02.2017 drejtuar Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Financave, znj. G.P, është përgatitur i planit të trajnimeve i detajuar me seminare 3 ditore në 61 bashki fokusuar në temat si më poshtë:
1. Trajnimi i koncepteve të përgjithshme menaxheriale të nëpunësve Autorizues dhe Zbatues si dhe plani i zhvillimit të MFK
2. Trajtimi i konceptit të menaxhimit të risqeve, të përgatitjes së regjistrit të riskut dhe menaxhimi i risqeve strategjike
3. Manuali i proceseve të punës dhe gjurma e auditit
Këto trajnime janë planifikuar të organizohen në formë trajnimesh dhe nga krahasimi i planit dhe dokumentacionin e vendosura në dispozicion nga DH/MFK të cilat dokumentojnë kryerjen e tyre rezultojnë:

- **Takimi në Tiranë** planifikuar me pjesëmarrje nga: Bashkia Berat, Ura Vajgurore Kucovë, Skrapar, Polican, Tiranë, Kamëz, Vlorë, Dibër, Mat, Bulqizë, Klos, Durrës, Shijak) në Mars 2017 dhe kryer në 4-6 Prill me USAID, dërguar për informim drejtuesve të bashkive, sipas shkresës nr. 4090, datë 27.03.2017.
- **Takimi në Vlorë** planifikuar me pjesëmarrje nga: Bashkia Vlorë, Himarë, Selenicë, Fier, Patos, Roskovec, Lushnjë,Divjakë në Mars 2017 dhe kryer në 15-17.03.2017, dërguar për informim sipas shkresës nr. 3250, datë 08.03.2017.
- **Takimi në Korcë** planifikuar me pjesëmarrje nga: Bashkia Korcë, Maliq, Kolonjë, Pogradec, Devoll, Pustec, në Prill 2017 dhe kryer në 19-21.04.2017 me USAID, darguar për informim drejtuesve të njësive sipas shkresës nr. 5006, datë 10.04.2017.
- **Takimi në Elbasan** planifikuar me pjesëmarrje nga: Bashkia Elbasan, Cërrik, Belsh, Gramsh, Peqin, Librazhd, Prrenjas, Kavajë në Qershor 2017;
- **Takimi në Shkodër** planifikuar me pjesëmarrje nga: Bashkia Shkodër, Lezhë, Kurbin, Krujë, Mirditë, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe në Qershor 2017;
- **Takimi në Kukës** planifikuar me pjesëmarrje nga: Bashkia Kukës, Has, Tropojë në Korrik 2017 dhe kryer në 6-8.11.2017, dërguar për informim drejtuesve me shkresën nr. 14986, datë 26.10.2017.
- **Takimi në Gjirokastër** planifikuar me pjesëmarrje nga: Bashkia Gjirokastër, Libohovë,Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë, Dropull, Finiq, Sarandë, Konispol, Delvinë, në Shtator 2017 dhe kryer në 16-18.10.2017, dërguar për informim njësive sipas shkresës nr. 13777/1, datë 09.10.2017

-Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se nuk ka evidenca të kryerjes së trajnimeve sipas takimeve planifikuar për :

- Takimi në Elbasan (Elbasan, Cërrik, Belsh, Gramsh, Peqin, Librazhd, Prrenjas, Kavajë) në Qershor 2017;
- Takimi në Shkodër (Shkodër, Lezhë, Kurbin, Krujë, Mirditë, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe) në Qershor 2017;

-Si dhe nuk rezultojnë të kenë qenë pjesëmarrës në këto aktivitete: përfaqësues të Urës Vajgurore, Kuçovë, Skrapar, Poliçan, Tiranë, Kamëz, Dibër, Patos, Cërrik, Belsh, Këlcyre.
-Në bashkëpunim me ASPA-n, Drejtoria e Harmonizimit ka zhvilluar trajnime me pjesëmarrje dhe tematika si më poshtë:
1. Menaxhimi i Riskut- organizuar sipas kërkesës së MZHETTS organizuar në 31 Mars 2017, me pjesëmarrje të: ATRAKO, M. Zhvillimit të Turizmit, Administrimi i Pronës Shtetërore,

Integrimi Europian dhe Projektet, Agjensia Kombëtare e Bregdetit, Ministria e Financës, MZHETTS, DPS, DPPI, AKT.
2. Njohuri të Përgjithshme mbi kontrollin e Brendshëm Financiar Publik
3. Instrumentet e Implementimit të MFK-
4. Kontrolli I Brendshëm Financiar Publik (ky trajnim është kryer në periudhën **10-14 Prill:** me pjesëmarrje përfaqësues nga; AMF, Ministria e Financave, MZHU, Agjensia për Zhvillim Ekonomik Rajonal, KLD, DSIK, MZHETTS, Kuvendi, MAS, KLSH, Komisjoneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioni i Prokurimit Publik, AMF, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë, **22-26 Maj**: Prefektura Shkodër, EITI Albania, DP.Standartizimit, DP. Përmbarimit, Ministria e Kulturës, Min. Arsimit, Shërbimi Kombëtar për Rininë, Shtypshkronja e letrave me vlerë, MPJ, Gjykata Kushtetuese. INSTAT, SHKP, MMSR, MZHETTS, DPPI, AKPT, MBZHRAU, Min. Energjetikës, AMSHC, Ujësjellës Durrës, FSDKSH, KLSH, Min. Drejtësisë, Min. Bujqësisë, Min. Integrimit, Agjensia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; **12-16 Qershor**: Enti Kombëtar i Banesave MZHU, MPJ, Inspektorati Qendror, Autoriteti Portual, Inspektorati Qendror, Gjykatave dhe ZABGJ-ve.
Gjithashtu janë ofruar edhe trajnime në institucione të veçanta në bazë të kërkesave të Institucioneve si: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (09.05.2017), në Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (Qershor 2017, dy cikle) për njësitë e vartësisë si dhe në Ministrinë e Ekonomisë (31.03.2017).
Sipas urdhrit nr. 120, datë 09.12.2016 të Ministrit të Financave **"***Për Përgatitjen dhe Ndjekjen në vazhdimësi të manualit të proceseve të punës në të gjitha institucionet dhe strukturat në varësi të Ministrisë së Financave***"**, kjo drejtori ka zhvilluar trajnim me tematikën "Manualet e Punës" në datën 17.01.2017 dhe 26.01.2017, me pjesëmarrje të një sërë drejtorisë të Ministrisë së Financës dhe varësisë së saj. Në lidhje me metodologjinë e Performancës së Ministrive të Linjës është zhvilluar në datat 08-10.05.2017 trajnim me përfaqësues të MZHETTS, MF, MTI, MBZHRAU, MAS, MEI, MMSR, MD, M.Mbrojt, M.Mjedis, M.SH, MK, MPJ, MIE.
Konstatohet se për vitin 2017 ende nuk është zhvilluar trajnim në njësitë e Ujësjellësve me qëllim informimin e komponentëve dhe metodologjive të MFK, sipas kërkesës nr. 83, datë 23.02.2017 që ka ardhur pranë kësaj drejtorie për trajnim nga Drejtori i Ujësjellës Kanalizime Lezhë.
Lidhur me dokumentacionet e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Harmonizimit, referuar përgjegjësisë së saj ligjore për organizimin e trajnimeve, cituar në nenin 26, pika 1 c: "*DH/MFK është përgjegjëse për përcaktimin e nevojave dhe udhëheqjen e trajnimeve e të trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë publike",* konstatohet se DH/MFK nuk disponon një regjistër apo dokument përmbledhës të të dhënave lidhur me trajnimet e kryera mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, sipas tematikave dhe pjesëmarrësve përkatës ndër vite. Gjithashtu, për trajnimet e kryera në bashkëpunim me ASPA-n, planifikimi i pjesëmarrësve dhe tematikave përcaktohet nga ASPA dhe punonjësit e Drejtorisë kontraktohen nga ky institucion vetëm për përgatitjen e materialeve dhe prezantimin e tyre. Pra, identifikimi i pjesëmarrësve dhe administrimi i dokumentacioneve që justifikojnë kryerjen e trajnimeve, administrohet nga ASPA, dhe jo nga DH/MFK. Krijimi i një regjistri ndër vite për trajnimet e kryera lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit, i cili të pasqyrojë tematikat e prezantuara sipas pjesëmarrësve të institucioneve, do të mundësonte identifikimin më të saktë dhe efektiv të nevojave për këto trajnime nga përfaqësuesit e sektorit publik.

Mbi fushën e zbatimit dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm realizuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

-Nga auditimi konstatohet se lidhur me përgjegjësinë e krijimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik, për të gjitha njësitë publike, ligji i Menaxhimit Financiar e kufizon

monitorimin e zbatimit të tij vetëm tek njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përkatësisht neni 3, pika 1 e ligjit nr. 10296, i ndryshuar; në dallim me ligjin e Auditimit të Brendshëm, i cili parashikon dorëzimin e dokumentacioneve dhe raporteve të AB tek DH/AB për të gjitha njësitë të cilat janë subjekt i zbatimit të ligjit, edhe pse komponentët e AB dhe MFK janë të një rëndësie të njëjtë për vetë kuptimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në garantimin se menaxhimi financiar dhe kontrolli i njësive publike është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efiçencë dhe ekonomi; ashtu edhe në organizimin e Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Në mënyrë të përmbledhur dispozitat përkatëse ligjore në mënyrë analoge për fushat e zbatimit dhe raportimit të MFK dhe AB, paraqiten si më poshtë:

	Ligji 114/2015 **"Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"**	**Ligji .10 296, Datë 8.7.2010** **"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"**	**Ligji 10 296, datë 08.07.2010** **"I ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015"**
Fusha e zbatimit të ligjit	**Neni 3** **Fusha e zbatimit të ligjit** Ky ligj zbatohet në njësitë e sektorit publik, ku, sipas këtij ligji, përfshihen: a) njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe çdo institucion tjetër që kryen funksione publike; b) shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme; c) njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare	**Neni 3** **Fusha e zbatimit të ligjit** Ky ligj zbatohet në njësitë e sektorit publik, ku, sipas këtij ligji, përfshihen: 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme. 2. Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe Autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. 3. Njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare.	**<u>Neni 3</u>** **<u>Fusha e zbatimit të ligjit</u>** Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku sipas ligjit përfshihen: 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme. 2. Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. 3. Njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare**.**
Përgjegjësia e raportimit	**Neni 14** **Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për**: a) organizimin e angazhimeve të AB, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji; b) hartimin e Kartës së Auditimit, akteve të tjera specifike për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, në zbatim të këtij ligji dhe akteve të tjera në zbatim të tij, si dhe dërgimin e tyre për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e AB; c) **hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e AB dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e AB, pas miratimit nga titullari i njësisë publike;** **ç) përgatitjen e raportit vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB dhe përmban të dhënat e mëposhtme, por nuk kufizohet vetëm në to:**	**Neni 18** **Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm** 1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, <u>sipas pikave **1 dhe 2 të nenit 3** të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i</u> njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një **deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë** publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një system të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji.	**Neni 18** **Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm** 1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, <u>sipas pikës **1të nenit 3** të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve</u>, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një **deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që** mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji.

Neni 8 i ligjit nr. 10 296, i ndryshuar, përcakton në pikën 1 se *"Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë."*, dhe respektivisht në pikën 1 përcakton detyrimin e titullarëve për caktimin e nëpunësit autorizues, përgjegjës sipas ligjit për depozitimin e raporteve dhe pyetësorëve pranë DH/MFK. Pika 3 nenit 8 përcakton se "*<u>Titullarët e njësive publike, të përmendura në pikat 2 e 3 të nenit 3 të këtij ligji</u>, mund të caktojnë një nëpunës të nivelit më të lartë drejtues dhe t'i ngarkojnë atij <u>përgjegjësi që janë të barasvlershme me ato të nëpunësit autorizues</u>.",* pra për garantimin e krijimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm por këto institucione, pas ndryshimit të ligjit nuk janë më subjekt i

monitorimit dhe raportimit të drejtorisë, pasi nuk sigurohet më informacion lidhur me to, pavarësisht se ato janë përgjegjëse për krijimin dhe zbatimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik, situatë kjo që rezulton në një raportim të pjesshëm mbi situatën reale të sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik në raportin vjetor të KBFP. Si rezultat, raportimi i DH/MFK për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, kryhet nga analizimi i te dhënave për rreth 156 njësi publike (njësitë e mëdha të qeverisjes së përgjithshme), nga një total prej mbi 1000 insitutionesh që rezultojnë nga të dhënat e buxhetit.

- Nga auditimi konstatohet se referuar ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, raportimi i njësive publike do të përfshijë në mënyrë të konsoliduar të dhënat e organin qendror të njësisë dhe njësitë e vartësisë të kontrolluara prej saj. Pavarësisht mungesës së sigurisë për kryerjen e konsolidimit, për shkak të monitorimit të kryer nga drejtoria të cilat nuk kanë mundur të vërtetojnë dhe monitorojnë nëse ky konsolidim është kryer , trajtuar më sipër në këtë material, vetë përmbajtja e pyetësorit të vetëvlerësimit evidenton disa problematika. **Së pari**, konstatohet se një formë e tillë raportimi rezulton në mungesën e gjurmëve të raportimit të institucioneve të mëdha publike, të cilave ju akordohen vlera të konsiderueshme buxheti, dhe përsëri nuk bëhen pjesë e raportimeve të DH/MFK, pasi ky informacion depozitohet në institucionet qendrore mëmë dhe në monitorimet e kryera nga DH/MFK nuk kryhet verifikimi për plotësimin e këtyre pyetësorëve në mënyrë të konsoliduar, port vetëm për aparatin. **Së dyti**, në shumë raste, veprimtaria dhe natyra e institucioneve është shumë e ndryshme krahasuar me varësitë e tyre, dhe si rrjedhojë edhe problematikat e hasura janë të vështira për tu konsoliduara në formën e duhur. **Së treti**, institucione të tjera të pavarura dhe të vogla, nuk bëhen pjesë e monitorimeve. Nga auditimi, arrihet në përfundimet se në mënyrë që të sigurohet një informacion nga institucionet e varësisë, OJF, sh.a etj; përgatitja e pyetësorëve të personalizuar sipas grupeve, do të garantonte më tepër efektivitet në raportim, referuar detyrimit të kësaj DH/KBFP për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për të ndihmuar nëpunësin e parë autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe për përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit publik, neni 26, pika 3 e ligjit të MFK.

Aneksi nr.4: Analiza e indikatorëve të vlerësimit të performancës së sistemit kontrollit brendshëm financiar publik.

Vlerësimi i indikatorëve qe tregojnë nivelin e zbatimit të objektivave të Strategjisë së PMF 2014-2020, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditit të brendshëm

Raporti vjetor i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP),është hartuar nga Drejtoria e MFK dhe AB, me përgjegjësinë e një strukture ndihmëse për Nëpunësin e parë autorizues dhe Ministrin e Financave për të përmbushur kërkesën ligjore[42] monitorimin e efektivitetit të sistemeve tëKBFP në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, duke i dedikuar këtij aktiviteti burime dhe kohën prej 3 muaj kohe e plotë pune- 6 specialistë (përfshirë monitorimet për besueshmërinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit, përpunimin e ë dhënave).

Në funksion të objektivit të auditimit: dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit te DH/KBFP, vlerësimit të sistemit KBFP në zbatim të Ligjit nr. 10296 dhe Ligjit Për Buxhetin nr. 9936, kemi analizuar dhe testuar Raportin vjetor për vitin 2017 në të 3 komponentët e tij: Vlerësimi i Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin (MFK); Auditi i Brendshëm (AB) dhe aktiviteti i Drejtorisë së Harmonizimit. Gjithashtu proceset e punës, sistemet e kontrollit janë testuar, në funksion të certifikimit të të dhënave dhe opinionit të dhënë në këtë raport nga DH mbi KBFP në nivel kombëtar.

[42] *Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 7 dhe 18*

- Në pjesën e parë të Raportit, me paraqitjen e pikëve dhe rankimin e njësive të analizuar për të 20 indikatorët bëhet një paraqitje dhe analizë e sistemit të kontrollit në të 4 komponentët e tij, analizë mbi të cilën konkludohet nga DH se:

"Opinion i Përgjithshëm: *Nga analiza e përgjithshme e këtyre indikatorëve, ne mund të arrijmë një konkluzion paraprak mbi komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Treguesit e mësipërm lidhen kryesisht me komponentin e aktivitetit të kontrollit, që përfshin ekzistencën e rregullave dhe procedurave të shkruajtura të proceseve kryesore si: të prokurimeve, të kontratave, urdhër-shpenzimeve, etj. Nga analiza e përgjithshme, rezulton që ka kontrolle efektive të ndërmarra nga ana e institucioneve, ku mesatarisht efektiviteti i tyre për njësitë e qeverisjes së përgjithshme* ***është 87%.*** *Megjithatë, në disa indikator apo tregues specifik lind nevoja për marrjen e masave për përmirësime të vazhdueshme në periudhat e ardhshme".,*

Opinioni i mësipërm është dhënë në përfundim të përpunimit të të dhënave të **126 njësive** nga të cilat: 11 Ministrive të linjës,61 Bashkive, si dhe janë shtuar dhe 26Institucioneve të pavarura dhe 17njësi të grupit 87-në varësi të Kryeministrit dhe 11 njësi shpenzuese me buxhet të madh, kjo në vijim të rekomandimeve të SIGMA-s Nëntor 2017[43]. Pra, paraqitja dhe vlerësimi i eficenses së indikatorëve të performancës dhe opinioni për nivelin e funksionimit të sistemeve të kontrollit është bazuar në **gjithsej 126 njësi nga 1253 njësi shpenzuese[44] ose 10% e numrit gjithsej.** Duke vazhduar më tej me shkallën e mbulimit të vlerësimit dhe monitorimit të sistemit të njësive të qeverisjes së përgjithshme, konstatojmë se indikatorët e Ministrive të linjës dhe rankimi i tyre përfaqëson vetëm situatën e sistemeve të kontrollit të brendshëm për aparatet e Ministrive dhe jo për njësitë e varësisë. Kjo, **<u>në kundërshtim me Pika II. Paragrafi 4 i Metodologjisë së vlerësimit të performancës së njësive publike</u>**".

Për të konfirmuar konstatimin tonë, nga grupi i auditimit, janë shqyrtuar raportet e dorëzuara nga ministritë e linjës dhe janë intervistuar specialiste që përpunojnë të dhënat e këtij raporti dhe formularin vete-vlerësimit përkatës. Kështu, nga shqyrtimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që ka 11 njësi varësie, konstatojmë se ai është plotësuar vetëm për aparatin e kësaj ministrie. Në relacionin shoqërues flitet për ndryshimet strukturore të Ministrisë së Financave në fund të vitit 2017 me përthithjen e disa programeve të Ministrive të cilat më pas pushuan së ekzistuari si më poshtë:

ish-MZHETTS :	**ish- MMSR**	**ish MZHU**
1. Planifikim, Menaxhim, Administrim	4. Sigurimi Shoqëror	8. Strehimi Social
2. Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	5. Tregu i Punës	
3. Mbështetje për Mbikqyrjen e Tregut	6. Inspektimi në Punë	
	7.Arsimi i Mesëm Profesional	

por nuk ka asnjë koment apo shënim konkret se si <u>ky proces ndikoi në 5 komponentët e menaxhimit financiar duke filluar me: analizën dhe azhornimin e risqeve që do të sillte ky ndryshim në burimet njerëzore, sistemet e komunikimit dhe informimit, monitorimit, kontabilitetit, inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme (transferimi nga librat kontabël të një ministrie te tjetra), delegimin dhe dorëzimin e detyrave, azhornimin e rregulloreve etj</u> (psh. Misioni i MFE që është ende i pa azhornuar[45]):

Gjatë auditimit konstatuam se, disa njësi varësie sjellin pyetësorin e vetëvlerësimit pranë DH por ai nuk konsolidohet nga DH me përgjigjen se ai duhej apo është dërguar tek njësia qendrore dhe mund të jenë dërguar pranë DH-së si një kopje dytë. Të pyetur nëse gjatë monitorimeve të kryera tek Ministritë (psh. MFE) është parashikuar verifikimi nëse ky pyetësor është dërguar nga të gjithë njësitë e varësisë te njësia qendrore (Aparati) dhe, nëse formulari i vetëvlerësimit

[43] Sigma Program, Raporti i Monitorimit "Principles of Internal Control", fq.146-149

[44]Burimi: Sistemi i Pagesave -Drejtoria e Thesarit- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

[45]ëëë.minfin.gov.al

reflekton/ konsolidon dhe rezultat e sistemeve të kontrollit të njësive të varësisë, përsëri përgjigja është se një verifikim i tillë nuk bëhej sepse"cdo njësi varësie funksionon më vete me titullarë përgjegjës më vete".[46]

Në kuadër të testimeve, iu kërkua Nëpunësit zbatues të MFE të na vihen në dispozicion pyetësorët e njësive të varësisë me qëllim llogaritje e efektivitetit të ministrive të linjës, me gjithë njësitë e tyre të varësisë. (Deri në këtë moment 5.6.2018, nuk na është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar). **Në përfundim, treguesi 87% i efektivitetit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit është përfaqësues vetëm i 11 aparateve të Ministrive të linjës.**

Përveç bazës së llogaritjes, e cila nuk është përfaqësuese e sistemit, DH shprehet në opinionin e saj se rezultati i efektivitet prej 87% ka lidhje "*kryesisht me komponentin e aktivitetit të kontrollit*", ndërkohë që në vijim të raportit komponentët e MFK dhe treguesi i efektivitet llogaritet për çdo komponent (pjesa II, pika 2.1.3 Aktivitet e kontrollit) me një vlerësim prej 87.6% të ministrive të linjës+bashki+ institucione të pavarura). Në gjykimin tonë, Raportit vjetor KBFP, i mungon një tregues efektiviteti në rang grup-njësish të marra në analizë sipas 20 indikatorëve, e cila në bazë dhe të peshës specifike apo faktorit të rëndësisë që këto 126 zënë në buxhetin e shtetit, të mund të ekstrapolohej në nivel gjithëpërfshirës të sistemit të njësive të qeverisjes së përgjithshmë (ose grup- njësish), për arritur në një rezultat relevant e të drejtë në bazë të karakteristikave të secilit grup.

- Në lidhje me mënyrën e zbatimit të "Metodologjia e vlerësimit të performancës" e miratuar me Urdhrin nr. 89 të Ministrit të Financave dt. 28.12.2015 konstatojmë se:

DH përdor një numër të ndryshëm indikatorësh për grup-njësi të ndryshme rrjedhimisht "**numër pikësh potenciale maksimale(0-600)**". Metodologjia përcakton 23 indikatorë shoqëruar me anekset përkatëse udhëzuese për mënyrën e llogaritjes të secilit indikator. Këta indikatorë, plotësohen nga titullarët e njësive publike ose specialisti përgjegjës në DH/AB[47]. Në këtë metodologji nuk përcaktohen kufizime nëse për grup njësi të ndryshme duhen apo aplikuar indikatorë të ndryshëm apo përjashtime të caktuara të ndonjërit prej tyre. Ndërkohë, në dijeninë e grupit të auditimit mbi informacionin e grumbulluar apo publikuar, Metodologjia, gjatë vitit 2017, nuk ka ndryshime/ përmirësime në numrin, llojin apo indikatorë të përjashtuar në të 4 grupet: Thesar, Buxhet, MFK dhe AB. Kështu në raport vlerësimet janë bërë mbi bazën e këtyre kufijve maksimalë të paraqitur në tabelën si vijon:

Grup-njësitë e analizuara	**Nr.**	**Numri max i pikëve**	**Indikatorët e papërfshirë**	**Shpjegimi i dhënë në Raport**	**Komenti i audituesit**
Ministritë e linjës	20	600	-	-	Ok
Bashkitë	15	450	-5 Indikatorët e buxhetit	s'ka shpjegime	Metodologjia nuk përcakton diferencime në nr. e indikatorëve të aplikueshëm për çdo grup-njësie. Nëse për treguesin nuk ka të dhëna atëherë vlerësimi duhet të jetë zero pikë.
Institucione të pavarura	18	540	"Urdhër prokurimet e pa-autorizuara" dhe "Shlyerja e detyrimeve të prapambetura"	DH: "Nuk ka të dhëna për këta dy indikator"	Vlerësimi maximal i mundshëm duhet të jetë 600 dhe vlerësimi për **2** indikatorët pa të dhëna të vlerësohet me zero pikë.
Grupi 87- në varësi të	18	540	"Urdhër prokurimet e pa-	DH: "Nuk ka të dhëna për	Vlerësimi maximal i mundshëm duhet të jetë 600 dhe vlerësimi për **2**

[46] *Intervistë, E-mail: 2 specialiste të DH/MFK*

[47] *Urdhëri nr.89 i Ministrit të Financve dt.28.12.2015, pjesa II*

Kryeministrit			autorizuara" dhe "Shlyerja e detyrimeve të prapambetura"	këta dy indikator"	indikatorët pa të dhëna të vlerësohet me zero pikë.
Njësi shpenzuese me Buxhet të madh	11	330	-1 indikator Thesar; -2 indikator Buxhet; -5 indikator AB	s'ka shpjegime	Vlerësimi maximal i mundshëm duhet të jetë 600 pikë dhe vlerësimi për **9** indikatorët pa të dhëna të vlerësohet me zero pike

Në gjykimin tonë, DH në rolin e saj udhëheqës si harmonizuese, zhvilluese e metodologjive, bazës ligjore, manualeve etj., duhet bëjë një analizë dhe vlerësim të indikatorëve pas vitit të dytë të aplikimit të tyre. Kjo analizë duhet të ketë si objektiv vlerësimin e indikatorëve bazuar në eksperiencën e deritanishme në grumbullim, përpunim, shpjegim, problematika reale të ardhura nga AB, auditi i jashtëm (KLSH) dhe rekomandimeve të SIGMA: Të vlerësojë nëse ato janë relevante, efektive, transparente dhe paraqesin me siguri të arsyeshme dhe transparencë, realitetin e sistemeve të kontrollit për të gjithë njësitë e qeverisjes publike; të identifikojë nëse ka vështirësi në grumbullimin e të dhënave, vështirësi apo paqartësi me Anekset dhe shpjegimet e tyre për mënyrën e llogaritjes së indikatorëve; të japë arsye pse disa indikatorë lihen jashtë vlerësimit? Për mungesë të dhënash apo për shkak të përformancës së ulët.

Në mbështetje të sa më lartë, DH ka zgjedhur 20 indikatorë për ti përmbledhur e paraqitur për 126 njësitë e analizuara dhe mbi bazën e tyre grupi i auditimit ka bërë një vlerësim se sa do të ishte treguesi i përfomancës së sistemeve KBFP, pa marrë parasysh këtu gabime të mundshme në përpunim[48], saktësi dhe besueshmëri në raportim[49] të cilat janë trajtuar në pikat e tjerat të këtij auditimi:

	Ministritë e linjës (11 njësi)	**Bashki (61 njësi)**	**Institucionet e pavarura (26 njësi)**	**Institucionet e grupit 87 (17 njësi)**	**Njësi shpenzuese me buxhet të madh (11 njësi)**	**Vlerësimi mesatar për cdo grup-indikator**
Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit						**68%**
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	53%	50%	53%	62%	47%	54%
2. Nr. i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	95%	96%	95%	100%	94%	96%
3. Nr. i urdhër shpenzimeve të refuzuara thesari	100%	93%	100%	97%	100%	97%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	21%	36%	21%	1%	27%	20%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	98%	94%	98%	0%	**nuk ka të dhëna**	73%
Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit						**50%**
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	97%	**nuk ka të dhëna**	97%	59%	**nuk ka të dhëna**	63%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	77%	**nuk ka të dhëna**	77%	42%	83%	49%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	55%	**nuk ka të**	55%	90%	62%	50%

[48] *Trajtuar si pikë e vecantë mbi testimin e aplikacionit PIFC dhe procesit të punes së përpunimit të pyetsorëve.*
[49] *Trajtuar si pikë e vecantë"Mbi monitorimet besueshmërisë e MFK"*

		dhëna				
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe nr. rialokimeve	89%	**nuk ka të dhëna**	89%	97%	**nuk ka të dhëna**	69%
10. Krijimi i detyrimeve të reja	41%	**nuk ka të dhëna**	41%	0%	**nuk ka të dhëna**	21%
Drejtoria e Harmonizimit për MFK						**88%**
11. Cilësia e mjedisit të brendshëm	97%	87%	97%	96%	91%	94%
12. Cilësia e menaxhimit të riskut	79%	71%	79%	67%	79%	74%
13. Cilësia e veprimtarive të kontrollit	81%	84%	81%	88%	85%	84%
14. Cilësia e sistemit të komunikimit dhe informacionit	94%	94%	94%	98%	94%	95%
15. Cilësia e monitorimit	100%	84%	100%	86%	94%	93%
Drejtoria e Harmonizimit për AB						**66%**
16. Përgatitja profesionale e AB	89%	71%	89%	15%	**nuk ka të dhëna**	66%
17. Raportimi në kohë i audituesve të brendshëm në MF	100%	80%	100%	18%	**nuk ka të dhëna**	74%
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të AB-ve	100%	75%	100%	18%	**nuk ka të dhëna**	73%
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	68%	41%	68%	15%	**nuk ka të dhëna**	48%
20. Kapacitetet e burimeve njerëzore të AB	89%	76%	89%	15%	**nuk ka të dhëna**	67%

- Në lidhje me paraqitjen e të dhënave në raport, në një seksion të veçantë janë paraqitur të gjitha rezultatet për çdo njësi të grupit të cilët kanë raportuar këta indikatorë. Megjithatë nuk është lehtësisht i lexueshëm rezultati i këtij vlerësimi kur mungojnë përmbledhja e indikatorëve (si psh në formatin e Aneksit 1 të Metodologjisë, i konkretizuar me rezultatet sipas: grup-indikatori; lloji njësie shpenzuese, krahasimi me një vit më parë etj.). Kështu , në ndryshim nga Raporti i vitit 2016 , për ministritë e linjës, nuk paraqitet ecuria dhe ndryshimi i rankimit me bazë krahasimore të një vit më parë. Nëse do të bëhej kjo do ishte lehtësisht e lexueshme se **në të gjitha ministritë ka ulje të pikëve në total të 20 indikatorëve (ose 6% krahasuar me vlerësimin mesatar të një viti më parë)**.

Institucioni	*Vlerësimi në pikë për vitin 2016*		*Vlerësimi në pikë për vitin 2017*	
Ministria e Zhvillimit Urban	585	-		*
Ministria e Financave (dhe Ekonomisw)	556	+++	530	*
Ministria e Punëve të Jashtme (pwr Evropwn dhe..)	550	+	500	*
Ministria e Arsimit dhe Sporteve	550		510	
Ministria e Punëve të Brendshme	540		495	
Ministria e Mbrojtjes	540		495	
Ministria e Mjedisit (Turizmit)	535		500	*
Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	535			
Ministria e Kulturës	525		470	
Ministria e Shëndetësisë (dhe Mirwqwnies Sociale)	515	+	500	*
Ministria e Integrimit Europian (-)	515	-		*
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	510	-		*
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	500		465	
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	500	++	480	*
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë Turizmit dhe Sipërmarrjes	490	-		*
Ministria e Drejtësisë	490		485	
	8,436		5,430	
vlerësimi mesatar	527		494	-6%

Nëse do të llogarisnim efektivitetin e KBFP në nivel grup-ministrie, mbi maksimumin e pikëve të mundshme 600 (20 indikatorë*30pikë), atëherë ai është 82% krahasuar me 88% në vitin 2016[50]. Nëse do të analizohej dhe paraqitej në raport, rankimi i Ministrive për secilin grup-indikatorësh, vlerësimi për ministritë e linjës paraqitet në tabelën në vijim ku duket qartë se indikatorët me ndikim më te madh në vlerësimin mesatar në rënie janë ato të:

Thesarit -12% dhe Buxhetit -13%:

- Indikatori 1: Dorëzimi në kohë i faturave në Thesar
- Indikatori 4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar
- Indikatori 10. Krijimi i detyrimeve të reja

		Thesar		Buxhet		MFK		AB	
Ministria	**Vlerësimi total në pikë për vitin 2017**	**v. 2016**	**v.2017**	**v. 2016**	**v.2017**	**v. 2016**	**v.2017**	**v. 2016**	**v.2017**
Ministria e Zhvillimit Urban		145		145		150		145	
Ministria e Financave (dhe Ekonomisë)	530	145	125	135	135	140	130	136	140
Ministria e Punëve të Jashtme (për Evropën d	500	135	105	150	120	130	130	135	145
Ministria e Arsimit dhe Sporteve	510	125	115	135	115	150	150	140	130
Ministria e Punëve të Brendshme	495	120	105	145	120	130	130	145	140
Ministria e Mbrojtjes	495	120	105	135	115	140	140	145	135
Ministria e Mjedisit (Turizmit)	500	145	110	115	115	140	140	145	135
Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë		130		120		150		135	
Ministria e Kulturës	470	130	110	105	85	150	150	140	125
Ministria e Shëndetësisë (dhe Mirëqënies Sociale)	500	110	115	120	110	150	140	135	135
Ministria e Integrimit Europian (-)		120		100		140		145	
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës		130		135		140		105	
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	465	130	110	95	70	140	140	135	145
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	480	105	110	105	110	150	120	140	140
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë Turizmit dhe Sipërmarrjes		120		85		150		135	
Ministria e Drejtësisë	485	120	105	115	90	110	150	145	140
	5,430	**1385**	**1,215**	**1355**	**1,185**	**1530**	**1,520**	**1541**	**1,510**
vlerësimi mesatar/ ndryshimi*	494		-12%		-13%		-1%		-2%
**nuk janë përfshirë në llogaritje ministritë e përthithura*									

[50]Sipas të dhënave të Raportit vjetor të KBFP 2017 dhe 2016 dhe tabelave në formë elektronike të vëna në dispozicion nga specialistet e DH-së

Sipas Urdhrit nr. 89 Drejtoria e Thesarit dhe Drejtoria e Buxhet janë përgjegjëse për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e indikatorëve respektivë tek DH, për efekt konsolidimi në Raportin vjetor Përtej një analize statistikore krahasimore individuale, me të dhënat e një viti më parë, Raporti nuk ka ndonjë analizë mbi monitorimin, vlerësimin e indikatorëve Thesar, Buxhet. Përjashtim bën vetëm indikatori 7 : Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente" i shoqëruar me një shpjegim për vlerësimin mesatar në rang ministrie linje.

Indikatorët e performancës së zbatimit të buxhetit[51]

Nga informacioni i marrë gjatë auditimit financiar të KLSH në MFE, rezultoi se shuma e faturave të prapambetura më 31.12.2017 ishte 30 milion lekë sipas Drejtorisë së Financës dhe 90 mion lekëpas testimit të balancave të llogarive nga grupi i auditimit. Ndërkohë MFE vlerësohet me 30 pikë maksimale me zero fatura të prapambetura.

Indikatorët e performancës për funksionet operacionale të Thesarit në Ministrinë e Financave

*Struktura përgjegjëse për **funksionet operacionale të Thesarit** në Ministrinë e Financave kryen funksionet e kontrollit financiar të transaksioneve para pagesës, menaxhimin e likuiditeve të qeverisë gjatë procesit të kryerjes së transaksioneve financiare, si dhe përgatit raporte të sintetizuara për cdo institucion qëndror dhe vendor*.

Me qëllim testimin e të dhënave dhe treguesve të paraqitur në Raportin vjetor i cili më pas do të bëhet pjesë e Raportit vjetor të zbatimit të Buxhetit të shtetit sipas Ligjit nr. 9936 dt. 26.6.2008, ju kërkua specialistëve të DH të na përcillej materiali i dërguar nga Drejtoritë e Thesarit dhe Buxhetit. Informacioni i marrë është vetëm elektronik, tabelor dhe i pa shoqëruar me relacion apo analizë mbështetëse. Përveç çështjes së saktësisë së të dhënave (rasti i MFE apo Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve), mungon plotësisht analiza e Drejtorive përgjegjëse për monitorimin: Buxhet dhe Thesar**.**

Për dy grup indikatorët e mësipërm, DH në rolin e saj si konsoliduese e të dhënave bën vetëm një përmbledhje mekanike të shifrave dhe një analizë të thjeshtë statistikore krahasimore me një vit më parë dhe në disa raste identifikon performuesin më të mirë apo më të dobët. Minimalisht duhet të bëhet një analizë mbi korrelacionin e indikatorëve: psh: nëse ka kontrata të dorëzuara me vonesë ekziston rreziku i krijimit të faturave të prapambetura. Për më tepër, analiza e indikatorëve si variabla të njeri tjetrit nxjerr në pah dhe subjektivizmin në vlerësim të indikatorëve të MFK dhe AB-së. Si mund të jetë situata e aktiviteteve të kontrollit, mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut kaq perfekte kur ende jemi në nivele 53% dhe 21% të dorëzimit të faturave dhe kontratave dhe në njësi ku performojnë mbi mesataren njësitë e auditit të brendshëm? Çfarë pamje do të kishte harta e perfomancës si më poshtë nëse do të kishim një indikator mbi proceset e prokurimeve?

[51] *Urdhërit nr. 89dt. 28.12.2015 i Ministrit të Financave, pika 3, Struktura pergjegjëse për **monitorimin e buxhetit** në Ministrinë e Financave, analizon dhe vlerëson raportet e sintetizuara periodike të monitorimit të njësive të qeverisjes qëndrore dhe përgatit një raport me konkluzione dhe rekomandime për secilën njësi të qeverisjes qëndrore për periudhën përkatese të raportimit. Mbështetur ne informacionin e raporteve te sintetizuara te monitorimit, njësia përgjegjëse për buxhetin rekomandon NPA të marre masat e nevojshme korrigjuese për menaxhimin e buxhetit, në rastet kur identifikohen devijime nga planifikimi*

	Thesar		Buxhet		MFK+AB			
Ministria	***Dergimi i faturave per pagese ne Thesar***	***Dorezimi ne kohe i kontratave ne Thesar***	***Raporti Fakt/Plan i shpenzimeve kapitale gjate nje viti***	***Krijimi i detyrimeve te prapambetura***	***Mjedisi i kontrollit***	***Menaxhimi i Riskut***	***Aktivitetet e kontrollit***	***Cilesia e raportimit te auditueseve te brendshem***
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	15	10	15	10	30	30	30	15
Ministria e Brendshme	15	5	15	15	20	20	30	25
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	15	10	15	0	30	30	30	25
Ministria e Infrastr. dhe Enerigjisë	15	5	30	5	30	20	20	25
Ministria e Kulturës	15	5	10	0	30	30	30	15
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	15	10	15	10	30	20	30	15
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	15	10	30	10	30	20	30	15
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	25	10	15	30	30	20	20	25
Ministria e Drejtësisë	15	5	15	15	30	30	30	25
Ministria e Mbrojtjes	15	0	15	10	30	20	30	15
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	15	0	5	30	30	20	20	25
vlerësimi mesatar në pikë	***15.9***	***6.4***	***16.4***	***12.3***	***29.1***	***23.6***	***27.3***	***20.5***
vlerësimi mesatar në %	***53%***	***21%***	***55%***	***41%***	***97%***	***79%***	***91%***	***68%***

Sa më lartë, sjell domosdoshmërinë e saktësimit apo shpjegimin e konceptit të **monitorimit dhe raportimit të vazhdueshëm** me të paktën edhe me një raportim 6-mujor atëherë kur dhe frekuenca apo numri i rialokimeve të buxhetit është më i lartë.

Mungon në raport një përmbledhje e dobësive në funksion të dhënies së rekomandimeve por mbi të gjitha të nevojës për vlerësim dhe rishikim të metodologjisë për të marrë parasysh karakteristikat e sistemit publik shqiptar, kapaciteteve drejtuese dhe menaxhuese, nivelit të gjetjeve dhe rekomandimeve të KLSH[52] në lidhje me investimet kapitale dhe procedurat e prokurimit, mungesës së standardeve të kontabilitetit publik etj. [53]

Indikatorët e performancës së menaxhimit financiar dhe kontrollit[54]:

[52]*Sipas Buletinit të Auditimve nr.4 "Për sa i përket shkeljeve të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, KLSH ka rekomanduar në shumën e përgjithshme* ***99,045 milion lekë*** *nga e cila:* ***92,677 milion lekë*** *në fushën e të ardhurave dhe 6,368,938 mijë lekë në fushën e shpenzimeve"*

[53]*Udhëri nr.89 dt. 28.12.2015 i Ministrit të Financave, pjesa III, gërma i, pika 1,2,3 dhe 4.*

[54] *Urdhri nr. 89 dt. 28.12.2015 i Ministrit të Financave, pika 3 : Struktura përgjegjëse të* ***harmonizimit te MFK,*** *monitoron në nivel tjetër cilësinë e sistemeve MFK për njësit♪7 publike. Ky monitorim kryhet*

Në raport thuhet se: "Nga analiza e përgjithshme e rreth **130 njësive**, u konkludua që efektiviteti i përgjithshëm i sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në këto institucione për vitin 2017 është 3.41/4.00, duke evidentuar progres në krahasim me vitin 2016, i cili ka qenë 3.16/4.00".

Nga tabelat e paraqitura në raport rezultojnë 126 njësi të analizuara. Vlerësimi është bërë mbi bazën e përpunimit të të dhënave të pyetësorëve me 39 pyetje. Me qëllim testimin, u kërkua dhe na u vu në dispozicion databaza e të dhënave të pyetësorëve të cilët përpunohen në aplikacionin PIFC dhe më pas në Excel. Procesi i përpunimit të të dhënave është tepër manual. Çdo pyetësor i ardhur elektronikisht mund të hidhet në aplikacionin PIFC për pjesët që mund të përpunohen nga ai dhe pjesa tjetër hidhet nga specialistja manualisht në Excel një nga një. Mënyra e përpunimit të të dhënave dhe pasaktësitë e konstatuara janë trajtuar në një pikë më vete, ku diferencat në vlerësim, edhe pse jo materiale nxjerrin në pah nevojën e menjëhershme të automatizimit të procesit. Kjo do të shmangë pasaktësitë dhe do të krijojë mundësinë që specialistët të fokusohen në analiza të mirëfillta ekonomike dhe financiare, dhe monitorime të vazhdueshme në shërbim të marrjes së masave korrigjuese dhe përditësimin e planit të veprimit.

Indikatorët e performancës së auditimit të brendshëm[55]

Indikatorët e AB kanë si synim matjen e performancës së strukturave të njësisë së auditit të brendshëm, mirë-funksionimin, efikasitetin dhe eficencën e tyre nënë sektorin publik. Gjatë auditimit u konstatua se:

Indikatori 16 i llogaritur sipas udhëzimeve në Aneksin 19 nuk parashikon vlerësim për njësitë që i kanë audituesit në proces certifikimi dhe lë vend për gjykim dhe ndërhyrje në vlerësim. Tabela si vijon paraqet rezultatin e testimit të vlerësimit të 26 njësive AB:

Institucioni	Plan	Fakt	AB të certif.	AB në proces certif.	AB të certif. dhe trajnuar	AB të pa certif. e të patrajnuar	Pikëgjithsej	Pikët maksimale të mundshme	Vlerësimi sipas DH/AB	Pikët gjithsej sipas Audituesit	Vlerësimi sipas Audituesit
Pikët			**15**	**0**	**30**	**0**					
MFE	10	9			8	1	270	270	**30**	240	**15**
AMF	2	2			1	1	60	60	**30**	30	**15**
Bashkia Ura Vajgurore	2	2		1		1	60	60	**30**	0	**0**
Bashkia Kucove	3	3				3	30	90	**0**	0	**0**
Bashkia Klos	1	1				1	30	30	**30**	0	**0**
Bashkia Shijak	3	3		1		2	60	90	**20**	0	**0**
Bashkia Prrenjas	1	1				1	30	30	**30**	0	**0**
Bashkia Divjakë	2	2		1		1	60	60	**30**	0	**0**
Bashkia Kolonje	3	3		2		1	90	90	**30**	0	**0**
Bashkia Tropoje	2	2		2			60	60	**30**	0	**0**
Bashkia Vau Dejes	3	3		1		2	60	90	**20**	0	**0**
Bashkia Selenicë	1	1		1			30	30	**30**	0	**0**
Bashkia Ura Vajgurore	2	2		1		1	60	60	**30**	0	**0**
Bashkia Kucove	3	3				3	30	90	**0**	0	**0**
Bashkia Diber	3	3			1	2	60	90	**20**	30	**15**
Bashkia Mat	3	3			1	2	60	90	**20**	30	**15**

nëpërmjet analizës së përgjigjeve të pyetësorëve vjetorë të vetëvlerësimit të sistemeve, si dhe monitorimit në vend të njësive publike mbi bazën dokumentare te MFK.

[55] *Struktura përgjegjëse e **harmonizimit te auditimit te brendshëm**, monitoron në nivel vjetor funksionimin e veprimtarisë te strukturave te auditimit te brendshëm ne sektorin publik. Ky monitorim kryhet nëpërmjet analizës së përgjigjeve të pyetësorëve vjetorë të vetëvlerësimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, të cilat depozitohet çdo fillim viti pranë kësaj strukture.*

Bashkia Bulqize	3	3			2	1	90	90	**30**	60	**15**
Bashkia Klos	1	1				1	30	30	**30**	0	**0**
Bashkia Shijak	3	3		1		2	60	90	**20**	0	**0**
Bashkia Elbasan	7	6			5	1	180	180	**30**	150	**15**
Bashkia Prrenjas	1	1				1	30	30	**30**	0	**0**
Bashkia Roskovec	2	2			1	1	60	60	**30**	30	**15**
Bashkia Lushnjë	3	3			2	1	90	90	**30**	60	**15**
Bashkia Divjakë	2	2		1		1	60	60	**30**	0	**0**
Bashkia Dropull	4	4		1	2	1	120	120	**30**	60	**15**
Bashkia Maliq	3	2			1	1	60	60	**20**	30	**15**
Bashkia Kolonje	3	3		2		1	90	90	**30**	0	**0**
Bashkia Pogradec	2	2			1	1	60	60	**30**	30	**15**
Bashkia Kukës	3	3			1	2	60	90	**20**	30	**15**
Bashkia Lezhe	5	5	4			1	150	150	**30**	60	**15**
Bashkia VauDejes	3	3		1		2	60	90	**20**	0	**0**
Bashkia FushëArrëz	3	3			2	1	90	90	**30**	60	**15**
Bashkia Kamëz	4	4			3	1	120	120	**30**	90	**15**
Bashkia Himarë	3	3			2	1	90	90	**30**	60	**15**
Bashkia Sarande	3	2			1	1	60	60	**20**	30	**15**
Bashkia Mirdite	4	4		2	1	1	120	120	**30**	30	**15**
Vlerësimi mesatar									***26***		***7,5***

Përqindja e gabimit në kampion 70% , e cila e aplikuar në totalin e njësive të vlerësuara do të ndryshonte treguesin e efektivitetit nga 66% në 53% për indikatorin dhe në 63% për grup indikatorët.

	Ministritë linjës (11 njësi)	**Bashki (61 njësi)**	**Institucion e pavarura (26 njësi)**	**Institucione grupit 87 (17 njësi)**	**Njësi shpenzue se me buxhet të madh (11 njësi)**	**Vlerësimi mesatar për çdo grup-indikator**
Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm						66%(63%)
16. Përgatitja profesionale e audituesve të brendshëm	89%	71% (20%)	89%	15%	**nuk ka të dhëna**	66%(53%)
Vlerësimi mesatar i 126 njësive	**81%**	**57%**	**81%**	**53%**	**43%**	**63%**

Indikatori 20 i llogaritur sipas udhëzimeve në Aneksin 23 con në rezultate dhe vlerësim të gabuar (mbivlerësim). I llogaritur sipas aneksit 23:

Indikatori"Kapacitetet e burimeve njerëzore të auditimit të brendshëm" =
Pozicione vakante të audituesve të brendshëm / numrin total të audituesve të miratuar në strukturën e njësisë publike (%)

Kështu nëse në njësi (bashki etj) struktura e AB-së miratohet nga titullari 2 auditues, nuk raporton vende vakante edhe pse sipas Ligjit nr. 114/2015 njësia duhet të ngrihet me 2+1 auditues, rrjedhimisht indikatori për këtë njësi llogaritet 2/2= 100% dhe vlerësohet me 30 pikë maksimale pasi sipas strukturës së miratuar nuk raportohen vende vakante.

Në këtë mënyrë indikatori nuk realizon objektivin e tij sipas Metodologjisë pika 4.1: "vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit të njësisë publike me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi". Në gjykimin e grupit të auditimit, ky indikator duhet të riformulohet për të vendosur një nivel të poshtëm "jo më pak se 3" për të nxjerrë në pah njësitë që janë në shkelje të ligjit nr. 114/2015, aq më tepër që ky është i vetmi indikator që bën vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të titullarëve të njësive publike. Pavarësisht kufizimeve në buxhet dhe kapacitete për të ngritur një NjAB me tre specialistë, njësia raportuese nuk mund të vlerësohet me pikët maksimale.

INSTITUCIONI	Plan	Fakt	Pozicione vakante	PIKET
Agjensia e Ofrimit te Sherb. Pub.te Integruara	2	2		30
Kuvendi I RSH	2	2		30
Prokurroria e Pergjithshme	2	2		30
Instituti I Statistikave	2	1	1	20
Autoriteti I Mbikqyrjes Financiare	2	2		30
Bashkia Ura Vajgurore	2	2		30
Bashkia Skrapar	1	1		30
Bashkia Klos	1	1		30
Bashkia Gramsh	1	1		30
Bashkia Prrenjas	1	1		30
Bashkia Patos	2	2		30
Bashkia Roskovec	2	2		30
Bashkia Divjakë	2	2		30
Bashkia Tepelenë	2	2		30
Bashkia Memaliaj	2	1	1	20
Bashkia Pogradec	2	2		30
Bashkia Tropoje	**2**	**2**		30
Bashkia Selenicë	1	1		30

Indikatori 19: Cilësia e raporteve të audituesve të brendshëm e përpiluar sipas Aneksit 22, në fakt plotësohet nga punonjësit e DH/AB pas leximit të 115 raporteve vjetore të dërguara nga NjAB-të. Pasi raportet shpërndahen midis 3 specialistëve, lexohen dhe në gjykimin e tyre bëhet vlerësimi në pikë sipas kësaj tabele:0 - 2% : 30 pikë / 3 - 5% : 25 pikë/ 6 - 25%:15 pikë/ 26-50%:10 pikë/ 51-75%: 5 pikë/ 76-100%: 0 pikë. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me përpunim të dhënash dhe intervalet me përqindje janë të pakuptimta. Në përmbledhje vlerësimi i këtij indikatori për 77 njësi paraqitet si vijon:

Grup- institucioni	Nr. Njësive të vlerësuara	Vlerësimi mesatar
Ministrite e Linjës	11	20
Instit. të pavarura	12	20
Grupi 87	5	21
Bashkitë	49	15
Gjithsej/vlerësim mesatar	**77**	**19**

Në gjykimin tonë përtej disa vlerësimeve në formatin dhe komponentët që duhet të përmbajë raporti vjetor do të ishte më efektive dhe eficiente kombinimi i këtij indikatori më një tregues në lidhje me nivelin e pranimit të rekomandimeve të AB-së

Në konkluzion, grupi i auditimit konkludon se përveç disa ndryshimeve pozitive me shtim të numrit të njësive të analizuara (26 institucione të pavarura dhe 11 njësi të grupit-87 në varësi të Kryeministrit), Raporti vjetor i KBFP për vitin 2017 ka mangësi në prezantim të situatës dhe në cilësi -përmbajtje. Me një mbulim ende të limituar të njësive të analizuara (10% e numrit total të njësive shpenzuese), me një analizë të thjeshtë statistikore nga ana e Drejtorive përgjegjëse e bën këtë raport të paplotë dhe jo efektiv në: 1) objektivin e tij për të "ofruar një garancie të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficente me kalimin e kohës"[56] dhe në 2) përmbushjen e përgjegjësive ligjore sipas Ligjit nr. 10 296 dt. 8.7.2010 i ndryshuar, neni 6.

Diferenca në treguesin e performancës 68% kundrejt 87% të paraqitur në raport; opinione të shoqëruar me reference të komponentëve të veçantë të MFK dhe jo të sistemit KBFP në tërësinë

[56] *Urdhëri nr.89 dt.28.12.2015 Pjesa I. Pika 2 dhe 4*

e tij; aplikimi i kritereve pikësh maksimale të ndryshme për grupe të ndryshme njësish, paaftësi për të mbledhur të dhëna të plota për të gjithë grup-indikatorët sidomos ato të në lidhje me zbatimin e Buxhetit. Mungesa e aplikimit të faktorëve të rëndësisë për indikatorë të ndryshëm dhe jo aplikimi i një mesatareje të thjeshtë do ta bënte më të lehtë dhe transparente pikat e dobëta të sistemeve të kontrollit duke rritur kështu vlerën e raportit në funksion të objektivit të tij ligjor. Gjithashtu, përpunimi tepër manual i të dhënave, ku fare mirë me kosto të brendshme mund të modernizohej të paktën në nivele funksionesh Excel-i, pa kërkuar investime shtesë (buit –in macro), kjo në përfitim të analizës, monitorimeve dhe pilotimeve me vetëm një specialist të dedikuar për përpunim të dhënash.

Në përfundim vlerësimi i risqeve të procesit të hartimit të raportit do të përmblidhej si me poshtë:

	Kriteret e auditimit	Risku	
1	Përcaktimi/ Formulimi/dizenjimi i informacionit të kërkuar	I mesëm	
2	Grumbullimi dhe procesimi I të dhënave	I mesëm	
3	Analiza dhe paraqitja e të dhënave	I mesëm	
4	Interpretimi dhe dobishmëria e të dhënave në përputhje me objektivin	I lartë	
5	Identifikimi I variancave dhe mangesive të të dhënave/informacionit	I larte	

Dy komponentët e vlerësuar me risk të lartë kanë të bëjnë me mungesën e një strategjie master- data në përpunim të dhënash; me qasjen, metodën dhe llojin e analizës, me ndryshimet strukturave të pakonsultuara dhe miratuara paraprakisht me impakt minimal në nxjerrjen e konkluzioneve të plota , transparente dhe të qëndrueshme në Raport mbi gjendjen e sistemeve të kontrollit në sistemin publik; mungesa e analizës së performuesve "më të dobët" në sistem; mungesa enjë reference dysheme në vlerësim ku kemi njësi të vlerësuara me 100 pikë nga 600 të mundshme pa asnjë shpjegim dhe masa konkrete ndaj titullarit të tyre dhe pasi vetë Ligji nr. 10296 nuk parashikon masa organizative apo disiplinore në lidhje me ngritjen, funksionimin e sistemeve të kontrollit.

- Mbi procesin e rishikimit dhe miratimit të raportit vjetor KBFP për vitin 2017 në zbatim të Ligjit nr. 10296 dt. 8.7.2010 i ndryshuar, neni 28 i tij.

Verbalisht është konfirmuar se draft-Raporti është kaluar për shqyrtim në Bordin e Mbikëqyrjes së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik më 24.5.2018. Grupi i auditimit ka kërkuar të na vihen në dispozicion minutat e mbledhjes së Bordit; relacioni i dërguar te Nëpunësi i Parë Autorizues; dhe vërejtjet dhe sugjerimet e mundshme të ardhura prej saj në zbatim të Ligjit nr. 10296, neni 7 pika2 dhe neni 26. Asnje nga këto dokumente nuk na ja në vënë ende në dispozicion.

Aneksi nr. 4: Mbi rolin e DH/AB në zbatim të Ligjit nr. 114/2015 dhe nr. 10296 i ndryshuar në lidhje përgjegjësinë sipas nenit pika a) zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizuar në fushën e auditimit të brendshëm publik, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar;

Në lidhje me shkallën e profesionalizmit:

Në raportin vjetor të KBFP për njësitë e qeverisjes së përgjithshme gjejmë të cituar faktin se 10 njësi kanë drejtues të pacertifikuar por asnjë iniciativë apo tërheqje vëmendje për titullarët e njësive përkatëse. Nga evidencat del si ky numër është edhe më i lartë: 15 njësi, përfshi këtu dhe njësitë e krijuara me 1 auditues në strukturë, apo 2 specialistë+1 përgjegjës apo 1 specialist+1 përgjegjës ku asnjë auditues i punësuar nuk është i çertifikuar:

Institucioni	Nr. Audituesve	Nr. Audituesve	Nr. Audituesve të	Nr. Audituesve	Nr. Audituesve

	Plan	Fakt	paçertifikuar	në proces	të çertifikuar
Spitali Shefqet Ndroqi Tirane	3	2	2		0
Spitali Rajonal Fier	1	1	1		**0**
Spitali Rajonal Shkoder	1	1		1	0
Ujësjellës Kanalizime Pogradec	1	1	1		0
Bashkia Ura Vajgurore	2	2	1	1	0
Bashkia Kucove	3	3	3		0
Bashkia Skrapar	1	1	1		0
Bashkia Klos	1	1	1		0
Bashkia Shijak	3	3	2	1	0
Bashkia Prrenjas	1	1	1		0
Bashkia Divjakë	2	2	1	1	0
Bashkia Kolonje	**3**	**3**	**1**	**2**	**0**
Bashkia Tropoje	2	2		2	0
Bashkia Vau Dejes	3	3	2	1	0
Bashkia Selenicë	1	1		1	0

Të gjitha këto njësi janë në shkelje të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 11 pika b[57]. Në rang kombëtar, sipas evidencave të vëna në dispozicion nga DH/AB rezulton se me rritjen e numrit të njësive AB të ngritura niveli i audituesve të çertifikuar ka rënë nga 90% në 77% në dy vitet e fundit ndërkohë që aktualisht në proces çertifikimi janë 56 audites të punësuar dhe jashtë sektorit publik janë aktualisht rreth 1600 audites të çertifikuar (1911[58] audites të çertifikuar nga të cilët vetëm 308 të punësuar në sektorin publik). Kjo flet për qarkullim të shpeshtë të stafit të AB , punësimin vetëm për efekt të plotësimit të kriterit të çertifikimit apo emërimeve dhe largimeve politike.

Përshkrimi/Vitet	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**
Numri i njësive të auditimit	106	100	103	112	119
Pozicione të auditimit të plotësuara (në %)	95%	93.9%	92%	93%	93%
Audites aktual të certifikuar (në %)	85%	82.9%	90%	76%	77%
Trendi (+/-)		-2%	8%	-18%	1%

Në lidhje me kontrollin dhe sigurimin e cilësisë: DH/AB shprehet raport se "*...Përveç vlerësimit të jashtëm të cilësisë, vlerësimet e brendshme janë një element shumë i rëndësishëm i cili siguron monitorimin dhe mbikqyrjen e punës së audituesve në vijimësi.* DH evidenton*: se 40 njësi AB ose **30%** e sistemit AB nuk garantojnë sigurojnë kontrollin e vlerësimin e cilësisë"*. Nga shqyrtimi i evidencave të vëna në dispozicion rezultojnë 22 njësi me 1 audites dhe 26 njësi me 2 audites pra gjithsej 48 njësi të ose **40%** e sistemit AB janë në shkelje të Ligjit nr. 114/2015 dhe funksionojnë dhe nuk garantojnë kontrollin e brendshëm të cilësisë. Në vijim, grupi i auditimit ka shqyrtuar evidencat duke marrë në konsideratë dhe faktorin "*aftësi dhe kapacitete profesionale*" ku evidentojmë se për 15 njësi që vërtetë plotësojnë kriterin ligjor 2+1 të audituesve të punësuar por raporti: audites të paçertifikuar kundrejt numrit total audituesish është 40% mbi 1/3 sipas kriterit ligjor. Këto njësi jo vetëm që janë në shkelje të VKM nr.83 dt.3.2.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", por duhen të merren në konsideratë kur flasim për vlerësim të cilësisë së auditimit dhe

[57] Ligji nr.114/2015, neni 11, pika 2.b) drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i certifikuar si "Audites i brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si audites i brendshëm ose i jashtëm;

[58] Sipas rregjistrit të Audituesve të Certifikuar të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

eficensën e tij. Shumë nga këto njësi raportojnë një realizim plani 100-200% por me tregues perfomance tepër të dobët si psh: përqindja mesatare e zbatimit të rekomandimeve prej 36% dhe gjetje në vlerë prej 17 milion lekë në total për të 15 njësitë.

Institucioni	**Nr. AB Fakt**	**Të çertifikuar**	**% e AB të paçertifikuar**	**Auditime të kryera**	**% Realizimit**	**Gjetje në vlerë**	**Rekomandime 2017**	**% zbatimit**	**Kosto e auditimeve[59]**
K. shaTiranë	4	2	**50%**	**11**	85%	-	47	89%	14,307
O. sha	23	15	35%	19	90%	-	417	15%	24,711
Ujesjellës Kanalizime Tiranë	3	1	67%	12	120%	-	131	64%	15,607
Ujesjellës Kanalizime Shkodër	3	1	67%	7	117%	-	72	32%	9,104
Bashkia Kucovë	3	0	100%	6	120%	1,591	0	0%	7,804
Bashkia Dibër	3	1	67%	8	100%	-	14	0%	10,405
Bashkia Mat	3	1	67%	12	171%	464	15	93%	15,607
Bashkia Shijak	3	0	100%	4	80%	95	25	100%	5,202
Bashkia Krujë	3	1	67%	6	100%	895	30	67%	7,804
Bashkia Dropull & Libohove & Finiq	4	2	50%	21	100%	10,199	36	100%	27,313
Bashkia Kolonjë	3	0	100%	28	200%	3,107	11	0%	36,417
Bashkia Kukës	3	1	67%	7	58%	-	59	14%	9,104
BashkiaVau Dejes	3	0	100%	9	75%	884	93	6%	11,705
Bashkia Malësia e Madhe	3	1	67%	14	175%	-	13	8%	18,208
Bashkia Mirditë	4	1	75%	4	100%	-	39	77%	5,202
Bashkia Vorë	4	4	0%	5	42%	-	0	0%	6,503
Total	**72**	**31**	**43%**	**173**	**108%**	**17,235**	**1002**	**36%**	**225,004**

Raste të tilla si:

1) K. sha me asnjë gjetje në vlerë nga auditi i brendshëm ndërkohë që nga raporti i auditimit të KLSH vetëm vlera e një gjetje me dëm ekonomik në një marrëdhënie kontraktore është 41.5 milion lekë ose mbi dyfishin e gjetjeve të 15 njësi AB së bashku,
2) Bashkia Kuçovë, Vorë me zero rekomandime në dy vjet,
3) Bashkia Kolonjë, me realizim 200% të planit të auditimit por vetëm me 11 rekomandime që do të thotë që ka patur dhe auditime me as edhe 1 (një) gjetje dhe rekomandim. Fakti që kjo njësi ka kryer 28 auditime në 12 muaj koha mesatare për një auditim ka qenë 0.4 muaj pra në më pak se 10 ditë. Lind pyetja a kanë qënë këto angazhime auditimi apo inspektime?
4) Bashkia Dibër me 0% rekomandime të zbatuara**,**
5) Bashkia Malësia e Madhe në 14 auditime (175% realizimi plani) ka dhënë gjithsej 13 rekomandime pra më pak se 1 (një) rekomandim për auditim dhe për më tepër raporton vetëm 1 (një) të zbatuar**.**

Raste të tilla si më lartë, duhet të silleshin në vëmendje në Raportin vjetor të KBFP dhe të paraqiteshin në analizë dhe opinion me profesionalizëm dhe transparencën e duhur në funksion të zbatimit të përgjegjësisë ligjore që kjo drejtori ka për përpilimin e këtij raporti.

[59] Kosto /auditim 1,300.6 mije lekë referuar Planit Strategjik 2017-2019

Në përfundim, nëse këto 15 njësi ku efiçensa tepër e ulët është evidente, i shtohen numrit të njësive më lartë të raportuara si njësi që nuk garantojnë sigurimin e cilësisë së auditimit e çojnë në 63 njësi apo **53% të sistemit të AB ku sistemi i sigurimit të cilësisë mungon ose nuk funksion rrjedhimisht ky sistem është ineficent.**
E llogaritur mbi bazën e kostos mesatare për një audites sipas Planit Strategjik 2017-2020: 1300.6 lekë, **totali i kostos së auditimeve të kryera nga njësitë e mësipërme është 26,012 mijë lekë dhe treguesi i dobishmërisë së auditimit do të ishte 0.18 lekë / 1 lekë të shpenzuar** (duke supozuar se dëmet e vlerësuara janë të arkëtueshme).

Për më tej njësitë AB si vijon kanë kryer zero aktivitet për gjatë vitit 2017 me një numër punonjësish prej 12 vetë:

NR	INSTITUCIONI	Nr. AB fakt	I pa certifikuar	Plan	% realizimit planit	Paga bruto vjetore e përllogaritur në mijë lekë
1	Universiteti i Tiranës	1		**5**	0%	780
2	Universiteti Politeknik i Tiranës	1		**4**	0%	780
3	Fondi Shqiptar I Zhvillimit	2	1		0%	1,560
4	Spitali Rajonal Elbasan	1		**5**	0%	1,560
5	Spitali Rajonal Fier	1	1	**6**	0%	1,560
6	Spitali Rajonal Korce	1			0%	1,560
7	Spitali Rajonal Berat	1			0%	1,560
8	Bashkia Klos	1	1	**0**	0%	1,560
9	Bashkia Prrenjas	1	1	**7**	0%	1,560
10	Bashkia Tropoje	2[60]		**4**	0%	3,120
		12			**0%**	**16,380**

Struktura përgjegjëse për monitorimin e sistemit AB, me një staf prej 4+1 punonjësish, përtej statistikave të konsoliduara të planeve strategjike dhe përpilimit të indikatorëve, nuk ka një analizë dhe pamje të plotë se si funksionojnë këto struktura për të evidentuar nëse këto funksione pjesë e njësive shpenzuese kryejnë aktivitetin e tyre me efektivitet e eficensë dhe janë vlerë e shtuar për njësinë dhe titullarin përkatës. Në raportin vjetor të sistemit KBFP për vitin 2017 DH konkludon me opinionin se;" *Shërbimi i auditimit të brendshëm nuk shtrihet në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, aktualisht kjo problematikë vërehet në institucionet e pavaruara, njësi publike në varësi të Kryeministrisë dhe në disa bashki…Vihet re interesi në rritje i punonjësve të rinj për tu punësuar në strukturat audituese. Kjo shihet si një frymë e re, e përshtatur me zhvillimet teknologjike dhe energjinë që karakterizon brezat e rinj. Ata janë një gjeneratë e re që në bashkëpunim me audituesit me përvojë do të realizojnë në të ardhmen nivel gjithnjë e në rritje të cilësisë së punës audituesve",* nuk është serioze që në vend të theksimit të çështjes së ekzistencës të strukturave të ngritura në shkelje të ligjit, të punësimit në shkelje të ligjit me tregues performance tepër të dobët dhe totalisht ineficente, flitet për të si një çështje politikash punësimi për brezat e rinj.
I menaxhuar në mënyrë efektive, auditimi i brendshëm bëhet një element i rëndësishëm për të ndihmuar një njësi të arrijë objektivat e saj. Njësitë publike që kanë të ngritur strukturën e auditimit të brendshëm janë më të aftë të identifikojnë rreziqet e biznesit dhe joefikasitetin e sistemit, të ndërmarrin veprime korrigjuese të përshtatshme dhe në fund të fundit të mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm. Megjithatë, për të ruajtur dhe përmirësuar kredibilitetin e auditimit të brendshëm, këto njësi duhet të monitorohet për efikasitetin dhe eficensen e tyre.
DH/AB në mënyrë të menjëhershme duhet të analizojë me profesionalizëm dhe në thellësi çështjen e efektivitetit dhe eficensës së njësive AB dhe të reflektojë këtë analizë dhe rezultatet e

[60] *2 punonjësit janë në proces certifikimi*

saj në opinionet e dhëna në raportin vjetor të KBFP. Është e rëndësishme që aktiviteti i auditimit të brendshëm të marrë reagime nga palët kyçe të interesit mbi efektivitetin e auditimit dhe të bëjë rregullime të nevojshme dhe ti përcjellë tek të gjitha njësitë e AB dhe jo vetëm tek ato njësi që kanë qënë pjesë e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.
DH/AB në rolin e saj si harmonizuese e metodologjive dhe monitoruese e sistemeve KBFP ku një nga shtyllat është AB, duhet menjëherë të rishikojë metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik për komponentin AB, për t'u marrë në konsideratë matës relevant sasior dhe cilësor të efektivitetit dhe efiçencës.

Në lidhje me pavarësinë e strukturës AB dhe audituesit të brendshëm: Si një tregues tepër i rëndësishëm i cilësisë së auditimit dhe eficensës së strukturës së AB, gjatë auditimit është shqyrtuar Ligji për Auditin e Brendshëm në sektorin publik" dhe Ligji nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe përmirësimet që këto ligje kanë pësuar me ndryshimet e bëra gjatë vitit 2015. Një përmbledhje e neneve kryesore ku në gjykimin tonë cënohet apo rregullohet pavarësia e strukturës së AB është paraqitur në tabelën në vijim:

Ligji 114/2015 AB dhe Ligji 10296 MFK i ndryshuar	**Ligji nr. 9720/2007**	**Komenti i audituesit**

Neni 23: Përgjegjësitë e **Ministrit të Financave**. Për të ushtruar këto përgjegjësi, Ministri i Financave mbështetet nga **Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik** dhe **struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB** në Ministrinë e Financave Neni 24 Përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB: a) zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizuar në fushën e AB, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar; b) harton dhe propozon përmirësimin e legjislacionit kryesor dhe mbështetës për AB në sektorin publik; c) harton dhe propozon politikat, manualet, procedurat, udhëzimet dhe rregulloret për AB për përshtatjen dhe përafrimin e tyre me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të AB; ç) përgatit dhe administron planin e konsoliduar strategjik e vjetor të veprimtarisë së AB në njësitë publike; dh) harton dhe zbaton manualin për vlerësimin e cilësisë, e cila përfshin procesin e monitorimit dhe vlerësimit në **mënyrë periodike** të veprimtarisë së njësive të AB, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të AB; e) administron metodat e hartuara, në mbështetje të manualit të auditimit, për fusha specifike të AB të paraqitura nga njësitë e AB; ë) analizon rekomandimet e dhëna në raportet vjetore të njësive të AB; Ligji 10296 Neni 28 **Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik**. Në Ministrinë e Financave ngrihet Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, me detyrën e mbikëqyrjes së çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin **dhe auditimin e brendshëm**, në sektorin publik.	Neni 12 **Statusi i Komitetit:** Komiteti i AB është organ këshillimor pranë Ministrit të Financave. Komiteti propozon dhe këshillon për përcaktimin e strategjive dhe përmirësimin e veprimtarisë së AB, në sektorin publik. Neni 13: **Detyrat e Komitetit** janë: a) përgatitja dhe dhënia e vlerësimeve e të mendimeve për metodat e AB, të propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit; b) vlerësimi dhe dhënia e mendimeve për kuadrin, ligjor dhe rregullator, të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit në fushën e AB, në sektorin publik; c.vlerësimi dhe dhënia e mendimeve për raportet, tremujore dhe vjetore, të veprimtarisë së AB në subjektet e audituara, të paraqitura nga ***Njësia Qendrore e Harmonizimit për AB;*** ç)këshillimi i Ministrit të Financave dhe ***Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm*** në të gjitha aspektet e planeve dhe të punës së AB, në përshtatjen e praktikave ndërkombëtare të auditimit, në cilësinë dhe funksionimin e AB në subjektet e audituara	Ndryshimi ligjor që shkrinte Komitetin e Auditimit të Brendshëm në rang sistemi kaloi përgjegjësinë e krijimit të Komiteteve të Auditimit te cdo njësi individuale si kompetencë e titullarit. Kjo me qëllimin e synuar të **rritjes së eficensës** së strukturës së KAB dhe rolin e saj si mbështetëse e NjAB për të siguruar **pavarësinë dhe shmangien e konfliktit të interesit.** Por në të njëjtën kohë me ligjin vitit 2015 duket që një pjesë e funksioneve të KAB i kanë kaluar Bordit të KBFP I ngritur me anëtarë që kryejnë funksione operacionale në lidhje me AB. Vlerësimi i veprimtarisë së AB në ligjin e ri është kufizuar në vetëm 1 raportim, atë vjetor.
Neni 11 punësimi i audituesit të brendshëm bëhet në përputhje me dispozitat e punësimit të nëpunësit civil dhe kodit te punës		Vendimmarrje e titullarit
Neni 10 pika 1 ngarkohen njësite publike te krijojnë shërbimin e AB		Përgjegjësi e titullarit
Neni 10 pika 2 njësia e auditimit të brendshëm është e pavarur dhe raporton te titullari.		Konflikt interesi; punësim-raportim.
Neni 12 përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike. Ata janë përgjegjës për krijimin e njësive të auditimit, vendimmarrjen për politikat dhe strategjinë e auditimit		Titullari miraton/aprovon planin e auditimeve
Neni 16 pika ë: Përgjegjëse e audituesit të brendshëm: raporton te drejtuesi i njësisë së auditimit nëse vëren parregullsi apo veprime që përbëjnë vepër penale.		

Në përfundim, konkludojmë se ndryshimet dhe përmirësimet ligjore kanë forcuar dhe theksuar kompetencat e titullarëve për shërbimin e auditimit të brendshëm por nuk sigurojnë pavarësinë, cilësinë e auditimit rrjedhimisht ngritjen e një strukture eficente dhe efektive në shërbim të mirëmenaxhimit të fondeve publike. Shkrirja e një strukture të përgjithshme si Komiteti AB dhe krijimi i një Bordi KBFP me aktivitet tepër minimal, me struktura në vetvete me konflikte të funksioneve operacionale dhe mbikëqyrëse nuk siguron pavarësinë e strukturave AB. I mbështetur me strukturën e DH/AB sistemi AB monitorohet me akord vetëm për efekt të përpilimit të Planit të konsoliduar strategjik (Nëndor-Dhjetor) dhe për efekt të përpilimit të Raportit vjetor të KBFP (shkurt- maj).

Në lidhje me objektivine e Strategjisë për MFP 2014-2020: Në strategjinë për menaxhimin financiar publik 2014-2020 përcaktohet objektivi: Mirë-funksionimi dhe funksioni efikas i AB-së në sektorin publik. Për matjen e progresit në arritjen e objektivit janë ërcaktuar treguesi i rezultateve si vijon:
- Përqindja e rekomandimeve të zbatuara të auditimit të brendshëm;
- Numri i pjesëmarrësve në trajnime për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të audituesve të pavarur në vit, kundrejt numrit të pjesëmarrësve në trajnime për program certifikimi;
- Raportet e AB-së trajtojnë probleme/të meta në sistemet e kontrollit të brendshëm;
- Raporti vjetor i NJQH/AB-së mbi zhvillimin e auditimit të brendshëm tregon progres në cilësinë e auditimit të brendshëm;

Gjithashtu deri në vitin 2018 në këtë strategji është parashikuar që DH/AB do të krijojë një rrjet të Drejtuesve të Njësive të Auditimit të Brendshëm. Këta të fundit supozohet të ndajnë përvojat dhe ky është një instrument për DH/AB që të identifikojë probleme dhe zgjidhje praktike, të cilat mund të përbënin kontribute për programin vjetor të trajnimit. Rrjeti supozohet të takohet rregullisht. Drejtuesit e DH/AB e zotërojnë rrjetin. Në fazën fillestare, DH/AB do të jenë iniciuesi i mbledhjeve por pas disa kohësh ai do të drejtojë vetëm rrjetin.
Përhapja e njësive AB të krijuara dhe rastet e punësimit të drejtuesve AB, në shkelje të ligjit për auditin e brendshëm nr. 114/2015 dt. 22.10.2015 dhe VKM nr. 83 dt. 3.2.2016 për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të AB çon në konkluzionin se struktura aktuale e AB është ineficente me mungesë të theksuar të kontrollit të cilësisë dhe pavarësisë evidentuar sa me lartë. Kjo situatë kërkon vëmendjen e menjëhershme të Bordit dhe strukturës DH/AB për të bërë analizë dhe propozime konkrete për përmirësime ligjore në funksion të shndërrimin e të sistemit AB në një vlerë e shtuar për sektorin publik dhe jo për tja lënë në dorë çdo gjë ndërgjegjësimit të titullarëve nëpërmjet trajnimeve. Këto përmirësime duhet të prekin komponentët:
- e përgjegjësisë së titullarit për krijimin e njësisë AB në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Veçanërisht për njësitë e qeverisjes vendore që shpesh janë njësi të vogla me pamundësi për të ngritur NjAB me tre punonjës të merret në konsideratë bashkimin dhe krijimi i njësive të AB në rang qarku me staf të mjaftueshëm dhe hierarkik që siguron pavarësinë, objektivitetin dhe cilësinë e auditimit.
- kriteret e punësimit duke ndryshuar(ulur) raportin 1/3 të audituesve të pacertifikuar për të shmangur emërime të AB pa eksperiencën e duhur, shpesh vetëm për qëllim të plotësimit të kriterit për të marrë certifikatën e AB apo të emërimeve formale "me komandim" për një periudhë të përkohshme.
-parashikimin e dispozitave shtrënguese si masa disiplinore dhe organizative në funksion të zbatimit të Ligjit 114/2015 dt. 15.5.2010 dhe Ligjit 10296 dt. 8.7.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 dt. 22.10.2015
- forcimi i kompetencave të Bordit të KBFP dhe vetë Drejtorisë së Harmonizimit të AB për një monitorim me impakt real në zhvillimin dhe administrimin e strategjive të sistemit AB në përputhje me kërkesat ligjore dhe strategjinë e MFP 2014-2020.